

RAZI BRAHMI

LETTERSIA
DHE ARTE
NE DRITEN
E PARTISE

çm 9024

RAZI BRAHIMI

LETËRSIA DHE ARTET
NË DRITËN E PARTISË

Pjetrit
Zorlu.

Tiranë
« 29. V. 1975 »
~~~~~

KJO VEPËR FITOI ÇMIM TË PARË NË KONKURSIN  
LETRAR-ARTISTIK TË 30-VJETORIT TË ÇLIRIMIT.

## P A R A T H È N I E

Kultura socialiste dhe letërsia e artet e realizmit socialist në Shqipëri janë krijuar dhe po zhvillohen nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë e sipas orientimeve të saj marksiste-leniniste. Gjat më se tridhjetë vjetëve, në kongreset dhe në mbledhje të rëndësishme të forumeve dhe të organizatave të saj, në dokumenta të përgjithshme e të posaçme, PPSH, e mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit dhe në përvojën kulturore-artistike kombëtare e botërore, ka përpunuuar pothuajse të gjitha problemet themelore të krijimtarisë letrare e artistike dhe ka dhënë për secilën prej tyre një mendim shkencor, të kthjellët, të përcaktuar dhe luftarak revolucionar. Prandaj sot është e pamundur që të merresh me studimin e letërsisë e të arteve tona dhe përgjithësisht me zështjet e letërsisë e të arteve pa njohur në themel dokumentat e rëndësishme të PPSH dhe veprat e shokut Enver Hoxha, që janë një plotësim i parimeve të estetikës marksiste-leniniste dhe një konkretizim dhe zbatim krijuar i tyre në kushtet e sotme të ndërtimit të socializmit dhe të luftës kundër imperializmit dhe revisionizmit.

Orientimet e PPSH për letërsinë dhe artet kanë qenë kurdoherë të mbështetura në botëkuptimin marksist-leninist, në mësimet e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit si dhe në mendimin estetik marksist-leninist të përpunuuar nga lëvizja komuniste botërore, prandaj, në çdo kohë e në çdo situatë ato kanë ruajtur një karakter të theksuar revolucionar dhe kanë qenë garanci kryesore për zhvillimin e letërsisë e të arteve tona në

Redaktor: ISUF NELAJ

Kopertina nga: SVETLLANA STRAZIMIRI

Tirazhi 6.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike

Shtypshkronja «8 NËNTORI» Tiranë, 1975

rrugën e realizmit socialist, që është metoda krijuar e përparuar.

Në luftë me oportunistët e çdo kallëpi dhe sidomos me revizionistët e sotëm, mendimi estetik marksist-leninist i PPSH ka patur kurdoherë karakter të theksuar militant, ka mbrojtur parimet e estetikës marksiste-leniniste dhe ka qënë kontribut me rëndësi në zhvillimin e saj të mëtejshëm, duke e pasuruar me eksperiencën e luftrës së gjatë, të vazhdueshme e të ndërlikuar, që po zhvillohet në kohën tonë në fushën e ideologjisë, të kulturës, të artit e të mendimit estetik.

Si në të gjitha fushat e tjera edhe në atë të artit e të mendimit estetik, orientimet e PPSH dhe veprat e shokut Enver Hoxha kanë një vazhdimësi të pandërprerë, që shpreh qart e bukur vetë vazhdimësinë, thellimin dhe marshimin fitimtar të revolucionit në të gjitha sferat e jetës e, veçanërisht, në sferën e ideologjisë e të kulturës. Sidomos që nga Kongresi I i PKSH (sot PPSH) e deri në ditët tona ka ardhë kurdoherë duke u shtuar interesimi për letërsinë dhe artet, është përpunuar e detajuar mendimi për to, janë zgjeruar caqet e problemeve që kanë tërhequr vë-mendjen, është thelluar trajtimi teorik i çështjeve, po kurdoherë ka mbetur po ai qëndrim i përcaktuar revolucionar, po ajo pozitë e patundur marksiste-leniniste, që ka karakterizuar edhe orientimet dhe vendimet më të hershme. Vetë pasurimi i përvojës historike të Partisë, zhvillimi i madh i kulturës dhe i arteve dhe ballafaqimi aktiv me praktikat dhe teoritë borgjeze e revizioniste të kohës sonë kanë bërë që edhe tezat e parashtruara më parë në formë të përgjithshme për problemet e artit e të letërsisë të shtjellohen më gjërësisht dhe të analizohen deri në hollësi për t'u bërë kështu mbështetje të sigurta për lulëzimin e artit e të letërsisë së realizmit socialist dhe armë të mprehta në luftë kundër dekadentizmit e formalizmit të artit e të mendimit estetik borgjez e revizionist. Veprat e shokut Enver Hoxha për artin e për letërsinë zënë një vend me rëndësi të veçantë në thesarin e mendimit estetik marksist-leninist.

Kur ndodhet njeriu para dokumentave të shumta të

PPSH për letërsinë dhe artet e shikon qartë se nuk ka asnje problem të tyre me rëndësi, që të mos ketë tërhequr vëmendjen dhe, për çdo problem të trajtuar në këto dokumenta dhe në veprat e shokut Enver Hoxha, si krijuarët e studiuesit e letërsisë e të arteve, jo vetëm që gjejnë përgjigje për shqetësimet e tyre dhe orientohen në krijimtari e në punën studimore, po duke u njohur me to, shikojnë edhe më mirë ç'fushë të gjërë e të rëndësishme pune kanë përparrë tyre, ç'perspektiva çelen për lulëzimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve të realizmit socialist dhe përfugimin e mendimit teorik e kritik, për krijimtarinë letrare e artistike. Prandaj njohja e thelle e deri në imtësi e orientimeve të PPSH dhe e veprave të shokut Enver Hoxha, krahas përvetësimit të bazave të botëkuptimit e të estetikës marksiste-leniniste, mbetet një detyrë e përhershme për çdo shkrimtar, artist, studjues dhe kritik të letërsisë e të arteve, një siguri e madhe për sukseset e tyre të ardhshme.

Në librin që po i paraqitet lexuesit është bërë përpjekja fillestare për të trajtuar disa prej problemeve aktuale të letërsisë e të arteve të realizmit socialist nën dritën e orientimeve të Partisë dhe mësimëve të shokut Enver Hoxha, pa pretenduar se është përfshirë gjithë gjenerësia e çështjeve që janë shtjelluar në këto orientime. Qëllimi ka qenë jo aq për t'i trajtuar problemet për rrerethet e specialistëve e të studjuesve, sa për të bërë ndonjë shënim të dobishëm për masën e dashamirëve të letërsisë e të artit dhe për ata të rinj, që sapo hedhin hapat e para në krijimtarinë letrare e artistike dhe në kritikë. Se sa i është arritur këtij qëllimi kjo i përket lexuesit ta thotë.

## KREU I PARË

Partia e Punës e Shqipërisë është arkitektia e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Që prej themelimit të saj, më 8 Nëntor 1941 e deri në ditët tona, duke ndjekur hap pas hapi zhvillimin dhe shndërrimet revolucionare në jetën e popullit, ajo, me pikësynime dhe ideale të largëta të përcaktuara, ka orientuar dhe ka projektuar ndërtimin e shoqërisë socialiste e mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit, në unitet të plotë mendimi dhe veprimi me popullin, të cilin e ka udhëhequr në rrugën revolucionare të klasës punëtore.

Partia në krye të masave punonjëse, realizoi çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë dhe nga shtypja e egër e klikave feudo-borgjeze, u dha tokën fshatarëve dhe shoqërizoi mjetet e prodhimit, krijoi shtetin e diktaturës së proletariatit dhe e ka kthyer Atdheun tonë nga vendi më i prapambetur i Evropës, siç ishte dikur, në një vend me ekonomi të zhvilluar socialiste, me kulturë të përparuar revolucionare, me mbrojtje të çeliktë.

Përvoja e pasur e luftës së PPSH dhe veprimitaria e saj për mbrojtjen dhe zhvillimin krijues të marksizëm-leninizmit në ndeshje të hapëta, të ashpra dhe heroike me revisionistët e qdo ngjyre, ka marrë rëndësi ndërkombëtare dhe është bërë burim frysëzimi për të gjithë ata që luftojnë për çlirimin kombëtar e shoqëror, për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e fitoreve të tij. Mendimi i kthjellët revolucionar i PPSH është bërë pjesë me rëndësi e thesarit të madh të kulturës më të përparruar botërore.

PPSH gjatë gjithë veprimitarisë së saj i ka kushtuar

vëmendje të posaqme ngritjes së nivelit arsimor, kulturor dhe estetik të popullit. Në etapa të ndryshme të jetës së vet ajo ka shtruar dhe ka zgjidhur probleme me rëndësi të zhvillimit të kulturës, që nga lufta kundër analphabetizmit, organizimi i lëvizjes artistike diletante, puna propagandistike e kulturore dhe krijimi i shtypit revolucionar në vitet e Luftës Nacionallirimtare, deri në orientimet e sotme me rëndësi historike për themlin e mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kulturor. Partia ka ditur të frymëzojë, të orientojë, të organizojë dhe të udhëheqë me urtësi dhe largpamje leniniste masat e popullit dhe njerëzit e kulturës e të artit në veprimtarinë e madhe të krijimit të kulturës e të artit revolucionar socialist, duke zgjidhur njëra pas tjetës, në pajtim me kushtet konkrete, probleme me rëndësi historike. Ajo është mbështetur kurdoherë në mendimin krijues të njerëzve të kulturës e të artit dhe ka tërhequr masat në përpunimin e vijës së saj, prandaj kjo vijë është përqafuar kurdoherë me entuziazëm dhe është realizuar me sukses të plotë, si në çdo fushë tjeter, edhe në fushën e kulturës e të artit.

## 1

Zhvillimin e arsimit, të kulturës dhe të artit PPSH nuk e ka parë kurrë si diçka më vete, si një qëllim të veçantë apo të pavarur, që mund të arrihet ndarë zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë dhe pavarësisht nga ky. Përkundrazi. Në çdo etapë të revolucionit socialist vihet re se problemet e kulturës e të artit janë trajtuar *në vartësi* dhe në funksion të shndërrimit socialist të jetës, mbasi pa luftën revolucionare, pa depërtimin e marksizëm-leninizmit në të gjithë jetën e vendit, pa ndërtimin e socializmit, nuk mund të bëhej fjalë as përpërparimin e kulturës e të artit e aq më pak për krimin e një kulture e të një arti revolucionar popullor. Vetëm zgjidhja e detyrave themelore historike të çliri-

mit kombëtar, të vendosjes së marrëdhënieve socialiste në prodhim, të krijimit të shtetit të diktaturës së proletariatit, të zhvillimit të ekonomisë popullore dhe sigurimit të udhëheqjes së Partisë në të gjitha fushat e jetës do të bënin dhe kanë bërë të mundur përpërparimin e kulturës kombëtare, ngritjen e nivelit arsimor dhe kulturor të popullit dhe lulëzimin e artit të realizmit socialist. Nga ana tjeter, kultura dhe arti, që u krijuan prej revolucionit nuk mund të ishin veçse një kulturë dhe një art revolucionar, në shërbim të popullit, pjesë përbërëse e gjithë veprimtarisë revolucionare të masave punonjëse të udhëhequra nga Partia. Ato do të luanin një rol vepruesh për edukimin komunist të punonjësve, për forcimin e ndërgjegjes shoqërore socialiste, për krimin e njeriut të ri me botëkuptim, me moral dhe me qëndrim të ri ndaj jetës, për të mirën dhe për kënaqësinë e popullit.

Krimi i kulturës kombëtare socialiste dhe fitorja e realizmit socialist në letërsi dhe në arte janë suksese me rëndësi të ndërtimit të socializmit në Shqipëri, që janë arritur vetëm duke ndjekur me konsekuençë mësimet e marksizëm-leninizmit. Përndryshe, ose kultura, letërsia dhe artet do të vazhdonin të mbeteshin pronë e klasave të dikurshme shfrytëzuese, stoli e «njerëzve të zgjedhur» dhe të huaja për masat e gjera të popullit, ose, edhe pasi të kishin arritur disa suksese në transformimin e tyre socialist, do të degjeneronin më vonë, siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të Evropës Lindore. Si përvoja janë pozitive, edhe përvoja e degjenerimit borgjez të kulturës e të artit në vendet ku sunojnë klikat revisioniste provojnë se kultura dhe artet janë në vartësi të orientimit të përgjithshëm ideologjik e politik dhe janë-përdorur e përdoren kurdoherë si armë në luftën e klasave. Në rastin tonë kultura dhe arti përdoren si armë për ndërtimin e socializmit, për ngadhnjimin e marksizëm-leninizmit, për edukimin komunist të punonjësve, ndërsa në rastin tjeter, ato janë kthyer në armë të kundërrevolucionit, të përhapjes së ideologjisë borgjeze dhe po kultivojnë subjektivizmin, indivi-

dualizmin dhe shpirtin anarqik mikroborgjez. Koha ka provuar se revisionistët i kanë përdorur diskutimet dhe «eksperimentet» në fushën e kulturës e të artit si prelud të ndërrimeve kundërrevolucionare në drejtimin ideo- logjik dhe në vijën politike. Një gjë të tillë e provuan ngjarjet kundërrevolucionare të vitit 1956 në Hungari dhe në Poloni e, pastaj edhe në disa vende të tjera dikur socialiste. Prandaj është e qartë se pa një vijë revolucio- nare ideolegjike e politike nuk mund të ketë kulturë dhe art revolucionar dhe, nga ana tjetër, vetëm një kulturë dhe një art i frymëzuar ngajeta, nga lufta dhe nga puma ndër- timtare e popullit, i përshtuar nga ideologjia marksiste-le- niniste, mund të janë kulturë dhe art me të vërtetë re- volucionar e, për këtë arsy, edhe demokratik, realist, me përbajtje të vërtetë humanitare. Veprimitaria kri- juese e njerëzve tanë të kulturës e të artit e provon plo- tësish këtë të vërtetë historike. Ata, nën udhëheqjen e Partisë, kapercyen me sukses traditën negative të kul- turës e të artit feudal e borgjez, luftuan me vendosmëri kundër liberalizmit borgjez dhe pikëpamjeve oportu- niste të Sejfulla Malëshovës me shokë, përballojnë pre- zisionin ideolegjik imperialist e revisionist dhe janë he- dhur në sulm kundër tij, duke forcuar gjithnjë e më shumë pozitat e partishme të kulturës e të artit të realiz- mit socialist.

Në orientimet dhe në veprimitarinë praktike të PPSH dhe të organeve të Pushtetit Popullor vihen re, krahas kujdesit për zhvillimin, përparimin dhe përhapjen e kul- turës e të artit, edhe pikësynimet e qarta që kultura dhe arti, veprimitaria kulturore dhe artistike, krijimtaria le- trare dhe mendimi estetik e kritik, të çlironen jo vetëm prej anarshizmit mikroborgjez, karakteristikë për kultu- rën dhe artin në vendet kapitaliste e revisioniste, po edhe të përshtohen fund e krye nga idetë dhe idealet e re- volucionit socialist, të kenë një brendi të shëndoshë ideo- gjike revolucionare dhe të udhëhiqen nga motive shoqërore të rendësishme përparimtare. Kjo do të thotë, së pari, që Partia është interesuar për kultivimin dhe përhap-

jen e një kulture e të një arti *revolucionar* socialist dhe jo të çdo kulture e të çdo arti dhe, së dyti, ajo ka luftuar që krahas çlirimt të tyre prej ndikimeve feudale, borgjeze e mikroborgjeze t'i çlirojë ato edhe prej ndiki- meve negative shoqërore e psikologjike të trashëguara nga e kaluara, siç janë intelektualizmi, etja për lavdi, rendja pas fitimit, ndjekja e «modës» artistike të ve- ndeve kapitaliste etj., që ulin vlerën shoqërore të ve- primitarisë kulturore e artistike dhe mund të stimulojnë lindjen e elementit kundërrevolucionar edhe nën pet- kun e nën parrullat e artit e të kulturës socialiste.

Brendia e kulturës dhe e artit që është krijuar në Shqipëri, duke qënë thellësisht klasore dhe e partishme, nuk është as një «shpikje», as një grumbull dogmash. Ajo është vazhdim i natyrshëm i anëve më përparimta- re, më demokratike dhe më realiste të kulturës e të artit të së kaluarës njerëzore e kombëtare dhe shprehje e zhvillimit objektiv të tyre në kushtet e ndërtimit të so- cializmit. Kjo brendi e re, duke qenë më e përparuar, është në pajtim më të plotë me aspiratat e popullit e të mbarë njerëzimit. Ajo është brendia më njerëzore gjersa në themel të saj janë vënë parimet e çlirimt të gjith- anshëm të njeriut, zhdukja e çdo forme të sklavërisë, si- gurimi i lumturisë njerëzore në bazë të punës së lirë prej shfrytëzimit dhe të organizuar në mënyrë socialiste.

Ideologët dhe artistët revisionistë, kur flasin për thel- bin e brendisë së kulturës e të artit socialist pretendojnë që ajo nuk duhet të jetë «*drejtëvijëzore*» pra, nuk du- het që thelbi i saj ideolegjik të jetë i qëndrueshëm dhe të përfshijë gjithë horizontin tematik dhe shfaqjet kon- krete të veprimitarisë kulturore e artistike, mbasi, sipas tyre, një gjë e tillë do të shpinte në dogmatizëm. Ky është një prej atyre shtigjeve që përdorin revisionistët për të futur në kulturën dhe në artin socialist brendinë borgjeze. Duke bërë dallimin ndërmjet «*thelbit ideo- gjik*» dhe shfaqjeve konkrete ata vënë në kontradiktë brendinë klasore të veprave me karakterin e përgjith- shëm njerëzor dhe, në këtë mënyrë, pajtohen plotësish-

me ideologët e borgjezisë, që i drejtojnë goditjet kryesore pikërisht kundër brendisë revolucionare, në emër të një «gjerësie njerëzore» mbiiklasore. Koha ka provuar se një kontradiktë e tillë është e paqenë dhe arti më revolucionar, në të gjitha periudhat e historisë, ka qenë dhe mbetet arti më njerëzor. Kultura dhe arti socialist nuk kanë kufij në tematikën e tyre, po në trajtimin e çdo teme udhëhiqen nga botëkuptimi marksist-leninist, nga mohimi dialektik i asaj që është reaksionare, e pambetur, e vjetruar dhe nga afirmimi i të resë revolucionare, të cilës i përket e ardhmja. Heqja dorë prej kësaj pozite themelore do të shpinte në dobësimin e brendisë ideologjike revolucionare, pra, edhe të karakterit vërtetë përparimtar e humanitar, duke i dhënë shkas depërtimit të ideologjisë skllavëruese dhe degjeneruese borgjeze, që është ideologjia më çnjerëzore e kohës sonë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka ndjekur me konsekuençë vijën e krijimit të një kulture e të një arti, që t'i shërbejnë popullit. Jasht këtij kriteri themelor nuk mund të ketë art të vërtetë përparimtar. Arti i shkëputur nga populli kthehet në stoli të vdekur. Arti që vihet kundër popullit është reaksionar. Artim e vërtetë popullor mund ta krijojë vetë populli dhe shkrimitarët e artistët e dalë nga gjiri i popullit, të lidhur me popullin, që ngrihen në lartësinë e idealeve të mëdha popullore. Prandaj si nga prejardhja, si nga qëllimet të cilave u shërbën, arti ynë nuk është as vepër e një grupei njerëzish «të zgjedhur», as ka për qëllim të pasqyrojë e të kënaqëshjet e tyre subjektive. Ai krijohet nga populli, frysëzohet ngajeta e popullit dhe i drejtohet popullit. Shkrimitarët dhe artistët më të mirë janë ata që përfaqësojnë në veprat e tyre me thellësi e me gjerësi aspiratat dhe idealet e masave, duke u bërë përfaqësues dhe udhëheqës të vërtetë të tyre, sidomos në fushën e edukimit ideoartistik.

Në orientimet dhe në veprimtarinë praktike të PPSH dhe të organeve të pushtetit popullor të bie në sy menjëherë kujdesi i vazhdueshëm dhe i gjithanshëm për njëherë.

ngritjen e nivelit arsimor, kulturor dhe artistik të masave punonjëse, për veprimtarinë e tyre të drejtëpërdrejtë kulturore e artistike dhe për tërheqjen e gjykimit të tyre për letërsinë dhë artet. Hap pas hapi, duke kapërcyer vështirësi të mëdha e të shumta, është arritur që në Shqipëri, ku afro 90% e popullsisë dikur ishte analafabete, sot të jetë arsimi tetëvjeçar i detyrueshëm, të ketë një rrjetë të gjërë shkollash të mesme e të larta dhe për çdo njëmijë banorë të ketë një institucion kulturore e artistik. Po kështu, që gjatë Luftës Nacionalelli-rimtare, masat punonjëse po marrin pjesë gjithnjë e më vepruese në fushën e kulturës e të artit popullor socialist, nëpërmjet krijimit të vlerave të reja kulturore e artistike dhe veprimtarisë së qindra trupave artistike dilettante që po kënaqin gjithnjë e më mirë kërkesat e masave, zbulojnë talente, shërbejnë për vetedukimin e popullit. Për ngritjen e nivelit të përgjithshëm kulturor të popullit dhe pa pjesëmarrjen e tij në jetën kulturore e artistike të vendit nuk mund të kuptoheshin dhe as mund të arriheshin sukseset e sotme të letërsisë, të artistit, të kulturës e të shkencës. Talentet e shquara që kanë debutuar, veprat e tyre të bukura dhe ngritja e përgjithshme e nivelit ideoartistik të letërsisë e të arteve janë të lidhura ngusht me vijën e masave që ka ndjekur Partia. Në vendin tonë, duke dalë nga gjiri i popullit, shkrimitarët dhe artistët i kthejnë atij në formën e veprave letrare e artistike frymëzimet që kanë marrë prej tij, reflektojnë, në përgjithësi, shijet e shëndosha estetike popullore dhe vetëm kështu u shërbejnë masave punonjëse për të rritur nivelin e shijeve e të kërkesave artistike, duke bërë të mundur që prapë nga gjiri i popullit të dalin njerëz që do ta shpien edhe më përpara kulturën dhe artin socialist. Në këtë mënyrë roli i masave punonjëse në jetën kulturore e artistike nuk ka mbetur një parullë, po është bërë një realitet i madh historik.

Nëpër këtë rrugë të ndriçuar nga mësimet e PPSH janë zhvilluar kultura dhe artet tona, që, siç dihet, kanë arritur suksese të mëdha dhe kanë perspektiva për

një lulëzim të mëtejshëm si kulturë dhe arte të revolucionit socialist, me nivel gjithnjë më të lartë ideor e artistik.

Pas fitores së revolucionit popullor kultura dhe artet tona, nëpërmjet kalimit në pozitat revolucionare socialistë, kapercyen jo vetëm brendinë e vjetër dhe prapambetjen e trashëguar, po patën edhe një zhvillim të vrullshëm në të gjitha drejtimet, në cilësi dhe në sasi. Përveç letërsisë, që kish njohur vepra të shquara edhe në të kaluarën, artet e tjera si piktura, skulptura, teatri, kinematografia, muzika etj. qenë mjaft të prapambetura e ndonjë prej tyre nuk ekzistonte fare me gjithë traditën e pasur popullore e disa përpjekje që meritojnë vëmendje. Po edhe letërsia, që kishte njohur suksese të dukshme, u zhvillua më tej. Nëpërmjet realizmit socialist u krijuau drama dhe u stabilizua romani në letërsinë tonë, mori hov masiv krijuimtaria dhe u shtuan në përmasa të panjohura ritmet, vëllimi dhe sasia e botimeve. Teatri profesionist lindi pas fitores së Revolucionit Popullor. Po në këtë kohë u krijuau kinematografia dhe televizioni shqiptar, hynë në jetën artistike të vendit ekspozitat e arteve figurative me vepra të piktorëve e të skulptorëve tanë.

Me kujdesin e Partisë gjatë kësaj kohe u rritën shumë kuadro të kulturës e të artit, u ngritën dhjetëra institucione kulturore e artistike në të gjitha anët e vendit. Kultura dhe arti po hyjnë gjithnjë e më thellë në jetën e popullit dhe po ndihmojnë aktivisht në formimin e njeriut të ri të socializmit. Jeta jomë po bëhet gjithnjë e më e kulturuar dhe Shqipëria, me ritmet e zhvillimit që ka marrë, shpejt do të bëhet një nga vendet më të përparuara e më të kulturuara të botës. Për realizimin e kësaj perspektive të shkëlqyer punonjësit e kulturës e të artit, së bashku me gjithë masat punonjëse të udhëhequr nga Partia, kanë për të dhënë edhe në të ardhmen një kontribut të çmuar.

Letërsia dhe artet tona të realizmit socialist burim frysëzimi kanë patur dhe kanë jetën, luftën dhe punën e popullit, që përbëjnë temën themelore të tyre. Lidhjeve të përhershme dhe të ngushta të letërsisë e të arteve me realitetin revolucionar të kohës dhe të shkrimitarëve me jetën e popullit, me hallet, me problemet, me sukset, me èndrrat dhe me idealet e tij, Partia u ka kushtuar vëmendje të posaçme dhe i ka quajtur si një prej kushtave më me rëndësi për të patur një letërsi e një art me frysë të vërtetë popullore, të gjallë, të frysëzuar, aktiv dhe realist, të aftë të pasqyrojë me vërtetësi e nga pozita revolucionare realitetin objektiv në vepra të nivelit të lartë artistik dhe të ndikojë më edukimin e njerëzve me idetë, moralin dhe idealet komuniste.

«Nën udhëheqjen e Partisë, — porosit shoku Enver, — punonjësit e letërsisë e të arteve të bëjnë atë punë të thellë ideologjike, politike, morale dhe etike që lipset për të luftuar ndikimet dhe helmet e botës së vjetër dhe të asaj kapitaliste e revizioniste aktuale, për të vënë më dukje dhe për të rrënjosur më karakterin e njerëzve tanë virtytet e larta komuniste»<sup>1)</sup>

Letërsia dhe artet janë një pasqyrë aktive e jetës, më të cilën reflektohen fenomenet dhe proceset jetësore dhe vlerësohen ato nën prizmin e botëkuptimeve dhe pikëpamjeve e shijeve estetike të ndryshme, prandaj veprat letrare e artistike, duke qënë shfaqje të ndërgjegjes shoqërore ndikojnë pastaj mbi këtë ndërgjegje më drejtime të ndryshme, sipas pikëpamjeve ideologjike, politike, shoqërore dhe estetike që kanë udhëhequr krijuimtarinë e shkrimitarëve e të artisteve. Për këtë arsyesh lidhjet e letërsisë e të artit me jetën shoqërore janë të dyfishta: nga një anë ato kanë të bëjnë me raportet që krijojnë

1) Enver Hoxha: Shkrimitarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë f. 11.

letërsia e artet me realitetin e kohës, me shkallën e pasqyrimit në to të fenomeneve e të proceseve jetësore, me vërtetësinë e pasqyrimit të kontradiktave më tipike dhe të tipave shoqërorë më karakteristikë për çdo periudhë historike, etj., kurse, nga ana tjetër, ato shprehin rëndësinë që ka krijimtaria artistike në jetën shoqërore, si mjet i edukimit ideoartistik të punonjësve. Ana e parë e këtyre marrëdhënieve është më e rëndësishmja, mbasi varet nga qëndrimi që mbajnë shkrimitarët dhe artistët ndaj jetës e ndaj popullit nëse krijimtaria e tyre do të jetë përparimtare apo reaksionare, revolucionare apo kundërrevolucionare.

Në aspektin e parë gjëja kryesore që bie në sy është *horizonti tematik* i krijimtarisë letrare e artistike, problemet e rëndësishme shoqërore që tërheqin vëmendjen e shkrimitarëve dhe të artistëve, shqetësimet kryesore të tyre në një periudhë të caktuar historike. Pa një orientim të drejtë dhe të shëndoshë tematik as që mund të bëhet fjalë për letërsi dhe arte të realizmit socialist. Letërsia dhe artet që nuk shqetësohen për problemet e mëdha të kohës, që nuk rreh në to pulsi revolucionar i jetës, që nuk pasqyrojnë realitetin nëpërmjet shfaqjeve të tij më tipike, po u kalojnë anash çështjeve më jetike të masave punonjëse, nuk mund të ushtrojnë ndikim për të qënë në jetën shoqërore dhe, herët a vonë, do të shkëputen nga masat, do të veniten dhe do të shuhën, duke patur fatin e çdo gjëje pa vlerë shoqërore. Ndërsa «*kur arti mbart idetë dhe synimet e kundërrevolucionit, kur ai bëhet zëdhënës i elementeve ose i shtresave të burokratizuara e të borgjezuara, kur u kundërvihet aspiratave dhe luftës së masave, ai nuk mund të jetë kurrë art i vërtetë»<sup>2)</sup>*

Shkrimitarët dhe artistët tanë të realizmit socialist gjithnjë kanë synuar të pasqyrojnë në veprat e tyre jetën e popullit, luftën revolucionare dhe punën ndërtimtare të tij. Mjafton të kujtojmë letërsinë e Luftës Na-

cionalçlirimtare apo krijimtarinë letrare dhe artistike që shpërtheu pas Kongresit V të PPSH dhe fjalimeve programatike të shokut Enver Hoxha për të kuptuar sa të lidhura me popullin janë letërsia dhe artet tona, se ç'rëndësi jetike kanë për krijimtarinë artistike lidhjet e gjalla, të forta e të përhershme me përpjekjet, me problemet dhe me jetën e masave punonjëse dhe ç'krahë u jaspin ato veprave letrare e artistike për të depërtuar, sic thoshte Lenin, në thëllësitë e masave popullore e për të hyrë në zemrat e tyre. Për këtë arsyе Partia është kujdesur vazhdimi i që letërsia dhe artet tona të kenë një orientim të shëndoshë tematik dhe, për t'i arritur këtij qëllimi, si rrugë të vetme të drejtë u ka rekonduar shkrimitarëve dhe artistëve të jetojnë gju më gju me popullin, mbasi vetëm në popull ata do të gjejnë «*tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës, tempin e punës, frysëzimin e krijimit, shembullin e heroizmit e të sakrificës, virtytet e larta të thjeshtësisë popullore, të drejtësisë popullore, etj., etj.»<sup>3)</sup>*

Njohja e thellë dhe e gjithanëshme e jetës nuk ka të bëjë, siç mund të merret në mënyrë të thjeshtëzuar, vetëm me atrimin e përkohshëm të shkrimitarit e të artistit me ambiente të caktuara, me gjetjen e ndonjë subjekti ngajeta e të ndonjë tipi për veprën e ardhshme. Njohja e jetës së popullit është një proces i gjatë dhe i pandërrerprerë, i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, ku marrin pjesë përvoya, përjetimet vetiakë dhe mësimet e nxjerra nga të tjerët, ku ka rëndësi jo vetëm gjetja e hollësive dhe e subjekteve, po veçanërisht kuptimi i thellë i proceseve jetësore, ku zotësia pasqyruese varen jo vetëm prej njohurive dhe materialit të grumbulluar e prej mjeshëtërisë artistike, po sidomos prej raporteve shpirtërore që krijohen ndërmjet artistit dhe jetës së pasqyruar në veprat e tij. Këto anë të ndryshme të njohjes së jetës përbëjnë një tërësi unike dhe janë pjesë e ndërgjegjes dhe e botëkuptimit të shkrimitarëve dhe të artistëve. Ato

2) Enver Hoxha: Raport në Kongresin VI të PPSH-së, f. 160.

3) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1965-1966) f. 138.

janë aq organike për ta sa edhe rrahjet e zemrës dhe aq të natyrshme sa frysëmarrja. Praktika letrare dhe artistike provon se ka shkrimtarë dhe artistë, që nisen drejtpërdrejtë nga realiteti i gjallë për të krijuar veprat e tyre, kurse ka të tjerë, të cilët nisen më tepër prej problemeve të mëdha të kohës dhe e kompesojnë mungesën e hollësive jetësore me forcën e përgjithësimit, me mprehtësinë e analizave, me përfytyrimin e guximshëm poetik të jetës, etj. Të dyja këto rrugë janë të mundëshme dhe kanë dhënë rezultate të mira, por sidoqoftë, duke njohur vlerat dhe kufizimet e se cilës dhe duke luftuar njëkohësisht si kundër intuitivizmit edhe kundër tendencave racionaliste, nuk mund të mos mbahet parasysh se, meqë praktika është kriter i së vërtetës, atëherë edhe njohja artistike nuk mund të jetë kurrë e plotë dhe aktive pa pjesëmarrjen vepruese të artistëve në jetën shoqërore e në përpjekjet e masave punonjëse.

Artet dhe letërsia e realizmit socialist dallohen prej letërsisë dhe arteve të së kaluarës, ndër të tjera e në radhë të parë, prej materialit të ri jetësor që trajtojnë, prej pëlqimeve tematike që kanë, prej vështrimit të ri pohues ose mohues mbi materialin jetësor, që mund të kenë qenë objekt pasqyrimi dhe në të kaluarën. Asnjëherë në letërsinë e në artin e së kaluarës lufta revolucionare e popullit nuk ka qenë objekt kryesor frysëzimi për krijimtarinë, me gjithë përpjekjet e herëpas-hershme që janë bërë në këtë drejtim dhe asnjëherë heroi popullor nuk ka zënë vendin kryesor në veprat artistike, siç ndodh në letërsinë dhe artet e realizmit socialist, kurse puna për ndërtimin e socializmit dhe për krijimin e njeriut të ri komunist është një sferë tematike karakteristike vetëm për letërsinë e sotme. Kjo hapsirë e madhe dhe e rëndësishme tematike e diktuar nga vëtëjeta ka bërë të depërtojnë në letërsi e në art vulli entuziast i heroizmit popullor, qëndrimi realist ndaj jetës, gjykimi i drejtë i fenomeneve shoqërore, gjerësia e pasqyrimeve, mentaliteti, psikologjia dhe morali i shëndoshë i masave punonjëse.

Partia asnjëherë nuk ka vënë kufij për tematikën e letërsisë e të artit. Ato kanë trajtuar dhe mund të trajtojnë çdo temë nga pozita realiste revolucionare, por, si në çdo çështje, edhe në tematikë është e domosdoshme të dallojmë atë që është kryesore nga ajo që është e dorës së dytë, atë që është e domosdoshme nga ajo që nuk është e domosdoshme, në momente të caktuara apo që është e rastit. Kriteri i parë këtu mbetet kurdoherë qëndrimi ndaj aktualitetit dhe trajtimit, në radhë të parë, i temave aktuale, pa supozuar me këtë mohimin e mundësisë së trajtimit të temave historike dhe nga e kaluara, kur ky trajtim bëhet nga pozita revolucionare. Prandaj Partia ka theksuar me kohë se «*pasqyrimi më i gjerë e më i thellë i luftës, i jetës dhe i punës së popullit, i idealeve dhe aspiratave të tij, i aktualitetit, është problemi kryesor që duhet të tërheqë vëmendjen e shkrimtarëve tanë»<sup>4)</sup>, duke përfshirë në sferën e aktuale edhe temat e Luftës Nacionallirimtare.*

Ky përqëndrim i vëmendjes në temat e aktualitetit ka të bëjë drejtpërsëdrejti me rolin aktiv të artit në jetën shoqërore, me karakterin bashkëkohor të tij, me shpirtin e tij novator e revolucionar. Në qoftë se letërsia dhe artet shkëputin marrëdhëniet me kohën e tyre, cilidoqoftë talenti i shkrimtarëve dhe artistëve të veçantë, ato janë të gjykuara të mpihen, të atrofizohen, të humbasin gjallërinë jetësore dhe të hyjnë në rrugën e kërkimeve manieriste.

Por nuk mjafton vetëm që letërsia dhe artet të kenë një orientim tematik bashkëkohor. Çështja është edhe c'anë të realitetit të kohës, ç'tema dhe ç'heronj të kohës tërheqin vëmendjen e shkrimtarëve e të artistëve dhe deri në ç'shkallë këto tema dhe këta heronj përfaqësojnë prirjet objektive të zhvillimit historik, të sotmen dhe të ardhmen e shoqërisë. Devijimi i artit nga tematika kryesore aktuale, nga pasqyrimi i luftës revo-

<sup>4)</sup> PPSH — Dokumente kryesore, vëllimi IV, f. 563.

lucionare dhe i punës ndërtimitare në të gjitha aspektet e tyre, nga temat e shndërrimeve shoqërore dhe të botëkuptimit, të mentalitetit dhe të psikologjisë së njerëzve në vetë procesin e veprimitarisë revolucionare, nga raportet e reja që krijojen në socializëm ndërmjet shoqërisë dhe individit etj. dhe prirjet mikroborgjeze të tjerheqjes pas vogëlsive intime, zhbirimeve psikologjike, jetës së «njeriut të vogël» etj. sado aktuale që të janë, nuk mund t'i sjellin veçse dëm vetë artit dhe sidomos funksionit të tij shoqërор edukues.

Në dokumenta të rëndësishme të Partisë, që nga diskutimi i shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Byrossë Politike të KQ të PPSH (qershori 1949) deri në matrialet e Plenumit IV të KQ të PPSH (qershori 1973) është theksuar vazhdimisht se në temën aktuale vendin më me rëndësi duhet ta zëre Lufta Nacionalçlirimtare, lufta e Partisë dhe e popullit kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, tema e punës dhe e njeriut të punës, e revolucionarizmit të jetës dhe e marrëdhënieve shoqërore, shndërrimi socialist i fshatit, lufta në frontin ideologjik për asgjësimin e mbeturinave të së kaluarës dhe për afirmimin e ideologjisë e të moralit komunist, roli i klasës punëtore dhe i Partisë në ndërtimin socialist të vendit etj. Të tjerheqësh vëmendjen e shkrimitarëve dhe të artistëve në këtë problematikë të pasur e me rëndësi historike dhe letërsia e artet t'u drejtohen masave në këto drejtime themelore, do të thotë ta bësh krijimtarinë artistike mjet të fuqishëm të edukimit komunist, t'i japësh asaj një vend nderi në jetën shoqërore. Temat dhe problemet e tjera, duke përfshirë edhe intimitetet njerëzore (dashuria,jeta familjare, gëzimet e hidhërijet etj). trajtohen drejt dhe kanë rëndësi shoqërore vetëm në qoftë se do t'i nënshtronen frysës së përgjithshme revolucionare të letërsisë e të arteve të realizmit socialist. Përndryshe, siç ka ngjarë disa herë, ato do të shëmbëllejnë si qoshe mikroborgjeze në ndërtesën e mëdha të shoqërisë e të artit socialist dhe po të merrnin përpjete do të sillnin dëme serioze. Nuk është e rastit që përfshirët fillestare të revolucionizmit në letërsinë së ndër shfaqjet fillojnë si qoshe mikroborgjeze në ndërtesën e mëdha të shoqërisë e të artit socialist dhe po të merrnin përpjete do të sillnin dëme serioze. Nuk është e rastit që

vjetike ishin pikërisht edhe tendenca të tilla mikroborgjeze. Shkarje të tilla, nën ndikimin e drejtpërdrejtë të presionit ideologjik imperialist e revisionist, u dukën vitet e fundit edhe në letërsinë e në artet tonë, ku, siç theksohet në raportin e mbajtur nga shoku Enver në Plenumin IV të KQ të PPSH, u vu re «*kapja e teprvar pas temave të vogla intime, largimi nga problemet e mëdha shoqërore, tema e vëtmisë së njeriut, kur ky na u shndërruaka në kërmill, fik deti e absurditete të tjera, fenomenë që janë të lidhura me ndikimin e filozofisë e të estetikës ekzistencialiste, si dhe të rrymave letrare si simbolizmi etj.* Këto fenomene që janë vërejtur në disa poezi e tregime, në tekste këngësh, në disa piktura etj. janë në kundërshtim me frysë militante revolucionare të letërsisë e të artit tonë, me patosin qytetar dhe me karakterin epik të tyre»<sup>5)</sup>

Shfaqje të kësaj natyre u përtrinë në krijimtarinë letrare e artistike sidomos në fillim të viteve '70, kur ndaj tyre, si rezultat i veprimitarisë armiqësore të Fadil Pacramit e të Todi Lubonjës, mbahej një qëndrim i patolerueshëm miratues, që kalonte shpesh herë në entuziazëm dhe bëhej mbështetje për ato teorizime moderniste, që zunë vend në disa prej artikujve kritikë, që bo-toheshin në gazeten «Drita» dhe në revistën «Nëntori». Kjo pjesë e sëmurë e krijimtarisë sonë letrare e artistike, që po të mos luftohej do të bëhej e rrëzikshme në kuptimin artistik e shoqërор, nuk arrii dot të bëhej «tendencë kryesore» në letërsinë e në artet tonë, që mbenët në tërësinë e tyre të shëndosha dhe militante.

Aktualiteti i kuptuar në mënyrë të partishme ka genë objekt frysës për shumë nga veprat më të mira të shkrimitarëve dhe të artistëve tamë gjatë më se tri-dhjetë vjetëve. Le të kujtojmë, për shembull, poemat: «Epopeja e Ballit Kombëtar», «Prishtina», «Ashtu Myzeqe», «Shqiponjat fluturojnë lart», «Devoll, Devoll», «I përkasim komunizmit» etj. romanet: «Këneta», «Komisa-

5) Enver Hoxha: «Të thellojmë luftën kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre» f. 19-20.

ri Memo», «Tokë e ashpër», dramat «Toka jonë», «Familja e peshkatarit», «Cuca e maleve», «Fytyra e dytë», filmat: «Vitet e para», «Ngadhnjim mbi vdekjen», tablotë: «Puhetorët», «Vojo Kushi» etj., veprat skulpturale: «Partizani fitimtar», «Lart frymën revolucionare» e shumë të tjera që të bindemi se problemi i trajtimit të temave aktuale në aspektet më kryesore të tyre, është vënë në rrugën e zgjidhjes me sukses dhe është mishëruar në dhjetëra vepra të bukurat të letërsisë e të arteve tonë të sotme.

Pas kongresit V të PPSH, duke iu përgjigjur thirrjes për të jetuar «gju më gju» me popullin dhe për të pasqyruar «flakë për flakë» realitetin revolucionar të kohës, shkrimitarët dhe artistët tanë u afroan edhe më tepër me jetën dhe përpjekjet e masave punonjëse. Ky atrim pati ndikim përtërëtës, pasuroi tematikën, solli në krijimtari ambiente, heronj dhe probleme të reja, sidomos lidhur me heroizmin në punë, me luftën kundër prapambetjes së trashëguar, me rolin e klasës punëtore në ndërtimin socialist, me problemet e emancipimit të gruas, të luftës kundër burokratizmit etj. Bilanci tematik i veprave anoi në dobi të temave aktuale. Por kjo nuk do të thotë se u arrit gjithçka. Bile përpjekjet për të pasqyruar «flakë për flakë» ndryshimet në jetën shoqërore disa herë kanë shpënë në mbivlerësimin e përshtypjeve të rastit, në empirizëm në dëm të vlerësimit të thellë e të gjithanshëm ideoartistik të fenomeneve e të proceseve jetësore aktuale, në nxitim, që solli si pasojë ndonjëherë edhe uljen e nivelit artistik të veprave, krijimin e shablloneve dhe mbivlerësimin prej kritikës dhe opinionit shoqëror të veprave me vlera të kufizuara, siç qenë disa prej «dramave dokumentare» ndonjë roman dhe mjaft vjersha e poema.

Si në cdo fushë tjetër të veprimitarë shoqërore, edhe në krijimtarinë artistike, duke shtruar problemin e lidhjeve të ngushta me jetën, Partia ka qënë si kundër empirizmit dhe intuitivizmit, që ulin rolin vlerësues dhe përgjithësues të artit, edhe kundër sociologizmit vulgar, që rreh të zëvendësojë pasqyrimin artistik realist të jetës me arsyetime dhe debate për virtytet dhe veset e

njerëzve. Prandaj, shoku Enver na mëson se: «*Serioze quhet ajo vepër që prek të gjitha anët e çështjes në fjalë, me kompetencë, në mënyrë shkencore, që i çon çështjet deri në fund, që zberthen drejt procesin në mënyrë realiste, e bën atë plotësish të kuptueshmë dhe në këtë proces ve në dukje si duhet anët e mira e negative, rrethanat që e lindën atë, rolin e vepruesve dhe të aktorëve kryesorë të këtij procesi. Atëherë vepra bëhet e gjallë, edukative, zgjon entuziazëm dhe hap perspektiva, heronjtë gjithash tu dalin të gjallë e luftojnë, jo me hënëzën, po me realitetin, me vështirësitë e jetës.*<sup>6)</sup>

Në këto fjalë të shokut Enver Hoxha theksohet nevoja e studimit dhe përgjithësimit shkencor të proceseve të jetës në mënyrë që figura artistike të mos i ngjajë një trillimi subjektiv, po të zbulojë me mjetet e veçanta të artit thelbim dhe anët kryesore të fenomenit që përshkruhet, faktorët që e lindën dhe që e bëjnë të zhvillohet, lidhjet e tij kryesore, luftën e të kundërtave që progresivitetin e kalimit nga një proces në tjetrin, kur është fjala për jetën socialistë. Ky është një mësim me vlerë të veçantë për letërsinë dhe për artet tonë, jo vetëm në parim, po edhe për gjykimin e praktikës letrare e artistike, mbasi edhe në ditët tona nuk janë shumë të rralla rastet kur veprat nuk krijohen në bazë të një studimi të thellë të jetës, po për thurjen e tyre i besohet intuitës krijuese dhe përshtypjeve të rastit, prandaj kemi ende vepra të përcipta, me prirje natyraliste e të tjerë ku zotërojnë «reflekset e botës personale të autorëve» si dhe vepra skematike, në të cilat pasqyrimi i jetës realizohet sipas mendimeve dhe skemave të paracaktuara. Sigurisht, fenomene të tilla negative nuk përbëjnë vijën kryesore të letërsisë e të arteve, po është puna që të luftohet më me këmbëngulje për të shmangur gjithë ç'pengon për një pasqyrim të gjithanshëm, të thellë dhe artistikisht të përgjithësuar në mënyrë realiste të jetës. Skematizmit nuk mund t'i kundërvihet subjektivizmi dhe

6) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1965-1966), f. 140-141.

ky i fundit nuk mund të luftohet me sukses nga pozita skematike. Vjetëm një letërsi dhe një art që niset nga jeta, që mbështetet në botëkuptimin materialist-dialektik dhe në parimet themelore të realizmit socialist mund t'i kapërcejë këto qëndrime të njëanshme dhe të krijojë vepra me vlerë.

Arti dhe letërsia e realizmit socialist mbajnë qëndrim veprues ndaj realitetit të kohës. Sikurse filozofia marksiste edhe ato nuk mjaftohen vetëm me pasqyrimin dhe shpjegimin e botës, po synojnë që të ndikojnë në shndërrimin e saj revolucionar. Një funksion të tillë e përmban vetë natyra e metodës së realizmit socialist në një shkallë më të lartë nga gjithë letërsia dhe arti i së kaluarës, mbasi në veprat e realizmit socialist zbulohen më me vërtetësi kontradiktat dhe lufta e të kundërtave dhe realiteti jepet në zhvillimin e vet revolucionar, nëpërmjet figurash dhe heronjsh që përfaqësojnë tendencat më të përparuara të kohës, që janë mbartës të idealeve të së ardhmes dhe prandaj kanë një forcë më të madhe ndikuese. Në këtë mesës është e nevojshme të mbajmë parasysh jo vetëm specifikën e llojeve e të gjinive të ndryshme të artit, po edhe faktin se letërsia dhe arti, për vetë natyrën e tyre, janë «armë me qitje të largët», vaprojnë në mendjen dhe në ndërgjegjen e njerëzve dhe rezultati i tyre nuk matet me korrigjimin e menjëhershëm të të metave apo me kapërcimin e vështrimësive të kohës, ndonëse edhe forma të tilla artistike ekzistojnë (karikatura, estrada, pllakati etj.), po me transformimin revolucionar të ndërgjegjes së njerëzve, me ndikimin që ato ushtrojnë për edukimin revolucionar të tyre. Këtë funksion letërsia dhe artet e plotësojnë jo vetëm nëpërmjet pohimit të së resë, po edhe nëpërmjet mohimit të së vjetrës, nëpërmjet afirmimit dhe kritikës, kur kjo kritikë u nënshtronhet qëllimeve të pohimit revolucionar të idealeve socialiste. Si në njëren mënyrë si në tjetërën dhe nëpërmjet të dyjave së bashku letërsia dhe arti bashkërenditen me format e tjera të punës ideo-

logjike, politike dhe edukative për formimin e njeriut të ri të socializmit.

Karakteri aktiv i letërsisë dhe i arteve ka të bëjë veçanërisht me qartësinë e perspektivës, me idealet që frysmezojnë shkrirtarët e artistët, me pasqyrimin e realitetit jo si diçka të ngurtë, po në lëvizje, në luftë të kundërtash, në transformim, si momente në të cilat vazhdimisht kapërcehet e vjetra dhe lind e reja, kur edhe kjo e re nuk mbetet në vend po çan përpara, rritet, forcohet dhe pregetit kushtet për një zhvillim të mëtejshëm revolucionar. Në disa vepra krijuhet përshtypja se momenti i pasqyruar përbën kulmin e zhvillimit, herë të tjera ky moment merret i shkëputur, si diçka më vete, jashtë lidhjeve të shumanshme shoqërore dhe ndodh gjithashtu, që në vepra të veçanta proceset në zhvillim të pasqyrohen si krejtësisht të realizuara, duke krijuar përfytyrime iluzore për realitetin. Të tria këto fenomene mbështeten në një konceptim dhe pasqyrim jo dialektik të jetës. Për këtë çështje në Plenumin XV të KQ të PPSH u mor si shembull trajtimi i temave nga jeta e fshatit të sotëm dhe u theksua se në shtjellimin e tyre „...nuk është fjala vetëm për pasqyrimin e asaj që ndodhi dje në fshatin tonë gjë që, pa dyshim, ka rëndësi të veçantë, po edhe për ndjekjen e këtij procesi që zhvillohet jo vetvetiu, po në luftë kundër pengesave e vështrimësive të shumta, kundër forcës së zakonit dhe tradiçës...»<sup>7)</sup>

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për trajtimin e temës së emancipimit të plotë të grave e të vajzave, përluftën kundër zakoneve dhe traditave feudoborgjeze, përkontrollin e klasës punëtore etj., mbasi në mjaft vepra fenomenet paraqiten me të kaluarën, po pa të ardhme dhe ngjan sikur gjithçka është arritur në realitetin e ditëve tona dhe vendimet e Partisë dhe dokumentat e saj programatike për këto çështje merren jo si orientime dhe si armë përluftën që vazhdon të zhvillohet, po si

7) PPSH — Dokumente kryesore, vëllimi IV, f. 565.

kurorëzime të plota të idealeve. Kështu, nga entuziazmi i tepert dhe i përciptë, nënveftësohet perspektiva e luf-tës dhe e shndërrimeve të mëtejshëm revolucionare.

Në realitetin e ditëve tona, në plan të përgjithshëm shoqëror dhe në qdo rast të veçantë, në realitetin objek-tiv dhe në botën e brëndshme të njerëzve zhvillohet një luftë e ashpër, në të cilën ndeshen e kaluara me të ardh-men, ajo të cilës i ka ikur koha dhe duhet të vdesë me atë që ka lindur e duhet të zhvillohet ose që do të lindë prej të sotmes. Kjo luftë nuk bëhet në vijë të drejtë, e në mënyrë të njëtraftshme, po është e shumanëshme dhe e ndërlikuar, është një luftë në të cilën përlëshen tra-ditat e pasionet e vjetra me të rejet, mendimet dhe zako-nit e kaluara me mendimet e zakonet e kohës, mëryra e vjetër e prodhimit dhe e jetesës me mënyrën socialiste të prodhimit të jetesës, individualizmi borgjez me ko-lektivizmin socialist, anarshizmi mikroborgjez me disi-plinën, organizimin proletar etj. Në këtë luftë që sjell zhvilliminë e shoqërore, duke u kapur me mprehtësi pas hallkave më kryesore, duke ditur të dallohen kategoritë e kontradiktave, pleksja e tyre, shfaqjet e tyre konkrete dhe të zbulohet e reja revolucionare, pa u gënjer prej petkave që vesh disa herë e vjetra për të vazhduar që-nien me dinakëri, duke iu përshtatur përkohësisht kush-teve të reja. Për këtë vlen jo vetëm njohja e dukjes së iashtme të fenomeneve dhe të proceseve jetësore, po hyr-ja në thelbin e tyre, zbulimi i anëve më tipike dhe in-terpretimi nga pozita marksiste-leniniste i prirjeve të zhvi-limit. Trajtimi objektivist i fenomeneve jetësore, zbut-ja ose sheshimi i kontradiktave, mbulimi i tyre me pre-tekst se mos «errësohet realiteti», shqetësimi i tepruar për të vjetrën dhe kujdesi i paktë për zbulimin, pasqy-rimin dhe afirmimin e së resë, përshkrimi i hollësishëm i të kaluarës së fenomeneve dhe mungesa e depërtimit në të ardhmen janë disa shfaqje që pengojnë pasqyrimin realist të jetës dhe, në këtë mënyrë, dobësojnë karaktere-aktiv edukues të letërsisë e të arteve të realizmit so-

cialist. Raste të tilla negative janë dukur herë pas here edhe në letërsinë dhe në artet tona si shprehje të ndi-kimeve borgjeze e revisioniste e si manifestime të rutinës dhe të frysës konformiste.

Për të kapërcyer me sukses këto dobësi është e do-mosdoshme që lidhjet me jetën dhe me realitetin e kohës të jenë sa më të gjalla e më të shumanëshme dhe proceset e zhvillimit, fenomenet dhe tipat të shihen e të trajtohen në mënyrë realiste revolucionare, duke mbaj-tur parasysh se: «ka dy lloje shikimesh të zhvillimit të jetës: njëri është shikimi idealist, mistik, pesimist dhe konservator, dhe tjetri është shikimi realist, me frysë revolucionare, frys i një analize materialiste të ngjarjeve dhe të historisë, plot me ndjenja optimiste për një ndry-shim dhe zhvillim të mëtejshëm pozitiv të historisë e të zhvillimit të shoqërisë, të një shoqërie pa klasa.»<sup>8)</sup>

Vështirësitë në pasqyrimin e pamjaftë, të cekët e jo të plotë të realitetit të kohës Partia i ka parë gjithashtu «... në mosnjohjen e thellë të jetës dhe të proceseve të zhvillimit të saj, në moskapjen e asaj që është krye-sore në procesin e jetës, sidomos të dallimit të asaj që është e re dhe që përfaqëson tendencën përparimtare të fenomeneve»<sup>9)</sup>, kurse rrugën e daljes prej këtyre vësh-tirëve e ka gjetur në lidhjen e ngushtë të shkrimita-rëve e të artistëve me popullin dhe në përvetësimin dhe zbatimin nga ana e tyre të dialektikës marksiste, në stu-dimin dhe pasqyrimin e jetës, se vetëm kështu ata do të munden «... të shohin nga afër, të prekin transformi-met e mëdha që janë bërë në jetën e vendit dhe në ndërgjegjen, psikologjinë, botëkuimin e njerëzve tanë»<sup>10)</sup>.

Kur është folur për pasqyrimin e jetës në veprat artistike dhe për orientimin tematik të letërsisë e të ar-

8) Enver Hoxha: Shkrimitarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë f. 15.

9) PPSH — Dokumente kryesore, vëllimi IV, f. 566.

10) Enver Hoxha: Fjala e mbylljes në Plenumin e KQ të PPSH-së «Për forcimin e punës ideologjike të Partisë» (korrik 1964), f. 28-29.

teve, është përdorur edhe termi «tema të përjetëshme», siç janë konsideruar nga disa teoricienë temat e dashurisë, të miqësisë, të amësisë, të qëndrimit ndaj natyrës etj. të marra këto të shkëputura nga lidhjet e gjalla me jetën e kohës, me kushtet historike e shoqërore, me anët e tjera kryesore të jetës e të veprimtarisë njerëzore, sidomos me ato anë që shprehin qëndrimin aktiv të njeriut në shoqëri. Pra, të kuptuara kështu, të ashtuquajturat «tema të përjetëshme» janë vetëm një kundërvënie artificiale dhë metafizike e elementeve «të përgjithshme» njerëzore elementit bashkëkohor. Në të vërtetë edhe në këtë rast e përgjithshmja shfaqet nëpërmjet të veçantës, e përjetëshmja nëpërmjet historikes, njerëzorja nëpërmjet klasores etj. Asnjë ndjenjë, asnjë qëndrim dhe asnje mendim i rëndësishëm nuk është i shkëputur prej kushteve historike konkrete, që e përcaktojnë dhe i japin zhvillim e drejtim. Në çdo epokë ndjenjat dhe mendimet njerëzore janë shprehur më plotë dhe më madhërishëm në jetën dhe në veprimtarinë e klasave më të përparuara, që kanë mishëruar shkallén e zvillimit dhe perspektivën e njerëzimit. Nga kjo pikëpamje ndjenjat dhe mendimet e klasës punëtore dhe tematika e luftës revolucionare dhe e ndërtimit socialist janë zbulimi më i madhërishëm i realitetit njerëzor, gjersa përbajnjë në vetvete jo të kaluarën, po të sotmen dhe të ardhmen e njerëziunit. Çështja është se deri në c' shkallë shkrihet në vepra e veçanta me të përgjithshmen, aktualiteti me perspektivën, me c' forcë mendimi e talenti karakteri i theksuar klasor i veprave të realizmit socialist mishërohet si kulti i zhvillimit të gjertanishëm të njerëzimit, si hallkë e domosdoshme objektive e kalimit të mëvonshëm në të ardhmen komuniste pa klasë, kur njeriu, sipas shpërthjes së Marksit, do t'i kthehet plotësisht vetvetes. Vetëm nëpërmjet një kuptimi të tillë historik dialektik mund të trajtohen drejtë raportet ndërmjet të përjetshmes dhe të historikes, njerëzores dhe klasores, gjersa klasat janë një realitet objektiv.

Jeta përcakton artin dhe çdo kohë ka artin e vet. Nga ana tjetër, duke qenë pasqyrim dhe vlerësim i jetës, reflektim i problemeve të kohës, arti ndikon aktivisht në jetën shoqërore, bëhet armë për realizimin e idealeve të caktuara dhe, në rastin tonë, ai është vlerësuar kurdoherë nga Partia si mjet i rëndësishëm për edukimin komunist të masave.

Çdo klasë dhe çdo parti politike me rëndësi është përpjekur dhe përpipet që ta përdorë letërsinë dhe artin, nga një anë për të pasqyruar jetën dhe pikësynimet e veta, për të shprehur e për të kënaqur shijet e veta dhe, nga ana tjetër, për të përhapur me anë të veprave e të veprimtarisë artistike pikëpamjet, moralin dhe shijet e veta estetike edhe në masat e gjera të popullit, për t'i sunduar ato shpirtërisht. Forcën ndikuese të artit e njohin të gjithë dhe lufta në këtë fushë bëhet për t'i tjerhequr shkrimitarët e artistët në këtë ose atë anë, për t'i bërë ata partizanë të përparimit e të revolucionit ose përkrahës të reaksionit e të ideologjisë kundërrevolucionare.

Partia e Punës e Shqipërisë, e mbështetur në vlerësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit, ka luftuar gjithnjë për një art revolucionar, që shërben për çlirimin shpirtëror të njerëzve prej vargonje të obskurantizmit, të ideologjisë reaksionare, të psikologjisë mikroborgjeze, të shijeve estetike dekadente e formaliste. Ajo e ka parë kurdoherë letërsinë dhe artin jo si amatori të «njerëzve të ngeshëm», po si një mision të rëndësishëm shoqëror, si pjesë përbërëse të revolucionit kulturor-socialist.

«Gjithë puna kulturale, arsimore e artistike» porosit shoku Enver «duhet të na vlejë në radhë të parë për të realizuar qëllimin themelor: edukimin e komunistëve e të gjithë punonjësve me një frymë të lartë klasore revolucionare marksiste-leniniste»<sup>11)</sup>

11) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 135.

Krijimtaria artistike nuk është e vëtmja formë e edukimit komunist të masave, bile do t'ishte pa vend edhe sikur të konsiderohej ajo si forma më e rëndësishme. Në jetën tonë socialistë janë shumë faktorë, forma pune dhe institucionale të Partisë e të shtetit, që merren me edukimin komunist të punonjësve dhe që realizojnë nëpërmjet veprimtarisë së tyre shumë të gjerë masive revolucionar ideologjik, pikësynimeve të të cilit i nën-shtrohet edhe veprimtaria kulturore dhe artistike. Letërsia dhe artet kanë vendin e tyre në këtë veprimtari të gjerë, integrohen në të dhe marrin rëndësi si forma specifike të pasqyrimit të realitetit e të ndikimit, si forma, që gjëzojnë popullaritet dhe e kryejnë misionin e tyre ideologjik nëpërmjet një brendie ideoemocionale konkrete dhe të këndshme, nëpërmjet subjekteve të thurura me mjeshtëri, figurave artistike, heronje dhe vlerave të tjera artistike. Ato, për këto arsyen, luajnë rol me shumë rëndësi për edukimin e shijeve të shëndosha estetike si pjesë përbërëse të edukimit komunist të punonjësve. Kjo forcë ndikuese e artit njihet mirë prej Partisë e cila, siç porosit shoku Enver, «duhet të preokupohet jashtëzakonisht për këto vepra dhe sidomos për njerëzit që i krijojnë ato», mbasi në kohën tonë, si në të gjitha frontet e ideologjisë, edhe në frontin e letërsisë e të arteve bëhet një luftë e ashpër, e shumanashme dhe e rafinuar nga ana e borgjezisë dhe e revisionistëve përtë fituar terren, për të ruajtur diçka nga pozitat e humbura, për të hedhur farën e barërave helmuese, duke marrë parasysh se nëpërmjet formave të stërholluara artistike, «marifeteve të stilit» etj. mund të depërtohen më lehtë ideologjikisht në ndërgjegjen e njerëzve. Ky preokupim i borgjezisë dhe i revisionistëve për krijimtarinë artistike, tregon se edhe ata e njohin mirë formën ndikuese të kësaj arme dhe përpiken që ta kenë në duart e tyre, ta venë në shërbim të qëllimeve të tyre kundërrevolucionare.

«Armiku i klasës e njeh mirë ndikimin e literaturës dhe të arteve në ndërgjegjen e njerëzve, ai i ka parasysh.

*kurdohëre pikat e dobëta të kësaj shtrese të inteligjencës dhe prandaj bën përpjekje kolosale që të ndikojë përtë keq në to, t'i thyejë, t'i çarmatosë, t'i bëjë vegla kundër revolucionit»<sup>12)</sup>*

E fortë, e mprehtë dhe e shumanashme zhvillohet kjo luftë në kohën tonë si në përgjithësi, edhe kundërvendit tonë dhe kulturës e artit të tij socialist. Duke vënë në veprim gjithë potencialin e tyre propagandistik dhe duke shfrytëzuar me intensitet të ethshëm mjetet e shumta të komunikimit shoqëror, bongjezia dhe revizionistët janë përpjekur dhe përpiken të shuanjë qëdo qëndresë revolucionare e të mposhtin qëdo vatër të revolucionit e të socializmit. Në planet e tyre ata kurrë nuk kanë hequr dorë as prej pikësynimeve përtë fituar pozitat e humbura në Shqipëri, përtë shuar këtë fener të flaktë të socializmit e të marksizëm-leninizmit. Dhe, krahas gjithë përpjekjeve të tjera, ata kanë llogaritur dhe kanë vënë në zbatim edhe planin e agresionit kulturor, në të cilin një vend të veçantë zenë letërsia dhe artet.

«*Thelbi i këtij agresioni ideologjik dhe synimi kryesor i armikut të klasës në kushtet e sotme për degjenerimin e rendit socialist, të politikës së brendshme e të jashtme të Partisë e të shtetit tonë, është nxitja e liberalizmit në të gjithë frontin*». Kështu ndodhi degjenerimi në Bashkimin Sovjetik, ku «në jetën shpirtërore liberalizmi u bë kyçi që hapi dyert përvërshimin e kulturës e të mënyrës së degjeneruar perëndimore të jetës»<sup>13)</sup>

Një orientim të tillë kërkonin t'i jepnim letërsisë dhe arteve edhe rrufjanët politik Fadil Paçrami e Todi Lubonja, të cilët i bënë të vetat parullat borgjezo-revi-

12) *Enver Hoxha*: Fjala e mylljes në Plenumin e KQ të PPSH-së «Mbi forcimin e punës ideologjike të Partisë (Korrik 1964) f. 28.

13) *Enver Hoxha*: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 13.

zioniste të liberalizmit dhe u orvatën të atentojnë kundër kulturës dhe arteve të realizmit socialist, duke u gjunjëzuar para modernizmit perëndimor, mënyrës borgjese të jetesës dhe koncepteve filozofike e artistike të kulturës, të artit e të estetikës së sotme dekadente.

Krahas njoftes në parim të rëndësisë së letërsisë dhe arteve si njëtë të edukimit komunist të masave dhe kritikave të herë pas hershme kundër shfaqjeve të huaja që janë vënë re në këtë fushë, Partia ka vlerësuar kurdoherë lart kontributin që kanë dhënë shkrimitarët tanë dhe rëndësinë që ka patur veprimitaria shumëformshe artistike për forcimin e ndërgjegjes revolucionare të punonjësve në etapa të ndryshme të revolucionit.

Që në vitet e stuhishme dhe të vështira të Luftës Nacionallirimtare Partia dha orientimet e duhura dhe udhëhoqi punën për zhvillimin e një veprimitarie të gjerrë kulturore dhe artistike në radhët e reparteve partizane, në zonat e çliruara, në qytetet e pushtuara prej fashistëve, bile edhe në burgjet e në kampet e përqëndrimit. Këngë partizane i tërbonte pushtuesit fashistë dhe veglat e tyre ashtu siç i tmerronte pushka partizane, kurse popullit i jepte zemër, e frymëzonte për heroizma, e mbushte me gjëzim dhe me optimizëm. Teatri partizan, me pjesë të shkruara shpejt e shpejt dhe të vëna në skenë nga qindra grupe amatore të Ushtrisë Nacionallirimtare dhe të organizatave të Rini të Antifashiste, përhapte në popull idealet e revolucionit, lartësonte heroizmin e partizanëve e të popullit, demaskonit manovrat e pushtuesve e të kuislingëve, vinte në lojë krerët e tradhëtisë kombëtare etj. Në zgjarrin e luftës, më 24 maj 1944, kur zhvillonte punimet Kongresi i Përmetit, u krijuat e para trupë teatrale kombëtare, bérthama e Teatrit të sotëm Popullor. Në mesazhin drejtuar këtij teatri, me rastin e 20-vjetorit të krijuimit të tij, shoku Enver Hoxha shkruante:

*«Pushkën, këngën, vallen si dhe pasqyrimin skenik të fenomeneve të jetës shoqërore e politike, qoftë edhe*

*në format më të thjeshta, ai (populli Red.) i ka gërshtuar me njëra-tjetër, i ka bërë pjesë të pandara të jetës. Në kohën e Luftës Nacionallirimtare këto karakteristika dhe armë të tij morën një zhvillim të paparë deri atëherë. Kujtoni se si pas betejave të përgjakshme me armiqëtë, partizanët shlodheshin, këndonin dhe jepnin shfaqje të shkurtëra pranë zjarrit, se si në burgje, ku shokët tanë i torturonin, i vrissin apo i varnin fashistët, zemrat e bije të popullit rimerrin zjarr akoma më me furi nga këngët dhe shfaqjet revolucionare të grupave artistike amatore; se si ngrihej peshë populli i robëruar i lagjeve të qyteteve apo i fshatrave nga shfaqjet ilegale, ku kumbonte zëri i Partisë. Atje, në luftë, Partia zbuloi në sytë e të gjithëve dhe futi thellë në ndërgjegjen e masave forcën e madhe transformuese të artit në përgjithësi, të artit teatral në veçanti.»<sup>14)</sup>*

Duke njoftur këtë «forcë të madhe transformuese» të artit, Komiteti Antifashist Nacionallirimtar, akoma pa u çliruar Shqipëria, që në tetor 1944, udhëzonte këshillat nacionallirimtare të merreshin, krahas detyrave të tjera të shumta e të ngutshme të luftës e të rindërtimit, edhe me organizimin e lëvizjes artistike në qark.

«Në çdo qark» thuhet në një qarkore të asaj kohe «duhet të krijohen ansamble, d.m.th. një kor dhe një orkester me elementët më të mirë të qarkut, një grup teatral dhe bashkë me këtë agitatorë e propagandistë, konferencierë të mirë. Ky ansambël do të vejë krahinë më krahinë, kudo që është nevoja në qarkun e tij dhe duhet të bëhet një faktor me rëndësi për të propaganduar luftën tonë dhe për të ngritur popullin nga pikëpamja kulturale.»<sup>15)</sup>

Edhe në periudhat e mëvonëshme nuk janë të rralla veprat letrare e artistike që kanë ndikuar fuqimisht në edukimin revolucionar të masave punonjëse dhe kanë

14) «Zëri i popullit» 1964, 31. maj.

15) Dokumente të organeve të larta të pushtetit revolucionar Nacionallirimtar (1942-1944), f. 253.

ndërhyrë aktivisht në shndërrimin revolucionar të jetës dhe të ndërgjegjes së njerëzve. Në një kohë kur lufta e klasave në fshat ishte shumë e ashpër dhe kulakët vpronin ende me agresivitet u shkrua dhe u vu në ske-në drama «*Toka jonë*», e cila pati jehonë në atë kohë dhe la përshtypje të thella sidomos në krahinat e veriut, ku ndeshjet klasore ishin nga më të mprehtat e më të ndërlikuarat. Të njejtën efekt ka bërë kohët e fundit në ato krahina drama «*Cuca e maleve*», që ka ndikuar pozitivisht në aksionin e madh të luftës kundër patriarkalizmit, besimeve fetare dhe poshtërimit të gruas prej njerëzve me mentalitet regresiv. Figura e Cucës u bë simbol i vajzës revolucionare, që nuk lufton vetëm për lirinë dhe të drejtat individuale, po ngrihet në lartësinë e luftëtares për çeshtjen e madhe të popullit e të socializmit. Në aksionet e mëdha popullore, që u ndërmorën pas fjalimit historik që mbajti shoku Enver më 6 shkurt 1966, për mobilizimin e masave dhe për ngritjen e entuziazmit revolucionar të tyre ndikuani në mënyrë të dukshme këngët luftarakë, që u krijuan prej kompozitorëve tanë. «*Në njérën dorë kazmën, në tjetrën pushkën*» mori përhapje shumë të gjërë dhe u bë marsh luftarak i të gjithë punonjësve, ashtu siç qenë bërë dikur këngët e frymëzuara të Luftës Nacionalçlirimtare. Shembulla të kësaj natyre ka plot dhe të gjitha ato dëshmojnë për vitalitetin e letërsisë e të artit tonë të realizmit socialist, për forcën e tyre të madhe transformuese. Ky kontribut i shkrimtarëve dhe i artistëve tanë është vlerësuar më se një herë në dokumenta të rëndësishme të Partisë. Në të gjitha kongreset e veta, në plenumet të veçanta të KQ të PIPSH, në takime të udhëheqësve të Partisë me shkrimtarët e me artistët etj. letërsisë dhe arteve u është kushtuar vëmendje: janë vlerësuar lart sukseset e arritura prej tyre dhe janë çelur perspektiva për një zhvillim edhe më të shquar në të ardhmen. Asnjëherë më parë krijimtaria artistike nuk është vlerësuar kaq lart dhe nuk është nxitur e stimuluar me forcë kaq të madhe dhe kurë më parë shkrimtarët dhe artistët nuk kanë patur një

vend kaq të ndëruar në jetën shoqërore. Partia dhe pulli kanë ndjekur gjithnjë me interesim sukseset e krijimtarisë së tyre dhe i kanë përdorur ato në veprimtarinë edukative për krijimin e njeriut të ri të socializmit. Një realitet i tillë provon, nga një anë se shkrimtarët dhe artistët tanë kanë krijuar veprat me nivel të lartë ideologjik e artistik, që kanë merituar miratimin dhe simpatinë e masave punonjëse dhe, nga ana tjetër, se në vendin tonë niveli kulturor i punonjësve ka ardhur vazhdimisht duke u rritur dhe kërkesat intelektuale të tyre janë shtuar së tepërti, kështu që letërsia dhe artet ndiqen tanë nga një masë shumë e gjërë lexuesish, shikuesish dhe dégjuesish të kategorive dhe të moshave të ndryshme.

Për afrimin më të madh të letërsisë e të arteve me masat e gjera të popullit Partia ka dhënë shumë orientime të rëndësishme dhe, në saj të tyre, në vendin tonë janë krijuar shumë mundësi praktike për popullarizimin dhe propagandimin e veprave të shkrimtarëve dhe të artistëve, për zhvillimin e një veprimtarie të gjerë e të dëndur artistike. Botimet e shumta me tirazhe të konsiderueshme të letërsisë, çelja e ekspositave kombëtare dhe krahinore të arteve figurative, organizimi i shfaqjeve dhe i koncertereve me krijimtarinë e kompozitorëve tanë, krijimi i një rrjeti të tërë teatrosh dramatike të estradave dhe i ansambleve artistike, kinostudioja dhe radiotelevizioni etj. Kanë bërë të mundur që krijimtaria letrare e artistike të bëhet ushqim shpirtëror i masave të gjera popullore të qytetit e të fshatit. Veç këtyre kushteve Partia ka orientuar që me propagandimin e letërsisë e të arteve të merren në mënyrë të organizuar institucionet shtetërore të kulturës dhe organizatat e masave, të cilat bëjnë një punë të vazdueshme për edukimin e punonjësve nëpërmjet veprave artistike. Diskutimet dhe komentet e ndryshme, takimet me shkrimtarë dhe artistë të njohur, organizimi i muajit të letërsisë, i dekadave artistike dhe shumë aktivitete të tjera masive kanë hyrë me kohë në jetën tonë kulturore dhe shërbjenjë gjithnjë e më mirë për ta bërë artin pronë të vërtetë të popullit.

Kjo veprimtari e gjerë e organizuar shpreh faktin se arti ynë është kultivues i ndërgjegjes revolucionare të masave. Për këtë shok Enver Hoxha, duke folur për teatrin ka thënë:

«Teatri, në përgjithësi, është kultivues i ndërgjegjes së masave. Teatri ynë, në vëçanti, është kultivues i ndërgjegjes revolucionare të tyre, ai ka përmision të ndihmojë në formimin e forcimin e saj, në brumosjen e njerëzve me vetitë e moralit komunist»<sup>16)</sup>

Për t'u bërë arti i masave dhe përmët kryer me sukses misionin e kultivuesit të ndërgjegjes së tyre, përvèç kushteve shoqërore të favorshme përmët një gjë të tillë dhe brendisë së shëndoshë e formës së lartë artistike të krimtarisë, është e nevojshme, gjithashtu, që nga një anë, shkrimtarët dhe artistët të krijojnë në një gjuhë të kuptueshme dihe të pëlqyeshme prej popullit dhe, nga ana tjetër, nëpërmjet arsimimit masat punonjëse të ngrihen në lartësinë e vlerësuesve dhe gjykatesve të të gjitha formave të veprimtarisë letrare e artistike. Këto dy përpjekje janë dy anë të të njëjtë proces që po zhvillohet me sukses në kushtet e ndërtimit të shoqërisë socialistë në vendin tonë.

Për ngritjen e nivelit të masave punonjëse «deri në të kuptuarit e përgjithësimit artistik» vepron gjithë jeta jonë shoqërore. Në radhë të parë me rëndësi është ngritja e nivelit ideopolitik dhe arsimor të popullit. Dihet se në këtë drejtim tek ne po bëhet një punë e madhe. Në shkollat e kategorive të ndryshme me shkëputje e pa shkëputje nga puna sot mësojnë më shumë se gjysmë milion vëtë. Kjo shtrirje e arsimit doemos ndikon drejtpërdrejt edhe në përpunimin e shijeve estetike të masave. Së dyti, ka rëndësi në këtë drejtim rrjeti i gjerë i institucioneve kulturale dhe artistike, nëpërmjet veprimtarisë së të cilave masat familjarizohen me veprat e artit dhe ndihmohen t'i kuptojnë ato më lehtë e më mirë. Së terti, nëpërmjet radios e televizonit disa forma të krimtarisë artistike

po depërtojnë gjithnjë e më shumë edhe në familje dhe, së katërti, vëtë sukseset e letërsisë e të arteve tona pre-gatitin një masë artdashësish me shije më të përpunuara dhe me kërkesa gjithnjë më të forta.

Nëpërmjet këtyre rrugëve, realizohet njëkohësisht ngritja e vazhdueshme e nivelit ideoartistik të letërsisë dhe të arteve dhe lartësimi e përpunimi i shijeve estetike të masave. Shkrimtarët dhe artistët tanë, duke u nisur prej popullit e duke mësuar prej tij, bëhen edukatorë të masave punonjëse, kultivues të ndërgjegjes së tyre revolucionare, përpunues të shijeve të tyre estetike. Për realizimin me sukses të këtij misioni shoqëror Partia ka parashtruar këtë program në fushën e letërsisë e të arteve.

«Partia shtron detyrën që letërsia dhe artet të bëhen një armë e fuqishme në duart e Partisë për edukimin e punonjësve në fryshtë e socializmit e të komunizmit, që ato të qëndrojnë në radhët e para të luftës përmët edukuar një rini të pastër ideologjikisht e moralisht, që gjithë krimtaria artistike të ketë një nivel të lartë ideologjik, të përshkohet nga fryma revolucionare luftarakë e Partisë si dhe nga një fryshtë e shëndoshë kombëtare. Partia kërkon që letërsia dhe artet të pasqyrojnë më gjerë luftën, punën dhe jetën e popullit punonjës, idealet dhe aspiratat e tij, ndjenjat e tij fisnike, karakterin e tij heroik, thjeshtësinë dhe madhështinë e tij, hovin e tij revolucionar; të pasqyrojnë me vërtetësi dhe në zhvillimin e vet revolucionar realitetin dhe aktualitetin tonë, që në qendër të krimtarisë të vihen heronjtë e kohës sonë..., që institucionet artistike dhe kulturale të udhëhiqen kurdoherë nga kërkesat ideopolitike të Partisë, të luftojnë e të demaskojnë ideologjinë borgjeze, me qëllim që të ushtrojnë në masat një ndikim edukativ revolucionar, të jenë të popullit dhe përmët popullin».<sup>17)</sup>

Në këtë parashtrim të qartë programatik të pikësy-nimeve të Partisë në fushën e letërsisë e të arteve është

16) «Zëri i popullit» 1964, 31 maj.

17) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 136.

vënë theksi në çeshtjet më kryesore ideoartistike, që përbëjnë tiparet dhe detyrat themelore të realizmit socialist, siç janë karakteri kombëtar, popullor, klasor dhe i partishëm i krijimtarisë artistike, problemet themelore të metodës krijuar, të heroit të veprave, të luftës kundër artit dhe ideologjisë borgjeze etj., probleme për të cilat do të flitet në vazhdim të këtyre shënimeve.

#### KREU I DYTE

Për të patur një letërsi dhe një art që «*të jenë të popullit dhe për popullin*», është e nevojshme që veprat e shkrimtarëve dhe e artistëve të kenë karakter kombëtar socialist, frysë të shëndoshë popullore, përkatësi klasore revolucionare.

Edhe letërsia dhe arti i mëparshëm përparimtar dhe dekadent si dhe letërsia dhe arti i sotëm borgjez e revisionist kanë karakter klasor e të partishëm. Ndërsa shkrimtarët dhe artistët përparimtarë, sipas shkallës së afërsisë së tyre me popullin dhe me klasat përparimtare të shoqërisë u kanë dhënë veprave të tyre një karakter të përgjithshëm popullor demokratik, shkrimtarët dekadentë përkundrazi, edhe kur në veprën e tyre është fshehur protesta kundër rendit shoqëror kapitalist, kanë qenë dhe mbeten antipopullorë, mbasi kurdoherë kanë ushtruar dhe ushtrojnë një ndikim negativ, çarmatosës, depresionues dhe çoroditës në masat punonjëse, duke paralizuar luftën revolucionare dhe duke përhapur helmin e një filozofie pasive në mos haptas reaksionare dhe çnjerëzore. Në përgjithësi si arti dhe letërsia dekadente e të gjitha kohëve ka qenë e lidhur me klasat më reaksionare të shoqërisë dhe me partitë e me drejtimet ideo-logjike e politike më regressive, me feudalizmin dhe me klerikalizmin (Shatobriani), me borgjezinë imperialiste (Dali), me fashizmin (D'anuncio, Marineti), me mikroborgjezinë (simbolistët francezë), me revizionizmin (Shollohoy, Solzhenicin, Jevtushenko) etj. etj. Nga pozita përgjithësisht mikroborgjeze krijohet edhe në ditët tona një

pjesë e letërsisë dhe e artit të Perëndimit, i cili ushtron një ndikim paralizues në lëvizjen revolucionare, duke ushqyer individualizmin antishoqëror mikroborgjez. Edhe në letërsinë tonë të së kaluarës shkrimtarët reaksionarë kanë qenë të lidhur me forcat më regresive shoqërore e politike (Fishta me klerikalizmin e me patriarkalizmin. Koliqi me fashizmin etj.)

Shkrimtarët dhe artistët përparimtarë, brënda kufijve të kushteve historike në të cilat jetuan, të botëkuftimit dhe të metodës artistike që kishin, në tendencën e tyre kryesore kanë qenë popullorë dhe kanë shtruar turrenë e thellimit gjithnjë më të madh të karakterit popullor të letërsisë e të arteve, duke krijuar kështu një vazhdë të ndritur përparimtare që arrin deri në letërsinë e në artet e realizmit socialist, në të cilat karakteri kombëtar, popullor, klasor dhe i partishëm marrin një përbajtje dhe një shprehje artistike të re, më të lartë dhe më revolucionare. Në letërsinë tonë kombëtare nga De Rada deri te Migjeni është luftuar për një krijimi patriotike dhe demokratike dhe gjatë kësaj periudhe është theksuar fryma luftarakë klasore dhe janë përforcuar anët më të mira të karakterit kombëtar dhe popullor të krijimtarisë. Kjo traditë kombëtare, dhe tradita e pasur e letërsisë dhe e artit përparimtar e revolucionar botëror kanë qenë një mbështetje e fortë për sukseset e realizmit socialist.

## 1.

Partia ka theksuar vazhdimisht, që kultura dhe arti ynë socialist, sipas parimeve të njoitura marksiste, duhet të jenë «socialistë në përbajtje dhe kombëtarë në formë», duke siguruar kështu një unitet dialektik historik ndërmjet karakterit klasor e të partishëm revolucionar dhe karakterit kombëtar socialist. Që në raportin e mbajtur në Kongresin I të PKSH (nëntor 1948), në diskutimin në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (qer-

shor 1949) dhe në shënimet «Këshilla për shkrimtarët e rinj», shoku Enver Hoxha ka parashtuar tezën se letërsia dhe artet duhet të mbështeten fort në *truallin amtar* dhe të kenë një karakter të përcaktuar kombëtar socialist.

*«Kultura jonë nationale»* thotë shoku Enver, «duhet të jetë, siç na mëson shoku Stalin, socialiste në përbajtje *dhe nationale* në formë. Ajo duhet të jetë pasuri e masave të gjera të popullit, t'i shërbejë popullit, ta edukojë popullin me frymën e internacionalizmit proletar, të forcojë pushtetin popullor dhe të zbulurojë jetën e njeriut.<sup>18)</sup>

Karakteri kombëtar i kulturës dhe i artit të një populli është shprehje e tërësisë së veçorive të tij kombëtare e të formuara dhe të kristalizuara historikisht në procesin e lindjes e të zhvillimit të kombit. Ai është shprehje e konstitucionit të njëjtë shpirtëror të të gjithë bashkëkombasve, e atyre veçorive në mënyrën e jetesës e në konceptimin e gjërave, që e dallojnë një komb prej një kombi tjeter edhe kur ndodhen në shkallë të njejtë zhvillimi shoqëror. Vetë kushtet historike të zhvillimit ndikojnë që në kulturën dhe në artin e kombeve të ndryshme brendia e përgjithshme shoqërore, edhe kur është e njejtë, të shfaqet në mënyra të ndryshme, të marrë trajta origjinale të shprehjes në çdo vend dhe brenda çdo vendi në periudha të ndryshme historike. Në arkitekturë, në kostume, në zakone, në gjuhë, në këngë, në valle, në letërsi, në artet figurative e të aplikuara dhe në çdo formë tjeter të kulturës materiale e shpirtërore të popullit çdo gjë të kujton dhe të flet për historinë e popullit, për karakterin e tij, për mënyrën e jetesës dhe për ato veçori të botëvështrimit, që përcaktohen prej fatave historike të popullit. Në këtë krijimi të gjërë popullor për përvetësimin material dhe shpirtëror të bantës reflektohet ashpërsia dhe madhështia e maleve tona,

18) Enver Hoxha: Dhjetë vjetë nën udhëheqjen e Partisë, 1951, f. 56.

ushtima e luftave të pandëprera kundër armiqëve të shumtë e të egër, hovi i heroizmave të popullit gjat shekujve, nderimi i trimave, gjurmët e përpjekjeve për të siguruar jetën, dëshira për ta gëzuar atë, shpërthimet e forta dhe qëndrueshmëria e ndjenjave, vrulli në beteja dhe durimi në punë, deri edhe dridhjet delikate të zemrës para bukurive të natyrës dhe kënaqësive të jetës. Në këtë krijimtari ka depërtuar, sidomos me revolucionin popullor, entuziazmi dhe optimizmi revolucionar, besimi në të ardhmen, krenaria e shumëfishuar kombëtar, idealitet e socializmit e të komunizmit fitimtar. Në këtë mënyrë karakteri kombëtar i kulturës dhe i arteve tona, duke ruajtur tiparet themelore dalluese, është zhvilluar dhe është pasuruar me elemente të reja të rëndësishme, që lidhen me kalimin e vendit tonë në etapën e re historike.

Historikisht në zhvillimin e kombit tonë, pra edhe të karakterit kombëtar të kulturës e të artit, dallohen mirë dy etapa me rëndësi: etapa parasocialiste, që nis me Rilindjen Kombëtare dhe etapa socialistë, që nis me Çlirimin e vendit dhe fitoren e Revolucionit Popullor, më 1944. Sot në Shqipëri rron një komb socialist, pa klasa antagonistë, që ka në themelët e veta aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste, që udhëhiqet nga PPSH. Ky ndryshim rrënjesor historik në strukturën klasore të kombit ka sjellë si pasojë edhe ndryshime në karakterin kombëtar të kulturës e të artit, të cilat duke u pasuruar me një brendi të re revolucionare, kanë fituar edhe shumë elemente të reja shprehëse, që janë zhvillim i tipareve më pozitive të së kaluarës dhe reflektim i kushteve të reja historike, i vendit që zenë masat punonjëse me klasën punëtore në krye në jetën e sotme shoqërore dhe i humbjes së pozitave ekonomike, politike dhe shpirtërore të klasave të dikurshme shfrytëzuese.

Karakteri kombëtar i artit dhe i letërsisë është përaktuar në radhë të parë prej shkallës së pasqyrimit në të të shpirtit të kombit dhe të aspiratave të tij përparimtare. Në të kaluarën ka patur shkrimitarë, ndër të cilët

Gjergj Fishta, të cilët kanë qënë të lidhur me forcën shqërore regresivë dhe kanë ekzaltuar në veprat e tyre rendin fisnor e të bajraqeve me pretekstin se nëpërmjet ambienteve dhe tipeve patriarkale u pasqyruakan më mirë tiparet kombëtare të shqiptarit. Reflekse të zbeta të një kuptimi të tillë të karakterit kombëtar të letërsisë e të artit janë dukur edhe në fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist dhe në mendimin tonë kritik. Në disa drama e poema të viteve '50, krahas pasqyrimit të trimërisë dhe të shpirtit luftarak të popullit, janë manifestuar dhe tendenca të lëvdimit të rendit fisnor dhe të zakoneve e të mentalitetit patriarkal. Mbështetur në këto koncepte dhe në këtë praktikë krijuese me pretekstin e ruajtjes së traditave kombëtare, disa herë në mendimin tonë kritik janë shprehur pikëpamje të theksuara konservatore, që mohomin çdo zhvillim dhe arrinin gjeratje sa edhe disa forma të shprehjes artistike, siç është vargu i lirë, t'i shpallin «të huaja» për karakterin kombëtar të letërsisë dhe t'i venë, bile, në kundërshtim edhe me vetë natyrën e gjuhës shqipe. Në këto raste e reja është gjykuar e vlerësuar nga pozitat e së vjetërës, në një kohë kur, siç dihet, karakteri kombëtar, si në kuptimin ideologjik edhe në kuptimin estetik, është shprehje e pikëpamjeve, e qëllimeve dhe shijeve të klasave inë të përparuara, që përbëjnë forcën më revolucionare, lulën e vendit, të ardhmen e tij. Prandaj Partia ka qenë kurdoherë si kundër mohimit metafizik të traditave kombëtare, edhe kundër gjunjëzimit para tyre, që do të frenonte zhvillimin dhe do të kthente shikimin e njerëzve të artit e të kulturës nga e ardhshmjëa në të kaluarën.

Në dokumenta të ndryshme të Partisë është theksuar më se një herë rëndësia e forcimit dhe e zhvillimit të mëtejshëm të karakterit kombëtar të letërsisë e të arteve tona, duke shtruar si detyrë në këtë drejtim luftrën e njëkohëshme dhe pa lëshime kundër kozmopolitimit borgjez, që është ideologjia reaksionare e ekspansionit imperialist, veçanërisht e imperializmit amerikan dhe kundër nacionalizmit borgjez — armik të shpirtit re-

volucionar socialist të letërsisë e të arteve. Sipas mësimave të Partisë: «Tiparet kombëtare janë ato që dallojnë artin e një populli nga arti i një populli tjetër, ato që i jepin atij një vullë të fortë origjinaliteti dhe që e bëjnë artin më të efektshëm për edukimin estetik të njerëzve. Ai është së pari pasqyra e një shoqërie të caktuar dhe pastaj e shoqërisë në përgjithësi»<sup>19)</sup>

Letërsia dhe artet tona të realizmit socialist, në tërën e tyre, kanë karakter të përcaktuar kombëtar, që mishërohet në pasqyrimin e fateve historike të popullit, në gdhendjen në figura artistike të fuqishme të karakterit kombëtar, në frymën e shëndoshë të krenarisë e të dashurisë për Atdheun, në reflektimin në vepra të shijeve artistike të formuara gjatë shekujve e të përpunuara në kushtet e ndërtimit të socializmit, në gjuhën e pastër shqipe, në futjen në vepra të ngjyrave, të dritës, të tingujve të natyrës e të jetës shqiptare, të dinamizmit, të ritmeve dhe të tempit luftarak të realitetit tonë të sotëm. Pra, karakteri kombëtar nuk lidhet vetëm me trajtimin e temave historike dhe as me pasqyrimin vetëm të luftës së popullit për çlirimin kombëtar dhe për mbrojtjen e Atdheut. Ai ka një kuptim më të gjerë se sa trajtimi i motiveve patriotike, në të cilat veçoritë kombëtare mund të janë më të dukshme, po nuk përbëjnë gjithë përbajtjen e nocionit karakter kombëtar. Çeshtja është që trajtimi i çdo teme dhe çdo vepre për të kaluarën historike apo për kohën tonë, për luftën çlirimitare apo për punën ndërtimitare, për tema politike apo shoqërore dhe etike të bëhet në formë kombëtare, të mbajë vulën e ditëve tona, vulën e Shqipërisë socialiste. «Generali i ushtrisë së vdekur» nuk ka karakter kombëtar më të dobët se «Kështjella» ndonëse në të dy veprat janë pasqyruar dy epoka të largëta në kohë e në karakter prej njëra-tjetrës. «Partizanët e batalionit «Hakmarrja» i S.

19) Ramiz Alia: Mbi disa çeshtje të letërsisë dhe arteve («Rruga e Partisë» 1961, Nr. 8).

Shijakut apo «Barinjtë» e D. Jukniut kanë po aq ngjyra kombëtare së edhe «Vrana Konti në Krujë» e S. Kamberit; grupi skulptural «Heronjtë e Vigut» i Sh. Haderit tingëllon po aq shqiptar sa edhe monumenti ekuestër i Skënderbeut. Të njejtën gjë mund të themi për baletet «Halili è Hajria» dhe «Cuca e maleve» dhe për shumë vepra të tjera letrare, muzikore të arteve figurative, të teatrit e të kinematografisë etj. Në qoftë se do të niseshim nga një kuptim i ngushtë i karakterit kombëtar në tematikë dhe në mjetet shprehëse do t'ishte e vështirë, në mos e pamundur, të gjenim atë gjë të përbashkët në zhvillim që lidh me njëra-tjetrën vepra që u kushtohen epokave dhë temave më të ndryshme. Më e vështirë aksoma do të ishte, pastaj, ta gjenim këtë gjë të përbashkët në krijimtarinë e shkrimitarëve e të artisteve të epokave të ndryshme, të gjenim, për shembull, atë gjë të përbashkët që kanë Naimi, Migjeni e Kadareja etj. Në qoftë se do të thuhej se ndërmjet tyre nuk ka diçka të përbashkët duke u nisur prej ndryshimeve që bien në sy në tematikë, në stilë etj. atëherë do të bënim një pohim krejt absurd, mbasi në të gjithë këtë krijuimtarin, në një formë ose në një tjetër ndihet tingulli i shpirtit të shqipatarit në lëvizje të përjetshme shtigjeve e rrugëve të historisë, që nga lashtësia deri në ditët tona.

Duke vënë theksin në karakterin kombëtar të krijuimtarisë letrare e artistike të epokave të ndryshme nga Rilindja e këtej do të ishte pa vend të pohohej, nga ana tjetër, se ky karakter kombëtar ka mbetur ai që ka qënë. Një pohim i tillë gjithashu do t'ishte paradosal, mbasi dihet që kombi është një kategori historike që lind në kushte të caktuara historike, zhvillohet historikisht dhe, në një të ardhme shumë të largët edhe do të shuhet. Ky zhvillim historik i kombit reflektohet domosdo edhe në karakterin kombëtar të kulturës e të artit. Karakteri kombëtar i kulturës socialiste në themel e veta është i shkrirë me karakterin klasor proletar dhe me frymën e partishmërisë komuniste, gjë që nuk mund të arrihej në letërsinë dhe në artin pararendës, tek të cilët, përkundra-

zi, gjejmë ndikimet e botëkuptimeve e të shijeve të klasave shfrytëzuese, që duke ngushtuar karakterin popullor të krijimtarisë, dobësojnë edhe karakterin kombëtar të saj.

Në letërsinë dhe në artet e realizmit socialist, arrinhet uniteti i plotë i analizës klasore dhe i karakterit kombëtar. Një veçori e tillë ka të bëjë me natyrën e shoqërisë socialiste, në të cilën zhdukjet kontradikta historike ndërmjet masave punonjëse dhe shtetit çifligaroborgjez. Atdheu bëhet i gjithë popullit, i cili merr në duart e veta fatet e kombit dhe e përfaqëson atë në kundërshtim me aspiratat reaksionare të klasave shfrytëzuese. Ky realitet historik bën që në karakterin kombëtar të letërsisë e të artit të zhduken ndikimet negative të shijeve feudale, borgjeze e mikroborgjeze dhe të fitojnë shijet dhe pikëpamjet e masave punonjëse, të zotërojë ekstrati popullor. Drejtimin kryesor karakterit kombëtar të letërsisë dhe arteve tona të sotme ia jepin idealet revolucionare që frysmezojnë popullin në ndërtimin e socializmit, në gadishmérinë përmbrrojtjen e Atdheut socialist, në luftën kundër imperializmit e revolucionizmit përmbrrojtjen e popujve dhe përfitoren e marksizëm-leninizmit. Ai është mishërim i virthyteve të larta të popullit dhe i shijeve të tij të shëndosha estetike. Për këtë brendi të re të karakterit kombëtar të kulturës e të artit tonë socialist foli shoku Enver në Kongresin VI të PPSH, duke e pasuruar më tej konceptin dhe duke e parë atë në lidhjet dialektike me kushtet historike të epokës sonë. Pasi flet përmbrrojtja e pasqyrimit në veprat letrare e artistike të kontradiktave të kohës, shoku Enver thekson:

«Të gjitha këto, si edhe mbështetja fort në truallin kombëtar, në krijimtarinë dhe trashëgiminë kulturale përparimtare të popullit tonë, i jepin letërsisë dhe artit socialist atë originalitet dhe atë novatorizëm që e dallojnë nga të tjerët, jo vetëm si krijimtari e një populli dhe e një kombi të caktuar, po edhe përmbrrojtja që fiton kjo krijimtari përmes kushteve të luftës kundër imperializ-

mit e revolucionizmit modern dhe përmbrrojtja e gjithë jetës së vendit.»<sup>20)</sup>

Lenini zbuloi qenien në shoqërinë me klasa antagoniste të dy kulturave kombëtare brënda çdo kulture kombëtare: të kulturës demokratike, përparimtare, revolucionare të popullit dhe të kulturës reaksionare të klasave shfrytëzuese<sup>21)</sup>. Në socializëm shkohet drejt krijimit të një kulture të vetme kombëtare, që përfaqësohet prej kulturës demokratike-revolucionare, po edhe pas zhdukjes së kulturës «kombëtare» reaksionare, vazhdojnë të jetojnë përmbrrojtja kohës së gjatë shumë mbeturina dhe ndikime të vjetra, të cilat ushqehen në kushtet e sotme prej trashëgimeve feudale e borgjeze, prej pikëpamjeve dhe shijeve mikroborgjeze si dhe prej ndikimeve borgjeze e revolucioniste. Përmbrrojtja arsyesh, si në çdo drejtim tjetër edhe në forcimin e karakterit kombëtar të artit të realizmit socialist, tiparet e reja janë të lidhura me luftën kundër imperializmit e revolucionizmit dhe me revolucionarizmin e gjithanshëm të jetës së vendit. Kjo luftë i jep karakterit kombëtar të kulturës e të artit përbajtjen kryesore të kohës, gjallërinë dhe freskinë e mendimeve, të ndjenjave dhe të formave, atë gjë të vëçantë, që e dallon letërsinë dhe artin kombëtar të dëtitëve tona nga ai i kohëve të mëparshme.

Në bazë të këtyre orientimeve marksiste-leniniste të Partisë përmbrrojtja e karakterit kombëtar të krijimtarisë para shkrimitarëve dhe artisteve lindin kurdoherë probleme të reja dhe dalin detyra ideoartistike, që kërkojnë zgjidhje më të plotë dhe më të përsosur. Studimi më i thellë dhe përgjithësimi më i guximshëm i thesarit të traditës popullore e kombëtare, duke dalë më me vendosmëri prej kufijve krahinorë dhe prej mbivlerësimit të anëve të vëçanta të traditës, ndjekja me vëmendje dhe pasqyrimi me realizëm i elementeve të reja, që kanë hyrë në jetën e popullit, në realiztin, në psikologjinë,

20) Enver Hoxha: Raport në Kongresin VI të PPSH-së, f. 160.

21) Lenini përmbrrojtja e gjithë jetës së vendit, Tirana 1960, f. 184.

në mënyrën e jetesës dhe në shijet estetike, që pasurojnë dhe plotësojnë karakterin kombëtar të kulturës, lufta kundër ndikimeve ende të dukshme të kulturës së vjetër dhe rutinës, që e lidh karakterin kombëtar kurdoherë me të kaluarën qoftë kjo edhe e afërt, mbajtja pastër e fizionomisë kombëtare të kulturës e të artit prej ndikimeve negative të huaja dhe shfrytëzimi me mjeshtëri i traditës botërore në dobi të kulturës e të artit kombëtar socialist, përtëritja e formave të shprehjes artistike si pasqyrime të shijeve të sotme estetike të masave do të ishin disa prej drejtive kryesore të punës së mëtejshme për forcimin dhe zhvillimin e karakterit kombëtar të letërsisë e të arteve të realizmit socialist.

Në Plenumin IV të KQ të PPSH u theksua edhe një herë domosdoshmëria e forcimit të mëtejshëm të karakterit kombëtar socialist të letërsisë e të arteve tona si një kusht me rëndësi për të ruajtur origjinalitetin dhe epërsinë e tyre ndaj rrymave dekadente e formaliste të ushqyera prej teorive reaksionare kozmopolite, që përpunojnë e përhapen prej ideologëve dhe estetëve imperialistë dhe socialimperialistë që e kanë bazën në politikën imperialiste të skllavërimit të popujve, të nënshtimit të tyre, të «sovranitetit të kufizuar» etj.

*«Borgjezia imperialiste»* thuhet në raportin e mbajtur nga shoku Enver, «gjithnjë është përpjekur të denigrojë apo të zhdukë traditat kulturale të popujve të vegjël, frysni kombëtare të artit e të kulturës së tyre. Kjo është një nga rrugët për realizimin e agresionit të saj kultural e të nënshtimit të popujve. Koncepti reaksionar borgjezi mbi «ndërkombëtarizmin» e kulturës e të artit, mendimet se «tanimë u kapërcye fazë e shkollave kombëtare», kanë për qëllim zhdukjen e kulturave të popujve të tjere. Në këto kushte për ne bëhet edhe më imperativë lufta për të ruajtur fizionominë kombëtare të artit, pasurinë kulturale të popullit.

Duke luftuar për mbrojtjen e frysni kombëtare të letërsisë e të artit, ne gjithmonë theksojmë me forcë karakterin e tyre revolucionar e socialist. Brendia socialist-

te është tipari dallues e më esencial i letërsisë dhe i artit tonë. Kjo brendi ka një karakter të qartë klasor proletar. Si e tillë ajo duhet të realizohet në unitet me formën kombëtare, gjë që e shohim edhe në praktikën e krijimtarisë sonë letraro-artistike»<sup>22)</sup>

## 2.

Arti dhe letërsia e realizmit socialist, krahas formës së qartë kombëtare, që u jep origjinalitetin e shprehjes, si kontribut i veçantë i çdo kombi në thesarin e kulturës botërore, kanë edhe një karakter të thellë e të gjerë popullor, që shprehet nëpërmjet brendisë së tyre ideoemonionale dhe mishërimit në të të jetës dhe të aspiratave demokratike e revolucionare të masave punonjëse.

Edhe letërsia dhe artet përparimtare të së kaluarës kanë patur karaktere popullor, që është shprehur në pikëpamjet demokratike të shkrimitarëve dhe të artisteve, në trajtimin e temave nga jeta dhe lufta e masave punonjëse, në simpatinë dhe përkrahjen për «vegjelinë», në kritikën dhe urrejtjen kundër skllavërisë dhe skllavëruesve, në pasqyrimin, deri në një farë mase, të idealeve të punonjësve për një jetë më të mirë e të denjë njerëzore, në nisjen prej pikëpamjeve popullore për jetën dhe prej shijeve të tyre estetike. Ky karakter popullor i letërsisë dhe i artit përparimtar të së kaluarës ka ardhur vazhdimi i duke u theksuar dhe duke u mprehur deri sa ka marrë formën e thirrjeve të harta revolucionare për përbysjen e rendit skllavërues çifligaroborgjez dhe për krijimin e një rendi të ri shoqëror, ku të sundonin liria dhe barazia shoqërore, ku njerëzit e punës të gjëzonin frytet e djersës e të mundit të tyre. Prandaj përbajtja e karakterit popullor të krijimtarisë artistike nuk ka qënë e njëjtë për të gjitha epokat dhe për të gjithë shkrimitarët e artistët. Ajo ka ardhur duke u pasuar

22) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, I, 28-29.

dhe duke u mprehur historikisht sipas afërsisë që kanë krijuar shkrimtarët dhe artistët me jetën dhe idealet popullore, sipas shkallës se sa krijimtaria e tyre ka buruar nga populli dhe është vënë në shërbim të tij. Popullore ishte vepra e Naimit mbasi në të njihet lufta e popullit për liri kombëtare, i këndohet punës së bujkut e të bariut, u qahët halli të varfërve dhe aludohet në mënyrë utopike për një shoqëri ku të pasur e të varfër do të rrojnë si «vëllezëri». Çajupi dhe Mjeda e shpunë më përrapa këtë brendi demokratikë, duke hedhur poshtë iluzionin e «vëllazërisë» dhe i dhanë krijimtarisë së tyre një frysë antifeudale, duke dalë si mbrojtës të fshatarësisë. Kritika kundër feudalëve në veprën e tyre del prej kufijve të çështjes patriotike dhe merr karakter më të gjerë popullor. Pas tyre Fan Noli e vëcanërisht, Migjeni dhe letrarët revolucionarë të viteve '30 u bënë përfaqësues të rrymës më demokratike të kohës dhe arritën deri në pranimin e dhunës revolucionare, që ndonjëherë e shprehën fare qartë duke iu drejtuar «katundarëve dhe punëtorëve», «vullneteve të ndrydhura» dhe «bijve të shekullit të ri».

Në veprat e shkrimtarëve përparimtarë të së kaluarës ka ardhur duke u zgjeruar edhe shkalla e pasqyrimit në vepra e jetës dhe e hallevë të masave popullore. Paraqitjes romantike e të idealizuar të jetës së barinjve e të bujqve në poemën «*Bagëti e bujqësi*» ia zënë vendin më vonë tablotë realiste të fshatit shqiptar në poezinë e Çajupit dhe në poemën «*Andrra e jetës*» të Mjedës, heroi i të cilave, në aspekte të ndryshme, është fshatari shqiptar. Edhe në disa vepra të prozës (romanet «*Lulja e kujtimit*», «*Sikur t'isha djalë*») heroi është marrë prej shtresave popullore dhe nëpërmjet tij shkrimtarët kanë përfaqësuar disa ideale demokratike përparimtare me kufizimet e njohura të botëkuptimit, të pikëpamjeve shoqërore dhe të metodës së tyre artistike jo plotësisht realiste. Në veprën e Migjenit ky pasqyrim i jetës popullore, sidomos i shtresave më të varfëra dhe më të shtypura të qytetit që të fshatit, në aspektet më dramatike e më tragjike të saj, arrin kulmin e letërsisë të së kaluarës.

Edhe në vepra të tjera të shkrimtarëve e të artistëve tanë të së kaluarës është pasqyruar deri në një farë mase jeta, hallet dhe vuajtjet e popullit. Në veprën skulpturale «*I urituri*» Odise Paskali na ka dhënë një figurë rrëqethëse të vuajtjes njerëzore brenda kushteve historike të kohës dhe realitetit shqiptar, që me forcën e përgjithësimit artistik dhe me realizimin që e karakterizon, i kapërcen shumë kufijtë e rrethanave që e kanë lindur. Në muzikë kjo frysë demokratike u përfaqësua kryesisht me interesimin për këngën popullore, me përpunimin dhe përhapjen e saj prej artistëve të shquar si Tefta Tashko, Marie Kraja etj.

Kjo traditë demokratike e artit të së kaluarës përbën një bazë të shëndoshë për zhvillimin e mëtejshëm të karakterit popullor në letërsinë dhe në artet e realizmit socialist. Duke njohur këtë traditë pozitive si dhe kufizimet ideore dhe tematike të saj, shkrimtarët dhe artistët e realizmit socialist kanë bërë një punë me vlerë të madhe për demokratizimin e mëtejshëm të krijimtarisë, për zbulimin më të gjithanshëm të karakterit popullor të saj në brendi dhe në formë. Në vepra të shquara të letërsisë, të pikturës, të muzikës, të artit skenik etj. është pasqyruar jeta e masave punonjëse në të kaluarën, gjatë Luftës Nacionale kirimtare dhe në periudhën e ndërtimit socialist. Përmasat e pasqyrimit të jetës së punonjësve dhe të mishërimit në figura artistike të idealeve të tyre në veprat e realizmit socialist janë shumë më të gjera dhe më të përcaktuara se sa edhe në veprat më të shquara e më përparimtare të së kaluarës.

Në themel të karakterit popullor të letërsisë e të arteve të realizmit socialist qëndron njohja e rolit historik të masave punonjëse, të veprimtarisë së tyre aktive e të ndërgjegjëshme për shndërrimin revolucionar të botës, të faktit se ato janë autorët dhe aktorët kryesorë në jetën e njerëzimit dhe në përcaktimin e fateve të vendit. PPSH jo vetëm që i është përbajtur me besnikëri këtij parimi marksist, po ka ndërmarrë shumë vep-

rime konkrete me rëndësi historike pér të têrhequr mendimin dhe forcën e masave punonjëse pér realizimin e revolucionit popullor dhe pér ndërtimin e shoqërisë sociale. Ajo ka kultivuar në popull ndjenjën e përgjegjësisë pér fatet e revolucionit dhe i ka bërë ato të ndërgjegjshme pér misionin që kanë. Nëpërmjet zbatimit me konsekuençë të vijës së masave punonjësit e vendit tonë e, sidomos klasa punëtore, e ndiejnë veten zotër të vendit dhe ushtrojnë ndikimin e tyre revolucionar në jetën ekonomike, shoqërore dhe politike. Parulla leniniste e Partisë: «socializmin e ndërtojnë masat, Partia i bën ato të ndërgjegjëshme» pasqyron më së miri vëndin që zënë punëtorët e fshatarët në veprimin revolucionar dhe rolin që luan pararoja e tyre — Partia.

Ky orientim i përgjithshëm ideologjik dhe politik i Partisë është reflektuar edhe në krijimtarinë letrare e artistike. Letërsia dhe artet tona janë prirë kurdoherë drejt qëllimit që të pasqyrojnë sa më realisht jetën, luftën dhe punën e masave punonjëse, të mbruhën me idealitet e tyre, të vënët në qendër të veprave heronjtë e dalë nga gjiri i popullit, ata që përfaqësojnë dhe mishërojnë veprimin aktiv të masave në shndërrimin revolucionar të jetës, në luftë e në punë pér ta bërë atë sa më të lumenj më të bukur, pér të shprehur kështu në aspektet më të ndryshme idenë se:

*Zot i madh i këtij vendi  
është vetë populli... — siç thuhet në një  
këngë popullore.*

Në veprat më të mira të letërsisë dhe të arteve të realizmit socialist, nëpërmjet pasqyrimit me realizëm të ambienteve dhe të heronjve popullorë, të mendimeve e të ndjenjave të popullit, është shtruar dhe është vënët në rrugën e zgjidhjes së drejtë edhe problemi i raporteve të individit e të masës, të heroit dhe të popullit, gjë që ka sjellë dhe po bie ndryshime me rëndësi, jo vetëm në brendinë ideologjike, po edhe në formën artistike të veprave. Filli kryesor ideologjik që përshkon letërsinë

dhe artet e realizmit socialist në këtë drejtim është shprehur qartë një shekull më parë nga poeti komunar Eugjen Potje, i cili shkruante:

*Nga zot, as mbret s'duam shpëtimin,  
as nga heronjtë kordhëtar,  
me duart tona ne shpëtimin  
do ta fitojmë, o proletarë...*

Kjo frymë e shëndetëshme popullore ka pëershkuar edhe letërsinë dhe artet tona dhe ka bërë që në to t'u jepet vendi i merituar masave punonjëse dhe preokupimi kryesor i shkrimitarëve të jenë problemet dhe veprimtaria krijuar historike e këtyre masave.

Në romanin «Këneta» pér shembull është pasqyruar puna dhe entuziazmi popullor në një aksion të madh revolucionar dhe është shtruar e zgjidhur drejt nga pozita realiste revolucionare problemi i raporteve të heroit me masat, duke e vlerësuar këtë hero jo si «trim kordhëtar», po në bazë të faktit se gjer në ç'shkallë përfaqëson ai virtytet dhe idealet popullore, sa vihet në shërbim të popullit dhe ç'tipare karakterizojnë marrëdhëniet e tij me masat. Megjithëse në vepër heroit kryesor *Stavri Larës* i jepet vend me rëndësi si organizator, drejtues dhe frymëzues i masave, gjë që përcaktohet edhe nga rrethanat historike në të cilat zhvillohen ngjarjet, tingullin e saj kryesor nuk e përbën mbivlerësimi i heroit, po njohja prej tij dhe prej vetë shkrimitarit e rolit vendimtar të masave në tharjen e kënetës dhe në ndëshkimin e armiqve. Shkrimitarit nuk i ka shpëtuar as pasqyrimi aty-këtu i veprimtarisë së Partisë pér të futur ndërgjegjjen revolucionare në masat dhe ndërhyrja e masave pér t'u diktuar kuadrove një metodë dhe stil revolucionar në zgjidhjen e problemeve dhe në qëndrimin ndaj njerëzve.

E njëjtë frymë sundon edhe në pjesën më të mirë të krijimtarisë letrare e artistike të realizmit socialist, në të cilën pothuajse asnjëherë nuk është vënë re tendencia e mbivlerësimit të heroit nga pozitat idealiste të kultit të

individit, meqjithëse puna për një pasqyrim më të plotë dhe më artistik të veprimtarisë krijuese të masave dhe raporteve të tyre me heronjtë e veprave do të kërkojë përpjekje akoma më të mëdha për të gjetur atë zgjidhje revolucionare që tanimë ka gjetur në realitetin e shoqërisë socialiste. Puna e fryshteshme që është bërë deri tani dhe kërkimet e shkrimitarëve e të artistëve për të zgjeruar kornizat e veprave të tyre dhe për të përfshirë në to veprimtarinë konkrete të masave dëshmojnë se ky ka qenë dhe mbetet një shqetësim krijues me rëndësi, që ka të bëjë me zbatimin më të plotë të parimeve të materializmit historik në krijimtari.

Një hap me rëndësi në pasqyrimin e veprimtarisë aktive të masave për ndërtimin e socializmit dhe për revolucionarizimin e gjithanshëm të jetës së vendit, u hodh në letërsinë dhe në artet tonë pas Kongresit V të PPSH, si pasqyrim i aksioneve të mëdha revolucionare, që u ndërmorën nga masat punonjëse për shpejtimin e ritmeve të ndërtimit të socializmit, për çrrënjosjen e shumë të këqijave të trashëgura nga e kaluara dhe për kalitjen e ndërgjegjes revolucionare të njerëzve. Në mjaft vepra të kësaj periudhe zëri i masave ushtoi më i fuqishëm dhe më i drejtpërdrejtë. Disa herë vendin e heroit të individualizuar e të vënë në qendër të subjektit të veprave e zuri pasqyrimi i drejtpërdrejtë i masës së punonjësve, e cila dikton vullnetin e vet dhe zbulon forcën dhe madhështinë e mendimeve dhe të shpirtit të popullit, që po fiton ndërgjegjen e «zotit të madh të vendit». Një gjë e tillë dëshmon se një brendi më e gjerë dhe më e plotë popullore do të sjellë edhe në të ardhmen ndryshime të tjera me rëndësi ideore dhe artistike, duke thyer ngushtësinë e mendimit tradicional dhe skemat artistike të huajtura nga e kaluara.

Në dokumenta të njoitura të Partisë është parashtruar një program i gjerë pune për thellimin e mëtejshëm të karakterit popullor të letërsisë e të arteve të realizmit socialist.

«Arti dhe kultura janë sociale» porosit shoku Enver «duhet të mbështet fortë në tokën tonë amtare,

në popullin tonë të mrekullueshëm, ato duhet të burojnë nga populli dhe të jenë plotësish të shërbim të tij, të qarta dhe të kuptueshme për popullin, por aspak «banele dhe pa ide». Partia është për një krijimtari artistike e kulturale, në të cilën përbajtjes së thellë ideologjike e fryshtës së gjerë popullore t'i përgjigjet një formë e lartë artistike, që të prekë thellë ndjenjat dhe zemrat e njerëzve, t'i fryshtësojë e t'i mobilizojë ato për veprat e mëdha».<sup>23)</sup>

Këtej del, veç të tjerave, se mbetet kurdoherë aktualë detyra e pasqyrimit më të gjerë të jetës së masave punonjëse dhe të ambienteve popullore, për të zbuluar në jetë dhe për të sjellë në veprat letrare e artistike një material të pasur, që ende nuk ka dalë, për të parë ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur e po ndodhin në mënyrën e jetesës, në zakonet, në marrëdhëniet dhe në mentalitetin e njerëzve të popullit, për t'u bërë kështu letërsia dhe artet pasqyrë e vërtetë, e gjerë dhe besnikë e jetës së popullit.

Në vepra të tilla, krahas fryshtës së përgjithshme popullore të pasqyrimit të jetës e të portretizimit të heroinje vërehet edhe vërtetësia e hollësive artistike në përshkrimin e ambienteve dhe në zbulimin e botës së brendshme të njeriut të thjeshtë, të njeriut të luftës e të punës, që filozofon pak, po shpreh me besnikëri filozofinë e popullit, qëndrimin e tij ndaj jetës. Duke përmendur këto rezultate do të ishte e padrejtë, siç është vënë re me kohë prej kritikës në qoftë se me ambiente popullore do të kuptionim vetëm ambientet e prapambetura të fshatit të dikurshëm shqiptar dhe të tipave që, meqjithë vitytet e tyre popullore, pasqyrojnë njëkohësisht edhe paditurinë dhe shkallën e ulët të zhvillimit, që sundonin vendin tonë në të kaluarën. Ambientet e sotme popullore të qytetit e të fshatit ende nuk po zenë vendin e duhur në veprat letrare e artistike. Një kufizim të tillë e gjejmë edhe në ato vepra, në të cilat ndërsa ambientet, tipat dhe mentalitetet e vjetra janë pasqy-

23) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së; f. 137.

ruar me realizëm dhe me forcë ideoemocionale, ambientet, tipat dhe marrëdhëniet e reja janë dhënë në forma jo aq të papërcaktuara, më tepër me intuitë, se sa në bazë përshtypjesh të gjalla nga realiteti i ditëve tona. Sot në krijimtarinë artistike ka ende shumë vend për pasqyrimin më të gjërat të jetës së shtresave të ndryshme popullore të qytetit e të fshatit dhe në këtë drejtim kanë patur e do të kenë sukses ata shkrimtarë e artistë që ndjekin me vëmendje ndryshimet e mëdha e të shpejta që ndodhin në jetën e popullit.

Një prej kufizimeve aktuale në letërsinë dhe në artet tona të sotme përsa i përket pasqyrimit të jetës së popullit është njëfarë intelektualizmi, që vazhdon të duket ende në krijimtarinë e shkrimtarëve e të atristëve dhe që e ka burimin në përpjekjet e tyre për të mbushur me «reflekse të botës personale» boshllëget që vinë prej njohjes së paktë e të përciptë të jetës. Ky intelektualizëm duket jo vetëm në përshkrimin e ambienteve intelektuale dhe në trajtimin e problemeve të kësaj shtrese shoqërore, po edhe në mbivlerësimin e rolit të intelektualeve në jetën shoqërore dhe në intelektualizimin e tipave të marrë nga populli. Këto kufizime, ku më shumë e ku më pak, i gjejmë në mjaft vepra të letërsisë së sotme. Kështu, për shembull, në romanin «Dasma» shkrimtari S.K., nëpërmjet të cilit janë pasqyruar mjaft nga episodet, ambientet dhe tipat e veprës, është vizatuar në mënyrë tepër të idealizuar si një figurë, në të cilën është ngjeshur gjithçka pozitive në mendimin dhe në qëndrimet e kohës, gjë që do t'i takonte në një masë shumë më të madhe kolektivit të punëtorëve. Jo qëndrimi i shkrimtarit ndaj punëtorëve, po qëndrimi i këtyre ndajtij do të kish patur vlerë shoqërore më të madhe dhe do të kish bërë që jeta të pasurohej më me realizëm. Po kështu në romanin «Brezat», megjithëse pasqyrohet një periudhë hovi revolucionar në jetën e fshatarësisë koooperativiste, është prapë intelektuali që shkon në fshat dhe ndikon për një ndryshim rrënjosor të gjendjes. Intelektualët popullorë kanë vendin e tyre në jetën shoqërore dhe në ndërtimin e socializmit, po përpëra masave

të gjera të popullit ata janë vetëm një shtresë, që kryen një mision pozitiv duke zbatuar vullnetin e popullit dhe duke u vënë në shërbim të tij me forcën e aftësive e të talentit të tyre.

Përpjekjet e mëtejshme për të futur më gjërisht dhe më me art figurën e njeriut të popullit, të punëtorit dhe fshatarit në veprat letrare dhe artistike përbëjnë një drejtim tjeter të punës së ardhshme për thellimin e karakterit popullor. Edhe deri më sot përpjekjet në këtë drejtim nuk kanë qënë të pakta dhe rezultatet e arritura janë me vlerë. Në galerinë e tipave më të realizuar të letërsisë e të arteve tona gjen shumë figura, që janë mishërim i vityteve dhe i fateve të popullit, që përfaqësojnë popullin, si me idealet që mbartin, edhe me tiparet dhe veçoritë që i karakterizojnë. Krahas kësaj, si në tematikë, edhe në tipat karakteri popullor shfaqet me sukses edhe nëpërmjet qëndrimit revolucionar popullor ndaj tipave jo popullorë e antipopullorë. Për t'i shpënë edhe më përpëra këto rezultate ideoartistike është e nevojshme që kujdesi i shkrimtarëve dhe i artistëve të jetë më i madh jo vetëm për prejardhjen shoqërore të heronjve dhe për hollësitë që lidhen me të, por sidomos për shkallën sa më të gjërat të pasqyrimit nëpërmjet tyre të shpirtit, të aspiratave dhe të idealeve të popullit në të kaluarën, gjatë Luftës Nacionallirimitare dhe vëçanërisht në ditët tona. Në vepra me hero qëndror si dhe në ato që pasqyrojnë heroizmin masiv dhe e reflektojnë jetën nëpërmjet personazhesh të shumtë pa ndier nevojën e një figure qëndrore, shtrohet problemi që nëpërmjet figurave artistike të fuqishme, duke përfshire këtu edhe qëndrimin e autorëve dhe heroin lirik të poeziës dhe të muzikës sinfonike, pa mohuar vlerën e hollësive realiste dhe të gjuhës populllore, rëndësi të dorës së parë ka mishërimi në figura i heroit popull, i cili ka mbartur mbi shpinë nëpër shekuj fatet e vendit dhe ka çarë përpëra me mund, me sakrifica dhe me heroizma për të arritur në dritën e ditëve tona dhe mban në mendje e në zemër dëshirën e përjetshme për të shkuar gjithnjë përpëra dhe më lart.

Një temë që do të ndikonte shumë në theksimin e karakterit popullor të letërsisë e të arteve dhe për bashkëkohësimin e mëtejshëm të këtij karakteri do t'ishte tema e punës, e cila, për të patur vërtetë një letërsi dhe një art të fuqishëm bashkëkohor, duhej të kishte zënë një prej vendeve më kryesore në krijimtarinë e shkrimitarëve dhe të artistëve tanë, krahas temave të tjera me rëndësi si ato të Luftës Nacionalçlirimtare, të shndërrimit të marrëdhënieve shoqërore etj.

Trajtimi i temës së punës do të kishte rëndësi jo vetëm se është pasqyrimi i një prej aspektave më themelorë të jetës së sotme shoqërore dhe veprimitaria më me rëndësi shoqërisht e dobishme e masave punonjëse, po edhe për të pasqyruar e për të kultivuar qëndrimin e ri socialist ndaj saj, për të mishëruar nëpërmjet figurash artistike bindëse rolin kryesor të punës për revolucionarizimin e botës shpirtërore të njeriut, për krimin e njeriut të ri të socializmit e të komunizmit.

Ana tjetër e karakterit popullor të letërsisë e të arteve është shprehur në orientimin e Partisë, që ato «*t'i drejtohen popullit, të janë të qarta dhe të kuptushme për popullin».*

«*Çdo gjë për popullin, çdo gjë që krijohet të mbajë vulen e krijimtarisë popullore, të shpirtit revolucionar popullor, të realizmit socialist. Jashtë këtyre asgjë nuk vlen*» — na mëson shoku Enver.<sup>24)</sup>

Për trajtimin e drejtë dhe të plotë të kësaj çështje, nëpërmjet së cilës në krijimtari e në mendimin kritik shfaqen prirje të ndryshme, është e nevojshme të nisemi, krahas domosdoshmërisë së pasqyrimit të jetës së popullit, brumosjes së veprave me aspirata dhe idealet demokratike e revolucionare të popullit dhe vëniec në qendër të tyre të heroit popullor, edhe prej domosdoshmërisë tjetër që shkrimitarët dhe artistët të asimilojnë përvojën shekullore artistike të popullit, të njojin shijet dhe pikëpamjet e tij të shëndosha estetike, t'i përpunojnë dhe t'i përparojnë ato dhe, në këtë mënyrë, jo vetëm në

plan ideor, po edhe në plan estetik e artistik, të janë përfaqësues të masave, të vihen në pararojë të tyre.

Dibet që letërsia dhe artet e realizmit socialist, në tërësinë e tyre janë në pozita të shëndosha popullore dhe prirjen e forcimit të mëtejshëm të këtyre pozitave e gjejmë në ata shkrimitarë dhe artistë, që janë lidhur ngushtë me popullin dhe kontribuojnë me krijimtarinë e tyre për edukimin e popullit me vepra të nivelit të lartë ideoartistik. Në këtë drejtim është për t'u vënë re që disa herë ngatërrohet karakteri popullor i krijimtarisë me pëlqimet stilistike të shkrimitarëve dhe të artistëve. Poezia e Lazar Siliqit është po aq popullore sa edhe poezia e Dritero Agollit, «*Kështjella*» dhe «*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*» të Ismail Kadaresë, sa «*Para agimit*» i Shefqet Mu-sarajt dhe «*Lumi i vdekur*» i Jakov Xoxes, tablotë e Guri Madhit sa ato të Fatmir Haxhiut, muzika e Feim Ibrahimit sa ajo e Nikolla Zoraqit, megjithëse përfaqësojnë prirje të ndryshme stilistike mbi bazën e parimeve të realizmit socialist.

Në këtë mes rëndësi kanë përpjekjet e ndërgjegjshme të tyre për të qenë të qartë e të kuptueshme për masat pa ulur nivelin artistik të veprave; pa u larguar prej trajtimit realist të materialit jetësor dhe pa fshehur prapa thjeshtësisë në dukje mungesën e ideve e të emocioneve, banalitetin artistik, përfytyrimin natyralist të jetës apo edhe meskinitetin disa herë. Thjeshtësia dhe qartësia artistike janë vlera të veprave të shquara, që pasqyrojnë një realitet të njojur mirë prej shkrimitarit e artistit dhe nië mendim të kthjellët e paekuivoke për problemet që trajton për botën dhe për njerëzit.

Mbi bazën e keqkuptimit që u përmend dhe të mbyllerësimit ose të nënveftësimit të ndikimit të formës artistike në krijuimtari, kanë lindur prirjet e kundërtë të vulgarizmit e të anakronizmit, nga nië anë dhe të subjektivizmit modernist, nga ana tjetër, të cilat nga dreitime të kundërtë cënojnë dhe démtojnë karakterin popullor të letërsisë e të artit. Në veprat me karakter vulgar dhe anakronik, që mbështeten në një njojje të kufizuar,

24) Enver Hoxha: Raporte e fjallime (1967-1968), 2. 487.

të përciptë dhe të vjetruar të shijeve estetike dhe të krijimtarisë artistike popullore dhe në lidhje të rastit me jetën, pasqyrohen koncepte ideoartistike primitive e të prapambetura, që bëhen pengesë për zhvillimin e e mëtejshëm të letërsisë e të artit, nuk merret parasysh niveli i shijeve dhe pikëpamjeve të përparuara të kohës dhe, për këtë arsy, populli nuk gjen ç'të mësojë prej tyre ndaj edhe i neverit. Veprat të tillë karakterizohen nga mungesa e mendimit, nga mefshtësia e depërtimit në proceset e gjalla jetësore. Nga ana tjetër, siç thotë shoku Enver Hoxha:

*«Ne jemi kundër shkëputjes së arteve dhe të letërsisë nga realiteti, kundër shkëputjes së tyre nga masat. Kërkesat për t'i larguar letërsinë dhe artet nga anakronizmi nuk duhet të identifikohen me përpjekjet për të krijuar një art dhe një letërsi të pakuptueshme për popullin»<sup>25)</sup>*

Luftha kundër subjektivizmit në letërsi e në art eshtë një luftë për të forcuar karakterin populor të tyre, një luftë që synon, nëpërmjet afritimit gjithnjë më të madh të shkrimitarëve dhe të artistëve me jetën, t'i çlirojë ata prej ndikimeve subjektiviste dhe prej tentimeve manieriste të kësaj natyre e t'u japë «vulen e krijimtarisë popullore, të shpirtit revolucionar populor». Bazë e subjektivizmit eshtë mosnjojja e jetës dhe e shijeve të popullit, mbivlerësimi i shijeve individuale apo të grupeve të kufizuara shoqërore, ndjekja e «modës artistike» me snobizëm dhe vështirësimi me tendencë i formës.

Eshtë e natyrshme që si në çdo fushë tjetër të veprimtarisë shoqërore dhe në fushën e krijimtarisë letrare e artistike përparimi dhe ngritja e vazhdueshme e nivelit ideoartistik nuk mund të arrihet duke u nisur prej shijeve dhe pikëpamjeve të prapambetura dhe as duke absolutizuar ato shije dhe pikëpamje që për një kohë përbëjnë «nivelin mesatar». Përparimi mund të arrihet me sulkses dhe me ritme më të shpejta, në qoftë se, du-

ke mbajtur parasysh «nivelin mesatar» do të nisej prej shijeve dhe pikëpamjeve më të përparuara të kohës, të cilat për këtë arsy përbajnë jo vetëm kërkesat e një periudhe të caktuar po edhe ato të perspektivës. Shkëputja prej masës në letërsi e në art nuk eshtë shkaktuar kurrë prej nivelit të lartë artistik (niveli i lartë kurdoherë eshtë i qartë), po prej pikënisjeve subjektiviste në brendi e në formë, që përdhunojnë realitetin dhe vështirësojnë artificialisht kuptimin e veprave, ose përkundrazi prej rënies së shkrimitarëve dhe artistëve në vulgarizim artistik.

*«Shkrimet e errta nga brendia dhe forma janë pjetllë e mendimit dhe e ndjenjave të çoroditura të njerëzve ku sundon regjimi i kapitalit, i shtypjes dhe i shfrytëzimit të njeriut, i shtypjes kombëtare dhe i mungesës së lirisë së shprehjes së mendimeve<sup>26)</sup>», prandaj për letërsinë dhe artet tona ka qenë e huaj «prirja e përdorimit të një figuracioni të errët në kundërshtim me traditën e poezisë aq të qartë shqipe.»*

Ndërmjet kulturës, artit dhe popullit në të kaluarën ka patur një hendek të madh ideoartistik, që nuk eshtë kapërcyri dhe as që mund të kapërcehej dot as prej shkrimitarëve dhe artistëve më përparimtarë. Ky hendek kish karakter ideologjik në rastin e kulturës e të artit të klasave sunduese apo të tendencave formaliste dhe manieriste të krijuar të ndryshëm. Arti dhe kultura e klasave shfrytëzuese, siç eshtë e natyrëshme, shprehnin interesat, botëkuptimin, moralin dhe shijet estetike të këtyre klasave, ishin të lidhura zakonisht me një botë në perëndim e sipër me një botëkuptim dhe botëvështrim reaksionar, me një moral konservator e hipokrit, me shije estetike të prapambetura, konservatore, që ishin shprehje e shthurjes morale dhe e mbeturinave anadollake në ndërgjegjën e këtyre klasave. Ndaj kësaj kulture dhe këtij arti populli i papërfillur prej tyre mban-

26) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre. (faqe 20).

25) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 488.

te qëndrim armiqësor, kurse shkrimtarët dhe artistët përparimtarë nuk arrinin dot ta hidhnin plotësisht hëndekun, jo vetëm pér shkak të kufizimeve ideoartistike të tyre, po edhe pér shkaqe themelore shoqërore e politike (varfëria dhe padituria) që e mbanin popullin larg jetës kulturore e artistike, sadoqë edhe kjo ishte vetë e varfër dhe e prapambetur. Pér këto arsyet letërsia dhe arti përparimtar i së kaluarës iu kthyen popullit dhe u bënë pronë shpirtërore e tij vetëm pas fitores së Revolucionit Popullor, nëpërmjet ngritjes së nivelit të masave deri në atë shkallë, sa jo vetëm t'i shijojnë ato, po edhe të mbajnë një qëndrim kritik ndaj kufizimeve dhe dobive të tyre ideoartistike.

Kur flitet sot pér një afrim më të madh të letërsisë e të arteve me popullin nuk është fjala pér ndonjë «hëndek» si ai i dikurshmi, mbasi bazë shoqërore dhe ideoartistike pér një ndarje të atillë nuk ka më, po vetëm shfaqje të veçantë të shkëputjes prej popullit, që janë reflekse ndikimesh të vjetra e të huaja në botëkuptimin dhe në pëlqimet artistike të shkrimtarëve e të artistëve të veçantë.

Në dritën e fjalimeve që mbajti shoku Enver më 1973 dhe të materialevë të Plenumit të Katërt të KQ të PPSH, opinioni ynë letrar e artistik kritikoi ashpér shumë shfaqje të huaja të shkëputjes së krijimtarisë prej popullit, nëpërmjet adoptimit prej disa pak poetëve të rinj të hermetizmit në poezitë e tyre, deformimit të vijës së qartë melodike dhe përhapjes së ritmeve të shfrenuara, sidomos në muzikën e lehtë, përdorimit të konvencionalizmit në artin skenik dhe shenjave të pranimit të disa «teknikave» moderniste në artet figurative.

Duke gjykuar këto shfaqje të huaja pér karakterin popullor të letërsisë e të arteve të realizmit socialist, në Plenumin IV të KQ të PPSH u theksua se ato «janë në kundërshtim me partishmërinë e letërsisë e të artit, me rolin formues dhe edukues, me karakterin popullor e kombëtar të tyre. Ato vënë një barrierë midis artit dhe

*popullit, zbehin natyrën demokratike që duhet të ketë arti ynë, prishin shijet e masave punonjëse»<sup>27)</sup>*

Një fushë më vete interesimi përbëjnë lidhjet e krijimtarisë letrare e artistike «të kultivuar» me krijimtarinë artistike të popullit. Në këtë drejtim ne trashëgojmë një eksperiencë të bukur nga e kaluara. Poetë të shquar si De Rada, Dara e Çajupi janë mbështetur fuqimisht në krijimtarinë e popullit dhe kanë lënë veprat me nivel të lartë ideoartistik, disa herë të një forme moderne, që ruan freskinë e shprehjes edhe në ditët tona. Krahas kësaj kemi patur edhe spekulime mbi krijimtarinë popullore si ato të Fishtës, apo me karakter formalist folklorizant si disa krijime të Lasgush Poradecit.

Vlera të shumta pozitive janë krijuar edhe në letërsinë e në artet e sotme në poezi, në prozë e në muzikë. Dashuria dhe afiniteti me folklorin, të kuptuara në mënyrë krijuese, janë shfaqje të dashurisë e të afinitetit me popullin.

Krijimtaria e gjerë dhe e larmishme popullore (vjerashat dhe përrallat, këngët dhe vallet, folklori teatral, mjeshtëritë artistike, kostumet dhe arkitektura popullore, veglat muzikore etj.) përbën një prej vlerave të paçmueshme të kulturës e të artit tonë kombëtar, që janë zhvilluar e pasuruar gjat shekuive si shprehje të drejt-përdreja të shpirtit të popullit dhe si konkretizime të mahnitshme të gjenisë krijuese të tij. Kjo pasuri e pallogaritshme e kulturës shpirtërore të popullit, jo vetëm që ka shërbyer dhe shërben pér edukimin ideoestetik të masave dhe është një prej formave të gjalla të shprehjes së realitetit, aspiratave dhe shijeve të tyre artistike edhe në ditët tona, po është edhe mbështetja më e gjerë dhe më e sigurt pér zhvillimin e mbarë të kulturës e të artit tonë kombëtar socialist. Asnjë krijimtar letrare e artistike e së kaluarës dhe e kohës sonë, sado e pasur dhe e përkryer që të jetë, nuk mund të zëvendësoj vle-

27) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 20-21.

rën kolosale që ka folklori si *taban* i patundshëm për letërsinë dhe artet e realizmit socialist, si shprehje autentike e shpirtit të popullit dhe fizionomisë kombëtare.

Vlerat e paçmueshme të folklorit tonë — edhe kur nuk njiheshin akoma mirë, — janë vlerësuar shumë lart prej studiuesve përparimtarë, kurse në kohën tonë në çdo manifestim kombëtar dhe në çdo festival e konkurim ndërkombetar ky floklor, duke u vënë përballë krijimtarisë së shumë popujve të tjerë, ka treguar origjinalitetin e papërsërithshëm, forcën e madhe shprehëse, vitalitetin dhe përsosmérinë artistike të një krijimtarie të shkëlqyer. Prandaj, në gurrën e pashtershme të krijimtarisë popullore, shkrimitarët dhe artistët tanë më të mirë kanë gjetur dhe kanë shfrytëzuar me mjeshtëri ato elemente të rëndësishme të brendisë e të formës, që u kanë dhënë veprave të tyre fryshtësive sigurt popullore e kombëtare. Letërsia ka pasur një traditë të njohur në shfrytëzimin krijues të folklorit dhe ka synuar ta zhvillojë e ta përpunojë atë edhe në ditët tona, duke harmonizuar brendinë e shëndoshë socialiste me fryshtësive popullore kombëtare, po edhe në artet e tjera, sidomos në muzikë, vlera e mbështetjes krijuese në këngët e në vallet popullore ka ardhur gjithnjë duke u rritur dhe në krijimet më të mira të kompozitorëve tanë ka shërbyer për t'u dhënë atyre brendi të gjerë popullore dhe gjuhë të qartë e të sigurt kombëtare.

Nuk është çështja këtu që krijimet të jenë të mbështetura vetëm në ndonjë motiv apo në ndonjë akord të këngëve popullore, por, siç porosit shoku Enver, «*të jenë të mbrujtura me baltën e kësaj toke, të jenë të fryshtësuar nga krijimtaria, puna e aspiratat e këtij populli dhe atij t'i kushtohen, atij t'i pëlqejnë, atë të ngrenë peshë. Po u largove nga ky taban, as popullit tënd nuk i shërben, por as popujt e tjerë s'kanë pse të të vlerësojnë, sepse nuk sjell gjë të re në thesarin e përbashkët të kulturës e të artit përparimtar botëror».<sup>28)</sup>*

28) Enver Hoxha: Shkrimitarët dhe artistët tanë janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë, f. 34-35.

Është e kuptueshme, se duke pasur vlera të kësaj natyre krijimtaria popullore, tok me veprat e shëndosha të shkrimitarëve e të artistëve të të gjitha kohëve, ka shërbyer dhe shërben edhe si një barierë e pakapërcyeshme kundër agresionit kulturor imperialist e revisionist dhe kundër ndikimeve të huaja moderniste në letërsinë dhe në artet. Në qoftë se populli ynë i ka përballuar me sukses të gjitha rrëbeshet e historisë dhe i ka shpëtuar asimilimit prej pushtuesve, që kanë sunduar mbi të qindra vjet kjo, veç të tjerave, ka ndodhur edhe për shkak të vitalitetit të tij krijues, për shkak se ai ka luftuar jo vetëm me pushkë, po ka përdorur njësoj si pushkën edhe këngët e vallen si mjete të pazëvendësueshme të ruajtjes së kombësisë e të sovranitetit shpirtëror. Për këtë arsyе Partia gjithmonë i ka këshilluar shkrimitarët dhe artistët, që të mos shkëputen prej krijimtarisë popullore, po ta studjojnë atë me vëmendje, ta përvetësojnë e ta përdorin në mënyrë krijuese, ta pastrojnë prej ndikimeve të huaja të klasave shfrytëzuese, ta përpunojnë dhe ta përhapin gjëresisht në popull. Po për këtë arsyë janë kritikuar më se një herë ato tendenca intelektualiste ksenomane e moderniste, që kanë synuar të nënveftësojnë vlerën e krijimtarisë popullore dhe rëndësinë e saj si mbështetje e gjallë për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve të realizmit socialist.

«Në spekulimet rreth arkaizmit, folklorizmit etj, kemi të bëjmë me një qëndrim të hapët përbuzës përgjithësisht ndaj folklorit, ndaj vlerave të mëdha artistike e shoqërore të tij, ndaj raportit të tij me artin e kultivuar. Pikërisht qëndrime e teorizime të tilla kanë qënë një nga shkaqet e largimeve nga tabani i shëndoshë kombëtar dhe kanë shërbyer si argumenta për t'i përligjur këto largime»<sup>29)</sup>

Mbështetja në traditën e pasur popullore, nga çdo

29) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 23.

pikëpamje që ta marrësh, është një prej kërkesave themelore për të patur kurdoherë një krijimtari letrare e artistike të shëndoshë, me frysë popullore e kombëtare, që frysëzohet nga populli, prandaj është e dashur për të. Dhe kjo ka qenë dhe mbetet rruga nëpër të cilën kanë ecur letërsia dhe artet tona në pjesën më të mirë të tyre, duke bërë të dështojnë e të hidhen në kanal si gjëra pa vlerë të gjitha teorizimet moderniste dhe ato pak «krijime» të huaja për shijet dhe për idelet e popullit.

### 3

Artet dhe letërsia e realizmit socialist kanë karakter të theksuar demokratik popullor, mbasi ato janë shprehëse të botëkuptimit të klasës punëtore, e cila është në pararojë të zhvillimit shoqëror të epokës sonë dhe është e vetmja klasë që mund të përfaqësojë interesat revolucionare të të gjithë masave punonjëse dhe t'i integrojë ato në procesin e madh historik të shndërrimit revolucionar të marrëdhënieve shoqërore, deri në kthimin e të gjithëve në punëtorë dhe në zhdukjen edhe të kujtimit më të zbetë të pronës private, siç thoshte Lenini. Për këtë arsy karakteri klasor i realizmit socialist jo që nuk është në kundërshtim me karakterin popullor, po përkundrazi e përforcon atë dhe e bën më efektiv dhe më luftarak.

Siç është vënë re, në letërsinë dhe në artet e së kaluarës karakteri klasor i tyre herë ka qenë në kundërshtim me frysën popullore (në rastin e letërsisë e të artit reaksionar, dekadent e formalist) e herë të tjera e ka kufizuar atë. Shkrimtarët dhe artistët më popullorë kanë qenë kurdoherë shkrimtarët dhe artistët më revolucionarë.

Historia e letërsisë dhe e arteve të realizmit socialist është e lidhur organikisht me historinë e lëvizjes revolucionare të klasës punëtore e të masave punonjëse, me lindjen dhe me përhapjen e botëkuptimit të saj, me punën për ndërtimin e socializmit, me luftën e klasave në të gjitha etapat e zhvillimi e në të gjitha frontet, me udhëheqjen e Partisë marksiste-leniniste. Që nga Komuna e

Parisit, kur shkruhen veprat e para të frysëzuanë nga lufta revolucionare e klasës punëtore e deri në Revolucionin Socialist të Tectorit u bënë përpjekje të shumta në vende të ndryshme për të pasqyruar në letërsi e në arte lëvizjen revolucionare të proletariatit dhe figurën e luftëtarit të ndërgjegjshëm kundër shtypjes e shfrytëzimit kapitalist, për krijimin e botës së re socialiste. Që prej asaj kohe letërsia dhe artet socialiste kanë patur përhapje të madhe dhe kanë njojur suksese të shquara. Ato kanë tingëlluar dhe tingëllojnë si një zë i ri dhe i fuqishëm në tërësinë e kulturës botërore, si zëri i klasës punëtore dhe i masave punonjëse, që e shohin botën ndryshe nga borgjezia dhe kanë për ideal shndërrimin e saj revolucionar mbi baza socialiste.

Karakteri klasor i letërsisë dhe i arteve, sikurse karakteri kombëtar i tyre, është një kategori historike. Ai ndryshon gjat zhvillimit të njerëzimit dhe do të shkrihet plotësisht në karakterin popullor, kur të janë zhdukur edhe mbeturinat më të fundit të dallimeve kiasore dhe të luftës së klasave në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Çdo klasë ka kulturën dhe artin e vet. Në epokën tonë kulturat kryesore që janë vënë plotësisht kundër njeratjetër janë kultura revolucionare proletare dhe kultura reaksionare borgjeze, ndërmjet të cilave mundohen të qëndrojnë ata shkrimtarë dhe artistë përparimtarë, që pasqyrojnë në veprat e tyre përgjednjimin e botës kapitaliste, po nuk arrijnë deri në njojjen e forcave revolucionare në gjirin e saj, në pranimin e dhunës revolucionare kundër saj, prandaj bien viktimi e individualizmit mikroborgjez, që pjell çgënjimin, dëshpërimin dhe pesimizmin. Edhe në vetë letërsinë dhe në artet e shoqërisë kapitaliste dallohen disa faza zhvillimi, që janë të lidhura me ngritjen dhe rënien e borgjezisë, me periudhën revolucionare dhe reaksionare të historisë së saj.

Ndryshe është puna me kulturën dhe me artin e proletariatit. Me që klasa punëtore përfaqëson të ardhmen e njerëzimit edhe arti i saj, duke u zhvilluar historikisht, njeh vetëm një zhvillim në ngritje të përherëshme drejt një brendie gjithnjë më të pasur dhe një formë artistike

më të përsosur kurdoherë në pajtim me shijet dhe pikëpamjet më të përparuara të kohës.

*Lufta e drejtimeve të ndryshme letrare e artistike* është shprehje e luftës së klasave në terrenin ekonomik, botëkuptimor, ideologjik, politik, moral etj. Në këtë luftë klasash, që ka të bëjë, jo vetëm me brendinë ideologjike, po edhe me formën artistike, gjejmë një pleksje shumëformëshe ndikimesh reciproke, të cilat duhen mbajtur parasysh, po asnjëherë nuk duhet (mbasi nuk munden) të fshehin thelbin klasor të letërsisë e të arteve në tërësi, të shkrimitarëve e artistëve të ndryshëm dhe të veprave të veçanta letrare e artistike.

«*Borgjezia*», thotë shoku Enver, «në fazat e ndryshme të zhvillimit e të dekadencës së saj, ka krijuar dhe krijon literaturën e saj me shkrimitarë, poetë, muzikantë, artistë etj., të mëdhenj e të vegjël, nga ata që i kanë rezistuar kohës dhe nga ata që i ka marrë rrëkeja.... Ne duhet të zgjedhim ata autorë dhe ato libra që janë nga më përparimtarë, nga më revolucionaret dhe të momenteve më revolucionare... Të tillë shkrimitarë, poetë, artistë ka, po kurdoherë të mos harrojmë se në ta nuk do të gjejmë plotësisht atë që kërkojmë dhe ashtu si e duam ne, pasi edhe në këta autorë përparimtarë ose revolucionarë do të gjejmë të pleksur, në mos plotësisht, por në një mënyrë ose në një tjetër, pasqyrimin e ideve borgjeze, të jetës dhe të mendimeve sunduese të epokës që kanë jetuar»<sup>30)</sup>

Këtej del se lufta e klasave në fushën e letërsisë e të arteve nuk është thjesht një luftë kundër asaj krijimtarie që mbart ideale haptas reaksionare apo që është në pozita krejtësisht dekadente e formaliste, po përfshin një fushë të gjerë problemesh e aspektesh, që nga demaskimi i rrymave reaksionare e formaliste të së kaluarës e të ditëve tona, deri tek përpjekjet për çlirimin e plotë të krijimtarisë prej ndikimeve të këqija të së kaluarës e të së sotmes në brendinë ideologjike dhe në formën artistike. Në Kongresin V të PPSH, kur u fol për konceptin e përgjith-

shëm të luftës së klasave dhe për qëndrimin e Partisë ndaj saj u përfshi në të edhe lufta kundër «izmave» të artit të sotëm borgjez e revisionist. Për të vënë në jetë deri në fund e me vendosmëri këtë orientim të Partisë për karakterin klasor të letërsisë e të arteve dhe për luftën ideoartistike në terrenin e tyre, përvëç qëndrimit të diferencauar revolucionar ndaj traditës dhe eksperiencës së huaj dhe traditës e eksperiencës sonë kombëtare, për të cilat do të flitet më poshtë, kanë rëndësi edhe disa aspekte të tjera kryesore që mbeten aktuale gjithnjë, me gjithë sukseset e arritura deri tanë.

Së pari, letërsia dhe artet tona, si letërsi dhe arte të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit do të ecin edhe në të ardhmen në rrugën e forcimit të pozitave të tyre proletare, duke u bërë, nëpërmjet një procesi të gjatë shndërrimi revolucionar, gjithnjë më përfaqësuese të aspiratave dhe të shijeve të klasës punëtore. Ky shndërrim që nis me kalimin e letërsisë e të arteve në pozitat e realizmit socialist, nuk ka të bëjë as me trajtimin në krimtarinë artistike vetëm të temave nga jeta e klasës punëtore, as me përjashtimin e temave të tjera, po me trajtimin e çdo teme nga pozitat ideologjike revolucionare të klasës punëtore. Po kështu ky shndërrim nuk ka të bëjë vetëm me futjen në veprat letrare e artistike të heroit punëtor, mbasi një kufizim i tillë do ta varféronte krimtarinë dhe do ta largonte artificialisht atë prej realitetit. Çështja është që cilido qoftë heroi i veprave, ai duhet pasqyruar e vlerësuar nga pozitat e klasës punëtore, nën prizmin e raporteve që ka ai me luftën revolucionare dhe me ndërtimin e socializmit. Disa studiues të huaj kanë shprehur pikëpamjen naive se për të qënë shkrimitar e artist i realizmit socialist është e domosdoshme që të jesh me prejardhje punëtore. Duke u nisur nga një pikëpamje e tillë ata kanë arritur në përfundimin që edhe Maksim Gorki nuk mund të konsiderohet i realizmit socialist, gjërsa nuk rridhete nga një familje punëtorësh. Në letërsinë e në artet tona sidomos nga vitet 60 e këtej, janë bërë përpjekje serioze nga shumë shkrimitarë e artistë për të pasqyruar drejtpërdrejt jetën e klasës punëtore dhe vendin e

30) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 374.

saj pararojë në shndërrimin revolucionar të jetës. Kështu, për shembull në vëllimin poetik «Ritme të hekurta» e Fa-tos Arapit në tablonë «Montatorët» e Shaban Hysës, në «Vallen industriale» e Feim Ibrahimit dhe në mjaft veprat e shkrimtarëve, piktorëve, skulptorëve, kompozitorëve dhe artistëve tanë të skenës éshtë sjellë hovi entuziast, shpirti revolucionar dhe profili moral i punëtorëve tanë, që i janë përveshur me heroizëm ndërtimit të socializmit dhe shikojnë me optimizëm drejt të ardhmen. Por, me gjithëse lista e veprave me vlerë éshtë edhe më e gjatë, prapë vihet re një farë shablonizmi dhe trajtimi i cekët i temës dhe i figurës së klasës punëtore, sidomos në poezi, ku përshtypjeve të gjalla dhe mendimeve të freskëta ua zë vendin shpesh një vërshim figurash, kurse në skulpturë janë krijuar shpesh disa standarde dhe éshtë kaluar në njëfarë theksimi të panatyryshëm të forcës fizike, prandaj veprat mbeten të jashtme e të cekëta në ndjenja e në mendime, pa forcë artistike përgjithësuese.

Në shumicën e rasteve edhe për shkak të vetë strukturës së dikurëshme klasore të shqërisë sonë, në të cilën mbi 80% ishin fshatarë dhe mungonte proletariati industrial, në veprat letrare e artistike éshtë pasqyruar kryesisht jeta e fshatarësës dhe e shtresave të varfëra të qytetit dhe e intelektualëve. Edhe në ditët tona bilanci tematik anon akoma në favor të këtyre pasqyrimeve, po duke e pranuar këtë kufizim tematik, do të vemë re si një sukses me rëndësi ideoartistike trajtimin e këtyre temave nga pozitat revolucionare të klasës punëtore, me ose pa praninë e heronjve e të personazheve punëtorë. Kryesisht nëpërmjet këtij procesi shndërrimi dhe lartësimi ideoartistik dhe, pastaj, nëpërmjet pasqyrimit të drejtpërdrejtë të klasës punëtore, letërsia dhe artet tona kanë theksuar gjithnjë më shumë e më qartë pozitat klasore revolucionare dhe krijimtaria éshtë pëershkuar nga fryma e shëndetshme, nga botëvështrimi dhe optimizmi punëtor. Ka mjaft vepra të bukura të realizmit socialist të cilat ndonëse nuk e kanë të pranishme klasën punëtore, janë veprat e një brendi klasore revolucionare, që éshtë përcaktuar nga platforma ideoartistike e tyre dhe nga shkalla e asi-

milimit prej shkrimtarëve dhe artistëve të botëkuptimit dhe të ideologjisë së klasës punëtore. Kjo vlerë e re, që ka sjellë realizmi socialist në pasqyrimin e ambienteve të njoitura edhe për artin e së kaluarës, do të forcohet më tepër në të ardhmen. Vetë jeta jonë, e rindërtuar mbi bazat e botëkuptimit e të pikësynimeve të klasës punëtore, rritja e peshës specifike dhe e ndërgjegjes së vetë kësaj klase, ndikimi i saj gjithnjë më vendimtar mbi shtresat e tjera shoqërore, afrimi përherë më i dukshëm i këtyre shtresave me klasën punëtore, zotërimi gjithnjë më efikas i marksizëm-leninizmit në shoqërinë tonë dhe në krijimtarinë artistike përbëjnë bazën objektive të këtij shndërrimi të mëtejshëm revolucionar të letërsisë e të arteve, jo vetëm nëpërmjet pasqyrimit të jetës së klasës punëtore, po edhe nëpërmjet trajtimit nga pozita më të fuqishme dhe më të përcaktuara klasore të të gjitha temave. Me rëndësi në këtë drejtim, krahas vazhdimit me vendosmëri të luftës kundër mbeturinave të koncepteve patriarkale, mbetet sidomos lufta e ashpër, më e thellë dhe në front më të gjerë kundër shfaqjeve të botëkuptimit, të koncepteve shoqërore dhe të shijeve artistike mikroborgjeze, të cilat kanë ende bazë shoqërore dhe përbëjnë një prej rrëziqueve aktuale për letërsinë e për artin. Mikroborgjezi i pasqyruar dhe i vlerësuar nga pozita mikroborgjeze ka sjellë dhe mund të sjellë në letërsi e në art vetëm një frymë paralizuese, bile, haptas kundërrrevolucionare nëpërmjet shikimit të transfiguruar subjektivist të realitetit, shqetësimit për «folenë» e prishur, përhapjes së dobësisë dhe brengës së tij në të tjerët, individualizmit dhe egoizmit nëpërmjet prirjeve anarhistë, ekstravagancave nervozë dhe snobizmit artistik. Të gjitha këto shpien në mënyrë të pashmangshme në largimin prej pozitave klasore revolucionare dhe bëhen shkak, po të mos luftohen, për kalimin e letërsisë e të artit në pozita kundërrrevolucionare. Elemente të tilla mikroborgjeze në letërsinë e në artet tona ka patur edhe vitet e fundit dhe, ç'është më e keqja, kritika ndaj tyre ka qenë e dobët, e përciptë dhe vetëm në rastet më flagrante. Romani «Tuneli» dhe drama «Njollat e murme» bazën e të keqes së tyre ideoartistike

e patën pikërisht në trajtimin mikroborgjez të mikroborgjezit, në ngritjen e tij, me gjithë bagazhin ideoemocional negativ, në nivelin e shembullit për t'u ndjekur, në shuarjen kështu edhe të qëndrimit më të zbetë kritik ndaj tij. Po ka pasur edhe krijime të tjera në poezi, në prozë e në dramë, në të cilat fryma mikroborgjeze shfaqet nëpërmjet formave më të ndryshme: keqardhjes për «fatkeqësitë» e dashurisë së tipave të mëfshtë, trajtimit gjer në hollësi të «brengave shpirtërore» të vajzave, që dinë të merren e të kujdesen vetëm për vetveten, idealizimit të një dashurie meskine të shkëputur ngajeta e të mbuluar me pëshpëritje e pshëritëma, të shpirtngushtësisë para sakrificave, pasqyrimëve meskine të heroizmit në luftë e në punë, kuptimit të ngushtë të jetës, trajtimit nga pozita pacifiste dhe pseudohumaniste të luftës etj. Krijimet me brendi të tillë nuk kanë qenë fort të pakta. Ato janë kritikuar me kohë nga Partia, po në kushtet e sotme, duke marrë parasysh edhe ndikimet e jashtme në këtë drejtim, lufta kundër shfaqjeve mikroborgjeze duhet të jetë më e ashpër dhe më e shumanshme, aq më tepër se letërsia dhe artet tonë të sotme kanë arritur në një shkallë të atillë zhvillimi, sa janë në gjendje t'u kundërvihen me sukses të gjitha atyre shfaqjeve që dëmtojnë ose dobësojnë fryshtë e tyre revolucionare.

Në kongresin VI të PPSH-së u theksua se:

*«Konceptet dhe prirjet mikroborgjeze ruhen dhe mbanen akoma gjallë. Ato shfaqen jo vetëm në fshat por edhe në qytet, në këtë ose atë masë në të gjitha shtresat e popullsisë. Mbeturinat mikroborgjeze mpleksen në të gjitha format e ideologjisë së klasave shfrytëzuese, si me zakonet prapanike e patriarkale, ashtu edhe me ndikimet borgjeze e revolucioniste...»*

*Këtej del akoma më qartë se lufta kundër ideologjisë mikroborgjeze dhe shfaqjeve të saj, është një nga detyrat më të rëndësishme të punës së gjithanshme të Partisë e veçanërisht të punës së saj ideologjike.<sup>31)</sup>*

31) Enver Hoxha: Raport në Kongresin VI të PPSH-së, f. 137.

Problemet që kanë dalë gjat zhvillimit të letërsisë e të arteve të realizmit socialist provojnë se ky konstatim i Partisë për jetën shoqërore është plotësish i vërtetë dhe i saktë edhe për krijimtarinë letrare e artistike. Mjafton të përmendim se si në fillim të viteve 60 në disa krijime poetike, drama dhe tregime u pleksën predispozitat mikroborgjeze me ndikimet revisioniste për të patur më të qartë nevojën e një luftë pa kurrëfarë kompromisi e lëshimi kundër çdo shfaqjeje të mentalitetit dhe të shijeve artistike mikroborgjeze, për forcimin gjithnjë më të madh të pozitave klasore revolucionare të realizmit socialist.

Një shfaqje tjetër që prek brendinë klasore revolucionare të letërsisë e të arteve, krahas subjektivizmit mikroborgjez, është edhe objektivizmi borgjez, që arrin deri në pretendimin e qëndrimeve mbiklasore, jashtë klasave e luftës së klasave. Këto tendenca janë trajtuar teorikisht dhë po vihen në jetë prej revisionistëve të sotëm, të cilët, të nisur nga ideologjia e bashkëpunimit klasor me borgjezinë dhe nga politika e afrimit me imperializmin, krijojnë iluzione kundërrrevolucionare dhe, në vend të qëndrimeve të pretenduara mbiklasore, bien plotësish në pozitat ideologjike borgjeze në pasqyrimin e jetës e të luftës revolucionare. Shkrimtarët dhe artistët tanë të realizmit socialist kanë luftuar me vendosmëri kundër këtyre tendencave dhe, nën udhëheqjen e Partisë, kanë kapërcyer me sukses ato shfaqje, sidomos në poezi e në dramë, po tek-tuk edhe në disa tregime, që janë dukur deri vonë nën ndikimin e revolucionizmit.

Lufta e klasave, sic na mëson shoku Enver «është një luftë e shumanëshme, para së gjithash ajo është sot një luftë ideologjike, një luftë për mendjet dhe zemrat e njërrëzve, luftë kundër degjenerimit borgjez e revolucionist, kundër të gjitha mbeturinave e shfaqjeve të huaja, që ruhen e manifestohen, ku më shumë e ku më pak, në të gjithë njerëzit tanë, është luftë për triumfin e ideologjisë dhe të moralit tonë komunist». <sup>32)</sup>

Në mënyrë shumë të mprehtë Partia i shtroi edhe

32) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 126.

një herë këto probleme në Plenumin IV të KQ të PPSH, duke e lidhur luftën e klasave në fushën e letërsisë e të arteve me luftën e gjithanshme që zhvillohet në epokën tonë ndërmjet popujve, socializmit e marksizëm-leninizmit, nga një anë dhe imperializmit e revizionizmit, nga ana tjetër, pa harruar as mbeturinat e klasave të përbysura brenda vendit dhe bagazhin ideologjik, ideoestetik dhe etiko-moral të trashëguar prej tyre. Nën dritën e këtyre mësimeve del më se e qartë se forcimi i mëtejshëm i karakterit klasor të letërsisë e të arteve do të bëhet njëkohësisht në të dy drejtimet kryesore të tij: në konsolidimin e mëtejshëm të frymës revolucionare socialistë dhe të lidhjeve gjithnjë më të ngushta me problemet e mëdha të shndërrimit revolucionar të jetës dhe, së dyti, në luftën e papajtueshme kundër imperializmit e revizionizmit, rrjame të tyre filozofike, estetike e artistike dhe kundër çdo shfaqje të huaj e qëndrimi liberal ndaj tyre në letërsinë e në artet tona. Në këtë luftë e vjetra reaksionare dhe prapanike nuk mund të shkëputet prej ndikimeve të sotme borgjeze e revizioniste, konservatorizmi nuk mund të shkëputet nga liberalizmi, mbasi ata janë mbështetje për njëri-tjetrin dhe kanë po të njejtën natyrë kundërrevolucionare.

Vala e madhe e propagandës çoroditëse imperialiste e revizioniste, që përplaset edhe në brigjet tona, na mëson shoku Enver, — «*plekset ngushtë me shumë njolla të së kaluarës në ndërgjegjen e punonjësve, veçanërisht me shfaqjet e individualizmit mikroborgjez*. Këto dy anë ushqejnë njëra-tjetrën, e vjetra dhe modernistja shkrihen në një front të vetëm lufte kundër socializmit dhe diktaturës së proletariatit. Për pasojë, edhe lufta jonë kundër këtyre dy të këqijave përbën një front të vetëm kompleks e të pandarë».<sup>33)</sup>

Sic del nga gjithë ç'u tha karakteri klasor i letërsisë dhe i arteve të realizmit socialist nuk i kundërvihet karakteri

33) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 15.

terit popullor, po e përforcon atë. Shkrimtarët dhe artistët reaksionarë borgjezë luftojnë në mënyra të ndryshme për të ruajtur pozitat shfrytëzuese të borgjezisë, dhe për të kënaqur shijet e njerëzve të mërzitur prej majmërisë dhe ushtrojnë ndikim degjenerues dhe shtypës mbi masat punonjëse për të paralizuar luftën e tyre revolucionare dhe për të larguar vëmëndjen prej atyre problemeve themelore të jetës, që përfaqësojnë tendencën e zhvillimit revolucionar të shoqërisë. Përkundrazi, letërsia dhe artet e realizmit socialist, duke theksuar karakterin e tyre klasor revolucionar, bëhen një forcë shtytëse për zhvillimin përparimit të shoqërisë dhe përfaqësojnë më së miri interesat jetike dhe shijet estetike të punonjësve dhe i përpunojnë ato, duke u prirë përherë drejt të ardhmes, të nisur nga realiteti i kohës.

#### 4

Shprehja më e lartë e karakterit revolucionar të letërsisë e të arteve të realizmit socialist është partishmëria komuniste. Vetë lëvizja punëtore dhe revolucionare është e lidhur ngushtë me krijimin e ndërgjegjes, të ideologjisë dhe të botëkuptimit të klasës, me lindjen dhe përpunimin e parimeve themelore të filozofisë, të socializmit shkencor dhe të ekonomisë politike marksiste-leniniste. Klasa punëtore mëpërmjet marksizëm-leninizmit bëhet e ndërgjegjshme për misionin e saj historik dhe e përdor atë si armë për fitoren e revolucionit dhe për ndërtimin e socializmit e të komunizmit. Pikërisht në periudhën e lëvizjeve të fuqishme të klasës punëtore dhe të depërtimit në të të marksizëm-leninizmit lindi dhe u zhvillua edhe një letërsi e një art i ri, që nuk përfaqësonë më borgjezinë dhe mikroborgjezinë po proletariatin revolucionar dhe idealet e tij. Konkretizim i rolit drejtues të marksizëm-leninizmit në luftën revolucionare dhe në ndërtimin e socializmit është udhëheqja e partisë komuniste, e cila realizon idealet e klasës punëtore dhe të masave punonjëse mëpërmjet zbatimit në praktikë të marksizëm-leninizmit dhe përpuni-

nimit të strategjisë e të taktilës, të vijës së përgjithshme politike pér organizimin e lëvizjes revolucionare, pér fitoren e revolucionit dhe pér zhvillimin socialist të ekonomisë e të kulturës.

Që në shekullin e kaluar Marksit, duke bërë fjalë pér *tendenciozitetin* që ka karakterizuar krijimtarinë letrare të çdo epoke që nga Eskili e Aristofani, ka hedhur dritë pér kuptimin e partishëm të letërsisë e të artit, duke e vënë theksin në brendinë ideologjike, në idealet që udhëheqin shkrimitarët, në anën që ata mbajnë në pasqyrimin e kontradicave dhe në forcat shoqërore që përfaqësojnë me krijimtarinë e tyre. Duke u mbështetur në këto vlerësimë të Marksit e të Engelsit, Lenini përpunoi më vonë në artikullin me rëndësi historike «*Organizata e partisë dhe letërsia e partisë*» parimin e partishmërisë proletare në letërsi e në art. Në këtë artikull parashikohej krijimi i një letërsie e të një arti në shërbim të çeshtjes së përgjithshme të proletariatit, të brumosur me ideologjinë e klasës punëtore, të ciluar plotësisht prej vartësisë mbytëse të ideologjisë borgjeze, të anarshizmit mikroborgjez, të qeses me para, të ndjekjes së verbër të «modës artistike, që sundon në perëndim», të egoizmit dhe të etjes pér lavdi, etj. Sipas Leninit kjo letërsi me partishmëri të shëndoshë e të hapët do të ishte plotësisht e lirë, mbasi do të lidhej me masat shumëmillionëshe, do të frymëzohej prej tyre dhe do t'u shërbente atyre që janë lulja dhe e ardhshmja e vendit.

Ky parim leninist është një përgjithësim teorik i letërsisë dhe i artit të gjerathershëm dhe është konkretizuar e vërtetuar më së miri prej zhvillimit të derisotëm të letërsisë e të arteve të realizmit socialist. Gjatë më se gjysmë shekulli është provuar plotësisht se largimi prej parimit të partishmërisë komuniste e ka futur letërsinë dhe artin në rrugën e degjenerimit borgjez dhe i ka çelur shtigjet dekadentizmit dhe formalizmit. Në kohën tonë një provë e gjallë dhe e shëmtuar e këtij devijimi është krijimtaria e atyre shkrimitarëve dhe artistëve në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të Evropës Lindore, të cilët

qëndrojnë plotësisht në pozitat ideologjike dhe politike të revisionistëve të sotëm.

Karakteri i partishëm i letërsisë dhe i arteve ka të bëjë drejtërsëdrejt me çeshtjen në se ato do të udhëhiqen nga idealet revolucionare apo nga idealet e kundërrevolucionit, do të përfaqësojnë botëkuptimin dhe ideologjinë e proletariatit apo ato të borgjezisë, në se në to do të pasqyrohet jeta nën prizmin e revolucionit e të komunizmit apo nën prizmin e ruajtjes e të restaurimit të kapitalizmit, në se ato do të synojnë pér krijimin e njeriut të rime profil moral e politik revolucionar apo pér çoroditjen e tij me moralin e kalbur borgjez, në se ato do të nisen nga populli e do t'i drejtohen popullit apo do të estetizojnë shëmtimin e realitetit e të shpirtit borgjez. As më parë dhe aq më pak në ditët tona nuk ka patur dhe nuk mund të ketë letërsi dhe art pa tendencë ideologjike, pa frymë partie. Gjithë arti i çdo epoke ka qenë tendencioz, i partishëm, gjersa ka pasqyruar një realitet të caktuar nga pozita të caktuara ideologjike, gjersa çdo shkrimitar e artist është udhëhequr në krijimtarinë e vet nga një botëkuptim i caktuar.

Estetët borgjezë dhe revisionistë, duke thirrur në ndihmë paragjykimet mikroborgjeze dhe trajtimin disa herë vulgar e të ngushtë të partishmërisë proletare, në luftën e tyre kundër estetikës marksiste-leniniste dhe praktikës krijuarë të realizmit socialist, goditjet kryesore i kanë drejtuar kurdoherë kundër këtij parimi themelor. Duke luftuar kundër partishmërisë proletare në emër të «çlirimt» të artit prej ideologjisë e politikës dhe pér të patur, siç thonë ata, një art «të paangazhuar», në një mënyrë ose në një tjetër, luftojnë pér të arritur disa pikësynime të caktuara ideoartistike regressive kundërrevolucionare. Në të vërtetë, pavarësisht në se e pranojnë ose jo një gjë të tillë, ata nuk janë kundër çdo partishmërie, kundër çdo ideologji dhe çdo politike në art. Ata, drejtërdrejt ose tërthorazi, haptas ose në mënyra të kamufluara janë vetëm kundër partishmërisë komuniste dhe përkrahin çdo frymë tjetër, që i kundërvihet asaj ose nuk pajtohet me

atë gjer në fund. Kështu, në fushën e estetikës e të artit në të vërtetë ata janë përkrahës të pretendimit borgjez se, botëkuptimi, ideologjia, morali dhe shijet e borgjezisë janë të vetmet shprehje të kohës dhe të synimit borgjez që këto t'i përhapin në shtresat e gjera të popullit për të vazhduar sundimin shpirtëror mbi to. Kjo është arsyaja që rrymat më reaksionare filozofike, sidomos të idealizmit subjektiv si ekzistencializmi, froidizmi etj. kanë gjetur përhapje shumë të madhe në artin borgjez e revisionist dhe kanë depërtuar edhe në krijimtarinë e disa shkrimitarëve e artistëve përparimtarë të kohës sonë. Duke folur për «lirinë e krijimit» dhe për «çlirimin» e artit e të artistit, ata jo vetëm fshehin vartësinë e vërtetë të tyre prej «qeses me pare» në botën kapitaliste, po u japid këtyre nocioneve një kuptim të ngushtë borgjez, duke i kufizuar brënda caqeve të lirisë për t'i shërbyer deri në fund borgjezisë. Dhe kjo është plotësisht e kuptueshme. Ajo është reflektim i faktit që kurdoherë prapa euforisë liberale borgjeze e revisioniste është fshehur diktatura më e egër, ideologjia më reaksionare, politika më dinake, ndalimet dhe kufizimet më të rrepta ndaj çdo gjëje revolucionare dhe ndaj çdo shkrimitari ose artisti revolucionar.

Partishmëria komuniste, duke e frymëzuar shkrimitarin dhe artistin me idealet e revolucionit e të komunizmit, duke i dhënë atij në dorë një botëkuptim shkencor për njojhen dhe shndërrimin e botës dhe duke patur si qëllim të fundit zhdukjen e plotë të ndarjes së shoqërisë në klasa është e vetmja partishmëri që përmban në thelbin e vet lirinë më reale dhe më të plotë, jo vetëm se çliron shkrimitarin dhe artistin prej vartësisë ekonomike ndaj borgjezisë dhe ve në dispozicion të talentit të tij të gjitha mjetet e shtet socialist, po e çliron atë edhe prej skllavërisë shpirtërore të filozofisë reaksionare, kurse artin dhe letërsinë i shpëton prej anarshisë mikroborgjeze, që ka dukjen e lirisë, po është vetëm një mjet për të ruajtur më mirë sundimin borgjez.

Në asnjë kohë nuk ka patur art dhe artistë të paangazhuar. Çdo krijim i çdo kohe qoftë, — thotë shoku Enver, mban vulën e epokës në të cilën është shkruar, kështu që

çështja shtrohet preras në se arti dhe letërsia do të vihen në shërbim të borgjezisë dhe të rrëtheve socialimperialiste apo në shërbim të popullit e të revolucionit. Shkrimitarët dhe artistët e realizmit socialist e pranojnë hapur «angazhimin» e tyre në luftën revolucionare dhe «vartësinë» e tyre prej luftës, punës, idealeve dhe shijeve artistike të popullit. Edhe vetë ky pranim i hapur i «angazhimit» tregon drejtësinë dhe sigurinë e drejtimit që kanë zgjedhur. Borgjezët dhe revolucionistë e fshehin me dhëlpëri të shumta tendencën e vërtetë të tyre pikërisht se e ndjejnë dobësinë e pozitave dhe përpinqen të mashtrojnë masat me predikime filozofike dhe estetike të një arti «mbiklasor», i cili do të mbetet kurdoherë një mashtrim, gjersa të ekzistojë shoqëria me klasa.

Për të ndikuar sidomos në elementin mikroborgjez, që përbën një masë të madhe të inteligjencës artistike dhe që prej vetë natyrës shoqërore të tij është i prirë drejt anarshizmit dhe individualizmit, teoricienët borgjezë e revolucionistë kanë spekuluar e spekulonjë shumë në rolin udhëheqës të partisë komuniste në fushën e letërsisë dhe të artit, duke krijuar përshtypjen se çdo vepër letrare e artistike krijuhet nën diktatin e udhëheqjes së partisë. Njohja prej shkrimitarëve dhe artistëve e rolit udhëheqës të partisë në fushën e kulturës e të artit nuk është dhe nuk mund të jetë kurrsesi e diktuar dhe e imponuar. Ajo buron nga vetë realiteti i luftës revolucionare dhe i punës për ndërtimin e socializmit, nga vetë roli me rëndësi historike i Partisë në përpunimin e vijës politike, në përgjithësimin teorik të eksperiençës së grumbulluar dhe në çeljen e perspektivave të mëtejshme të zhvillimit të kulturës e të arteve. Politika e Partisë në fushën e letërsisë e të arteve është mishërim i idealeve ideoartistike të shkrimitarëve revolucionarë. Ajo mbështetet në rezultatet më të mira të krijimtarisë dhe përpunohet me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të vetë krijuesve në parashtrimin dhe në zgjidhjen e problemeve që dalin prej zhvillimit historik të letërsisë e të arteve.

«Vija e Partisë sonë për çështjet themelore të letërsisë dhe të arteve nuk i sillet frontit kulturalo-artistik nga

*jashtë dhe nuk i imponohet si diçka e huaj. Kjo vijë, që mbështetet në marksizëm-leninizmin, është një përgjithësim i përvojës së praktikës artistike dhe të mendimit teoriko-kritik të artistëve dhe të letrarëve tanë, si edhe të gjykimeve të masave të gjera të popullit. Artistët, kritikët, letrarët tanë kanë dhënë e jasin kontributin e tyre të çmuar në këtë front jo vetëm duke e zbatuar, duke e mbrojtur vijën e Partisë, por edhe duke ndihmuar në përpunimin e saj. Partia gjithmonë është konsultuar për çdo çeshtje të rëndësishme të vijës së saj në këtë fushë me masën e artistëve, të letrarëve e të kritikëve. Vija e saj është vijë e vetë artistëve dhe e shkrimtarëve tanë. Këtu qëndron një nga shprehjet më të fuqishme të partishmërisë proletare të kulturës sonë artistike socialiste».<sup>34)</sup>*

Këtu qëndron uniteti i plotë i shkrimtarëve dhe i artistëve tanë me Partinë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe me problemet e zhvillimit të mëtejshëm të letërsisë e të arteve. Nga ana tjetër, duke njoftuar si një realitet historik konkret e me rëndësi rolin udhëheqës të Partisë e të komunistëve në revolucionin popullor dhe në ndërtimin e socializmit, unitetin e plotë të tyre me popullin, shkrimtarët dhe artistët tanë e kanë pasqyruar atë në veprat e tyre, duke i qëndruar besnik realitetit të kohës. Partia ka hyrë thellë në ndërgjegjen e popullit. Ajo është bërë vetë ndërgjegjja e tij revolucionare, prandaj edhe në krijimtarinë artistike popullore dhe në veprat e shkrimtarëve i është kenduar asaj me aq dashuri e ngrohtësi, me aq singjeritet ndjenjash. Edhe ky pasqyrim realist i jetës me elementet e reja historike që sjell zhvillimi nuk i pëlqen borgjezisë dhe revizionistëve, të cilët duan të çrrënjosin idealet revolucionare nga krijimtaria artistike, t'i heqin asaj heroin e vet tipik me profil komunist ose, nga ana tjetër, ta pasqyrojnë këtë realitet të ri me ngjyra të zeza, nga pozita reaksionare e dekadente. Kjo është arsyesa që ata duartrokasin çdo vepër antikomuniste, që nga drama «Duart e ndyra» të Zhan Pol Sarrit

34) Ramiz Alia: Mbi zhvillimin e debatit për letërsinë e artit («Nëntori», 1972, Nr. 8).

deri tek tregimet e Solzhenicinit. Ata i tmerron lufta revolucionare për përbysjen e kapitalizmit, i tërhojnë fitoret e popujve për ndërtimin e socializmit, prandaj s'ka si të pajtohen me pasqyrimin në veprat letrare e artistike të realitetit revolucionar, të idealeve dhe të heronjve komunistë, që i ka nxjerrë vetë zhvillimi shoqëror në arenën e historisë.

Një prej çështjeve themelore që ka të bëjë me partshmérinë e letërsisë e të arteve është çështja e botëkuptimit të shkrimtarëve dhe artistëve, mbasi pa një botëkuptim revolucionar nuk mund të ketë as art revolucionar dhe se vetë metoda artistike që përdoret në krijimtari i ka bazat e veta në një botëkuptim të caktuar. Shkrimtarët dhe artistët e realizmit socialist janë partizanë të botëkuptimit materialist dialektik. Ata e shohin jetën në zhvillim revolucionar, njohin rolin e klasës punëtore dhe të Partisë së saj marksiste-leniniste dhe janë të bindur se shkalla më e lartë e zhvillimit të shoqërisë është komunizmi, që do të jetë e ardhshmjë e njerëzimit. Botëkuptimi marksist-leninist u jep mundësi shkrimtarëve dhe artistëve ta njoftin dhe ta pasqyrojnë jetën nga pozita realiste revolucionare, të vlerësojnë nga pozita të shëndosha objektive të kaluarën dhe të sotmen dhe të depërtojnë me hovin e imaginatës së tyre përtëj aktualitetit, të parandjejnë dhe të parashikojnë të ardhmen, duke u nisur prej filizave të saj të sotme. Prandaj Partia i ka porositur vazhdimisht shkrimtarët dhe artistët që t'i përvishen me zell studimit të marksizëm-leninizmit «duke e mësuar atë jo vetëm në-përmjet librave, por edhe në luftën për zbatimin e vijës së Partisë dhe për pasqyrimin e saj në veprat letrare e artistike».<sup>35)</sup>

Teoricienët borgjezë e revizionistë për të larguar krimtarinë letrare e artistike prej pozitave marksiste-leniniste dhe për t'i çelur rrugën ndikimit të rrymave filozofike idealiste, kanë hedhur në diskutim problemin e kontradiktave në botëkuptimin e shkrimtarëve e të artistëve dhe të kontradiktave ndërmjet botëkuptimit dhe metodës së

35) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 136.

tyre artistike, duke marrë si shembull për këto raste kri-jimtarinë e Lef Tolstoit e të Balzakut dhe duke i interpretuar kontradiktat në botëkuptimin e tyre nga pozita subjektiviste si kulme të pasqyrimit artistik dhe jo si kufizime ideoartistike. Ata lënë shteg të hapur që bashkë me pasqyrimet e gjera e të thella të realitetit të kohës në veprat e shquara të Tolstoit të përhapen edhe pikëpamjet e tij reaksionare të vtpërsosjes morale, të nënshtimit ndaj së keqes dhe të pranimit të fesë si ngushëllimin e vetëm për njeriun. Në qoftë se e gjykojmë nga pozitat e një realizmi konsekuent, krijimtaria e Tolstoit, krahas vlerave të mëdha ideoartistike, që janë reflektimi të lidhjeve të shkrimitarit me kohën, me popullin, me atdheun e vet dhe të anëve përparimtare të botëkuptimit të tij, do të gjejmë edhe të këqijat që përmendëm, që e kanë kufizuar gjerësinë dhe thellësinë e pasqyrimit realist dhe vlerën shoqërore përparimtare të veprave. Madhështinë e Tolstoit nuk e përbëjnë kontradiktat në botëkuptimin e tij, po sundimi i anëve përparimtare mbi anën reaksionare; i realizmit mbi konceptet idealiste të vtpërsosjes, të nënshtimit e të pranimit të fesë. Në rastin e Balzakut, siç e ka vënë re Engelsi, kemi të bëjmë gjithashtu me suksesin e realizmit mbi pikëpamjet politike të shkrimitarit. Edhe praktika e letërsisë dhe arteve të realizmit socialist ka njobur raste, kur shkrimitarë dhe artistë të talentuar e të lidhur me popullin e me revolucionin kanë triumfuar mbi pikëpamjet dhe kufizimet e tyre ideore e artistike të më-parshme dhe kanë krijuar vepra të shquara realiste revolucionare. Po teoricienët borgjezë e revizionistë nuk shqetësohen për këtë proces përparimtar. Ata synojnë dhe predikojnë «kapërcimin» e botëkuptimit marksist-leninist prej shkrimitarëve dhe artistëve të realizmit socialist dhe shqetësohen prej unititetit ideologjik të tyre. Ata do të dëshironin që kudo të ndodhte ajo që po ndodh në letërsinë dhe në artin e sotëm sovjetik e të vendeve të Evropës Lindore ku ky «kapërcim» është arritur në dobi të ideologjisë borgjeze e revizioniste, pra, përfaqëson një kthim prapa, ndonëse me disa «forma të kohës», prandaj edhe gjithë procesi ka karakter regresiv, reaksionar, ndryshe

nga karakteri përparimtar që ka kapërcimi i botëkuptimit borgjez prej shkrimitarëve dhe artistëve realistë, të cilët, me gjithë kufizimet ideoartistike, pasqyrojnë në veprat e tyre një pjesë me rëndësi të realitetit të kohës. Ky është edhe shkaku objektiv historik që në letërsinë dhe në artin e vendeve kapitaliste e revizioniste nuk mund të ketë një drejtim artistik unik për të gjithë shkrimitarët e artistët, po sundon një atmosferë heterogjene, në të cilën përzihen drejtimet më të ndryshme filozofike dhe artistike. Arti jasht botëkuptimit nuk ka, ashtu siç nuk ka njeri normal që të mos mendojë.

Një fushë tjeter në të cilën manifestohet partishmëria komuniste e artit të realizmit socialist është lidhja e tij e hapët me politikën e proletariatit revolucionar dhe të shtetit socialist. Kur e trajtonë këtë çështje teoricienët borgjezë e revizionistë, me qëllim ose me mendjengushtësi, e reduktojnë problemin si një lidhje të jashtme të tematikës letrare e artistike me ngjarjet e rëndësishme e politike dhe me direktivat dhe vendimet e partisë e të shtetit socialist, pa dashur ose pa arritur të zbulojnë lidhjet e thella organike ndërmjet fenomeneve. Në të vërtetë kuptimi i lidhjeve të letërsisë e të arteve të realizmit socialist me politikën revolucionare të partisë dhe të shtetit socialist janë shprehje, në radhë të parë, e mishërimit në vijën e përgjithshme politike të partisë të proceseve objektive të zhvillimit shoqëror e të interesave jetësore të masave punonjëse dhe të raporteve objektive që ekzistojnë ndërmjet ndërgjegjes politike dhe artistike të njerëzve. Në realitetin tonë socialist vija e përgjithshme politike e Partisë, e përpunuar në dobi të masave të gjera punonjëse me pjesë-marrjen e tyre vepruese, përfaqëson vetë realitetin shoqëror në zhvillim, atë realitet bashkëkohor dhe perspektiv, që përbën objektin kryesor të krijimtarisë letrare e artistike. Ajo është platforma e vetme shkencore revolucionare e jetës shoqërore, që nuk përfaqëson pikëpamje të ngush-ta grupesh e personash, po ligjet e zhvillimit historik, prandaj edhe lidhjet e krijimtarisë artistike me të kanë një përbajtje më të thallë dhe më të gjerë nga ç'paraqitet disa herë në mënyrë të thjeshtëzuar e të sipërfaqshme.

Duke njohur vartësinë e letërsisë e të arteve ndaj një politike të tillë marksiste-leniniste, Partia ka njohur kurdoherë edhe rëndësinë e krijimtarisë artistike në formimin dhe forcimin e ndërgjegjes politike të masave, ndikimin e tyre në vetë orientimin politik të popullit nëpërmjet pasqyrimit me realizëm revolucionar të proceseve dhe të forcave të zhvillimit shoqëror, të vlerësimit të grupeve shoqërore, të partive politike dhe të individëve nga pikëpamja e interesave të punonjësve dhe të idealeve të tyre revolucionare.

Lidhjet e letërsisë e të artit me politikën konkretizohen si në fryshtë e përgjithshme që i përrshkon ato edhe në trajtimin e temave të drejtpërdrejta politike në veprat letrare e artistike. Edhe kjo është një gjë fare e natyrshme, gjersa veprimitaria politike është pjesë përbërëse e veprimitarisë së njerëzve dhe e jetës shoqërore. Letërsia dhe artet e realizmit socialist, sikurse gjithë puna e Partisë, synojnë të kultivojnë në masat punonjëse ndjenjën e zotërve të vendit, të përgjegjësisë përfatë e atdheut e të revolucionit, të thyejnë indiferentizmin politik, aq të lakuuar prej borgjezisë dhe prej revisionistëve, të forcojnë ndërgjegjen e tyre politike, të nxitin pjesëmarrjen aktive në gjykimin e problemeve të jetës, në përpunimin e vijës politike revolucionare, në zbatimin e saj me vendosmëri e në qeverisjen e vendit. Kjo përbajtje politike e letërsisë dhe e arteve tona është thellësisht demokratike dhe popullore dhe nuk ka asnjë të përbashkët as me teorizimet borgjeze-revisioniste, as me fryshtë konformiste dhe me ato vepra të cekëta, që fshehin mungesën e ideve prapa frazeologjisë politike apo që i trajtojnë temat politike në mënyrë të vulgarizuar si në brendi edhe në formën artistike.

Së fundi, vlen të shënohet që orientimet dhe vendimet e rëndësishme politike të Partisë luajnë rol me rëndësi në orientimin tematik të letërsisë e të arteve, jo se ato ushtrojnë ndikimin e «detyrimit nga lart», siç pretendojnë revisionistët, po sepse, duke qënë përgjithësime shkencore të realitetit të kohës dhe duke përcaktuar drejtimet kryesore të përparimit të mëtejshëm të jetës shoqërore, ato,

ashtu siç shërbejnë për mobilizimin e masave për zgjidhjen revolucionare të problemeve me rëndësi që dalin prej proceseve të zhvillimit, po ashtu u jepin shtytje edhe drejtimeve tematike të letërsisë e të arteve dhe i ndihmojnë ato të lidhen më ngushtë me realitetin e kohës, me masat punonjëse që realizojnë në jetë politikën e Partisë dhe me fryshtë optimiste revolucionare të heroizmit popullor. Në këtë mënyrë letërsia dhe artet, duke synuar kurdoherë që ta pasqyrojnë realitetin në mënyrë të gjithanëshme, mprehin edhe karakterin e tyre politik, marrin pjesë aktive në jetën shoqërore të kohës dhe kontribuojnë për realizimin me sukses të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit.

Përvoja e deritanishme e letërsisë dhe e arteve tona të realizmit socialist ka treguar se këto lidhje, kur janë kuptuar thellë dhe janë realizuar në mënyrë krijuar, kanë qenë shumë të fryshtë dhe kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e letërsisë e të arteve, në forcimin e funksionit të tyre shoqëror dhe në rritjen e interesimit të masave punonjëse përfatë letrare e artistike, prej të cilave kërkojnë trajtimin e problemeve më të mprehta të aktualitetit. Faktet tregojnë, se lidhjet e letërsisë e të arteve me problemet kryesore të revolucionarizimit të gjithanshëm të jetës kanë bërë që të rritet shumë popullariteti i tyre dhe, përfasojë, edhe ndikimi i tyre pozitiv në jetën shoqërore e politike të vendit. Me gjithë këto suksese të dukshme në drejtimin përfatë cilin bëhet fjalë vihen re edhe disa dobësi, që dëshmojnë përfatë një kuptim ende të ngushtë e të sipërfaqshëm të lidhjeve të krijimtarisë artistike me politikën.

Ndodh disa herë, që pas vendimeve me rëndësi të organeve udhëheqëse të Partisë, të vihet re një shpejtësim përfatë trajtuar problemet e pasqyruara në to. Përveç anës pozitive një praktikë e tillë tregon edhe një dobësi të punës letrare e artistike: prapambetjen dhe lidhjet ende jo shumë të forta të saj me realitetin shoqëror në zhvillim, të cilin Partia e njeh shumë mirë, prandaj edhe është në gjendje ta përgjithësojë dhe ta orientojë me kohë, gjë që do të presupozohet ta bënte edhe krijimtaria letrare e artistike, në qoftë se shkrimitarët dhe artistët do të ndiqnin

hap pas hapi zhvillimin e realitetit, do ta studjonin atë në thellësi dhe do të merrnin kështu guximin për të depërtuar në të ardhmen e proceseve shoqërore. Veç kësaj prej një kuptimi të ngushtë jo vetëm të orientimeve politike, po edhe të vetë krijimtarisë artistike, ndodh që trajtimi i problemeve të ndryshme të bëhet në mënyrë artificiale, i shkëputur prej problemeve të tjera shoqërore e politike të kohës, duke cënuar parimin e njohur të pasqyrimit të gjithanshëm të jetës. Kështu ndodh që problemet e luftës kundër burokratizmit, të emancipimit të gruas etj. të trajtohen në mënyrë të shkëputur nga tërsia e problemeve dhe e kontradiktave shoqërore e politike të kohës, nga vetëjeta e njerëzve, të cilët janë objekti kryesor i letërsisë dhe i arteve, që të mos përmendim pastaj edhe orientimin e krijimtarisë disa herë jo në aspektet themelore të problemeve që vihen në rendin e ditës, po në ato aspekte që janë më të lehta dhe më pa telashe për t'u trajtuar. Në këtë mënyrë mund të shpjegohet që në letërsinë dhe në artet tona të sotme të ndihet akoma nevoja e trajtimit të temave që kanë të bëjnë me raportet e individit e të shoqërisë socialiste, me qëndrimin e ri ndaj punës e ndaj pronës shoqërore dhe me shumë probleme të tjera të jetës sonë aktuale, që janë trajtuar me kohë në dokumenta të rëndësishme të Partisë.

Në kushtet e sotme të zhvillimit ndërkombëtar partishmëria e letërsisë dhe e arteve të realizmit socialist është e lidhur shumë ngushtë me luftën kundër imperializmit e revizionizmit, si në plan të përgjithshëm shoqëror e politik, edhe në planin estetik dhe artistik. Presioni imperialishto-revizionist dhe ndikimet e huaja në letërsi e në art, si mjete të diversionit ideologjik, kanë patur dhe kanë për qëllim ta largojnë krijimtarinë artistike dhe mendimin estetik e kritik nga «rruga e drejtë revolucionare e realizmit socialist dhe nga tabani kombëtar, për t'i shmanqur ato nga viaja e Partisë dhe nga orientimet e saj të drejta». Prandaj, siç u theksua edhe një herë në Plenumin IV të KQ të PPSH, forcimi i partishmërisë proletare është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e letërsisë dhe të arteve në rrugë të drejtë, dhe kjo mund të arrihet vetëm duke u

qëndruar besnik mësimeve marksiste-leniniste të Partisë dhe duke luftuar me vendosmëri e në mënyrë frontale në të dy krahët, si kundër konservatorizmit, ashtu edhe kundër liberalizmit si dy të këqija që cënojnë, në radhë të parë, frysë e partishme të letërsisë e të artit të realizmit socialist. Lufta kundër rrymave borgjeze e revisioniste në letërsi e në art, si në çdo fushë tjetër të veprimtarisë shoqërore, duke patur një karakter të theksuar sulmues, nuk drejtohet vetëm kundër rrymave dekadente e formaliste në letërsinë e në artin e sotëm botëror, po edhe kundër ndikimeve të mundshme të tyre në letërsinë e në artin tonë. Këto ndikime, siç e dëshmuan edhe disa krijime letërare e artistike të viteve të fundit dhe teorizimet rreth tyre, nuk kanë qënë dhe nuk janë një «rrezik në potencë», po një rrezik real, të cilit mund t'i kundërvihet me sukses vetëm një letërsi e një art i partishëm, siç janë, në tërsinë e tyre, letërsia dhe artet tona të realizmit socialist.

«Partia jonë» thotë shoku Enver «i përbahet me vendosmëri parimit leninist të partishmërisë proletare në fushën e artit, të kulturës dhe të gjithë jetës shpirtërore të shoqërisë. Ashtu si kudo, edhe në këtë fushë bëhet një luftë e ashpër klasore midis dy ideologjive — ideologjisë materialiste marksiste-leniniste dhe ideologjisë idealiste, feudale e borgjeze. Vetëm duke u bazuar fort në ideologjinë tonë, në botëkuptimin materialist-dialektik, mund të kuptojmë drejt botën, jetën, të gjitha fenomenet e saj»<sup>36)</sup>

E kuptuar kështu partishmëria proletare në letërsi e në art është luftë dhe fitore e artit realist revolucionar mbi artin dekadent e formalist, e botëkuptimit materialist dialektik mbi botëkuptimet idealiste borgjeze, e vijës politike revolucionare mbi vijën politike reaksionare e revisioniste, e moralit komunist mbi moralin e shthurur borgjez, e njeriut të ri të revolucionit e të socializmit mbi njeriun skllav e pronar sklevërish, e shijeve të shëndoshë estetike populllore mbi shijet e borgjezëve të pasur dhe të lakejve të tyre në fushën e letërsisë e të artit.

36) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 139.

KREU I TRETE

1.

Krahas lidhjeve të ngushta me jetën dhe përvetësimit të marksizëm-leninizmit prej shkrimtarëve e artisteve, Partia i ka dhënë rëndësi kurdoherë edhe përpunimit dhe përvetësimit nga ana e tyre të një metode krijuese, që do t'u jepte mundësi të krijonin vepra me vlera të mëdha ideore e artistike, që do të ishin pasqyrime të denja të epokës së lavdishme të Revolucionit Popullor dhe të ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Kjo metodë krijuese njihet tanimë me emrin e realizmit socialist.

Partia që nё kohёn e Luftёs Nacionalçlirimtare, nё pёrmjet veprimtarisё praktike tё saj, drejtimit qё i dha zhvillimit tё letёrsisё e tё artit tё ri dhe kontributit tё shtypit revolucionar tё asaj kohe, synonte tё krijohej nё vendin tonё njё letёrsi realiste luftarake, e aftё dhe e denjё pёr tё pasqyruar heroizmin popullor, idealet e revolucionit, tipin e ri tё luftetarit kundёr shtypjes e skllavёrisё kombёtare e shoqёrore, njё letёrsi dhe njё art qё do tё shёrbenin pёr mobilizimin e masave nё lüftё dhe pёr edukimin e tyre komunist. Dhe kёshtu, nё vitet e ashpra e tё vrullshme tё Luftёs Nacionalçlirimtare, u hodhёn themelat e njё letёrsie e tё njё arti tё ri tё mbёshtetur nё traditёn mё demokratike, mё patriotike dhe mё realiste tё sё kaluarёs, qё ishte nё kundёrshtim tё hapur me tendencat reaksionare e klerikale, me prirjet formaliste e dekadente, me romantizmin kallp dhe me letёrsinё e artin konformist, qё ekzistonin nё atё kohё dhe qё pёrfaqёsonin aspiratat ideoartistike tё klasave sunduese e tё pushtuesve fashistё. Prandaj ёshtё i drejtё mendimi se nё periudhёn e Luftёs

Nacionalçlirimtare letërsia dhe artet tona hynë në rrugën e realizmit socialist, megjithëse në atë kohë nuk u dha asnjë orientim dhe nuk u botua asnjë traktat teorik për metodën artistike që duhej ndjekur. Ishin jeta dhe lufta e popullit, mësimet e marksizëm-léninizmit, puna ideologjike e politike e Partisë dhe pjesëmarrja e vetë shkrimtarëve dhe artistëve në Revolucionin Popullor, që diktuan dhe shtruan rrugën nëpër të cilën do të ecnin letërsia dhe artet e reja. Ky fakt është një dëshmi tjeter historike me rëndësi që provon se metoda e realizmit socialist nuk është një metodë, kërkosat e të cilës janë përpunuar në mënyrë akademike dhe janë imponuar në mënyrë administrative, siç pretendojnë shumë teoricienë borgjezë e revisionistë, po është rezultat praktik i zhvillimit historik të letërsisë e të arteve, shprehje e lidhjeve të tyre të ngushta me jetën e popullit. Parimet e realizmit socialist nuk janë formuluar në mënyrë aprioristike, sipas dëshirave dhe koncepteve subjektive të njerëzve, qofshin këta edhe shkrimtarë e artistë. Ato janë përgjithësim i një përvoje të madhe krijuese të shumë shkrimtarëve dhe artistëve të revolucionit, përpunim krijues i kontributit të tyre pozitiv, duke patur parasysh edhe traditën më të mirë të artit përparimtar të së kaluarës dhe perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm.

Realizmi socialist, — ndryshe nga ç'paraqitet në trajtimet dogmatike dhe në interpretimet borgjeze e revizioniste, — është një metodë artistike që u jep mundësi shkrimtarëve dhe artistëve ta pasqyrojnë jetën në mënyrë të thellë e të gjithanshme, të krijojnë vepra me nivel të lartë artistik dhe me rëndësi të madhe shoqërore, të përpunojnë dhe të zhvillojnë prirjet e tyre më të shëndosha dhe të përdorin stilet më të ndryshme realiste. Ajo në thelb dhe në aplikim të shkrimtarëve e të artistëve të talentuar revolucionarë, është kundër çdo kuptimi tal-mundist të formulimeve teorike, kundër çdo dogmatizimi të parimeve, kundër çdo kanonizmi artistik. Ajo është një metodë artistike që mbështetet në botëkuptimin materialist dialektik dhe jo vetëm rreh ta pasqyrojë jetën në zhvillim revolucionar, po edhe vetë letërsinë dhe artet i studjon.

dhe i kupton në zhvillim të përhershëm, nëpërmjet luftës së të kundërtave, në perspektivën e historisë së tyre të ardhshme. Si letërsi dhe arte të lidhura me revolucionin dhe me ndërtimin e socializmit, me një realitet përherë në përtëriturje e me prirje drejt të ardhmes, letërsia dhe artet e realizmit socialist do të ruajnë kurdoherë freskinë e përbajtjes e të formës dhe karakterin e tyre të theksuar novator. Ato do të janë në luftë, jo vetëm me traditën negative, me kufizimet e së kaluarës dhe me tendencat e sotme dekadente e formaliste, po edhe me rutinën dhe qëndrimet konservatore që krijojnë mënyrë të paevitueshme gjatë procesit të zhvillimit dhe që pasqyrojnë edhe në letërsi e në art ligjin e përjetshëm universal të luftës të së resë kundër së vjetrës edhe në terrenin e vetë realizmit socialist. Ky është një element tjetër me shumë rëndësi që përbahet në natyrën e metodës krijuese të realizmit socialist.

Në mënyrë teorike problemet e metodës krijuese të letërsisë e të arteve tona nisën të trajtohen pas Kongresit të Parë të Partisë (1948). Dokumentat e para që flasin përkëtë gjë janë materialet e mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH kushtuar prebatitjeve për konferencën e tretë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe shënimet e shokut Enver Hoxha «Këshilla për shkrimtarët e rinj» shkruar në qershor të vitit 1949. Në këta dokumenta është shprehur qëndrimi i Partisë ndaj letërsisë dhe arteve dhe janë dhënë orientimet e para të rëndësishme që realizmi socialist «të bëhet metodë drejtuese» e letërsisë dhe e arteve tona të reja, duke e kuptuar këtë si një mbështetje të forte «në terrenin kombëtar dhe në ideologjinë marksiste-leniniste», pastaj edhe në trashëgiminë e letërsisë përparimtare botërore, sidomos të letërsisë revolucionare të realizmit socialist.

Kalimin e letërsisë e të arteve në pozitat e realizmit socialist Partia e shikonte që në atë kohë si një domosdoshmëri objektive për të patur një krijuar të lidhur me popullin e me revolucionin, gjë që do të arrihej nëpërmjet orientimit të ri tematik, luftës kundër dekadentizmit

e formalizmit dhe kapercimit të kufizimeve të «realizmit të vjetër».

Shkrimtarët e vjetër, shkruan shoku Enver, janë kufizuar «vetëm të nxjerrin lakuriq veset e një shoqërie të perënduar, që rronte mbi kurrizin e popullit, të vënë në dukje vetëm veset e bejlerëve, jetën e tyre plot krimë, ahengje e kusërrira.

Shkrimtarët e rinj — vazhdon ai — duhet ta braktisin këtë rrugë dhe të ndjekin rrugën e realizmit socialist, që pasqyron realitetin e ri, jetën e re, forcën e re. Nëpërmjet përshkrimit të tipit të ri të shëndoshë nga trupi dhe nga mendja, tip kurajoz, heroik, përfaqësuesit të popullit, që lufton për jetën e re, për jetën e lirë, realizmi socialist denoncon të kaluarën shtypëse, veset e këqija, obskurantizmin, shtypjen e klasave feudale e borgjeze, denoncon dhe lufton shpirtin mikroborgjez dhe çdo gjë që e ndalon njeriun e ri të ecë në rrugën e tij të lavdishme dhe të realzojë aspiratat e tija për të ardhshmen, për ndërtimin e shoqërisë sociale». <sup>37)</sup>

Realizimi i këtyre ndryshimeve rrënjosore në bordinë ideologjike të letërsisë e të arteve, që kishin nisur të duke shin në krijuar tarinë e shkrimtarëve e të artistëve tanë dhe që do të thelojeshin në periudhat e mëvonshme, kërkonte një qëndrim të ri ndaj artit dhe një metodë të re krijuese që do të ndihmonte për të pasqyruar me realizëm e nga pozita revolucionare «realitetin e ri, jetën e re, forcën e re».

Partia e ka ndjekur me interesim zhvillimin e letërsisë e të arteve në çdo kohë dhe për çdo periudhë të përparimit të tyre ka përgjithësuar përvojën e fituar, ka vlerësuar rezultatet e arritura dhe ka çelur horizonte të reja për forcimin e këtyre rezultateve dhe për lulëzimin e mëtejshëm të krijuar tarisë në rrugën e realizmit socialist nëpërmjet thellimit e pasurimit të brendisë ideologjike dhe përsosjes së formës artistike. Në qëndrimet e Partisë vihet re përkrahja entuziaste e çdo suksesi të shkrimtarëve e artistëve, principialiteti komunist në gjykimin e fenome-

37) Enver Hoxha: Vepra, vëllimi 6, f. 210-211.

neve pozitive e negative, thellësia dhe mprehtësia shkençore në nxjerrjen e përfundimeve teorike dhe të detyrave, duke marrë parasysh karakterin shoqëror dhe specifikën e artit, nxitjen e forcave të reja krijuese, kujdesin për edukimin e tyre ideologjik, profesional etj.

Në Vendimin e KQ të PPSH (qershori, 1961) sipas rezultateve të arritura, u dalluan tri fazë të zhvillimit të realizmit socialist në letërsinë dhe artet tona.

«Letërsia dhe artet tona të realizmit socialist» thuhet në vendim «pas dy dekadash, tanimë kanë hyrë në fazën e pjekurisë. Në qoftë se në dhjetë vjetët e fillimit ato hidhnin hapat e tyre të para, por të sigurta në rrugën e realizmit socialist, në qoftë se në dhjetë vjetët që kaluan patën një zhvillim në gjerësi dhe thellësi, dekadat e ardhshme do të sjellin një përparim cilësor të dukshëm, karakteristikë e të cilit duhet të jetë hyrja në thellësi në proceset e ndryshimeve që po bëhen në vendin dhe në njërejt tanë.»<sup>38)</sup>

Sipas këtij vendimi letërsia dhe artet tona ishin mbështetur në mënyrë krijuese në traditat më të mira të së kaluarës, kishin kapërcyer prapambetjen e trashëguar, kishin përvetësuar metodën e realizmit socialist dhe nëpërmjet saj kishin dalë në rrugën e gjerë të përparimit, ishin zhvilluar mbi një bazë të shëndoshë ideologjike marksiste-leniniste, kishin trajtuar problemet kryesore aktuale të jetës së popullit dhe kishin ushtruar një ndikim të shëndoshë në formimin e njeriut të ri. Shkrimtarët dhe artistët, theksohej në vendim, kanë qëndruar në të gjitha situatat të bashkuar rreth Partisë dhe kanë bërë një luftë parimore dhe të vendosur kundër gjithë pikëpamjeve të ideologjisë borgjeze e revizioniste, duke u treguar kështu luftëtarë të palëkundur në frontin ideologjik.

Periudha prej vendimit të KQ të PPSH (1961) deri në Kongresin VI të PPSH (1971) ishte një kohë plot ngjarje me rëndësi në jetën e vendit dhe u karakterizua nga një luftë e madhe politike dhe ideologjike kundër imperializ-

38) Vendimi i KQ të PPSH për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve («Zëri i popullit» 4 qershori 1961).

mit e revizionizmit për mbrojtjen e marksisëm-leninizmit, të fitoreve të revolucionit, për ndërtimin e socializmit dhe për revolucionarizimin e gjithanshëm të jetës. Letërsia dhe artet u orientuan prej këtij realiteti historik dhe kontribuan në luftën e popullit tonë në të gjitha fushat e veprimtarisë. Ata iu nënshtruan procesit të revolucionarizimit të mëtejshëm, kapërcyen shumë kufizime të trashëguar nga e kaluara, forcuan brendinë ideologjike aktuale dhe karakterin novator, përballuan me sukses ndikimet borgjeze e revizioniste, që u dukën në disa krijime, arritën në një nivel më të lartë artistik.

Në Kongresin VI të PPSH, shoku Enver Hoxha, i paraqiti kështu sukseset kryesore të kësaj periudhe:

«Të ndjeshme dhe me një vlerë të çmuar edukuese janë rezultatet e viteve të fundit edhe në zhvillimin e letërsisë e të arteve. Lufta heroike e Partisë dhe e popullit kundër bllokadës imperialiste e revizioniste, revolucionarizimi i gjithanshëm i jetës së vendit, kërkesat e Partisë për një kulturë militante me frymë revolucionare aktuale dhe kombëtare, si edhe kuptimi e qëndrimi më i drejtë ndaj botimeve e repertorëve nga letërsia dhe arti i huaj, i dhanë nxitje të fuqishme zhvillimit të letërsisë dhe artit tonë. Ata fituan pjekurinë më të madhe ideopolitike dhe nivel më të lartë artistik. Si kurrë ndonjëherë është rritur krijimtaria artistike dhe janë zhvilluar me sukses të gjitha gjinit e artit dhe të letërsisë, si proza ashtu edhe poezia, si muzika ashtu artet figurative, teatri, kinematografia, etj. Talenteve të njohura iu shtuan e po u shtohen qdo ditë talentë të reja. Krahas ngritjes cilësore të krijimtarisë profesioniste, shpërtheu një hov i paparë i krijimtarisë popullore dhe i lëvizjes artistike amatore.»<sup>39)</sup>

Në dokumente të tjera me rëndësi të Partisë gjatë kësaj periudhe (materialet e Plenumin të 15-të të KQ të PPSH, raporti i shokut Enver Hoxha në Kongresin V të PPSH dhe fjallimet e tij historike në Byronë Politike të KQ të PPSH për revolucionarizimin e mëtejshëm të shko-

39) Enver Hoxha: Raport në Kongresin VI të PPSH-së (faqe 158-159).

Ilës dhe në Konferencën e 17-të të organizatës së Partisë të Tiranës) u shtruan probleme më aktuale të zhvillimit të letërsisë e të arteve dhe iu dha një zgjidhje marksist-leniniste shumë çështjeve që delnin prej gjendjes aktuale të tyre, siç qenë çështjet e raporteve ndërmjet traditës e novatorizmit, të qëndrimit ndaj letërsisë dhe artit të huaj, të nevojës së kapercimit të plotë të çdo ndikimi borgjez e revolucionist, të kuptimit të realizmit socialist si një fenomen në zhvillim, të raporteve ndërmjet anës objektive e subjektive në krijimtari, të etikës së punës krijuar artistike, të parimeve të kritikës letrare e artistike etj.

Zhvillimi dhe përpunimi i metodës së realizmit socialist dhe përparimi i letërsisë dhe i arteve tona në këtë trugë nuk janë arritur pa ndeshje mendimesh e praktikash të kundërtë, pa luftë e pa lajthitje, pa përpjekje serioze për të pastruar rrugën prej trashëgimeve negative të së kaluarës dhe për të ruajtur fisionominë realiste socialiste të letërsisë e të arteve prej ndikimeve çthurëse borgjeze e revolucioniste, pa punë të mundimshme për të rritur nivelin ideoartistik të krijimtarisë, duke hedhur mënjanë shfaqjet e ndryshme skematike, sentimentaliste, natyraliste, postromantike etj., që kanë nxjerrë krye herë pas here në krijimtari dhe në mendimin teorik e kritik. Lufta për konsolidimin e metodës realiste socialiste në letërsi e në art, me gjithëse në momente të caktuara merr më tepër zjarr, nuk është çështje fushatash, po një luftë e përherëshme, e vazhdueshme, e gjerë dhe e ndërlikuar, që ka të bëjë, para së gjithash, me domosdoshmérinë e çlirimt të plotë të artit prej çdo ndikimi të huaj, të vjetër ose të ri, dhe me përpjekjet e vazhdueshme për rritjen e mëtejshme të nivelit ideoartistik të krijimtarisë, duke ruajtur pozitat revolucionare dhe duke siguruar gjithnjë një fryshtë shëndoshë popullore, të partishme kombëtare, realiste dhe bashkëkohore.

Historia e letërsisë dhe e arteve tona të realizmit socialist ka prouar se kjo luftë është bërë gjithmonë në front të gjerë si kundër liberalizmit edhe kundër sektarizmit, si kundër modernizmit edhe kundër konservatorizmit, kurse përpjekjet për t'i-dhënë asaj drejtim të njëanshëm

kanë sjellë kurdoherë dëme serioze dhe kanë qënë shmangie prej vetë parimeve të realizmit socialist dhe prej orientimeve të drejta të Partisë për letërsinë dhe artet, kanë qenë përpjekje armiqësore për të ngjallur konfuzion dhe përcarje në radhët e shkrimtarëve e të artistëve. Të tilla kanë qënë edhe teorizimet dhe qëndrimet antimarksiste dhe antikombëtare të Fadil Paçramit e të Todi Lubonjës, të cilët luftonin me ethe për t'i celur rrugën modernizmit në letërsinë e në artet tona, për të dobësuar karakterin e tyre të partishëm dhe fryshtës kombëtare, për të shkallmuar pozitat e realizmit socialist. Po edhe në këtë raشت shkrimtarët dhe artistët e udhëhequr nga Partia, i shpalluan këto përpjekje dinake armiqsh, duke pastruar vreten dhe krijimtarinë prej ndikimeve të huaja dhe, në luftë e sipër, po i japin një hov të ri letërsisë dhe arteve, po forcojnë më tepër pozitat e realizmit socialist, duke u bërë më të ndërgjegjshëm për këtë gjë. Kongresi VI i PPSH, Plenumi IV i KQ të PPSH dhe fjalimet që mbajti shoku Enver gjatë vitit 1973 janë një tjetër mbështetje e sigurt për sukseset e ardhshme që do të arrijnë letërsia dhe artet gjatë viteve që vinë. Optimiste si gjithmonë, Partia edhe në këtë rast ka shprehur bindjen se:

«Të udhëhequr nga parimi i madh i partishmërisë komuniste, shkrimtarët dhe artistët do të na japin me siguri vepra edhe më të denja për këtë luftë heroike që bëjnë sot Partia e populli ynë për çështjen e revolucionit e të socializmit, vepra të qarta e të kuptueshme për masat, me ide të larta komuniste, me një fytyrë të qartë kombëtare, me një nivel artistik gjithnjë e më të përsosur»<sup>40)</sup>

40) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfakjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 41.

2.

Elementi me rëndësi që dallon realizmin socialist prej letërsisë dhe arteve të së kaluarës është shikimi dhe pasqyrimi i jetës nga pozita revolucionare, nëpërmjet kontradiktave më tipike të kohës. Ky parim themelor i realizmit socialist mbështetet në ligjin e njohur të zhvillimit të botës dhe të jetës nëpërmjet luftës së përhershme të tendencave e të forcave të kundërtë, në karakterin revolucionar të zhvillimit dhe të formave të zhvillimit, në ligjshmérinë objektive të fitores të së resë mbi të vjetrën, të përparimtares mbi të prapambeturën, të revolucionares mbi kundërrevolucionaren e reaksionaren, në prirjen e përjetshme të njerëzimit drejt të ardhmes, drejt shkallëve më të larta të zhvillimit të jetës materiale dhe të ndërgjegjes shoqërore.

Në letërsinë dhe në artin e së kaluarës janë reflektuar kurdoherë, në një formë ose në një tjetër, kontradiktat e jetës shoqërore e politike të kohës nga pozita përparimtare ose reaksionare, sipas këndit të vështrimit të shkrimtarëve e artistëve të ndryshëm. Në veprat më të shquara letrare e artistike këto kontradikta dhen konflikte shoqërore e politike janë pasqyruar në forma shumë të mprehta tragjike, dramatike ose komike, po kurdoherë në mënyrë të kufizuar dhe pa perspektivë ose me një perspektivë utopike, që shprehte dëshirat e mira të shkrimtarëve, po nuk pajtohej me tendencën e zhvillimit objektiv të shoqërisë. Ky ka qenë dhe mbetet edhe në ditët tona një prej kufizimeve më të rëndësishme ideoartistike të letërsisë e të artit përparimtar të realizmit kritik, që e ka bërumin jo vetëm në botëkuptimet idealiste të shkrimtarëve e të artistëve dhe në mosnjohjen prej tyre të rolit të klasës punëtore e të revolucionit socialist, po edhe në kufizimet artistike të metodës krijuar, si pasojë e tyre.

Duke folur për këtë tipar themelor të metodës së re artistike, shoku Enver, i mbështetur në përvojën e pasur të së kaluarës dhe në trajtimin marksist-leninist të problemeve letrare e artistike, që në vitin 1949 theksonte se

realizmi socialist jetën dhe procesin e zhvillimit duhet ta shohë «në të gjitha pamjet, në mënyrë realiste dhe në dinamizmin dhe progresivitetin e saj»<sup>41)</sup>. Në këtë orientim, me fare pak fjalë, është dhënë karakterizimi i plotë i thelbit të metodës së realizmit socialist, që prespozon pasqyrimin e gjithanshëm realist të jetës, dinamizmin e zhvillimit të saj nëpërmjet luftës dhe shikimin e saj prej shkrimtarëve e artistëve në mënyrë revolucionare si një proces me karakter të përhershëm përparimtar, megjithë ndërlifikimet, zikkakzet dhe kthesat historike të përkohshme që mund të ndodhin në luftën e proletariatit kundër borgjezisë dhe në procesin e ndërtimit të socializmit e të komunizmit:

Pasqyrimi i gjithanshëm realist i jetës në veprat letrare e artistike ka të bëjë jo vetëm me gjerësinë tematike të letërsisë e të artit në përgjithësi, po edhe me trajtimin e gjithanshëm të proceseve jetësore në vepra të vëçanta, me aftësinë e shkrimtarëve e të artistëve për të krijuar tablo të gjera e të vërteta të jetës, për të riprodhuar artistikisht kompleksitetin e marrëdhënieve shoqërore dhe dialektikën e ndërgjegjes njerëzore. Realizmi socialist, ndryshtë nga ç'pretendojnë kritikët borgjezë e revisionistë, është një metodë artistike krejt e kundërt me tendencat natyraliste, skematiqe dhe racionaliste-skolastike, të cilat zbehin brendinë ideoemocionale dhe thellësinë filozofike shoqërore të artit, dëmtojnë pasqyrimin e gjallë e të plotë të jetës e të shpirtit të njeriut dhe i zëvendësojnë ato me skema të paramenduara, me problematikë e tipa artificialë dhe me diskutime sofistikatë për të mirën e të keqen, për të moralshmen e të pamoralshmen etj. shkëputur nga realiteti konkret historik. Në letërsinë dhe në artet e realizmit socialist, siç e provojnë edhe veprat më të mira të shkrimtarëve e të artistëve tanë, fantazia dhe trillimi artistik edhe pse kalojnë përmes botës subjektive të krijuesve, janë reflektim i përshtypjeve të drejtpërdrejta ngajeta, të seleksionuara nën prizmin e botëkuptimit marksist-leninist. Brendia ideore e tyre

41) Enver Hoxha: Vepra, vëllimi i 6-të, f. 207.

rrjedh nga vetë jeta në zhvillim, është mishërim i atyre proceseve dhe idealeve, që lindin nga lufta revolucionare dhe nga puna për ndërtimin e socializmit. Po kjo nuk do të thotë se në letërsinë e në artet tona nuk ka vepra të dobëta skematike, me prirje natyraliste dhe me reflekse të theksuara të botës subjektive të shkrimtarëve e të artistëve. Për vepra të tillë është folur vazhdimi i kritikën tonë, gjë që tregon se të meta e dobësi të tillë nuk janë në natyrën e metodës krijuese, po pasojë e njohjes së paktë të jetës, e caktësisë ideoologjike, e përvetësimit dhe zbatimit mekanik të parimeve etj.

Karakteri konkret historik i brendisë ideoemocionale të letërsisë e të arteve të realizmit socialist nuk ka të bëjë, siç lihet të kuptohet ndonjëherë, me autenticitetin e ngjarjeve e të heronjve, po me vërtetësinë e problematikës shoqërore e politike që trajtohet, me objektivitetin e pasqyrimit të prirjeve të zhvillimit historik, me domosdoshmérinë që tablotë artistike dhe heronjtë e veprave të përbajnjë në vjetvete ato elemente me rëndësi të zhvillimit shoqëror, që janë tipike për një periudhë të caktuar historike. Kjo është ana themelore e çështjes. Vërtetësia e hollësive plotëson vërtetësinë e përbajtjes themelore të veprave, e cila, në qoftë se bie ndesh me realitetin e kohës, nuk mund të shpëtohet prej vërtetësisë së fakteve të veçanta, që mund të përbahen në to. Në disa raste është vënë re edhe në letërsinë dhe në artet tona, që me gjithë autenticitetin historik të ngjarjeve e të personazheve të veprave, tingulli i tyre, jo vetëm nuk ka përbajtur të vërteta me rëndësi historike, po ndonjëherë ka qenë edhe në kundërshtim të hapur me tendencën objektive të zhvillimit. Kjo ka ndodhur në ato raste kur shkrimtarët e artistët kanë mbivlerësuar faktin e veçuar dhe nuk kanë parë rrjedhën e gjerë të proceseve historike, kur nuk kanë hyrë thellë në studimin e këtyre proceseve, po kanë notuar në sipërfaqe të ngjarjeve dhe kur i kanë vlerësuar këto ngjarje nga pozita jo revolucionare. Prandaj *pasqyrimi konkret historik i realitetit* ka të bëjë, në radhë të parë, me studimin dhe pasqyrimin nga pozita revolucionare të prirjes objektive të zhvillimit his-

torik, me njohjen dhe vlerësimin e drejtë të forcave shoqërore që përbëjnë shoqërinë e një periudhe të caktuar, me pasqyrimin artistik të atyre fenomeneve të jetës që janë tipike për kohën që përshkruhet. Një kuptim i tillë i vërtetësisë historike të veprave, i largon letërsinë dhe artet prej prirjeve subjektiviste, që krijojnë tablo të transfiguruara të realitetit si dhe prej prirjeve sempliste natyraliste, që duke nëpërkëmbur specifikën e përgjithësimit artistik të realitetit, shpien në një identifikim të plotë të së vërtetës artistike me të vërtetën konkrete të jetës.

Realizmi socialist, duke patur si një prej kritereve të vlerësimit të artit besnikérinë e pasqyrimit të realitetit, ballafaqimin e brendisë së veprave me brendinë reale të proceseve shoqërore që përshkruhen në to, është kundër thjeshtësimit të çështjes deri në atë shkallë, sa të kërkohet prej veprave të artit një fotografim i thjeshtë i realitetit jetësor.

«*Shkrimtari dhe artisti*» thuhet në raportin e Plenumit të 15-të të KQ të PPSH «duhet ta paraqesin drejt realitetin në zhvillimin e tij revolucionar, ta pasqyrojnë atë me besnikéri dhe me forcën e duhur përgjithësues, në mënyrë që të ngjallin emocione të forta dhe të ushtrojnë ndikimin e duhur edukativ tek lexuesit e spektatorët. Për këtë një rëndësi të veçantë ka këndi i tyre i të parit, qëndrimi ideor dhe emocional ndaj realitetit, talenti dhe aftësia e tyre...»<sup>42)</sup>

Për të patur një pasqyrim të gjithanshëm dhe historikisht konkret të realitetit ka rëndësi të dorës së parë zbulimi, kuptimi dhe interpretimi i drejtë ideoartistik i kontradiktave tipike të kohës, i konflikteve politike shoqërore karakteristike, i luftës së klasave në të gjitha format dhe në të gjitha fushat e shfaqjes së saj. Nëpërmjet kontradiktave dhe konflikteve politike e shoqërore pasqyrohet në veprat letrare e artistike problematika e pasur e kohës, kurse prej qëndrimit të shkrimtarëve e artistëve ndaj kontradiktave të pasqyruara përcaktohet karakteri shoqëro-

42) PPSH — Dokumente kryesore, vëllimi IV, f. 568.

-edukativ i krijimtarisë, roli i tyre aktiv në jetën shoqërore.

Arti i vërtetë kurdoherë ka qenë pasqyrë e ndeshjeve të mëdha shoqërore, prandaj edhe ka tërhequr vëmendjen e njerëzve, ka ngjallur kundërshtim ose entuziazëm, si pas brendisë që ka pasur e sipas qëndrimit të forcave të ndryshme shoqërore ndaj tij. Pushtuesit turq ndiqnin dhe pengonin në çdo mënyrë përhapjen e letërsisë së Rilindjes, në të cilën pasqyroheshin nga pozita patriotike kontradiktat e popullit tonë me ta, kurse censura e Zogut ndaloi qarkullin e «Vargjeve të lira» të Migjenit, në të cilat pasqyroheshin kontradiktat e mprehta ndërmjet rinasë revolucionare të asaj kohe dhe forcave të reaksionit, «paçavrave që kishin zënë myk ndër tempuj». Nga ana tjetër këto vepra ngjallnin entuziazëm dhe frymëzonin forcat patriotike e revolucionare në luftën e tyre për çlirimin kombëtar e shoqëror. Interesimi i shoqërisë sonë të sotme për letërsinë dhe artet e realizmit socialist është përcaktuar gjithashtu nga fakti se në veprat e mira të shkrimitarëve dhë të artistëve tanë janë pasqyruar me vërtetësi kontradiktat dhe konfliktet tipike të kohës, janë prekur ato probleme politike, shoqërore dhe morale që shqetësojnë njerëzit e kohës sonë dhe që përfaqësojnë prirjen e zhvillimit të sotëm e të nesërm të vendit. Në këtë drejtim në veprat më të mira është mbajtur parasysh kriteri se kontradiktat dhe konfliktet më tipike janë ato që lindin prej statit më të përparuar të zhvillimit shoqëror, mbasi nëpërmjet tyre paraqitet në formën më të mprehtë lufta e së resë revolucionare me të vjetrën, me prirjet e huaja, konservatore ose liberale qofshin. Arti i realizmit socialist presupozon mprehjen dhe theksimin e kontradiktave nga pozita revolucionare, në mënyrë që të tërheqë me kohë vëmendjen e shoqërisë në problemet që lindin nga procesi i zhvillimit, në filizat e reja të së ardhmes dhe në vjetërimin e anëve të ndryshme në marrëdhëniet shoqërore, në mentalitetin dhe në ndërgjegjen e njerëzve. Theksimi artistik i kontradiktave përban në vetvete tendenciozitetin ideologjik të realizmit socialist, që mishëro-

het në entuziazmin afirmues për forcat dhe elementet e reja e të shëndosha shoqërore dhe në kritikën e ashpër e në demaskimin e pamëshirshëm të elementeve dhe forcave shoqërore reaksionare, regresive, çthurëse ose frenuese. Nëpërmjet pasqyrimit të luftës së ashpër, të kontradiktave antagoniste dhe jo antagoniste të zhvillimit dhe përkrahjes së anës revolucionare në këtë luftë, letërsia dhe artet e realizmit socialist arrijnë të jasin një tablo besnikë emocionuese të zhvillimit revolucionar të jetës. Një qëndrim i kundërt do të krijonte distancë ndërmjet zhvillimit shoqëror dhe gjendjes së letërsisë e të arteve, do të ulte vlerën e tyre shoqërore aktive.

«Partia në krye të masave» theksoni shoku Enver «lufton me këmbëngulje për afirmimin e asaj që është socialiste dhe për heqjen e çdo pengese që frenon ecjen tonë përpara, ajo zbulon me guxim kontradiktat dhe luftron për kapercimin e tyre, kritikon të metat dhe nuk e humbet kurrë perspektivën, kryen për ditë atë proces të njojur të ndërtimit të së resë dhe të shkatërrimit të së vjetrës, transformon jetën e njerëzve, formon njeriun e ri. Këto qëllime duhet të kenë kurdoherë parasysh edhe letërsia e arti ynë, këtë vulë të mbajnë edhe ato. Pasqyrimi i realitetit të ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar dhe në kontradiktat e kohës, që i jasin letërsisë dhe artit dramaticitetin dhe konfliktet e nevojshme, — këtu qëndron përbajtja e re që i jep forcën letërsisë e artit tonë të realizmit socialist.»<sup>43)</sup>

Këto parime të përgjithshme të pasqyrimit artistik të kontradiktave e të konflikteve shoqërore të kohës përfshijnë gjithë sferën e krijimtarisë dhe gjejnë zbatim si në letërsi edhe në pikturë, si në kinematografi e në muzikë edhe në të gjitha llojet e tjera të artit dhe konkretizohen në frymën e tyre afirmuese dhe kritike, ku kritika dhe denoncimi i nënshtronës pohimit të frymës revolucionare,

43) Enver Hoxha: Raport në Kongresin VI të PPSH-së, f. 159-160.

pohimit dhe përkrahjes të forcave e të tendencave të reja shoqërore. Po kahas kësaj ane të përgjithshme parimore çdo lloj arti, çdo gjini krijuese ka edhe specifikën dhe mjetet artistike të veçanta të pasqyrimit të kontradiktave e të konflikteve shoqërore. Në balet, për shembull, pasqyrimi i konflikteve nuk mund të ketë atë konkretizim në lëvizje e në mimikë, në Mizanskena e në hollësi të tjera që ka në teatër, kurse nga piktura nuk mund të kërkohet ajo gjerësi dhe shtrirje në kohë që është karakteristikë për letërsinë, për kinematografinë etj. Po kështu intensiteti i ngjarjeve dramatike nuk mund të jepet me të njëjtën mënyrë në veprat teatrale, në poesi, e në prozë gjersa mundësítet dhe mjetet pasqyruese të tyre janë të ndryshme. Veç kësaj, në disa forma krijimtarie si në peisazh, në poezinë e shkurtër lirike etj. zakonisht kontradiktat lihen të nën-kuptohen prej qëndrimit pohues ose mohues të piktorit e të poetit e rrallë herë dalin në dukje e në plan të parë. Qëndrimi i artistit ndaj objektit të pasqyruar përbën në këto raste kontradiktën shoqërore, qëndrimin shoqëror ndaj aspekteve dhe fenomeneve të pasqyruara.

Zbulimi dhe theksimi i kontradiktave historikisht konkrete në letërsinë e në artet e realizmit socialist nuk është një qëllim në vetvete. Ai shërben si bazë objektive për të realizuar në vepra, nëpërmjet luftës së të kundërtave në tërë kompleksitetin e saj, pasqyrimin e realitetit në zhvillimin e tij revolucionar, mbasi dihet që pa luftë nuk ka zhvillim. Ky është qëllimi kryesor i përpjekjeve të vazhdueshme që bëjnë shkrimitarët dhe artistët e realizmit socialist për të zbuluar dhe për të pasqyruar jetën nëpërmjet të gjitha shfaqjeve dhe fenomeneve të saj, jo si dikë statike e të amullt, po si dikë që vazhdimisht lëviz, rritet e lartësohet, si një proces të përjetshëm të ndërtimit të së resë dhe shkatërrimit të së vjetrës. Në çdo kohë, në çdo moment historik shkrimitari dhe artisti i vërtetë realist di të zbulojë e të pasqyrojë realitetin në tre dimensionet e njoitura të tij, siç thoshte Maksim Gorki: në të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen dhe të gjejë në të atë që po vdes, atë që vjetërohet, atë që lind e

forcohet dhe të përcaktojë tiparet e ardhshme të fenomeneve që sapo shfaqen në jetë. Ky është pikërisht një prej kapërcimeve më të guximshme dhe më novatore që i bën letërsia dhe arti i realizmit socialist traditës artistike të së kaluarës.

«E tanishmja pregatit të ardhmen dhe këtë të ardhme nuk e pregatit nëpërmjet èndërrimeve dhe imagjinatave ireale, po nëpërmjet parashikimeve shkencore materialiste, të drejtuara nga ligje të zbuluara, të cilat shkencërisht ndihmojnë për të zbuluar të tjerë»<sup>44)</sup>

Mbi këtë bazë kuptimi i parimit të pasqyrimit të realitetit në zhvillimin e tij revolucionar nuk do vulgarizuar deri në atë shkallë sa të identifikohet me «fundet e lumturë» të veprave të dobëta skematike dhe as me ato elemente të jashtme vulgare që të bien në sy në disa vepra skulpturale e pllakate, në të cilat me një dorë të shtrirë përpëra ose me një hap të hedhur pandehet se është shprehur plotësisht tendencia revolucionare e zhvillimit dhe perspektiva. Përkundrazi, raste të tilla i ngjajnë më tepër një parodizimi të parimit dhe s'kanë të bëjnë fare me thelbin revolucionar të metodës krijuese të realizmit socialist. Pasqyrimi i realitetit në zhvillim revolucionar mund të arrihet vetëm në ato vepra, në të cilat është depërtuar në dialektikën e brëndshme të fenomeneve e të proceseve jetësore dhe të ndërgjegjes së njeriut dhe është zbuluar kështu në çdo anë, në çdo pjesë e sidomos në fryshtën e përgjithshme të veprës, tendencia progresive e zhvillimit, forca e së resë fitimtare, besimi në të ardhmen dhe optimizmi revolucionar edhe kur si objekt pasqyrimi për veprat kanë shërbyer ngjarje tragjike. Në këtë rast, kahas pasqyrimit në vërtetësi të madhështisë heroike të së resë revolucionare, rëndësi të veçantë ka qëndrimi i drejtë i shkrimitarit ndaj kontradiktave të pasqyruara, pozita e tij klasore e përcaktuar, pa ekuivoke ideore, mbasi:

«Detyra e shkrimitarit komunist, me parti ose pa parti, është jo të bëjë thirrje për të «zbutur» urrejten ndaj

44) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968), f. 486.

armiqve, por t'i edukojoë masat me patriotizmin e flaktë, me urrejtje për armiqtë e lirisë e të pavarësisë së Atdheut dhe të çështjes së socializmit, jo të predikojoë paqen kris-tiane midis njërzëve, pa i dalluar ata se cilët janë, q'klasë përfaqësojnë, për q'interesa luftojnë. Një arti të tillë mbi-klasor, një «humanizmi» të tillë abstrakt, ne duhet t'i kundërvëmë artin dhe humanizmin tonë revolucionar, që u përgjigjen interesave të klasës, të partisë, të luftës për socializmin, kundër kapitalit, kundër shfrytëzimit, kundër pushtuesve»<sup>45)</sup>

Në këtë mënyrë, nëpërmjet pasqyrimit me vërtetësi të kontradiktave, nëpërmjet pohimit e mohimit revolucionar, letërsia dhe artet e realizmit socialist e paraqesin realitetin në zhvillim revolucionar, «*në dinamizëm dhe progresivitet*», me anësi ideoartistike të përcaktuar. Ato kanë si ideal të tyre bukurinë dhe madhështinë e luftës revolucionare për çlirimin e njerëzimit nga çdo formë shtypje e skllavërimi dhe për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, bukurinë dhe madhështinë e njeriut të revolucionit e të ndërtimit socialist me tiparet e luftëtarit komunist. Nën prizmin e këtij ideali letërsia dhe artet tonë e shohin dhe e pasqyrojnë jetën në të gjitha aspektet e saj, nëpërmjet ndeshjeve pambarim dhe konflikteve të shumta ekonomike, politike, ideologjike, shoqërore dhe etike kundër atyre forcave dhe shfaqjeve që bien në kundërshtim me të ose me ato anë të fenomeneve shoqërore, që me kohë vjetërohen, ndonëse dikur kanë pasur karakter përparimtar. Zotësia e shkrimitarëve dhe e artistëve në këtë rast është që të zbulojnë në jetë me kohë dhe pa u gabuar çdo gjë të re, që përfaqëson prirjen revolucionare dhe çdo element që është vjetëruar dhe kthehet në një forcë frenuese për zhvillimin e mëtejshëm.

Por, siç theksohet në raportin e Plenarit IV të KQ të PPSH, pasqyrimi i kontradiktave në letërsi e në art nuk është bërë kurdoherë nga pozita të shëndosha ideologjike e artistike, mbasi ka ndodhur që në disa drama,

45) PPSH = Dokumente kryesore, vëllimi IV, f. 572.

tregime e poema të mos mbahet qëndrim i drejtë realist në vlerësimin e natyrës së tyre dhe për këtë arsyen, edhe mënyra e trajtimit dhe zgjidhjet që u janë dhënë në këto raste kanë qenë të gabuara e, ndonjëherë, edhe haptas antisocialiste. Në ndikimin e tendencave moderniste dhe të presionit imperialisto-revizonist ka ndodhur që kontradiktat në gjirin e popullit, që siç dihet, janë kontradikta joantagoniste, të paraqitem e të zgjidhen si kontradikta me karakter antagonist, si luftë ndërmjet brezave ose si shfaqje të antagonizmave në gjirin e popullit e të socializmit. Tipike për një trajtim të tillë të kontradiktave joantagoniste kanë qenë dramat famëkeqe të Fadil Paçramit «Ngjarje në fabrikë» dhe «Çështja e inxhinier Saimirit», në të cilat realiteti ynë pasqyrohej në mënyrë krejt të shtrembëruar e nga pozita antisocialiste, anarkiste. Fadil Paçrami, duke reflektuar në letërsi pikëpamjet e veta anti-marksiste e armiqësore, ndërsa bënte thirrje që të lihen mënjanë kontradiktat ndërmjet nesh dhe armiqve, kontradiktat në gjirin e popullit i trajtonte si antagonizma klasore që s'mund të zgjidheshin me anë të kritikës, të autokritikës e të riedukimit, po vetëm me përmbytjen rrënjësore të gjendjes, pra, me një ndërhyrje anarshiste kundërrevolucionare. Një pozitë e tillë është mbajtur edhe nënja dy poema e në ndonjë vepër tjetër. Në këtë mënyrë, autorët e veprave të tilla, duke e parë realitetin e kohës nga pozita krejt të gabuara ideopolitike, e errësojnë atë deri në atë shkallë, saqë edhe zgjidhja që u japid kontradiktave të pasqyruara ose është një zgjidhje fiktive ose është një perspektivë e errët dhe e pashpresë.

Rrëshqitja në gabime të tillë, kur bëhen pa qëllim, ka të bëjë edhe me largimin nga tipizimi realist dhe nga pasqyrimi në vepra i fenomeneve dhe karaktereve tipike të ikohës, në rrëthana e ambiente tipike.

Shoku Mehmet Shehu, duke folur për këtë çështje, ka theksuar se tipike «janë rrëthanat në të cilat vendi ynë po ndërton socializmin i rrëthuar ideologjikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht nga armiku i klasës, nga imperializmi dhe revizionizmi. Kjo nuk duhet harruar kurrë. Të tipizosh sot fenomene dhe personazhe jashtë këtij rea-

liteti historik, kur është fjala për temën aktuale, do të thotë t'i largohesh realitetit.» Dhe realiteti ynë «karakterizohet nga suksesi dhe jo nga mos suksesi, nga përparrimi e zhvillimi dhe jo nga ngecja në vend e zvarritjes spontane, karakteristika dallonjëse e gjendjes sonë të përgjithëshme është vrulli revolucionar i masave dhe heroizmi masiv e jo plogështia, dembelizmi, frika; atmosfera e jetës sonë karakterizohet nga qartësia, optimizmi dhe gëzimi e jo nga zymtësia, pesimizmi, hidhërimi, etj. Pikërisht në këto karakteristika dallonjëse në këto rrethana të vencanta duhet kërkuar tipikja për të tipizuar personazhet dhe fenomenet». <sup>46)</sup>

Lidhjet me perspektivën historike dhe me lëvizjen revolucionare përcaktojnë edhe një tipar tjetër të realizmit socialist: shkrirjen organike në të të realizmit me romantikën revolucionare. Të dy këto elemente themelore të njësisë ideoartistike të realizmit socialist kanë një traditë të lashtë dhe shumë të pasur në letërsinë e në artin botëror. Njerëzit, që me mithet, përrallat e legjendat nië të herëshme, pastaj edhe me krijimtarinë artistike të kultivuar, janë përpjekur kurdoherë ta pasqyrojnë jetën jo vetëm ashtu siç është po edhe ashtu siç do të dëshironin ata të ishte dhe kurdoherë ndërmjet realitetit konkret dhe realitetit të dëshiruar kanë parë një hendek të madh, i cili vetëm me anë të fantazisë mund të kapërcehej. Kështu u janë dhënë krahë në letërsi e në art përfytyrimeve subjektiviste dhe utopike dhe idealizmit të objektit të pasqyrimit për të shprehur, nëpërmjet tyre, pakënaqësinë ndaj realitetit ekzistues dhe tëndrrën e bukur për një realitet tjetër vërtetë të paqënë, po më njerëzor, prandaj edhe shumë të dëshirueshëm. Njeriu në jetë kurrë nuk e ka ndarë punën e tij të përditshme dhe të mundimshme nga ëndrrat për të ardhmen, nga dëshirat për të realizuar disa qëllime, për të jetësuar disa ideale, që mund të kenë

46) Mehmet Shehu: Mbi thellimin e luftës ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre në letërsi dhe arte. («Nëntori», 1974, Nr. 2, faqe 6).

qënë reale ose ireale, të mundshme ose të pamundshme, përparimtare ose reaksionare, me karakter të gjërë shoqëror ose me frymë individualiste etj. Aq më tepër grupet e rëndësishme, shtresat dhe klasat shoqërore në çdo kohë kanë patur idealitet e tyre, që kanë qënë përcaktuar nga pozita e tyre në strukturën shoqërore, nga interesat e tyre klasore dhe, sipas këtyre, kanë patur karakter përparimtar ose reaksionar. Romantik ishte Fishta, po romantizmi i tij në plan shoqëror ishte reaksionar, mbasi ai i ushqyer nga ide dhe pikësynime klerikale, konservatore dhe patriarkale e shikonte me tallje, me përbuzje të hapur dhe me skepticitëzim çdo shenjë qytetërimi e përparimi dhe idealizonte obskurantizmin fetar, rendin e fiseve e të bajraqeve, prapambetjen. Romantik ishte edhe Migjeni, po romantizmi i tij, përkundrazi, ishte një shfrim i dufit dhe i urrejtjes popullore kundër klerit dhe fesë, kundër padrejtësise dhe pabarazisë shoqërore, ishte një klithmë e malësorit që vuante për bukë, ishte entuziazëm për bijtë e shekullit të ri dhe për grushtin e paligjshëm. Ky ishte romantizmi i forcave revolucionare para themelimit të Partisë Komuniste.

Edhe prej këtyre dy shembullave kuptohet se romantizmi në letërsinë dhe në artin e së kaluarës nuk ka patur ndonjëherë karakter unik. Njihet romantizmi reaksionar feudal e klerikal, romantizmi mikroborgjez, romantizmi përparimtar dhe romantizmi revolucionar, i përfaqësuar secili prej personalitetesh të njoitura të letërsisë e të artit botëror. Letërsia dhe artet e realizmit socialist mbështeten në traditën e romantizmit përparimtar dhe revolucionar të së kaluarës, e përpunojnë dhe e zhvillojnë atë më tej, duke e çliruar nga kufizimet që rridhni prej botëkuptimit dhe metodës artistike të krijuesve të vëçantë.

Po, kur flasim për traditën e së kaluarës dhe për hendekun që ka ekzistuar ndërmjet realitetit konkret historik dhe realitetit të dëshiruar, nuk do të ishte e saktë që për këtë gjë si shkak i vetëm të merreshin kufizimet ideoartistike të romantizmit ose të elementeve romantike në krijimtarinë letrare e artistike. Edhe realizmi në të kaluarën ka patur kufizime të dukshme ideoartistike dhe është

e natyrshme që një pasqyrim jo i plotë i realitetit të kohës, i kontradiktave themelore dhe i forcave vepruese të saj, do të sjellë domosdo si pasojë edhe një përfytyrim jo të vërtetë të «realitetit të dëshiruar», të së ardhmes. Prandaj, në realizmin socialist nuk bëhet një bashkim mekanik i traditës realiste dhe romantike të së kaluarës, po pér shkak të kushteve të reja shoqërore dhe të shikimit të jetës në mënyrë materialiste dialektike arrihet në një shkrirje organike krijuese të realizmit me romantizmin, duke marrë secili prej tyre tipare të reja që nuk i kanë patur më parë. Në letërsinë dhe në artin e realizmit socialist, po të shprehemi kështu, realizmi bëhet *më romantik*, duke u pasuruar me idealin e së ardhmes dhe me ndjenjën e me mendimin e ecjes përpëra, të perspektivës, kurse romantizmi bëhet *më realist*, se nuk është më një shkëputje prej realitetit, një èndërrim i zbrazët, një utopi ose një kredhje në botën subjektive, po është një fluturim i guximshëm dhe një himnizim i heroizmit, që merr hov prej vetë realitetit të luftës revolucionare dhe të punës pér ndërtimin e socializmit. Pra, kemi të bëjmë me një realizëm të ri dhe me një romantizëm të ri.

Romantizmi i realizmit socialist merr shkas prej realitetit objektiv, kështu që, edhe në këtë drejtim, nuk kemi të bëjmë me një formulim akademik ose me një «kanonizëm» artistik, po me pasqyrimin e plotë të vetë jetës dhe me një përgjithësim teorik të vetë përvojës së grumbulluar prej letërsisë e prej arteve.

«Ju duhet të futeni *thellë* në jetën e punonjësve» i porosit shkrimtarët dhe artistët shoku Enver. «*Ndiqeni jetën* dhe *punën* *heroike* të një shoferi, p.sh., dhe do të shihni se ai, megjithëse familjen mund ta ketë akoma pa apartament, ose ndonjë nga fëmijët edhe të zbatur, punon me ndërgjegje të lartë, me entuziazëm, pér të çuar maqineritë e mëdha pér ndërtimin e hidrocentralit, do të shihni se ç'poëzi e madhe vlon në shpirtin e tij. Ai mendon pér atë hidrocentral, që do të ngrihet dhe do t'i japë popullit drithë, që do të vërë në lëvizje fabrikat e mëdha që po ngremë dhe me këtë ndjenjë besimi dhe optimizmi

çan rrugët malore, të mbushura me borë nga të cilat ai mund edhe të shkëputet dhe të bjerë në hon...»<sup>47)</sup>

Kjo është romantika heroike e qëndrimit të njerëzve tanë të rindaj ndaj jetës socialiste dhe ndaj Atdheut të tyre, një romantikë që buron prej qëndrimit aktiv ndaj fateve të vendit, prej besimit në të ardhmen, prej vënies së interesave të mëdha shoqërore mbi interesat e ngushta personale, një romantizëm optimist dhe luftarak që presupozon dhe nxit heroizmin, që e pasuron dhe e lartëson njeriun dhe i jep punës e jetës së tij një kuptim shoqëror me rëndësi. Realiteti i mëparshëm historik nuk e ka njojur një romantikë të tillë edhe në momentet e ngrijave të fuqishme revolucionare, se asnjëherë më parë fatet e individit e të shoqërisë nuk kanë qenë kaq të harmonizuara ndërmjet tyre, prandaj dhe idealet e tyre nuk kanë patur gjithnjë të njëjtën natyrë.

Në letërsinë dhe në artin e sotëm perëndimor si dhe në letërsinë e në artin e vendeve revisioniste vihet re prirja e zhveshjes së krijimtarisë dhe të heronjve prej idealeve të mëdha shoqërore, prirja drejt pasqyrimit të një bote meskine me ideale mikroborgjeze, që pasqyron vetë realitetin shoqëror të atyre vendeve, deziluzionin dhe kufizimet ideore të shkrimtarëve e të artistëve, të cilët nuk arrijnë ose nuk mundën të vënë në qendër të veprave një realitet dhe një hero, që do të përfaqësonë realitetin e luftës e të kontradiktave klasore dhe hovin e betejave të ardhshme revolucionare. Prandaj në mendimin teorik borgjez e revisionist romantika konsiderohet si një dobësi e realizmit socialist, si diçka që i shtohet atij me qëllim dhe jo si një element me rëndësi që e përmban vetëjeta dhe që letërsia e arti, besnikë të realitetit, duhet ta pasqyrojnë. Duke u hedhur kundër romantikës borgjezët e revisionistët duan t'i largojnë letërsinë dhe artet prej idealeve të tyre revolucionare, duan t'i diskreditojnë para masave këto ideale dhe të mbjellin skepticizëm pér

47) Enver Hoxha: Fjala në mbledhjen e shkrimtarëve dhe artistëve më 11 korrik 1961 («Drita», 6 gusht 1961).

të ardhmen. Ndryshe prej tyre Partia janë porosit jo vetëm shkrimtarët e artistët, po edhe të gjithë njerëzit që të dinë të zbulojnë, të kuptojnë dhe të shfrytëzojnë romantikën e jetës, bile, jo vetëm ta zbulojnë, po edhe ta krijojnë, ta organizojnë atë, — siç thotë shoku Enver në fjalimin e mbajtur në Plenumin e KQ të PPSH kushtuar «gjendjes ekonomike, sociale e kulturale të fshatit dhe mësimeve përmes njërit e mëtejshme të saj» (qershori 1963).

Kuptimi i romantikës dhe i romantizmit revolucionar del jasht kufive të enderrimeve individuale dhe të qëndrimeve të individit ndaj jetës. Ai përbahet në të gjitha shfaqjet e lëvizjes revolucionare dhe të jetës socialiste. Në artin dhe në letërsinë e sotme të vendeve evropiane dhe në mendimin teorik për to janë konkretizuar dy qëndrime të kundërtë e të njëjanshme ndaj aspektit romantik të brendisë e të shprehjes artistike. Sipas një pale romantikës dhe romantizmit në shekullin e sotëm (që është një shekull i «sundimit» të teknikës dhe i marrëdhënieve praktike ndërmjet njerëzve dhe ndërmjet tyre e shoqërisë) u ka ikur koha, janë vjetëruar dhe nuk kanë të bëjnë me konceptet e njeriut të sotëm dhe me artin e sotëm modern. Në këtë qëndrim, nga pikëpamja shoqërore, kemi të bëjmë me një identifikim të shoqërisë kapitaliste me shoqërinë në përgjithësi, të qëndrimit borgjez ndaj jetës me qëndrimin në përgjithësi ndaj saj, etj. Nga pikëpamja artistike lufta, në të vërtetë nuk bëhet kundër çdo romantizmi, po vetëm kundër romantizmit revolucionar, mbasi praktika e sotme artistike provon se çdo prirje subjektiviste dekadente e formaliste, në brendi e në formë, është e mbarsur me një romantizëm reaksionar e mikroborgjez, është, si të thuash, forma më e degjeneruar e romantizmit. Qëndrimi tjetër, i formuluar teorikisht prej estetit francez Lé Fevér, i përbahet pikëpamjes se «epochës sonë» i mungon romantizmi, prandaj arti duhet ta krijojë atë dhe ta futë në jetë. Siç shihet prej këtij qëndrimi mohohet romantika e enderrimit, e mendimit, e veprimit dhe e idealeve revolucionare, që edhe po të mungonte në të vërtetë, d.m.th. të ishte përashtuar prej realitetit

nga vetë zhvillimi i tij, do të ishte e pamundur të injektohej prej shkrimtarëve e artistëve, do të ishte e kotë çdo përpjekje për ta bërë një gjë të tillë dhe çdo teori e ngriput mbi këto baza nuk mund të ishte veçse skolastike. Lenini që në vitin 1903 u ndodh para një problemi të tillë dhe, duke cituar Pisarjevin, përsërise:

«Enderra ime mund t'i dalë përpara zhvillimit të natyrshëm të ngjarjeve ose mund të marrë anën e kundërt, ku asnjë zhvillim të natyrshëm të ngjarjeve nuk mund të ketë kurrë. Në rastin e parë enderra nuk sjell asnjë dëm, bille ajo mund ta inkurajojë dhe ta shtojë energjinë e njeriut, që punon... Në endrra të tilla s'ka asgjë, që ta shtrembërojë ose ta paralizojë fuqinë punëtore. Bile është krejt e kundërt. Sikur njeriu të mos kishte asnjë mundësi të endërronit në këtë mënyrë, sikur ai të mos kishte mundësi herë pas here të delte përpara dhe të sodiste me fantazinë e vet në një formë të plotë dhe të përsosur atë kriesë, që sapo ka filluar të dalë nga duart e tij — atëherë unë s'mund të kuptoj në asnjë mënyrë, se ç'arsye nxitëse do ta bënte njerinë të ndërmerrte dhe t'i conte deri në fund reprat e mëdha dhe të lodhshme në lëmin e artit, të shkençës dhe të jetës praktike...»<sup>48)</sup>

Jeta, me gjithë ndryshimet e mëdha shoqërore dhe përparimet e mëdha teknike që kanë ngjarë e që, doemos janë reflektuar edhe në psikologjinë e njerëzve, e përban gjithnjë të vërtetën e mbrojtur nga Lenini. PPSH i është përbajtur kurdoherë asaj, si në veprimtarinë e gjerë për shndërrimin revolucionar të jetës edhe në vlerësimet e posaçme për letërsinë e artet, duke synuar që shkrimtarët e artistët të endërrojnë e të parashikojnë me guxim dhe, nga ana tjetër, të mos jepen kurrë pas trillimeve boshe të fantazisë dhe enderrimeve të zbrazëta, që do të binin në kundërshtim me të vërtetën e jetës.

Në themelët e veta letërsia dhe artet tona janë realiste. Ato nisen nga realiteti dhe jo prej përfytyrimeve subjektive mbi realitetin dhe e pasqyrojnë atë duke për-

48) V. I. Lenin: Vepra të zgjedhura në dy vëllime, vëll. I, f. 247-248.

dorur metodën realiste të tipizimit e të përgjithësimit artistik, që presupozon, siç thoshte Engelsi *krahas vërtetësisë së detajeve, edhe vërtetësinë e karaktereve tipike në rrëthana e në ambiente tipike*, duke kuptuar me fenomen, me ambient dhe me karakter tipik jo një të mesme statistikore, të zakonshmen e jetës së përditshme, po ato fenomene, ambiente e karaktere që përbajnjë në thelbin e tyre, qoftë edhe të pashfaqur plotësisht, tendencën objektive të zhvillimit shoqëror. Kjo mënyrë pasqyrimi përbën bazën e artit e të letërsisë sonë, themelin e saj ideo-artistik. Elementet romantike janë një plotësim i mënyrës realiste të konceptimit e të pasqyrimit të realitetit, që shkrihen organikisht në artin e realizmit socialist jo vetëm nëpërmjet përfytyrimit të së ardhmes po edhe nëpërmjet qëndrimit ndaj realitetit të kohës, pohimit të së resë e zbulimit të bukurisë së luftës revolucionare. Elementet romantiqe në mënyrën e pasqyrimit të realitetit dhe në mjetet e shprehjes artistike lidhen edhe me personalitetin krijues të shkrimitarit e të artistit, me zbulimin nëpërmjet veprave të botës së tij të brendshme, me refleksin në to të predispozitave të tij shpirtërore. Por, në realizmin socialist, në parim, tentohet vazhdimi i që raporti ndërmjet botës dhe pikëpamjes subjektive të artistit dhe botës objektive dhe pikëpamjes shoqërore revolucionare ndaj saj, të anojë kurdoherë në favor të kësaj të fundit, pa mohuar individualitet artistike, po duke u dhënë atyre një kuptim e një rëndësi më të madhe shoqërore, duke i larguar gjithnjë e më shumë prej subjektivizmit aq karakteristik për letërsinë dhe artin romantik të së kaluarës. Duke u nisur nga kjo pikëpamje shoqërore realiste «anës subjektive» në krijimtar i bëhet një vlerësim më i drejtë, që mban parasysh shkallën e përfaqësimit në të jo vetëm të mendimit shoqëror më të përparuar përfomenet e pasqyruara, po edhe të shijes estetike më të përparuar shoqërore, thellësinë dhe sigurinë realiste të saj.

«Kontradikta, për të cilën bëhet fjalë në një vepër artistike, duhet të jetë sintezë jo subjektive, por objektive dhe e bazuar në vetë jetën që zhvillohet, që ecën përparrë, në luftën e së resë me të vjetrën. Ana subjektive luan

një rol të veçantë në nxjerrjen dhe vënien në dukje së duhet të kontradiktave, me qëllim që ato të mos shihen në sipërfaqje dhe me një ide fikse, të sëmurë dhe individuale»<sup>49)</sup> Ndryshe veprat letrare e artistike do të largohe-shin nga e vërteta e jetës dhe në krijimtarinë artistike do të çelte rrugë subjektivizmi, përfytyrimi arbitrar i realitetit sipas predispozitave individuale mikroborgjeze dhe shprehja artistike do të largohej prej arritjeve estetike shoqërore në dobi të figurave abstrakte dhe hermetike, siç ndodh në artin borgjez e revisionist, disa reflekse të të cilit u dukën edhe në letërsinë e në artin tonë.

Romantika në letërsinë dhe në artet e sotme nuk është një shprehje e thjeshtë e pakënaqësishë, e revoltës apo e entuziazmit individual të heronje të afektuar, siç ndodhë në të kaluarën, po është mishërim i idealeve të përcaktuara shoqërore që lindin prej procesit të zhvillimit objektiv historik dhe nuk mbeten në sferën e ideve e të ënderrimeve të bucura, po konkretizohen në lëvizjen përpara, në transformimet revolucionare, në heroin e ri të revolucionit e të socializmit, i cili, gjithashtu, nuk është vetëm një ideal për shkrimitarët e artistët, po në tiparet kryesore të tij, është njeriu i përparuar i kohës.

Por, duke folur për parimin dhe arritjet më të mira, do të ishte e parakohshme të thoshim se disa ndikime romantike të së kaluarës nuk përbëjnë ende një shfaqje të prapambetjes ideoartistike në letërsinë dhe në artet tona. Në disa vepra poetike e dramatike kryesisht me tema nga e kaluara dhe me motive intime ndeshet një romantikë e vjetër, që lidhet me predispozita patriarkale e mikroborgjeze ose me idealizime pa baza të së kaluarës shoqërore, me një romantizëm të vjetruar, të shkëputur nga realiteti dhe idealet e kohës, që qëndron larg parimeve themelore të realizmit socialist si në konceptimin e përgjithshëm të realitetit dhe në mjetet e shprehjes artistike. Veç kësaj në letërsinë e sotme vërehet edhe një shfaqje tjetër «romantike» që cënon pasqyrimin me vërtetësi të

49) Enver Hoxha: Fjala në mbledhjen e shkrimitarëve dhe artistëve më 11 korrik 1961 («Drita», 1961, 6 gusht).

realitetit dhe rreh të mbulojë lidhjet e dobëta me jetën me anë të një euforie stilistike të bujshme dhe të një përfytyrimi afektiv të heroit. Kjo shfaqje është më e dukshme në poezi, po nuk është e huaj edhe për artet figurative, për muzikën, pjesërisht edhe për teatrin e për disa vepra të kinematografisë dokumentare.

Filli romantik i letërsisë dhe i arteve tona, qoftë në kuptimin e përgjithshëm, qoftë në prirjet individuale të shkrimitarëve dhe të artistëve të veçantë është i lidhur me èndërrimet dhe me idealet socialiste, që udhëheqin shoqërinë tonë. Prandaj Partia ka porositur kurdoherë që shkrimitarët dhe artistët të nisen nga jeta dhe nga realiteti i kohës, nga njerëzit e ditëve tona dhe tek ta të gjejnë burimin e fryshtëzimit dhe guximin për të èndërruar e për të fantazuar. Èndërrimet e shkëputura nga realiteti e që bien në kundërshtim me prirjet e zhvillimit të tij janë të huaja për realizmin socialist.

«Shkrimitarët dhe artistët tanë» porositi shoku Enver «nuk duhet ta konsiderojnë veten èndërrues të zbrazët, as njerëz që mund të krijojnë gjëra të bukura të shkëputura nga realiteti konkret dinamik i vendit dhe i shoqërisë sone socialistë... Disa prej tyre vënë èndërrimet, fantazinë e tyre mbi krijimtarinë e masave dhe nuk i lidhin ato me përfytyrimin realist dhe objektiv të perspektivës»<sup>50)</sup>

Sic shihet, romantika në letërsinë dhe në artet e realizmit socialist është e kushtëzuar jo vetëm prej realitetit të ri historik, prej të cilët fryshtëzohet, po edhe prej përpjekjes për të shkrirë përfytyrimet individuale të artistit me ato të masave punonjëse dhe prej «përfytyrimit realist... të perspektivës», që ka të bëjë si me brendinë ideologjike të veprave edhe me formën e shprehjes artistike. Këto bëjnë që elementi romantik i shkrirë në realizmin socialist të jetë një zhvillim i mëtejshëm krijues i romantizmit revolucionar të së kaluarës dhe jo një përsritje e thjeshtë e tij.

50) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 487-488.

Mishërimi më konkret i idealeve ideoestetike të letërsisë e të arteve janë heronjtë e tyre. Që me «Prometeun e lidhur» të Eskilit, si edhe më herët akoma, letërsia dhe arti kanë synuar kurdoherë që të gjejnë dhe të vënë në qendër të tyre atë tip shoqëror, që do të përfaqëson më mirë dhe në mënyrë më të plotë idealet e tyre historike, shijet e tyre estetike, normat morale dhe që do të ndikonte në edukimin e njerëzve me shembullin e tij e, në këtë mënyrë, do të bëhej një shptytës në zhvillimin e njerëzimit sipas idealeve të shkrimitarit e të artistit. Kësh-tu kanë lindur heronjtë e lashtësisë greke e romake, tipat e romaneve e të eposit kalorsiaq, figurat e letërsisë së revolucionit borgjez, ata të realizmit kritik për të arritur në fillim të shekullit tonë në figurën e punëtorit revolucionar e të komunistit. Pra, mund të themi se çdo epokë dhe çdo klasë ka në jetë e në art heronjtë e vet tipikë, që pavarësisht prej nuancave që merr në vepra të ndryshme, në thelb shpreh idealet e klasës që përfaqëson. Këto vepra krijohen për t'i përhapur idealet e tyre në gjithë shoqërinë, për t'i bërë ato shoqërisht të pranueshme dhe estetikisht të bukura për të gjithë. Edhe letërsia dhe artet e realizmit socialist nuk bëjnë përjashtim në këtë drejtim, gjersa ato kanë si synim të tyre të venë në qendër të vëmendjes heroin e revolucionit e të ndërtimit socialist dhe nëpërmjet tij të ndikojnë në edukimin komunist të punonjësve dhe në çrrënjosjen e çdo vjetërsie nga ndërgjegjja e njerëzve, të bëjnë që të përfqafohen prej tyre idealet dhe normat e moralit komunist dhe t'i paraqesin ato estetikisht të bukura, duke ua kundërvënë idealeve dhe normave të moralit borgjez, si dhe idealeve të shtresave mikroborgjeze, patriarkale e konservatore.

Dallimi i parë që të bie në sy kur merresh me heroin e letërsisë e të artit të epokave të ndryshme përbahet në tiparet shoqërore të tij, në veçoritë klasore dhe kohore, në ato anë karakteristike ideoshqërore, që i japin vulën e epokës në të cilën është krijuar dhe të idealeve që e

realitetit dhe rreh të mbulojë lidhjet e dobëta me jetën me anë të një euforie stilistike të bujshme dhe të një përfytyrimi afektiv të heroit. Kjo shfaqje është më e dukshme në poezi, po nuk është e huaj edhe për artet figurative, për muzikën, pjesërisht edhe për teatrin e për disa vepra të kinematografisë dokumentare.

Filli romantik i letërsisë dhe i arteve tona, qoftë në kuptimin e përgjithshëm, qoftë në prirjet individuale të shkrimitarëve dhe të artistëve të vëçantë është i lidhur me ëndërrimet dhe me idealet socialistë, që udhëheqin shoqërinë tonë. Prandaj Partia ka porositur kurdoherë që shkrimitarët dhe artistët të nisen nga jeta dhe nga realiteti i kohës, nga njerëzit e ditëve tona dhe tek ta të gjejnë burimin e fryshtëzimit dhe guximin për të ëndërruar e për të fantazuar. Ëndërrimet e shkëputura nga realiteti e që bien në kundërshtim me prirjet e zhvillimit të tij janë të huaja për realizmin socialist.

«*Shkrimitarët dhe artistët tanë*» porositi shoku Enver «nuk duhet ta konsiderojnë veten ëndërrues të zbrazët, as njerëz që mund të krijojnë gjëra të bukura të shkëputura nga realiteti konkret dinamik i vendit dhe i shoqërisë sonë socialistë... Disa prej tyre vënë ëndërrimet, fantazinë e tyre mbi krijimtarinë e masave dhe nuk i lidhin ato me përfytyrimin realist dhe objektiv të perspektivës»<sup>50)</sup>

Sic shihet, romantika në letërsinë dhe në artet e realizmit socialist është e kushtëzuar jo vetëm prej realitetit të ri historik, prej të cilët fryshtëzohet, po edhe prej përpjekjes për të shkrirë përfytyrimet individuale të artistit me ato të masave punonjëse dhe prej «*përfytyrimi realist... të perspektivës*», që ka të bëjë si me brendinë ideo-emocionale të veprave edhe me formën e shprehjes artistike. Këto bëjnë që elementi romantik i shkrirë në realizmin socialist të jetë një zhvillim i mëtejshëm krijues i romantizmit revolucionar të së kaluarës dhe jo një përsritje e thjeshtë e tij.

50) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968), f. 487-488.

Mishërimi më konkret i idealeve ideoestetike të letërsisë e të arteve janë heronjtë e tyre. Që me «Prometeun e lidhur» të Eskilit, si edhe më herët akoma, letërsia dhe arti kanë synuar kurdoherë që të gjejnë dhe të vënë në qendër të tyre atë tip shoqëror, që do të përfaqësonë më mirë dhe në mënyrë më të plotë idealet e tyre historike, shijet e tyre estetike, normat morale dhe që do të ndikonte në edukimin e njerëzve me shembullin e tij e, në këtë mënyrë, do të bëhej një shtytës në zhvillimin e njerëzimit sipas idealeve të shkrimitarit e të artistit. Kësh-tu kanë lindur heronjtë e lashtësisë greke e romake, tipat e romaneve e të eposit kalorsiaq, figurat e letërsisë së revolucionit borgjez, ata të realizmit kritik për të arritur në fillim të shekullit tonë në figurën e punëtorit revolucionar e të komunistit. Pra, mund të themi se çdo epokë dhe çdo klasë ka në jetë e në art heronjtë e vet tipikë, që pavarësisht prej nuancave që merr në vepra të ndryshme, në thelb shpreh idealet e klasës që përfaqëson. Këto vepra krijuhen për t'i përhapur idealet e tyre në gjithë shoqërinë, për t'i bërë ato shoqërisht të pranueshme dhe estetikisht të bukura për të gjithë. Edhe letërsia dhe artet e realizmit socialist nuk bëjnë përjashtim në këtë drejtim, gjersa ato kanë si synim të tyre të venë në qen-dër të vëmendjes heroin e revolucionit e të ndërtimit socialist dhe nëpërmjet tij të ndikojnë në edukimin komunist të punonjësve dhe në çrrënjosjen e çdo vjetërsie nga ndërgjegjja e njerëzve, të bëjnë që të përqafohen prej tyre idealet dhe normat e moralit komunist dhe t'i paraqesin ato estetikisht të bukura, duke ua kundërvënë idealeve dhe normave të moralit borgjez, si dhe idealeve të shtresave mikroborgjeze, patriarkale e konservatore.

Dallimi i parë që të bie në sy kur merresh me heroin e letërsisë e të artit të epokave të ndryshme përbahet në tiparet shoqërore të tij, në veçoritë klasore dhe kohore, në ato anë karakteristike ideo-shoqërore, që i japin vulën e epokës në të cilën është krijuar dhe të idealeve që e

kanë frysmezuar. Nga kjo pikëpamje letërsia dhe artet e realizmit socialist kanë mériten, që e pasuruan galerinë e madhe të artit botëror me heroin e ri të revolucionit socialist dhe të punës për ndërtimin e socializmit. Edhe më parë në veprat e shkrimitarëve e të artistëve më përparimtarë të vendeve të ndryshme kanë gjetur vend heroin kryengritës dhe figura e punëtorit, po mund të themi se asnjëherë më parë përmasat ideotematike të tyre nuk kanë qënë të atilla, saqë të përfaqësonin plotësishet idealet e vërteta të një përbysjeje të gjithanshme revolucionare të shoqërisë dhe aq më pak të krijimit të një rendi të ri shoqëror, që nuk do të mbështetet më në pronën private dhe në shfrytëzimin e njeriut prej njeriut, po në pronën shoqërore dhe në punën e frysmezuar nga interes i përgjithshëm shoqëror. Ky hero lindi në tallazet e luftës revolucionare të klasës punëtore e të masave punonjëse dhe në aksionin e madh historik të ndërtimit të socializmit dhe u bë flamur i idealeve shoqërore dhe estetike të realizmit socialist. Ai është hero i jetës dhe jo i fantazisë së shkrimitarëve dhe të artistëve, megjithëse në krimtarinë artistike, dihet, që si zmadhimi kritik i anëve negative, ashtu edhe theksimi i anëve pozitive kanë qënë kurdoherë të pranueshme e të pranishme si mjete që i shërbejnë zbulimit të thelbit të fenomeneve dhe ndikimit ideoestetik të veprave letrare e artistike. Në letërsinë e në artet tona ky është hero i luftave çlirimtare të popullit gjatë shekujve, është partizani i epopesë së Luftës Nacionallçirimitare, është ndërtuesi heroik i socializmit, luftëtar i çdo fronti të luftës përfitorë e së resë mbi të vjetër. Ai është bashkëkohësi ynë me tiparet e tij karakteristike i ngritur artistikisht në lartësinë e shembullit që duhet ndjekur prej të gjithëve.

«Çdo ditë në vendin tonë ka shembuj të shumtë konkretë heroizmi e vetëmohimi të paparë, me të cilët mund të ilistrohet në mënyrë të shkëlqyer viaja e Partisë sonë. Dhe duke i lidhur të gjithë këta shembuj me vijën e drejtë politike të Partisë, duke i parë ata gjithmonë nën prizmin politik, ne do të jemi të sigurtë se këto akte he-

*roizmi, zotësie dhe force nuk mund të venë dëm dhe astë dobësohen, përkundrazi, do të qindfishohen»<sup>51)</sup>*

Këto fjalë që shoku Enver i ka thënë për punën e përgjithshme të Partisë mund të përdoren plotësishet edhe për letërsinë e artet, të cilat e gjejnë heroizmin dhe heroin *në jetën e vendit, e përgjithësojnë atë*, duke zbuluar anët më karakteristike dhe e përdorin me qëllim që frysma e heroizmit të bëhet sa më masive, që heronjtë të bëhen shembull frysmezues për të gjithë.

Në heronjtë e veprave letrare e artistike lenë gjurmët e veta edhe konceptet ideologjike dhe filozofike të shkrimitarëve e të artistëve mbi rolin e individit dhe të masës në histori. Filozofia marksiste-leniniste është e para shkallë e mendimit dhe e veprimt revolucionar, që e ka zgjidhur plotësishet këtë çështje shoqërore themelore, duke njojur popullin si krijues të historisë, pa mohuar rolin e individuve dhe të personaliteteve të shquara, të cilët, sipas interesave klasore që përfaqësoninë, luajnë rol pozitiv ose negativ duke ndikuar në zhvillimin e ngjarjeve. Prej këtij parimi në jetën e përditshme shtrohet çështja e raportit të individit e të kolektivit, të interesave të përgjithshme dhe atyre personale, të kuptimit të madh shoqëror të veprimtarisë, të punës e të heroizmave të secilit, të lindjes së heroizmit, të virtyteve të reja dhe të vetë heronje prej kushteve konkrete historike në gjirin e masave revolucionare dhe përpunohet koncepti i heroizmit masiv, që është karakteristikë për Luftën tonë Nacionalçlirimtare dhe për kohën tonë të mbushur me përpjekje, me vetëmohim, me aksione revolucionare dhe me gatishmëri luftarake kundër imperializmit e revisionizmit.

«Heroizmi masiv revolucionar» thotë shoku Enver «është shembulli më i madh edukativ për njerëzit tanë. Heroizmi individual ka vlerë edukuese po ashtu, kur realizohet në kuadrin e këtij heroizmi masiv, kur është pjesë përbërëse dhe e pandarë e tij.

51) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 270.

*Prandaj nënveftësimi i vijës së masave, i rolit të tyre vendimtar, i hovit, i heroizmit masiv revolucionar, është gjëja më e rrezikshme. Ti vësh kësaj përballë pikëpamjet individualiste me të gjitha të këqijat morale, politike dhe ideologjike, është antisocialiste, antimarksiste dhe shumë e rrezikshme. Individ ka rolin e vet në shoqerinë tonë, pse nga individet e veçantë formohen masat. Marksizëm-leninizmi nuk ka për qëllim të nënveftësojë rolin e individit në shoqëri, por të edukojë atë me ideologjinë proletare, me koncepte të drejtë shoqërore dhe filozofike, me koncepte socialiste mbi jetën, mbi punën, mbi pronën, mbi familjen, mbi prodhimin, mbi politikën, mbi marrëdhëniet në mes të njerëzve, popujve, shteteve etj. Këtu është çështje lufte, çështje botëkuptimesh diametralisht të kundërta. Partia synon të cilorojë njeriun, kurse borgjezia ta mbajë atë në robëri shekullorë.<sup>52)</sup>*

Në këto koncepte marksiste-leniniste dhe në raportet socialist ndërmjet individit e shoqërisë e të njerëzve ndërmjet tyre mbështetet letërsia dhe arti i realizmit socialist për të shtruar e për të zgjidhur drejtë ideologjikisht, estetikisht dhe artistikisht problemim e rëndësishëm të heroit të vet, domethënë të heroit pozitiv. Dhe, përgjithësisht, në këtë rrugë është ecur.

Kuptimi i drejtë i rolit të individit dhe të masave dhe karakteri shoqëror i përcaktuar i heroit nuk mund të mos reflektohen e të mos kenë pasoja edhe për konceptet estetike dhe për realizimin e tyre në praktikën letrare e artistike të realizmit socialist. Vetë figura e heroit revolucionar komunist është një figurë e re e patrajtuar më parë dhe qëndrimi ideoemocional i shkrimitarëve dhe artistëve ndaj tij është gjithashtu i ri. Lidhjet me masat, pasqyrimi me realizëm i veprimtarisë, i idealeve dhe i heroizmit masiv, vlerësimi i individit në rapport me qëndrimin e tij ndaj popullit e të popullit ndaj tij, gjykimi jo sipas fjalëve po sipas veprimtarisë sho-

qërisht të dobishme e të bukur, mishërimi në figura artistike i tipareve më të mira morale të popullit, përfaqësimi në to i shkallës reale të zhvillimit shoqëror dhe të elementeve ideale që përbëjnë prirjen perspektive etj. bëjnë që heronjtë e letërsisë e të artit të realizmit socialist jo vetëm të jenë shoqërisht të rinj, po të jenë të rinj edhe si konceptim dhe si realizim artistik. Ata janë shprehës të anëve më të mira të së përgjithshmes njerëzore nëpërmjet shfaqjeve konkrete të veprimtarisë, të tipareve karakteristike të punëtorëve e të punonjësve, të cilët nuk shihen më si viktima të zhvillimit shoqëror ose si masa të revoltuara e të rebeluara, po si heronj revolucionarë që përbysin të vjetrën dhe krijojnë të renë, që transformojnë botën e, nëpërmjet kësaj veprimtarie me rëndësi historike, transformojnë edhe veten e tyre. Prej këtyre pikëpamjeve shoqërore, ideologjike dhe estetike për heroin rrjedhin shumë kërkesa artistike që gjunjë zgjidhje në artin e realizmit socialist dhe përcaktojnë përmasat dhe format e portretizimit të heroit të ri.

Kur flitet për heroin e letërsisë e të arteve mbahet parasysh edhe rëndësia e madhe edukuese e tij si shprehës i koncepteve dhe i qëndrimeve të reja ndaj jetës, si veprimtar i revolucionit dhe i ndërtimit të socializmit, si shembull frymëzues. Shoqëria e ka bërë dhe vazhdon ta bëjë edhe vetë këtë punë në mënyrë të ndërgjegjshme e të organizuar. Në veprimtarinë e gjërë të Partisë për edukimin komunist të punonjësve gjejmë një shembull të quartë të njobjes e të përgjithësimit shoqëror të çdo gjëje pozitive, të çdo akti heroik, të çdo iniciative revolucionare, të çdo shfaqje të tipareve të larta të njerëzve tanë të sotëm.

«Shembulli pozitiv luan një rol të madh edukativ dhe frymëzues në shoqerinë tonë socialist... Ne duhet të shfrytëzojmë gjithçka pozitive që lind, kudo që masat tona punonjëse krijojnë dhe bëjnë gjithçka pa u ndjerë,

52) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968) f. 313.

*pa bujë për realizimin dhe sidomos për tejkalimin e detyrate të planeve tonas*<sup>53)</sup> porosit shoqu Enver.

Në kuptimin e gjerë shoqëror këtë punë bëjnë edhe shkrimtarët e artistët nëpërmjet pasqyrimit në veprat e tyre të heroizmit, të së resë revolucionare, nëpërmjet portretizimit tipik të heroit të revolucionit e të socializmit duke plotësuar porosinë e Partisë që: «*Në qendër të vëmendjes së letërsisë dhe arteve duhet të janë heronjtë e kohës sonë, punëtorët, fshatarët, intelektualët populorë, njerëzit e rinj të edukuar nga Partia, ata që me vetëmohim e heroizëm punojnë e luftojnë për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lulëzimin e Atdheut» mbasi:*

Nëpërmjet këtij *heroï triumfon e reja* në jetë, pra do të triumfojë edhe në art, kapërcehet ose shembet e vjetra në jetë, pra do të kapërcehet ose shembet edhe në art, krijohet shembulli i gjallë i punës krijuese, pra do të krijohet edhe në art një shembull që t'i frysmezojë masat me dashurinë për punën, me shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit për çështjen e socializmit. Nëpërmjet këtij *heroï del perspektiva*, zbulohet e ardhmja, shfaqet optimizmi revolucionar i jetës, pra do të dalë edhe qëndrimi i shkrimtarit apo artistit në favor të këtij realiteti të ri në zhvillim, në favor të së resë që shkon përpura dhe që shkrimtarët dhe artisti kanë për detyrë ta mbrojnë e ta ndihmojnë të zhvillohet, si bartës, edhe ata, të idealeve të mëdha të komunizmit»<sup>54)</sup>

Çështja e heroit të letërsisë e të arteve të realizmit socialist del se ka rëndësi të shumanshme shoqërore, ideologjike dhe artistike dhe përfshin në vete një problematikë të gjerë, që ka të bëjë me karakterin real historik dhe me pasqyrimin realist të tij, me rëndësinë e tij në jetën shoqërore dhe në krijimtarinë artistike, me përcaktimin nëpërmjet tij të qëndrimit të shkrim-

tarëve e artistëve ndaj së resë përparimtare, me perspektivën e shoqërisë sonë socialiste e të vetë arteve të realizmit socialist. Nëpërmjet këtij *heroï positiv*, si dhe frysës së përgjithshme të veprave, pasqyrohet karakteri aktiv ndërtues i revolucionit socialist, lindja dhe formimi i njeriut të ri me tipare komuniste, ngadhnjimi i marrëdhënieve të reja shoqërore, i heroizmit popullor, i humanizmit revolucionar etj. Ai është «fokusi» i qëndrimeve të gjithanshme të shkrimtarit e të artistit ndaj realitetit. Ky hero ka karakter aktiv shoqëror. Ndrysht prej tipit mikroborgjez aq të përhapur në letërsinë e sotme perëndimore e revisioniste, që niset prej interesave të veta të ngushta, tmerrohet prej kontradiktave të kohës dhe në fakt, duke u përpjekur t'i largohet, i nënshتروhet makinës shtypëse imperialiste dhe i zgjat jetën kapitalizmit, heroï ynë lufton aktivisht kundër së keqes dhe nuk kufizohet vetëm në këtë luftë, po edhe krijon, ndërtton, transformon botën dhe veten i udhëhequr nga ideale të larta shoqërore, si antipod i individualistit dhe i egoistit borgjez e mikroborgjez. Nga këto pozita letërsia dhe artet e realizmit socialist i kanë dhënë një zgjedhje shoqërisht të shëndoshë e frysmezuese edhe problemi të sakrificës e të vetëmohimit, duke vënë theksin në anën heroike të veprimeve, duke zbuluar edhe në sakrificën më të madhe — dhënien e jetës — madhështinë frysmezuese dhe tiparet e luftëtarit revolucionar, që është i pushtuar nga dashuria e flaktë për popullin, për Attalët e për njerëzimin. Vetëm një shoqëri në qëndrim e në degjenerim e sipër e shikom heroizmin me skepticizëm dhe e profanon atë, mbasi ajo ka humbur perspektivën, nuk ka të ardhme, është në vdekje e sipër. Heroizmi i vërtetë është karakteristikë e forcave revolucionare, që luftojnë për të ardhmen dhe që janë në gjendje të çlironjë energjitet e pashtershme njerëzore e t'i frysmezojnë masat me idealet e tyre të ndritura. Për këtë arsyesh në vendet ku janë në fuqi klikat revisioniste kanë qjetur terren të favorshëm teoritë borgjeze të çheroizmit të konkretizuara në shumë vepra me karakter kun-

53) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968) f. 279.

54) PPSH — Dokumente kryesore, vëllimi IV, f. 570.

dërrevolucionar, ku sundon meskiniteti, individualizmi, egoizmi, kotësia dhe banaliteti borgjez e mikroborgjez.

Raportet ndërmjet reales dhe ideales si në portretizimin e heroit pozitiv edhe në pasqyrimin e realitetit në përgjithësi kanë të bëjnë me pozitën ideoshoqërore të artistit, me atë që është e bukur ose e shëmtuar përtë, me besimin e tij në mundësinë e transformimit revolucionar të jetës e të botës së brendshme të njeriut, me vetë konceptet e tij përfundimtare si forcë shoqërore që ndikon në kultivimin e tipareve të reja, të cilat duhet t'i ndihmojë e t'i përkrahë. Në këtë rast idealizimi pa baza i heroit e shkëput atë prej realitetit, e bën të pasueshëm e artificial dhe ul vlerën e tij ndikuese tek artdashësit, kurse nënëvlefësimi i këtij heroi dhe i forcës së tij aktive ose shikimi i tij me mosbesim e skepticitësë mikroborgjez do të shpinte në një trajtim shoqërisht negativ dhe artistikisht antirealist të figurës së njeriut tonë të sotëm, gjë që do të sillte si pasojë të pashmangshme largimin prej heroit të vërtetë revolucionar në dobi të një heroi mikroborgjez, siç ka ndodhur në ndonjë rast.

Cështja e estetizimit të filizave të së resë revolucionare, d.m.th. e zbulimit të bukurisë e të madhështisë së tyre të ardhshme nuk ka të bëjë aspak me lustrimin e realitetit dhe me «zbukurimin» artificial të heroit, po me qëndrimin e studjuar entuziast dhe optimist të shkrimitarëve ndaj tipareve komuniste të njeriut të sotëm. Diskutimet në se heroi pozitiv duhet apo s'duhet të ketë të meta, që kur ka një lindur e deri tanë ruajnë një karakter të dukshëm skolastik. Problemi është që të mos estetizohet e shëmtuara dhe të mos shëmtohet e bukura e realitetit tonë, kurse përsa i takon të metave e dobësive të mundëshme të heroit pozitiv do të mjaftonte të kujtonim fjalët e shokut Mehmet Shehu, i cili thotë:

«Unë të isha shkrimitar, anët e dobëta të heroit tim pozitiv ose do t'i lija fare mënjanë, në harresë, e zakonisht këshfu do të veproja ose, në ndonjë rast, po të më

nevojiteshun ato medoemos, atëherë edhe do t'i paraqitja, por natyrish si shfaqje sekondare të karakterit të heroit, veçse, në këtë rast, do të bëja që heroï im të mbante qëndrim pozitiv edhe kundrejt të metave të tij, në mënyrë që edhe kundrejt të metave të tij ai të ishte me të vërtetë hero pozitiv e t'i ndreqte ato. Sepse kjo është edhe karakteristika dallonjëse e tipit pozitiv të njeriut tonë të ri revolucionar.<sup>55)</sup>

Është diskutuar shumë edhe për çështjen e «heroit të lëkundshëm» ose «të ndërmjetëm», siç emërohet ndryshe, dhe janë shfaqur mendime se ai jo vetëm që është real e i mundshëm, po edhe i jep dorë shkrimitarit të paraqesë më mirë e në formë më emocionale komtradiktat e kohës. Praktika letrare gjithashtu tregon se atë e kanë vënë në qendër të veprave shumë shkrimitarë, duke i lënë heroit pozitiv vendin e dytë në shtjellimin e ngjarjeve.

Po të nisemi nga realiteti, më periudhën e ndërtimit të socializmit zhvillohet një luftë e ashpër e shumanëshme, e ndërlikuar dhe e gjatë ndërmjet të resë dhe të vjetrës në të gjitha fushat e jetës dhe brënda ndërgjegjes së njerëzve. Për shembull, transformimi socialist i fshatit nuk mund të kuptohet pa transformimin revolucionar të fshatarit, i cili historikisht ka përpunuar një natyrë të dyfishtë prej punëtori të tokës dhe prej pronari. Pra, për një kohë ai lëkundet ndërmjet këtyre dy anëve të personalitetit të vet, jo vetëm dëri në periudhën e kolektivizimit, po me përmasa dhe intensitet gjithnjë më të zgjedhur, edhe pas kolektivizimit. E njëjtë gjë mund të thuhet edhe përshtresat mikroborgjeze të qytetit, që të mos shtrihemi në ato dualitete shpirtërore ndërmjet botëkuptimit, mënyrës së jetesës, moralit dhe zakoneve të reja dhe të vjetrës, që janë dukur më qartë në procesin e revolucionizimit të gjithanshëm

55) Mehmet Shehu: Mbi thellimin e luftës kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberalë ndaj tyre në letërsi dhe arte. («Nëntori», 1974 Nr. 2).

të jetës. Lufta, po ta shohim çështjen nga pozitat e socializmit, bëhet për triumfin e anës revolucionare mbi anën reaksionare, për afirmimin në jetë të tipareve të reja të njeriut të socializmit e të komunizmit. Por do të ishte pa vend po të kufizoheshim vetëm në këtë konstatim dhe të mos shikonim ndërkaq anën më me rëndësi të problemit, që ka të bëjë me vendin që duhet të zerë ky «hero» në krijimtarinë letrare e artistike dhe me qëndrimin e shkrimitarit e të artistit ndaj një tipi të tillë. Përsa i takon çështjes së parë, d.m.th. vendit që duhet të zerë «hero i lëkundshëm» në krijimtarinë artistike, në Plenumin XV të KQ të PPSH është theksuar se duke absolutizuar konceptin e gabuar, «*sidomos përsa u përket njollave që duhet të ketë medoemos njenu i kohës sonë, shkrimitarët dhe artistët tanë do të shkonin shumë larg, do ta deheroizonin figurën e bashkëkohësit dhe do të merreshin me analiza psihike boshe, pa asnjë vlerë. Kjo do të conte që në qendër të letërsisë sonë të viheshin bile edhe heronj të lëkundshëm, që zenë një pozitë ideologjike jo të shëndoshë, që qëndrojnë ndërmjet nesh dhe armiqve tanë, gjë që do të ishte krejt e padrejtë, historikisht e pasaktë dhe ideologjikisht e gabuar.*»<sup>56)</sup>

Vënia e një «hero» të tillë në qendër të letërsisë e të arteve do të ishte *historikisht e pasaktë* mbasi fizionominë e kohës sonë nuk e përcaktojnë tipat e lëkundshëm, po njerëzit e pararojës, luftëtarët e ndërgjegjshëm për çështjen e socializmit e të komunizmit, të cilët, me veprimtarinë praktike dhe me shembullin e tyre frysmezues, ndikojnë për të krijuar edhe te të «lëkundëshmit» bindjet revolucionare dhe i udhëheqin ata për të kapërcyer kontradiktat që mund të kenë në botëkuptimin e në karakterin e tyre. Është *ideologjikisht e gabuar* një tendencë e tillë, mbasi, duke vënë në qendër të letërsisë e të artit lëkundjet, dyshimet dhe shpërpjesëtimet e «heroit të lëkundshëm» vendi kryesor, dashur pa dashur u

56) PPSH — Dokumente kryesore, vëllimi IV. Faqe 571.

lihet pikëpamjeve e qëndrimeve të tij mikroborgjeze dhe jo luftës që zhvillohet për korrigjinim e këtyre pikëpamjeve e qëndrimeve. Kurse përsa i takon qëndrimit të shkrimitarit e artistit ndaj një «heroit të lëkundshëm» është e qartë se ai s'mund të jetë një qëndrim objektivisht që vetëm të konstatojë lëkundjet e shpërpjestimet e aq më pak, s'mund të jetë një qëndrim që të përligjë e të përkrahë anët regresive në këto lëkundje e shpërpjesëtime. Në kontradiktat brënda personalitetit të njeriut, si dhe në qëdo kontradiktë tjetër, artisti i realizmit socialist merr anën përparimtare dhe atë përkrah, atë përpinqet të zhvillojë, duke pasqyruar me realizëm realitetin që i zgjidh këto kontradikta dhe arritjet më pozitive të kohës të mishëruara në figurën, dhe veprimitarinë e heronjve revolucionarë, të cilëve u takon vendi i parë në letërsi e në art. Prandaj Partia ka porositur që:

«*Heronjtë pozitivë të shoqërisë sonë, ndërtonjësit e vërtetë të socializmit dhe mbrojtësit e fitoreve të Republikës, që janë në vetvete një shprehje e lartë e forcës jetëdhënëse të së resë, duhet të jenë në qendër të letërsisë dhe artit tonë. Pa këta heronj as që mund të shkruhet dhe të pasqyrohet e vërteta mbi shoqërinë tonë socialiste.*»<sup>57)</sup>

Parimi kritik dhe mohues i realizmit socialist arrinhet edhe nëpërmjet heronjve dhe personazheve negativë, të cilët gjithashtu janë jetësorë, mishërimë të së keqes shoqërore, të trashëgimeve të këqija të së kaluarës dhe i ndikimeve të huaja çoroditëse. Duke bërë këtë ndarje në heronj pozitivë, të lëkundshëm e negativë, që ndihmon studimin e tipave artistikë, realizmi socialist, ndërkaq në krijimtarët dhe në kritikë e në teori, mban kurdoherë parasysh se këto grupime nuk janë të ndarë me thikë deri në hollësi, po kanë gjallërinë dhe shumanshmërinë e vetë jetës dhe procesin e zhvillimit e të ndërthurjes dialektike. Heronjtë e lëkundshëm sipas

57) Vendimi i KQ të PPSH mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve («Zëri i popullit» qershori, 1961).

kushteve shoqërore dhe rrethanave historike mund të marrin drejtime të kundërta, sipas atyre anëve që do të fitojnë në karakterin dhe në qëndrimet e tyre. Si e mira edhe e keqja ka një përbajtje të përcaktuar dhe historike dhe nuk mund të jetë e dhënë njëherë e përgjithmonë. Në vështrim të përgjithshëm për ne e keqe dhe e shëmtuar është gjithçka që i kundërvihet revolucionit, luftës për çlirim e punonjësve dhe për ndërtimin e socialist, idealeve komuniste, moralit revolucionar. Duke e parë këtë të keqe në mënyrë konkrete historike, e gjejmë jo vetëm në përfaqësuesit e klasave të dikurshme shfrytëzuese dhe të reaksionit politik, po edhe në atë kategori njerëzish, të cilët, në etapa të caktuara të zhvillimit i kundërvihen revolucionit, hyjnë në kontradiktë të hapur me të. Tipa të tillë nxori në sipërfaqe lufta popullore e udhëhequr nga Partia për revolucionarizimin e gjithanshëm të jetës dhe ata gjetën pasqyrim në veprat letrare e artistike, duke u bërë kështu një mjet në duart e shkrimtarëve dhe artistëve për demaskimin dhe çrrënjosjen e së keqes ngajeta socialiste, nëpërmjet talljes dhe neveritjes. Nëpërmjet heronjve pozitivë e negativë arti e letërsia pasqyrojnë konfliktet shoqërore me karakter antagonist jo vetëm në plan të përgjithshëm shoqëror e politik, po edhe në aspekte të veçanta.

Është diskutuar edhe për heroin negativ dhe është shtruar çështja nëse ky duhet portretizuar krejt me njolla të zeza apo duhet t'u lihet vend edhe anëve «pozitive» të tij. Ky diskutim, gjithashtu ka qënë dhe mbetet me karakter skolistik gjersa synon të paracaktojë norma e proporcione. Rëndesi edhe në këtë rast ka tendencia e shkrimtarit, vërtetësia e tipit, qoftë ky edhe i hipertbolizuar dhe i karikaturizuar në përmasa monstruoze. Kiu Koroziu i romanit «Juga e bardhë» është portretizuar me përmasa të theksuara satirike, po ekzagjerimi artistik është vënë në shërbim të zbulimit të thelbët shoqëror dhe të dukurive karakteristike të tipit, prandaj do të ishte absurde t'u këshillohej shkrimtarëve që doemos të gjenin tek heronjtë e tyre negativ edhe diçka pozitive.

Problemi i heroit të letërsisë e të arteve të realizmit socialist ka ngjallur diskutime edhe për format artistike të portretizimit të tij, për mënyrat e ndryshme që përdorin shkrimtarët dhe artistët për realizimin e figurave në vepra të veçanta. Letërsia dhe artet tonë, duke përdorur edhe traditën e pasur të artit botëror, kanë fituar një përvojë të mirë në trajtimin realist të figurave njerëzore, të lidhjeve të tyre me kushtet historike dhe me ambientet shoqërore, të zbulimit të botës së brëndëshme e të dukjeve të jashtme, të veprimit e të analizës psikologjike nëpërmjet mjeteve të ndryshme e shprehjes artistike etj. Kjo përvojë përbën një material të pasur për studimet dhe përgjithësimet teorike, të cilat do të hynin në rrugë skolastike në qoftë se, duke u nisur nga praktika të veçanta do të rekomandonin receta paraprake dhe do t'i vinin kufij të paracaktoar krijimtarisë. Në letërsinë tonë të sotme, me gjithë vërejtjet e pjesshme që mund të ketë për vepra të veçanta dhe për nivelin ideoartistik të realizimit të tipave, mund të dallojmë fare mirë disa mënyra portretizimi të heroit dhe të pasqyrimit të realitetit nëpërmjet tij. Në romanet «Kënetë», «Lumi i Vdekur» etj. shkrimtarët e kanë pasqyruar realitetin me anë të një kompleksi personazhesh e heronjsh të ndryshëm, duke mbajtur vazhdimisht në qendër të vëmen-djes njerin prej tyre (*Stavri Larën, Pilo Shpiragun*). Kjo mënyrë pasqyrimi u ka dhënë mundësi atyre që të vizatojnë tipa të ndryshëm dhe, nëpërmjet tipave, të pasqyrojnë anë të ndryshme të realitetit dhe të natyrës njerëzore. Ka vepra të tjera, të cilat mbështeten kryesisht në një hero të vetëm dhe synojnë të zbulojnë anët më të ndryshme të karakterit të tij në raport me kohën dhe me rrethanat e ambientet tipike që përshkruhen në to. I kësaj natyre është, për shembull, romani «Përsëri në këmbë», që pasqyron madhështinë e njeriut tonë të ri, i cili edhe në kushte shumë të vështira, di ta përballojë-

Jetën me burrëri dhe të mbajë ndaj saj qëndrim veprues revolucionar. Në romanin «*Para agimit*» shkrimtari është nisur të hedhë një material të pasur jetësor dhe t'i përshkruajë heronjtë të kredhur në detin e ngjarjeve e të -episodeve, të cilat shërbejnë jo vetëm si pasqyrë e kohës, po edhe si mjete karakterizimi të heronjve, të cilët e zbulojnë veten në mënyrë të ngadalëtë e të natyrshme. Vepra të tjera merren me analizën e botës së brendshme të heroit, me përshkrimin e luftës së motiveve të ndryshme e të kundërtës në ndërgjegjen e tyre, me pasqyrimin e shpërpjesëtimeve në personalitetin e njeriut. Një veپer e kësaj natyre është, për shembull, romani «*Vdekja e një nate*». Në vepra si romani «*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*» heroi kryesor negativ shërben dhe si mjet organizues. Në këtë rast shkrimtari nuk kufizohet vetëm në përfjetimet e heroit, po e përdor atë, në radhë të parë, për të zbuluar madhështinë e realitetit, të cilit heroi negativ i kundërvihet. Njihen gjithashtu format e kundërvënieve kolektive të shumë personazheve një hero negativ ose të identifikimit të heroit me shkrimtarin (poezia lirike) etj. Të gjitha këto mënyra trajtimi të heroit dhe të tjera si këto, janë arritje të suksesshme të letërsisë sonë të realizmit socialist, që meritojnë vëmendje, në mënyrë që të pasurohen, të përpunohen e të zhvillohen më tej, duke pasur si pikësynim kryesor pasqyrimin më vërtetësi të bukurisë e të madhështisë shpirtërore të heronjve të kohës, të njerëzve pararojë të revolucionit e të ndërtimit socialist.

Në kundërshtim të hapur me këto arritje dhe me këto pikësynime kanë qënë «ato teorizime që janë bërë për heroin pozitiv, për copëzimin e tij, për identifikimin e tij me gjithçka, për ndarjen artificiale në «hero tradicional» dhe «hero novator» etj., që «nuk janë gjë tjetër veçse pikëpamje që shpien te deheroizmi në letërsi e në art, te largimi ngajeta dhe nga njeriu»<sup>58)</sup>. Vetëm

58) Enver Hoxha: «Të thellojmë luftën ideoologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre» f. 34.

në luftë me teorizime dhe me shfaqje të tillë, si dhe me *kuptimin skematik të një heroi të idealizuar në mënyrë libreske*» e me «*skemën e re për një hero të lëkundur*» letërsia dhe artet tonë do të realizojnë ato kërkesa të mëdha ideoartistike që qëndrojnë para tyre për t'u bërë tribunë e vërtetë e heronjve të vërtetë të kohës, të ndjenjave dhe të idealeve të tyre.

## KREU I KATERT

### 1.

Realizmi socialist është një metodë artistike novatore. Novatorizmi i realizmit socialist përbahet në vetë natyrën e tij ideoartistike, në brendinë ideoemocionale gjithmonë të re, në mundlësitë që u krijon shkrimtarëve dhe artistëve pér ta pasqyruar realitetin në të gjitha aspektet, që jadin dorë të vlerësohen objektivisht fenomenet e jetës dhe të shfaqen prirjet më të shumëlojta individuale realiste.

Kur flasim pér novatorizmin e realizmit socialist mbahet parasysh si ndryshimet cilësore që ai ka sjellë në krahasim me letërsinë dhe me artin e së kaluarës, edhe tendencën e tij përparimtare të zhvillimit të përhershëm në përshtatje me kushtet e reja shoqërore dhe me nivelin e ri të shijeve estetike popullore. I kuptuar kështu realizmi socialist, në brendi e në formë, ka kurdoherë karakter bashkëkohor.

Bazén shoqërore të novatorizmit të realizmit socialist e përbëjnë lidhjet e tij me lëvizjen revolucionare të klasës punëtore dhe me veprimtarinë e saj të gjith-anshmë transformuese pér ndërtimin e socializmit e të komunizmit dhe pér krijimin e njeriut të ri. Realizmi socialist lind si pasojë e natyrshme e kësaj lëvizje dhe e ka këtë objektin kryesor të interesimeve të veta tematike. Dhe, me që kjo lëvizje është në ngritje të përhershme dhe priret vazhdimisht drejt së ardhmes, kuptohet vetveti që edhe realizmi socialist, si shfaqje e ndërgjegjes artistike të proletariatit revolucionar dhe të shoqërisë socialiste, do të jetë në përtërhitje të përher-

shme, jo vetëm nëpërmjet materialit jetësor gjithmonë të ri që do të sjellë, po edhe si shprehje e shijeve estetike gjithnjë më të përpunuara të masave punonjëse. Lëvizja revolucionare e klasës punëtore dhe veprimtaria pér ndërtimin e socializmit e të komunizmit i jadin letërsisë dhe arteve idealin estetik, që gjithashtu nuk mbetet krejt i njëjtë në të gjitha kohët, po pasurohet me elemente të reja dhe thekson anë të veçanta të tij, sipas shkallës së zhvillimit shoqëror, sipas detyrave historike që shtrohen përparrë shoqërisë në etapa të ndryshme të zhvillimit të saj. Prandaj novatorizmi nuk mund të kuptohet në mënyrë të ngushtë si përpjekje individuale e shkrimtarëve dhe e artistëve të veçantë pér të kërkuar e pér të gjetur forma të reja të shprehjes artistike, po si diçka që përbahet në vetë natyrën e metodës së realizmit socialist dhe që i diktohet asaj prej zhvillimit shoqëror. Pa mohuar rëndësinë e mbështetjes së sukseseve të reja në rezultatet e së kaluarës dhe të kontributit të shkrimtarëve dhe të artistëve të veçantë, mund të themi me plot gojën se karakterin novator realizmit socialist ia jep vetëjeta, vetë zhvillimi revolucionar i shoqërisë. Një shoqëri që e ka thënë fjalën e vet në histori, që e ka jetuar jetën e vet dhe që nuk ka më ideale pozitive nuk mund të krijojë një art novator, po do të përpëllet gjithnjë në pellgun e dekadentizmit dhe të kërkimeve formaliste, siç po ndodh sot në të gjitha vendet kapitaliste.

Novatorizmi i letërsisë dhe i artit të realizmit socialist lidhët ngushtë me botëkuptimin marksist-leninist dhe qëndrimin e ri revolucionar ndaj jetës. Studimi materialist dialektik i jetës, i jadin artit e letërsisë së realizmit socialist një forcë shprehëse realiste shumë të gjerë e të fuqishme, u sigurojnë atyre çelsin e zbulimit, të pasqyrimt dhe të shpjegimit të shfaqjeve të jetës, besimin në të ardhmen, aftësinë pér hetimin me kohë të së resë revolucionare, optimizmin dhe shpirtin luftarak. Prandaj Partia kurdoherë ka theksuar se krahas lidhjeve të

ngushta të shkrimtarëve e artistëve me jetën e popullit dhe pjesëmarrjes së tyre aktive në aksionet revolucionare, rëndësi të dorës së parë ka edhe ngritja ideologjike e tyre, studimi i filozofisë marksiste-leniniste, mbasi pa një botëkuptim të shëndoshë revolucionar nuk mund të ketë as art revolucionar dhe pa një kuptim të thellë shkençor të jetës nuk mund të ketë as një qëndrim artistik deri në fund realist ndaj saj. Kufizimet e letërsisë e të artit të së kaluarës dhe të artit e letërsisë përparimitare të ditëve tona, me gjithë shfaqjet dhe nuancat e ndryshme në shprehjen artistike, janë, në radhë të parë, reflektim i kufizimeve dhe i lajthitjeve ideore të shkrimtarëve e të artistëve, kurse realizmi socialistështë i ri në krahasim me to jo vetëm përmaterialin e ri jetësor që sjell dhe për heroin e ri që trajton, po edhe përmendimin e ri e të fuqishëm revolucionar që fut në krijimtarinë artistike. Është më se e qartë se pa mendim të ri, nuk mund të ketë art të ri.

Nga sa u tha kuptohet që novatorizmi i vërtetë ka të bëjë, para së gjithash, me brendinë e veprave artistike, me idealet që i frysmezojnë ato, me prizmin e shikimit të botës nga shkrimtarët e artistët, me qëllimet shoqërore që ata shtrojnë para krijimtarisë. Vetëm një brendi e re sjell si pasojë edhe një formë të re artistike, e bën atë të domosdoshme. Realizmi socialist nuk mund të ketë si pikëniqe kërkimet dhe eksperimentimet formale, po niset prej kuptimit dialektik të raporteve të brendisë me formën, i merr ato si një sintezë që janë përherë në unitet e në kontradiktë me njëra-tjetrën, dhe në këtë sintezë parësia i takon kurdoherë përbajtjes.

«E reja në art, duhet kërkuar në radhë të parë në përbajtje dhe pastaj në formë. Në vështrim të parë, në art, ky fenomenështë mjaft i komplikuar, sepse individualiteti i artistit, kur shihet thjesht nga ana e jashtme, mund të keqkuptohet e të merret si formë dhe jo si sintezë ideoartistike e përbajtjes me formën. Interpretimë të tillë të cekëta mund ta çojnë artistin në rrugë

të gabuar, ta shkëputin nga kërkimi i drejtë objektiv i së resë dhe ta futin në qorrskakun e formalizmit»<sup>59)</sup>

Bashkëkohësia e shprehjes artistike popullore është një shfaqje tjeter e novatorizmit, që përcaktohet prej brendisë popullore të veprave, prej shkallës së zhvillimit shoqëror dhe prej raporteve që krijojnë shkrimtarët e artistët me masën e lexuesve, të dëgjuesve e të shikuesve. Një brendi e re nuk mund të shprehet me sukses dhe pa u gjyntuar me një formë arkaike. Pasqyrimi i fenomeneve të reja do të kërkojë gjithnjë edhe një shprehje të re, një formë artistike të re, që mbështetet në qëndrimin e ri estetik ndaj jetës, në mjetet e rçia artistike, në futjen në art e në letërsi të hollësive që sjell zhvillimi. Ndryshimet e mëdha shoqërore sjellin kurdoherë ndryshime të tillë dhe në shijet e në pikëpamjet estetike të njerëzve dhe këto pikëpamje e shijë të reja do të reflektohen domosdo në krijimtarinë artistike, kështu që problemi i formës novatore nuk mund të ngushtohet vetëm me mjetet e thjeshta të stilit dhe me krijimin e figurave origjinale, po ka një shtrirje shumë më të gjerë dhe përfshin të gjitha anët e krijimtarisë artistike.

Zhvillimi shoqëror ndikon në përcaktimin e formave dhe të shprehjes artistike nëpërmjet të gjitha shfaqjeve të tij: me ndërrimet në strukturën klasore të shoqërisë, me ngritjen e nivelit arsimor e kulturor të masave, me zhvillimin e shkencës, të teknikës e të industrisë, me shumimin e mjeteve të komunikimit etj. Talenti i shkrimtarit dhe artistit duket, krahas zbulimit të fenomeneve të reja shoqërore, edhe në asimilimin e elementeve të reja të qëndrimit estetik ndaj botës dhe në konkretizimin e tyre në një formë artistike sa më të përkryer. Në një krijimtar artistike të vërtetë kjo amë e përgjithshme shoqërore ndikon mbi individualitetin e krijuesit, u jep gjerësi shijeve dhe pikësynimeve të tij artistike,

59) Ramiz Alia: Mbi disa çështje të letërsisë dhe arteve («Rruja e Partisë», 1961 Nr. 8).

përcakton drejtimin kryesor dhe krijon bazën objektive të unitetit ideoartistik të letërsisë e të artit të realizmit socialist. Në këtë vështrim bashkëkohësia e shprehjes artistike do të ketë kurdoherë karakter popullor, mbasi do të niset jo prej shijeve të ngushta personale, po prej shijeve më të përparuara të kohës. Theksimi i një gjëje të tillë bëhet më se i domosdoshëm në kohën tonë, që karakterizohet nga kontradikta të shumta, të cilat nuk mund të mos manifestohen edhe në shijet estetike.

«Ne, — thotë shoku Enver, «jemi kundër shkëputjes së arteve dhe të letërsisë nga realiteti, kundër shkëputjes së tyre nga masat. Kërkesa për t'i larguar letërsinë dhe artet nga anakronizmi nuk duhet të identifikohen me përpjekjet për krijuar një art dhe letërsi të pakuptueshme për popullin» dhe se shkrimitarët e artistët «nuk duhet ta vetëgjykojnë të përsosur krijimtarinë e tyre në rast se në veprat e tyre nuk pasqyrohen të ngjitura në art, ndjenjat, shijet, mendimet, krijimtaria e masave»<sup>60)</sup>

Novatorizmi artistik është i lidhur ngusht edhe me origjinalitetin kombëtar të formës, e marrë kjo formë jo si e dhënë njëherë e përgjithmonë, po në zhvillimin e vet historik, si arritje e re, që mbështetet në traditën e mirë të së kaluarës dhe në përvojën e artit e të letërsisë së sotme. Ashtu siç nuk mund të flitet për novatorizëm jashtë lidhjeve të artit me lëvizjen revolucionare, po ashtu nuk mund të flitet për të edhe jashtë truallit konkret kombëtar, në të cilën ka lindur dhe po lulëzon ky art novator.

Forma kombëtare e përpunuar gjatë shekujve dhe e përritur në kushtet e shoqërisë socialiste i jep novatorizmit të realizmit socialist ato tipare origjinale e të freskëta, që e dallojnë prej artit të kombeve të tjera, si një kontribut të veçantë në thesarin e përgjithshëm të artit botëror. «Letërsia, arti, kultura janë socialiste nuk kanë lindur në një vend të zbrazët, po mbi bazën e zhvi-

llimit të gjatë historik të shoqërisë sonë, të jetës së saj shpirtërore, të traditave të shquara e më të mira kulturnalo-artistike të popullit tonë. Mbështetja në këto tradita të kultivuara e popullore, të së kaluarës dhe të kohës sonë, është një çështje me rëndësi të madhe, pa të cilën nuk mund të bëhet fjalë për krijimin e vlerave të vërteta letrare artistike, për krijimin e origjinalitetit të kulturës, artit dhe letërsisë shqiptare, për respektimin dhe zbatimin në jetë të parimit marksist-leninist që arti dhe kultura janë të jenë socialiste nga përbajtja dhe kombëtare nga forma»<sup>61)</sup>

Mbi këto parime të përgjithshme realizmi socialist presupozon dhe siguron lulëzimin e individualiteteve artistike dhe njeh kontributin e veçantë të shkrimitarëve dhe artistëve të talentuar, në veprat e të cilëve shfaqet konkretisht novatorizmi në brendi dhe në formë.

Uniteti ideoartistik i letërsisë dhe i arteve tona s'ka të bëjë aspak me mohimin e individualiteteve, siç pretendojnë armiqtë e realizmit socialist. Vetë zhvillimi i sotëm i letërsisë dhe arteve tona provon më së miri, që parimet themelore të realizmit socialist gjunjë zbatim dhe konkretizim në prirjet më të ndryshme stilistike realiste, në gjinitë e ndryshme të artit, në pëlqimet më të ndryshme tematike dhe në përdorimin e teknikave dhe mjeteve shumëfarëshe të pasqyrimit. Në qoftë se theksi kryesor, kur flitet për novatorizmin, vihet mbi kushtet shoqërore që e lindin atë dhe imbi vetë natyrën e metodës sonë krijuese, kjo bëhet për të zbuluar karakterin objektiv të këtij novatorizmi dhe për të kuptuar se ai nuk është i lidhur vetëm e kryesisht me përpjekjet individuale të shkrimitarëve e të artistëve të veçantë, po përbahet në vetë parimet krijuese të realizmit socialist. Një interpretimi i kundërt i novatorizmit do ta ngush-tonte shumë kuptimin e tij dhe do të shpinte në subjektivizëm. Origjinaliteti individual mbetet pa kuptim pa përbajtjen e thelli shoqërore dhe pa mbështetjen në

60) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968) f. 487, 488.

61) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 148.

shijet dhe në idealet estetike popullore. Megjithëse në vështrim të parë origjinaliteti i veprës së shkrimitarëve dhe të artistëve të veçantë duket si diçka e pavarur, në të vërtetë, ai nuk mund të merret dhe të kuptohet kurri i shkëputur nga ato kushte dhe faktorë objektivë që ndikojnë në formimin e personaliteteve artistike, sado të fuqishme të jenë ato.

Talenti i madh duke qënë prodhim i epokës ai ndikon me krijimtarinë e vet në pohimin e atyre idealeve shoqërore dhe estetike, që shprehin më mirë prirjen objektive të zhvillimit. Për këtë arsyе Partia i ka dhënë rëndësi lulëzimit të individualiteteve të ndryshme artistike dhe ka orientuar kërkimet e reja mbi bazën e parimeve themelore të realizmit socialist.

«Metoda e realizmit socialist nënkuption dhe siguron një larmi të pakufishme stilesh dhe individualitetesh artistike. Ajo e siguron novatorizmin. Dhe Partia mendon se artistët gjithmonë duhet të kërkojnë»<sup>62)</sup>

Në këtë mënyrë novatorizmi dhe kërkimi në art nuk do të merren si ndjekje të modës dhe si kërkime vetëm në fushën formale, po do të kenë një përbajtje dhe një vlerë të madhe shoqërore dhe do ta bëjnë kri-jimtarinë artistike përfaqësuese të denjë të aspiratave popullore.

Afirmimi i novatorizmit në realizmin socialist dhe kërkimi i vazhdueshëm i së resë arrihet nëpërmjet luftës dhe ndeshjes së pashmangshme të prirjeve të kundërtë, jo vetëm me traditën negative të së kaluarës dhe shfaqjeve dekadente e formaliste të artit borgjez e revolucionar, po edhe në vetë gjirin e realizmit socialist, në ndeshjen e natyrshme të së resë me të vjetrën, të përparrimtare me rutinën, të prirjeve revolucionare me ato konservatore apo moderniste në brendi e në formë. Kjo luftë nuk mohon dhe as dobëson, po pohon shpirtin krijues të artit e të letërsisë sonë. Një luftë e tillë, e kon-

62) Ramiz Alia: Mbi disa çështje të letërsisë dhe arteve («Rru-  
ga e Partisë», 1961; Nr. 8).

kretizuar në krijimtarinë artistike që ecën gjithnjë përpara dhe e shfaqur në debatet për probleme të ndryshme të brendisë e të formës, ka karakterizuar zhvillimin e letërsisë e të arteve tona dhe vazhdon të mbetet një prej shtytjeve më me rëndësi të përparimit e të lulëzimit të tyre të mëtejshëm. Mbulimi i kësaj lufte ose largimi prej saj do të sillte si pasojë krijimin e një atmosferë krijuese të amullt dhe do të kanonizonte rezultatet e praktikave e të periudhave të veçanta në dëm të vlerësimit dialektik e historik të zhvillimit të letërsisë e të arteve dhe të ardhmes së tyre. Të tilla përpjekje u bënë vitet e fundit prçj disa kritikëve, të cilët arritën të mendojnë se letërsia dhe arti ynë i vërtetë kanë nisur vetëm në vitet 60 dhe se novatorizmi i tij është i lidhur me krijimtarinë e disa pak shkrimitarëve e artistëve të preferuar prej tyre. Nga ana tjeter, Partia kurdoherë ka porositur që idealet dhe kërkimet në fushën e artit duhet të shërbejnë për forcimin e pozitave të realizmit socialist dhe, mbi këtë bazë, të arrihet një unitet më i lartë ideologjik dhe estetik i forcave krijuese, një kuptim i përbashkët marksist-leninist i letërsisë dhe arteve në zhvillim, duke kundërshtuar, siç porositi shoku Enver, «*si modernizmin, ashtu edhe konservatorizmin*».

Letërsia dhe artet e realizmit socialist nuk janë të shkëputura nga letërsia dhe arti i sotëm botëror dhe në këtë art, dihet që përvëç vlerave realiste përparimtare, po lulëzojnë, të përkrahura e të propaganduara nga borgjezia, edhe rrymat më të shfrenuara të dekadentizmit e të formalizmit. Mundësia e ndikimit të tyre është diga që kushtëzohet jo vetëm prej rrëthimit kapitalist e revisionist dhe prej mënyrave të shumta të propagandimit të tyre. Ato gjejnë mbështetje edhe në elementin mikroborgjez, në dobësitë e pregetitjes ideologjike, të bëjnë të mos mbahet kurdoherë e deri në fund një qëndrim i prerë kritik ndaj tyre dhe të ngatérrohet lufta e drejtë për forcimin e karakterit bashkëkohor të shpresës artistike me eksperimentimet formaliste të shkrimitarëve e artistëve borgjezë të modës. Një përulje e tillë

ndaj prirjeve moderniste ka shpurë disa herë në mohimin e karakterit të vërtetë novator të realizmit socialist dhe në dobësimin e përpjekjeve për originalitet të vërtetë ideoartistik.

«Historia njeh shumë shembëlla, kur shkolla filozofike ose të artit, megjithëse janë paraqitur me emrat e ndryshme, kanë përsëritur shkolla të vjetra dhe megjithëse janë paraqitur si të reja, nuk kanë sjellë asgjë të re. Kjo ndodh shumë me idealizmin si rrymë filozofike dhe me izmat e ndryshme të artit borgjez. Ne luftojmë në art çdo gjë që paraqitet si e re, por që në të vërtetë nuk është e tillë. Një novatorizëm i tillë dhe i dëmshëm, nihilist, ngrihet kundër bazave themelore të vetë artit dhe çon në largimin nga realiteti. Tu zhvillojmë artin, t'i hapim rrugë novatorizmit në art, por nën maskën e novatorizmit të mos lejohet të minohet vetë arti.»<sup>63)</sup>

Ndërsa shkarja në pozita moderniste e lagon letërsinë dhe artin nga parimet e realizmit socialist dhe monsinë hon novatorizmin e vërtetë revolucionar, konservatorizmi mbështetet në rutinën shoqërore dhe artistike të trashëguar nga e kaluara ose të krijuar si rezultat i shkëputjes nga realiteti dhe nga lufta për zhvillimin e tij të mëtejshëm. Në thelb të tyre letërsia dhe artet e realizmit socialist janë kundër çdo shfaqje të konservatorizmit, dhe rënia në pozita të tilla do të shpinte në monhimin e shpirtit revolucionar të metodës sonë krijuese, në dogmatizimin e parimeve dhe në kuptimin metafizik të pikësimeve ideoartistike. Si modernizmi, ashtu edhe konservatorizmi, shfaqet në dy drejtime kryesore: në brendi përmjet tendencave të idealizimit dhe të mbrojtjes së kaluarës patriarkale, borgjeze e mikroborgjeze

dhe në formë, përmjet mbivlerësimit të traditës, absolutizmit të përvjohës së grumbulluar, përdorimit të formave artistike arkaikë, móspranimi dhe pengimi të çdo gjëje të re, duke e konsideruar atë të paligjshme e të papranueshme. Konservatorizmi i kthen sytë gjithnjë nga e kaluara, kurse modernizmi është hallakatje dhe hutim para tendencave të artit të sotëm formalist borgjez e revizionist.

«Për ne, marksist-leninistët» theksón shoku Enver «e re është ajo që i shërben shkatërrimit të çdo gjëje të vjetëruar, regresive e reaksionare, të çdo gjëje të huaj për shoqérinë dhe ideologjinë tonë, është ajo që i shërben afirmimit të çdo gjëje progresive e revolucionare, zhvillimit të shoqërisë socialiste, të bazës e të superstrukturës së saj, të prodhimit e të jetës shpirtërore. Të renë ne e shohim gjithmonë në radhë të parë në brendi e pastaj në formë. Kështu e shohim atë edhe në letërsi e në art»<sup>64)</sup>

## 2.

Novatorizmi i realizmit socialist nuk mund të kuptohet jashtë lidhjeve organike me traditat e artit përparrimtar të së kaluarës. Lenini ka theksuar se kultura socialistë është vazhdim i natyrshëm i gjithçkaje të mirë që ka krijuar njerëzimi gjatë shekuje, kurse në shumë dokumenta të PPSH është vënë në dukje, në pajtim me këtë parim leninist, se komunistët janë trashëgimtarët më legjitim të traditave përparimtare, demokratike e revolucionare të së kaluarës dhe se kultura dhe arti socialist nuk krijohen në vend të zbrazët, po mbi bazën e rezultateve më të bukura që janë krijuar prej popullit tonë dhe prej gjithë njerëzimit. Pra, traditat, të kuptuara në mënyrë krijuese marksiste-leniniste, nuk i venë

64) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre. f. 27.

kufi novatorizmit, po bëhen një mbështetje e fuqishme për të, një pistë betoni për fluturime të reja më të largëta dhe më të guximshme.

Kur flitet për traditatështë e nevojshme të mbahet parasysh, se përveç vlerësimit historik të tyre si kontribut i dhënë në një epokë të caktuar, ato do të vlerësohen gjithashtu edhe në raport me kohën tonë, në raport me dobinë ose dëmin që sjellin sot, d.m.th. gjykimi i tyre do t'i nënshtronhet detyrës për krijimin dhe forcimin e letërsisë e të artit të realizmit socialist, nivatorizmit të tyre. Ne çmojmë lart vlerën historike të veprave të Buzukut, të Budit e Bogdanit dhe i mbajmë ato si monumente të shquara të gjuhës sonë, po do të ishte absurde t'i jepeshin ato lexuesit të sotëm ose të flitet siç bën para tridhjetë e ca vjetësh klerikët katolikë, për ndjekjen e stilit të tyre. Përmendëm një shembull ekstrem për të qartësuar qëndrimin historik ndaj traditave dhe për të kuptuar pastaj më mirë çështjen e qëndrimit kritik ndaj atyre anëve të traditës, që nuk i kalojnë dot kufijtë e së kaluarës dhe prandaj, megjithëse mbeten vlera të një kohe të caktuar dhe kanë shërbyer si mbështetje e zhvillimit të mëvonshëm, pushojnë së paturi rol aktiv. Partia në këtë çështje ka adaptuar parimin e njohur marksist-leninist që «*e vjetra duhet t'i shërbejë të resë*», gjë që do të thotë se theksi kryesor vihet jo në vlerësimin në vetvete të traditave dhe as në kthimin e tyre në *kriter vlerësimi*, po në ligjshmëri në historike të lindjes e të forcimit të së resë përparimtarë historike të Lindjes e vjetra pozitive. Dhe rimbartë, të cilës duhet t'i shërbejë e vjetra pozitive. Dhe mund të kuptohet si përsëritje e thjeshtë tradicionaliste për kritikat e artistike të së kaluarës e të ditëve tona. Kështu konkretizohen tre qëndrime të ndryshme ndaj traditës: qëndrimi kritik dhe përvetësimi krijues i saj; qëndrimi nihilist mohues dhe qëndrimi tradicionalist

«*Të vjetrën*» porosit shoku Enver «*flas për të vjetrën pozitive, s'duhet ta vemë kundër së resë, ajo duhet t'i shërbejë së resë në zhvillim, në afirmim, në ecjen përpara, në krijimin e një shoqërie përparimtare, revolucionare, me tiparet që i përshtaten kohës dhe që trashëgojnë edhe të vjetrën pozitive, edhe ecjen revolucionare përpara, edhe paralajmërimin e së nesërimes që pregetitet*»<sup>65)</sup>

Ky është kriteri themelor i qëndrimit revolucionar ndaj traditave, që presupozon jo vetëm hedhjen jashtë të anës reaksionare e të prapambetur, që ka zënë vend në artin e së kaluarës si refleks i kushteve historike dhe botëkuptimeve idealiste, po edhe nënshtrimin krijues të anëve pozitive përparimtare, duke i vënë ato në shërbim të së resë dhe duke i vlerësuar në këtë prizëm.

Në qëndrimin ndaj traditave vemë re dy tendencia kryesore, që përfaqësojnë, në të vërtet, tendencat e sotme ideoartistike, mbasi është e kuptueshme që letërsia dhe arti i sotëm përparimtarë revolucionar do të mbështetet në traditën përparimtare e revolucionare, kurse arti dekadent e formalist do të kërkojë në të kaluarën ato elemente që janë më të afërtë me të dhe që gjenden në fazat e degjenerimit të klasave shfrytëzuese dhe të ideologjive reaksionare. Shembull tipik për këtë është afrimi i letërsisë dhe i arteve sovjetike fill pas tradhëtisë revizioniste në BRSS me shkrimitarët e artistët dekadentë e formalistë të viteve 20 dhe përdorimi i krimtarisë së këtyre në dobi të largimit nga pozitat e realizmit socialist e të degjenerimit borgjez.

Këto tendencia të kundërtë në qëndrimin ndaj traditave duken qartë edhe në studimet teorike e kritike për krimtarinë artistike të së kaluarës e të ditëve tona. Kështu konkretizohen tre qëndrime të ndryshme ndaj traditës: qëndrimi kritik dhe përvetësimi krijues i saj; qëndrimi nihilist mohues dhe qëndrimi tradicionalist

65) Enver Hoxha: Fjala në mbledhjen e shkrimitarëve dhe artistëve, më 11 korrik 1961 (Gazeta «Drita», 1961 6 gusht).

himmizues, që e vë të kalluarën mbi të sotmen dhe të ardhmen. Në të tria këto raste do mbajtur parasysh përmbajtja konkrete që mund t'u jepet atyre, mbasi edhe qëndrimi kritik e përvetësimi krijues i traditës mund të marrë karakter jo revolucionar ose haptas reaksionar në qoftë se kritika do të drejtohej kundër anëve realiste e përparimitare të artit të së kalluarës dhe do të merreshin prej tij ato elemente që do t'u çelnin rrugën dekadentizmit dhe formalizmit. Shfaqje të tillë mund të ketë jo vetëm ndaj rrymave dhe artit të epokave të ndryshme, po edhe ndaj krijimtarisë së shkrimtarëve e artisteve të ndryshëm, që, siç ka ndodhur shpesh në të kalluarën e në artin përparimtar të ditëve tona, përmban elemente kontradiktore në brendi e në formë.

*«Ne, — thotë shoku Enver, — jemi si kundër monumit të thjeshtë, jodialektik të traditës, ashtu edhe kundër hyjnizimit dhe gjunjëzimit përpara saj. Mohimi të shpie në qëndrime metafizike, nihiliste. Në pozitat e monumit të plotë të traditës ndodhen sot modernistët, të cilët janë armëmbajtësit kryesorë të borgjezisë në art dhe në letërsi. Hyjnizimi i traditës gjithashtu është i dëmshëm, ai çon në konservatorizëm dhe në shkëputje nga realiteti. Ne jemi gjithashtu edhe kundër vlerësimeve të njëanshme, «origjinalë», ndaj trashëgimisë letrare. Ne nuk jemi dakord me ata që mbivlerësojnë vlerat e një artisti në dëm të të gjithë trashëgimisë letrare pozitive, vetëm duke u nisur nga konsiderata subjektive, nga shijet dhe konceptet artistike individuale»<sup>66)</sup>*

Sipas karakterit të shoqërisë dhe të artit bashkëkohës përcaktohet edhe qëndrimi ndaj traditës, prandaj është e kuptueshme që arti i epokave revolucionare, sadotë largëta të jenë në kohë këto epoka, përbën një vazhdimësi përparimitare, se përmban shpërthimin e forcave të reja, që priren drejt së ardhmes, guximin dhe heroizmin e tyre, idealitet e tyre të përparuara dhe, në vartësi prej këtyre, edhe shikimin realist dhe optimist të jetës.

66) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 480.

Për këtë arsyе ngjallin edhe sot emocione pozitive veprat e skulpturës klasike greke të fryshtuara nga bukuria e qënies njerëzore; piktura e Rilindjes Evropiane si një hov i fuqishëm revolucionar për të flakur përmbajtjen mistike dhe kanunet kishtare dhe për të idealizuar botën reale, njeriun dhe jetën e vetme tokso; veprat e iluministëve me kultin e tyre të diturisë dhe me etjen për liri e përparim; krijimet e romantikëve përparimtarë të ngjizura me përbuzjen ndaj meskinitetit dhe padrejtësive dhe me shpërthimin e vrullshëm të ndjenjave liridashëse e humanitare; letërsia e realizmit kritik me forcën denoncuese kundër rendit borgjez në degjenerim etj. Po kështu edhe në terrenin e traditës sonë kombëtare letërsia dhe artet e realizmit socialist gjejnë afërsi me krijimet e mrekullueshme të popullit të fryshtuara ngajeta e nga dëshira për të gjëzuar jetën, nga heroizmi dhe idealet e atdherdashurisë e të demokracisë, nga dashuria për punën etj. Ato gjjejnë afërsi me letërsinë romantike të Rilindjes, sidomos me fryshten patriotike dhe karakterin kombëtar të saj dhe me letërsinë përparimitare të viteve 30, veçanërisht me karakterin thellësisht shoqëror dhe me tendencën e përgjithshme të saj në luftë me letërsinë klerikale dhe prirjet e atëherëshme klasiciste, dekadente e formaliste. Kjo afërsi me traditën e epokave revolucionare përbën rrugën e zhvillimit të letërsisë e të artit përparimtar, i cili ngjitet vazhdimisht drejt majave më të larta të një brendie shoqërore më të shëndoshë e më revolucionare e të një forme më të plotë realiste. Në këtë përparim të vazhdueshëm të ndërgjegjes artistike të njerëzimit, që është evident me gjithë larminë e nuancave ideoartistike dhe zigzagjet e pashmangshme të zhvillimit, dalin qartë dy momentet kryesore të qëndrimit dialektik ndaj traditave: pranimi i tyre si bazë për zhvillimin e mëvonshëm dhe qëndrimi kritik e krijues ndaj tyre për shikak të ndikimeve negative shoqërore e artistike që kanë zënë vend në to dhe të kufizimeve historike që kanë patur. Kështu, për shembull, duke marrë prej letërsisë së Rilindjes

anët e njohura pozitive të saj, ne shayrtojmë me sy kritik jo vetëm çdo shfaqje të botëkuptimeve idealiste, po edhe çdo kufizim ideoartistik të saj, mbasi vetë përmajtja patriotike, karakteri popullor dhe romantika e letërsisë dhë arteve të sotme kanë një fryshtë historike më të pasur, më të përparuar dhe më revolucionare nga ajo e letërsisë së Rilindjes, kurse parimet krijuarë të sotme janë të ndryshme jo vetëm në krahasim mit socialist janë të ndryshme jo vetëm në krahasim me parimet që udhëhiqin De Radën e Naimin, po edhe në krahasim me ato që udhëhiqin krijuarë e Migjenit me shokë. Siç shihet edhe «e vjetëra pozitive» nuk mund të ketë vlerë absolute për etapat e mëvonshme, po merret gjithnjë në raport me stadin e ri që është arritur. Ndryshtë nuk ka zhvillim, nuk ka përparim.

Në qëndrimin ndaj traditave ndikojnë edhe konceptet, pëlqimet dhe prirjet individuale të shkrimitarëve dhe të artistëve. Sipas tyre ne gjejmë në epoka dhe fazë të ndryshme natyra artistike të afërta ndërmjet tyre. Kjo është e kuptueshme, po nuk mund të jetë kurdoherë kriter i vlerësimit objektiv, mbasi pëlqimet individuale nuk janë të pavarura prej interesimeve dhe nxitjeve shoqërore në krijuarë dhe, sado objektive e të shëndosha që të jenë, ato kanë kurdoherë edhe karakter të kufizuar, gjë që mund të shpjerë në mbivlerësimin dhe idealizimin e shkrimitarëve dhe të artistëve të veçantë më dëm të vlerësimit të drejtë shkencor të krijuarë së një periudhe të tërë historike. Sado i madh që të jetë një artist, ai nuk mund të lindë e të kuptohet jashtë kushteve historike të kohës, i shkëputur nga tradita dhe nga arritet kryesore shoqërore dhe ideoartistike të kohës. Naimi nuk mund të kuptohet pa lëvizjen e çlirimt kombëtar dhe pa përpjekjet e intelektualëve patriotë për shkrimin e gjuhës shqipe, për diturimin e popullit dhe për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Po kështu nuk mund të kuptohet as Migjeni pa fillimet e lëvizjes komuniste në Shqipëri dhe pa atë prirje të shumë shkrimitarëve të rinj të asaj kohe për të pastqyruar në krijuarë e tyre hallet e popullit, për të mbaj-

tur qëndrim kritik ndaj realitetit shoqëror e politik të atëhershëm, për të demaskuar klerin reaksionar katalik, fashizmin dhe aparatin burokratik të shtetit anti-popullor. Prandaj vlerësimi i drejtë dhe i plotë shkencor i traditës nuk mund të identifikohet me pëlqimet individuale të shkrimitarëve e artistëve të veçantë, po duke parë me rigorozitet ç'gjë të re ka sjellë çdokush në krahasim me kohën dhe ç'anë të krijuarë së tij mund të shërbejnë si mbështetje për artin e kohëve më të vona.

Duke mbajtur parasysh të gjitha vlerat pozitive të së kaluarës, në rrëthana të ndryshme historike, marrin rëndësi dhe dalin në plan të parë tradita të kohëve të ndryshme dhe anë të veçanta të tyre. Kështu, për shembull, letërsia e Luftës Nacionaçlirimtare, për vetë karakterin e kohën kur u zhvillua, ishte më e afërt me letërsinë e Rilindjes, se sa me atë të viteve 30, që e kishte më të afërt në kohë, për shkak të sundimit në të të frymës patriotike. Edhe këto afrime fazash të veçanta, me gjithë bazën e tyre objektive, ruajnë një farëngushtësie dhe, për këtë arsy, nuk mund të identifikohen plotësisht me qëndrimin e gjithanshëm shkencor ndaj traditave të së kaluarës, që presupozon mbajtjen parasysh të raporteve të shumanshme ideore e artistike që krijuarëndërmjet së kaluarës, së sotmes dhe së ardhmes që preqatitet.

### 3.

Po cilat janë ato tradita pozitive kombëtare mbi të cilat është mbështetur dhe mbështetet letërsia dhe arti i realizmit socialist dhe cilat janë ato tradita apo anë të veçanta të traditës që mohohen dhe flaken prej tij?

Në radhë të parë është *krijuarë e pasur artistike e popullit* e krijuar gjat shekujve dhe e materializuar në atë thesar të madh të kulturës e të artit popullor, që është transmetuar brez pas brezi dhe është ngjitur drejt majave më të larta, duke u bërë mbështetje e fortë

dhe e sigurtë për zhvillimin e kulturës e të artit të kultivuar demokratik e revolucionar në të gjitha kohët. Për rastin e kulturës e të artit tonë kjo është kushtëzuar edhe prej vetë rrethanave historike në të cilat kanë lindur dhe janë zhvilluar letërsia dhe arti.

Në folklor, më tepër se në çdo krijimtari tjetër, të vjetër ose të re, është pasqyruar me vërtetësi shtegëtimi i popullit tonë në shekuj, jeta, lufta, puma, aspiratat, zakonet, mënyra e jetesës, temperamenti etj. dhe në këtë mënyrë, përmes një materiali shumë të pasur historik e të reflekseve shpirtërore të tij, është derdhur si në bronx fizionomia jonë kombëtare, «*konstitucioni i përbashkët shpirtëror i popullit tonë, i shprehur në njësinë e kulturës kombëtare*». Kjo vlerë e paçmueshme e krijimtarisë popullore ka tërhequr vëmendjen e patriotëve e të studiuesve, që në kohën kur De Rada, Jubani e Mitkuia iu vunë punës me zell e dashuri për mblehdhen, botimin dhe studimin e krijimtarisë popullore, sidomos të folklorit letrar, ndërsa Dora d'Istria e përdori me sukses këtë material para botës si flamur të kombësisë shqiptare. Edhe në ditët tona folklori i vjetër dhe i ri e ruan këtë vlerë, duke qënë një prej shprehjeve më autentike dhe më të drejtpërdrejta të aspiratave e të idealeve të popullit, një prej shfaqjeve më të fuqishme të vitalitetit të tij, duke marrë kështu edhe vlerën e një dëshmje artistike të pazëvendësueshme të atyre përparimeve kolosale që janë arriut pas revolucionit në Shqipëri në jetën shoqërore dhe në botën shpirtërore të njerëzve.

Një përmbajtje e tillë është derdhur në krijimtarinë e pasur dhe të shumëfarëshme popullore me një gjuhë artistike krejt origjinale, që tingëllon si një nga zërat më të bukurë dhe më të fuqishme në korin shumë të madh të krijimtarisë popullore botërore. Meloditë e këngëve, ritmet e valleve, ngjyrat, ornamentet dhe prerjet e kostumeve, punimet e mrekullueshme të artizanatit etj., jo vetëm që e mahnitin njeriun me mjeshtërinë e realizimeve, po mbi të gjitha, e bëjnë përvete me ori-

gjinalitetin e tyre kombëtar, si konkretizime të mrekullueshme të natyrës, të historisë e të aktualitetit të vendit tonë, si mishërimë të temperamentit dhe të botës së pasur e dinamike shpirtërore të popullit. Kjo krijimtari, me origjinalitetin e vet të papiersëritshëm, është nga pjesët më me rëndësi të kontributit që ka dhënë populli ynë në thesarin e madh të kulturës botërore, pa mohuar, në këtë rast, as ndikimet e drejtpërdrejta që ka ushtruar kjo krijimtari si dhe arti ynë i kultivuar në kulturën e popujve të tjerë, mbasi:

«Kultura e Gregisë së lashtë ka influencuar në kulturën e popullit tonë, por është e pamundur që edhe kultura e lashtë e popullit tonë të mos ketë influencuar në kulturën e popullit grek. Kultura bizantine gjithashtu ka influencuar në kulturën e popullit tonë, por edhe kultura jonë ka influencuar në zhvillimin e kulturës bizantine. Për këtë influencë e gërshtetim kulture flasin zbulimet që po bëhen në arkeologji dhe studimet mbi të kaluarën e popullit tonë»<sup>67)</sup>

Kjo vlerë themelore e krijimtarisë popullore — brendia demokratike e patriotike dhe gjuhja artistike kombëtare, — është një prej elementeve më aktive të traditave artistike të së kaluarës, që ka qënë dhe vazhdon të mbetet një prej mbështetjeve më pozitive për zhvillimin e letërsisë e të arteve të realizmit socialist, sidomos për t'u dhënë atyre një fizionomi të përcaktuar kombëtare nëpërmjet së cilës do të shprehej më së miri brendia e pasur socialiste. Në këtë rrugë e ka orientuar kurdoherë Partia letërsinë dhe artin e në këtë rrugë kërkimesh e realizimesh të suksesshme janë vënë shkrimtarët dhe artistët tanë më të mirë, të cilët kanë krijuar vepra të shquara, që mbajnë vulën e Shqipërisë sociale. Por, me gjithë arritjet shumë të mira të derisotme, sidomos në letërsi e në muzikë dhe përpjekjet e ndërgjegjshme që po bëhen për ta çuar më përpara këtë

67) Enver Hoxha: Fjala e mbajtur në mbledhjen e shkrimtarëve dhe artistëve më 11 korrik 1961 («Drita» 1961, 6 gusht).

traditë, puna për studimin, asimilimin dhe shfrytëzimin krijues të folklorit mbetet për çdo shkrimtar e artist një detyrë e përherershme dhe me shumë përgjegjësi për të ardhmen e letërsisë e të artit dhe për rolin që do të luajnë ato si mjete edukimi ideoestetik. Qëndrimet aristokratike ndaj krijimtarisë popullore dhe tendencat e nënveftësimit të tij nga pozita intelektualiste kanë qënë dhe mbeten një prej shfaqjeve më të shëmtuara në jetën kulturore, që i kanë sjellë dëme serioze letërsisë e arteve dhe u kanë çelur udhën ndikimeve të huaia moderniste. Tendenca të tilla vitet e fundit janë shfaqur kryesisht në formën e parullave të luftës kundër «arkaizmit» dhe «folklorizmit», duke ua ngjitur këto etiketa vetë krijimtarisë popullore dhe asaj pjese të letërsisë e të arteve që mbështetet në këtë krijimtari. Nuk është aspak e rastit që autorët e këtyre teorizimeve spekulative, që mohonin vlerën dhe të ardhmen e folklorit, ishin partizanë të flaktë të tendencave moderniste dhe përuleshin me servilizëm para modës artistike përendimore.

«Në spekulimet rrith arkaizmit, folklorizmit etj.» thotë shoku Enver «kemi të bëjmë me një qëndrim të hapët përbuzës përgjithësisht ndaj folklorit, ndaj vlerave të mëdha artistike e shoqërore të tij, ndaj raportit të tij me artin e kultivuar. Pikërisht qëndrime e teorizime të tilla kanë qënë një nga shkaqet e largimeve nga tabani i shëndoshë kombëtar dhe kanë shërbyer si argumenta për t'i përligjur këto largime. Çdo gjëje të mirë e të bukur popullore këta pseudoteoricienë i ngjitnin etiketa përqmuese, shumë herë të pakuptueshme edhe nga ata vetë, pse ishin terma e korrente borgjeze në literaturë e në art, që vetë rrjedha e kohës i kishte hedhur në kanale. Këta të ashtuquajtura estetë modernë i vinin rëndësi formës dhe aspak ideoologjisë, politikës, brendisë»<sup>68)</sup>

68) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 23.

Krahas kësaj vlere të përgjithshme ideoartistike, që përbahet në tërësinë e natyrës së krijimtarisë popullore, ajo përmban edhe vlera të veçanta artistike e të mjeshtërisë, që kanë shërbyer e shërbijnë si një tjeter mbështetje me rëndësi për letërsinë dhe artin e kultivuar. Siç është vënë re edhe deri tani në krijimtarinë letrare e artistike dhe në studime të ndryshme, shkrimitarët dhe artistët kanë gjetur në krijimet popullore gjuhën e gjallë, të pastër, të pasur dhe plot nuanca kuptimore e stilistike, ritmet e vargjeve, të këngëve e të valleve, motivet patriotike, të punës e të dashurisë, sensin e masës dhe harmonizimin e brendisë e të formës, koncizitetin e shprehjes artistike, thjeshtësinë dhe qartësinë, prirjen e përherershme të bashkëkohësimit të shprehjes, figuracionin e bukur dhe shumë vlera të tjera, që janë shfrytëzuar me mjeshtëri e me originalitet prej shkrimitarëve dhe artistëve të talentuar. Edhe në këtë drejtim, sikurse në drejtimin e parë, nuk është çështja për të arritur në disa përgjasime të jashtme vulgare me krijimet e popullit, po për asimilimin krijues të traditës popullore, për arritjen e një shkrirjeje të atillë me të, që do t'i jepte mundësi shkrimitarit e artistit të fliste vetë me gjuhën e popullit, të ngríhej në lartësinë e përfaqësuesit të tij të denjë artistik. Pra, është fjala për formimin e një personaliteti të atillë krijues për të cilin gjëja më e natyrshme do të ishte lidhja e përhereshme dhe e gjithanshme me krijimtarinë popullore, kurse shkëputja prej saj, do të ishte fare e pamundur. Naimi, Çajupi, Shevqet Musaraj, Jakov Xoxa, Dritero Agolli, dhe shumë të tjera na kanë dhënë shembulla të mrekullueshme të një kuptimi të tillë krijues të mbështetjes në traditën artistike popullore. Shembulla të tilla kanë dhënë në muzikë edhe kompozitorë të talentuar si Çesk Zadeja, Tish Daia, Feim Ibrahimi etj.

Tradita e krijimtarisë artistike popullore ruan vlera të mëdha vepruese dhe për kohën tonë, jo vetëm si mbështetje për zhvillimin e artit, po edhe si një mjet i fuqishëm i edukimit ideoestetik të masave, sidomos të

rinisë, si një mjet shumë efektiv i vetedukimit të popullit. Koha ka provuar plotësisht se edhe në këtë drejtim vlerat e folklorit janë të pazëvendësueshme dhe shumë efektive. Si një jehonë e fuqishme e të kaluarës së lavdishme, si shprehës i aspiratave popullore dhe si pasqyrues besnik i aktualitetit politik, shoqëror e shpirtëror të masave popullore, folklori ka patur dhe ruan rëndësinë për edukimin e punonjësve me dashuri për Atdheun e për Partinë, me shpirtin revolucionar të papajtueshmërisë klasore, me ndjenjën e punës, të solidaritetit e të humanizmit aktiv revolucionar, me një kuptim të shëndoshë të jetës, të lumturisë, të dashurisë, me virtutet e larta të popullit, me idealin e përsosmërinë morale e fizike të njeriut etj.

Tradita artistike popullore nuk kufizohet vetëm në krijimet poetike, muzikore, koreografike, spektakolare etj., po përfshin edhe mjetet e realizimit dhe mënyrat popullore të interpretimit të saj, për të cilat, për fat të keq, studimet janë akoma të pakta dhe në fazë fillestare, megjithëse interesimi shoqëror dhe i rrëtheve artistike për to ka ardhur duke u rritur. Si rezultat i këtij interesimi dhe i punës krijuese plot pasion e dashuri të kompozitorëve, koreografëve, këngëtarëve, valltarëve, njohësve të veglave muzikore popullore, piktorëve dhe kostumierëve të shfaqjeve artistike popullore janë arritur disa suksese të meritueshme edhe në këtë drejtim. Të tilla janë përpunimi i këngëve dhe i valleve popullore dhe interpretimi i tyre skenik në manierën e përpunuar prej popullit, krijimi i këngëve dhe i valleve të reja më të zhvilluara mbi bazën e melodive dhe ritmeve të njoitura të folklorit, përpjekjet për një përdorim më të gjerrë të veglave muzikore popullore dhe për temperimin e tyre, stilizimi i hijshëm i kostumeve dhe aplikimi i traditës popullore në dekorin e shfaqjeve. Ansamblı Shtetëror i Këngëve dhe Vallevë Populllore është bërë një qëndër me rëndësi e kësaj pune, që tanë ka marrë përhapje më të gjerë dhe ka tërhequr interesimin edhe të shumë ansambleve e grupeve artistike profesioniste e

diletante. Artistët tanë më të mirë, si në të kaluarën edhe sot, krahas repertorit operistik e të muzikës tjetër të kultivuar, kanë puquar kurdoherë me dashuri edhe mbi repertorin popullor dhe, në këtë mënyrë, jo vetëm që kanë vlerësuar muzikën e popullit, aq të dashur e të kërkuar prej dëgjuesve, po kanë zgjeruar e përpunuar edhe mjeshterinë e tyre ekzekutuese e interpretuese, duke e pasuruar me përvojën e pasur të atyre qindra e mijëra artistëve popullor, që janë bërë gjatë shekujve interpretët më të mirë të shpirtit, të talentit e të shijes së masave punonjëse.

Po a do të thotë kjo që në krijimtarinë popullore duhet marrë gjithçka, duhet të përulemi ndaj gjithçkaje, mjafton që ajo të ketë *formën* e krijimtarisë popullore? Jo, shoku Enver ka porositur, që edhe krijimtarinë popullore ta shikojmë në mënyrë dialektike, të marrim prej saj gjithçka të mirë e të bukur (dhe kjo është kryesorja), të lemë mënjanë ato pjesë të traditës popullore të cilës i ka kaluar koha dhe ta pastrojmë folklorin e të flakim tej prej tij ato ndikime të huaja të ideologjisë, të moralit dhe të shijeve artistike të klasave shfrytëzuese e të lumpenmikroborgjezisë, që kanë mundur të depertojnë në të për shkak të kushteve historike në të cilat është zhvilluar. Nga ana tjetër, ky qëndrim kritik e krijues ndaj folklorit diktohet edhe prej faktit, se vetë krijimtaria popullore ka qenë dhe është në zhvillimin dhe, si në çdo gjë që zhvillohet, edhe në të ka diçka që e përballon kohën e mbetet, ka diçka që përpunohet, lartësohet e përsoset ka edhe diçka që vjetërohet, që humbet e që, po nuk u trajtua drejt e po nuk u pastrua me kohë, kthehet në rutinë dhe pjell anakronizmin.

Vlera të shumta e të çmuara ruajnë për zhvillimin e letërsisë e të arteve të realizmit socialist edhe *traditat e artit* e të letërsisë së kultivuar kombëtare, të cilat Partia i ka vlerësuar kurdoherë drejt dhe i ka përdorur gjerësisht për edukimin politik, moral dhe ideoestetik të popullit. Nuk ka qenë e rastit që një prej manifesti-

meve më të mëdha kulturore në vitet e para pas Çlirimit ishte «Jubileu i Rilindasve» gjatë të cilit u bënë përpjekjet e para për vlerësimin e plotë të figurave më të ndritura të letërsisë sonë kombëtare përparimtare. Në mënyrë të veçantë rëndësi për letërsinë dhe artet tonë të sotme si dhe për edukimin ideoartistik të masave kanë dy periudha të zhvillimit letrar e artistik të së kaluarës: periudha e Rilindjes (1836-1912) dhe periudha e letërsisë demokratike revolucionare (1920-1939), gjatë të cilave u krijuan vlera të mëdha letrare e artistike dhe u afirmuan shumë personalitetë të shquara të letërsisë e të artit.

Ku qëndron konkretisht vlera e këtyre traditave për zhvillimin e letërsisë e të arteve të realizmit socialist?

Kjo vlerë qëndron, para së gjithash, në përbajtjen e tyre patriotike e demokratike, në karakterin populor dhe në fryshtën e qartë kombëtare. Duke u mbështetur në traditën popullore dhe në anët më pozitive të krijimtarisë letrare e artistike të kultivuar të asaj kohe, këta shkrimtarë e artistë, të frymëzuar nga lufta e popullit për liri e demokraci, shtruan dhe zgjidhën shumë probleme me rëndësi të brendisë e të formës artistike, duke qenë të shumtën e herës edhe iniciatorë të mëdhenj të një arti me potencë të madhe e të re. Problemet e shtruara e të zgjidhura prej shkrimtarëve e artistëve përparimtarë të së kaluarës do t'ishte jashtë çdo logjike po të merreshin si ezaurim i të gjitha problemeve letrare e artistike dhe aq më tepër si zgjidhje e përfjetshme dhe e pandryshueshme e tyre, mbasi çdo kohë ka problemet e veta dhe u jep nuanca të reja, disa herë mjaft të rëndësishme, edhe problemeve të shtruara e të zgjidhura më parë. Duke iu përbajtur parimit leninist që të gjejmë dhe të përvetësojmë atë pjesë të kontributit të artistëve të shquar «që nuk shkoi në të kaluarën, po që i përket të ardhmes»,<sup>69)</sup> në veprën e shkrimtarëve

69) Lenini për kulturën dhe artin, f. 109.

dhe artistëve të së kaluarës ne gjejmë, si një vlerë të madhe pozitive, krahas dashurisë së tyre për Attheun e për popullin, ideve të përparuara, ndjenjave të singerta dhe mjeshtërisë, edhe atë raport aktiv që patën ata me kohën dhe me bashkëkohësit, atë fryshtë militante që karakterizoi pjesën më të mirë të krijimtarisë së tyre, atë përpjekje të guximshme për të kapërcyer kufizimet ideoartistike të së kaluarës dhe për të çelur horizonte të reja ideore dhe artistike për letërsinë dhe artin kombëtar. Vetëm e kuptuar kështu tradita e së kaluarës do të bëhet edhe më tepër një mbështetje dhe një burim fryshtësimi për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve të realizmit socialist. Kështu që, në qoftë se pararendësit e shkrimtarëve e të artistëve të sotëm thanë 1 dhe 2 për shumë probleme të krijimtarisë artistike (dhe e thanë mirë fjalen e tyre), këta të fundit, të mbështetur në atë arritje, kanë thënë e do të thonë 5,10 dhe 100, po kurdoherë duke u nisur prej numërimit filletar, prej shkallëve të mëparshme të zhvillimit, pa të cilat do të ishte i pamundr përparimi i sotëm, do të kish qënë shumë më i vështirë trajtimi dhe zgjidhja e çdo problemi.

Mjeshtëria artistike e shkrimtarëve dhe artistëve të shquar është një shkollë e madhe për talentet, që ecin në vazhdën e tyre. Dhe kjo është një vlerë tjetër e traditës së letërsisë e të artit të kultivuar të së kaluarës, që duket qartas në krijimtarinë letrare e artistike dhe është pohuar me krenari prej vetë shkrimtarëve e artistëve të sotëm.

Por në qëndrimin ndaj traditave, qofshim këto edhe përparimtare, Partia ka shtruar detyrën që të mbahet parasysh se: «Arti dhe letërsia, si produkt i veprimitarisë njerëzore, si fenomen shoqëror objektiv, zhvillohen vazhdimisht, janë gjithnjë në rritje, ashtu siç është në zhvillim dhe në rritje vetë shoqëria njerëzore. Një pjesë e krijimtarisë letrare dhe artistike vjetërohet dhe shpesh harrohet, pjesë të tjera lulëzojnë, zhvillohen dhe vazh-

dojnë të rrojnë për aq kohë sa kanë forcë të kryejnë një funksion në shoqëri e në jetën e njerëzve»<sup>70)</sup>

Këtej del, se krahas kujdesit për të mos lejuar asnjë shfaqje mohimi nihilist dhe asnjë përpjekje që «për hir të novatorizmit të shtrembërohet e vërteta dhe realiteti historik», po të nxirren e të vlerësohen drejt anët më pozitive të traditave të së kaluarës, të mbahet parasysh gjithashtu nevoja e qëndrimit kritik ndaj tyre si në zgjedhjen dhe redaktimin e veprave të klasikëve që i jepen popullit nëpërmjet ribotimit, antologjive etj. ashtu edhe në trajtimin shkencor objektiv të vlerave, të kufizimeve e të dobësive që mund të kenë këto vepra, duke mos u bërë as më të voglin lëshim pikëpamjeve idealiste e teologjike për hir të stilit e të mjeshtërisë së shkrimitarëve të ndryshëm. Këto kriterë të parashtruan nga shoku Enver kanë rëndësi të posaçme për letrarët dhe artistët, për krijimtarinë. Shkrimitarët dhe artistët e sotëm, për të gjitha arsyet që u përmendën do të mbështeten dhe s'ka si të mos mbështeten në traditat pozitive të së kaluarës, po në asnjë traditë, në asnjë autor dhe në asnjë vepër të shquar të së kaluarës nuk mund të kërkohet dhe të gjendet zgjidhje për problemet e mëdha të kohës sonë. Kjo zgjidhje do të gjendet duke u mbështetur në tabanin kombëtar, në botëkuptimin marksist-leninist e në orientimet e Partisë, në lidhjet e përhershme e të gjalla me popullin, në njojen dhe shfrytëzimin e përvjohës së pasur të letërsisë e të arteve tonë të realizmit socialist, që përbëjnë një nga pjesët më të rëndësishme dhe më vepruese të traditave tonë.

«Partia ka theksuar vazhdimisht nevojën që të mbështetemi në traditat e shëndosha e t'i kultivojmë ato më tej. Ajo ka nxjerrë në pah vlerat e mëdha të traditave më të mira kulturale, frysëm patriotike e demokratike popullore të tyre. Por për ne traditë nuk është vetëm tradita e fuqishme e letërsisë patriotike të Rilindjes kombëtare, e letërsisë përparimtare demokratike

70) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968), f. 479.

e revolucionare të paraçlirimt, por edhe tradita tashmë tridhjetëvjeçare shumë e pasur dhe e larmishme e letërsisë dhe e artit tonë të realizmit socialist»<sup>71)</sup>

Kjo traditë e re, e pasur dhe revolucionare është një prej mbështetjeve më aktive e më të sigurta për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve tonë në rrugën e nisur që në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare.

Kjo traditë e re ka shumë rëndësi për të ardhmen e letërsisë e të arteve të realizmit socialist, është një mbështetje kryesore sidomos për krijimtarinë e shkrimitarëve e të artistëve të rinj, të cilët, krahas brumosjes me botëkuptimin marksist-leninist dhe njojen nga afër me realitetin e vendit e të popullit tonë, do të çajnë përpara e do të krijojnë vepra me vlerë edhe duke u mbështetur në mënyrë krijuar në eksperiencën më të mirë të shkrimitarëve e të artistëve të mirënjohur nga populli e nga Partia.

«Veprat që i kanë dhënë poezisë, prozës, muzikës, pikturës, etj. shkrimitarët dhe artistët tanë të mirënjohur, duhet të bëhen objekt kryesor studimi dhe frysëzimi për të gjithë ata që merren me letërsi dhe me arte përsa u përket etikës, brendisë, trajtimit të problemeve etj. Kjo krijimtari është dhe do të jetë një shkollë dhe ndihmë e madhe, që do t'u jepet të rinjve nga artistët e afirmuar»<sup>72)</sup>

#### 4.

Zhvillimi i letërsisë dhe i arteve të realizmit socialist nuk është kuptuar asnjëherë dhe nuk është bërë i shkëputur nga zhvillimi i përgjithshëm i letërsisë dhe i arteve të sotme botërore. Dhe kjo është e natyrshme dhe shumë

71) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 24.

72) Enver Hoxha: Shkrimitarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të punonjësve tanë, f. 17.

e kuptueshme, sidomos në kohën tonë kur janë aq të shumta dhe aq të fuqishme mjetet e komunikimit shqëror dhe kur njerëzit tanë, ndër ta edhe shkrimtarët e artistët, nuk interesohen vetëm se ç'ndodh në vendin e tyre, po janë shumë të interesuar të dinë edhe ç'ndodh në botë, të përfitojnë nga çdo gjë e mirë e të tjerëve dhe të përcaktojnë qëndrimin ndaj çdo fenomeni të kohës, duke u nisur prej qëllimit që të përkrahin çdo gjë përparimtare e revolucionare dhe të luftojnë çdo shfaqje të kalbëzimit borgjez e revizionist. Populli ynë në të gjitha kohët, pa paragjykime nacionaliste, ka çmuar drejt kulturnët dhe artin e popujve të tjerë dhe është përpjekur të marrë prej tyre çdo gjë të bukur e përparimtare, duke e vënë në shërbim të zhvillimit të mëtejshëm të kulturës e të artit të tij dhe një gjë të tillë e ka bërë jo duke u përulur para të tjerëve, po duke ruajtur e forcuar gjithnjë e më tepër frysni kombëtarë të kulturës së vet demokratike, që rrënjet i ka pasur në popull, në traditat e pasura dhe në historinë e tij të lavdishme. Këtë traditë demokratike internacionale e ngriti në një shkallë të re Partia e Punës e Shqipërisë, e cila ka kultivuar tek çdo punonjës dashurinë dhe respektin për popujt e tjerë dhe për traditat dhe arritjet e tyre kulturore përparimtare, revolucionare e realiste, duke i dalluar mirë këto prej kulturës borgjeze, imperialiste e revizioniste.

Bota e sotme nuk përfaqëson një tërësi unike, prandaj edhe kultura dhe arti botëror karakterizohet nga rryma dhe drejtime të ndryshme përparimtare e revolucionare, popullore e realiste, reaksionare e revizioniste, dekadente e formaliste, të cilat duke ekzistuar objektivisht dhe duke u përhapur ushtrojnë mbi njerëzit ndikime të ndryshme e të kundërtat, prandaj edhe qëndrimi ndaj tyre nuk mund të jetë i njëjtë dhe i pandryshueshëm. Sidomos në kuştet e sotme, nevoja e një qëndrimi të diferencuar ndaj traditës dhe aktualitetit kulturor e artistik të vendeve të tjera, bëhet më imperativ dhe kërkon nga çdo punonjës i kulturës e i artit një preqatitje të mirë, vlerësim ideologjik e politik të çdo fenomeni

dhe vigjilencë të lartë revolucionare, në mënyrë që të merret gjithçka që është vërtetë e mirë dhe e bukur dhe të flaket çdo gjë regresive, dekadente e formaliste. Veç kësaj raportet me traditën e huaj kulturore e artistike i nënshtrohen kriterit të njojur që e *huaja duhet t'i shërbujej kombëtares*, d.m.th. të merret nga eksperiencia e të tjerëve vetëm ajo gjë pozitive, që do të ndihmonte në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve të realizmit socialist.

«*Pikëpamjet se çdo gjë e huaj është e mirë*» thotë shoku Enver, «duhen luftuar e flakur tej. Kozmopolitizmi është i huaj për marksizëm-leninizmin... Edhe pikëpamjet se çdo gjë e huaj është e keqe duhen luftuar e flakur tej si të papranueshme. Ksenofobia është gjithashtu e huaj për ne marksistë-leninistët internacionalistë»<sup>73)</sup>

Në drejtimet dhe në variantet më të ndryshme, shpesh me pleksje, ndërlikime dhe ndikime të shumta reciproke, letërsia dhe arti i sotëm botëror të tërheqin vëmendjen me tri pamje kryesore e të njëkohëshme të tij: me artin revolucionar socialist, që është më i afërti për ne, me artin përparimtar realist të popujve që luftojnë për çlirim kombëtar e shoqëror dhe të forcave demokratike në vendet kapitaliste dhe me artin dekadent e formalist borgjez e revizionist, që kultivohet prej forcave më regressive e më të çoroditura të epokës sonë. Është e kuptueshme se ndaj këtyre tre grupdrejtimesh nuk mund të mbahet i njëjtë qëndrim gjersa bazat shoqërore, filozofike dhe ideoestetike të tyre janë të ndryshme e deri edhe diametralisht të kundërtat.

Në parim Partia ka theksuar që në dokumentet më të hershme të saj se «*punonjësit e frontit ideologjik, shkrimtarët, kompozitorët arkitektët e të tjerë duhet të përfitojnë... nga gjithçka është e mirë dhe përparimtare në jetën dhe në kulturën e vendeve të tjera, por duhet të hiqet dorë nga shablonizmi dhe mënyra mekanike në zbatimin e eksperiencës së huaj*»<sup>74)</sup>

73) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 139-140.

74) PPSH mbi kulturën, letërsinë dhe artin, f. 17.

Ky orientim i përgjithshëm për qëndrimin ndaj traditës dhe përvojës së huaj thekson katër aspekte kryesore të problemit, që janë: e para, nga tradita dhe përvuja e huaj duhet të marrim atë që është më pozitive, e dyta, që presupozohet prej të parës, duhet lënë mënjanë ajo që nuk i shërben edukimit të njerëzve dhe zhvillimit të letërsisë e të arteve tona, e treta, edhe kur merret kjo përvojë nuk duhet të kthehet në shablon, po të shfrytëzohet në mënyrë krijuese dhe, e katërt, duke njohur, studjuar e respektuar vlerat më pozitive të traditës e të përvojës kulturore e artistike të popujve të tjera, punonjësit e frontit të kulturës e të artit «*me guxim dhe vendosmëri... duhet të orientohen drejt punës krijuese dhe formave origjinale, duke u frysmezuar nga historia e lavdishme dhe puna heroike e popullit shqiptar*»<sup>75)</sup>, d.m.th. ta përdorin përfitimin prej traditës dhe eksperiencës së huaj në dobi të forcimit të frysës kombëtare socialistë të artit e të letërsisë së realizmit socialist.

Pse këto kritere ndaj artit të huaj përparimtar të së kaluarës e të kohës sonë?

Në radhë të parë, se cdo epokë ka kulturën dhe artin e vet, që u përgjigjet kushteve ekonomike, shoqërore dhe pikëpamjeve ideologjike të klasave që përbëjnë shoqërinë e asaj epoke, prandaj krijimtaria e cdo shkrimitari dhe e cdo artisti, cdo vepër arti, në një mënyrë ose në një tjetër, në një masë ose në një tjetër do të reflektojë pikëpamjet ideologjike dhe shijet estetike të kohës kur është krijuar, do të mbajë vulën e luftës së klasave në atë kohë. Ajo sado e përsosur që të jetë, s'mund të shërbejë si model për të gjitha epokat. Mjafton të përmendim dështimin e përpjekjeve të dikurshme klasiciste (ndonjë tentativë e vonuar u bë edhe në letërsinë tonë pas cilirimit) për të përtëritur artin e Greqisë së lashtë, sidomos tragedinë, që të bindemi se nuk mund të merret gjithçka nga arti i epokave të mëparshme. Botëkuptimeve, ideologjive, moraleve, shijeve ideoestetike u shtohen në këtë rast edhe ndryshimet që pëson vetë arti gjatë

<sup>75)</sup> Po aty.

shekujve nën ndikimin e jetës shoqërore, të zhvillimit të shkencës e të teknikës, të shkallës së integrimit të ndërgjegjshëm të masave në jetën shoqërore etj. E reja nuk hyn dot në kallëpe të vjetra. Ajo, brendia e re, kërkon forma të reja të shprehjes artistike dhe i krijon këto forma. Kështu qëndron puna, në vijat më të përgjithshme me artin e të gjitha epokave të mëparshme, duke përfshirë edhe artin e shoqërisë kapitaliste, që është gjithashtu një «epokë» e kapërcyer prej zhvillimit të sotëm shoqëror të Shqipërisë.

Së dyti, në cdo epokë, cdo klasë krijon kulturën dhe artin e vet, në të cilin përfaqësohen konceptet ideologjike, etike dhe estetike të kësaj klase, të cilat kanë karakter përparimtar, revolucionar ose dekadent e reaksionar, sipas pozitës që ka zënë dhe zë kjo klasë në jetën shoqërore të kohës. Ndikimet reciproke ideoestetike, në këtë rast, megjithëse nuk mund të mos mbahen parasysh, nuk përbëjnë thelbin e çështjes. Gjatë gjithë historisë së letërsisë e të artit botëror, me gjithë pleksjet dhenëdërlirimet e shumta, rrymat dhe shkollat e ndryshme, nuancat ideoartistike, etj. sipas orientimeve më të përgjithshme që kanë pasur, janë krijuar dy vazhda të mëdha artistike, që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite: arti përparimtar, qoftë ky klasik, romantik ose realist dhe arti reaksionar, dekadent e formalist me varietete të pakufishme shkollash e shkollëzash, shumë prej të cilave e kanë pasur jetën tepër të shkurtër. Është e natyrshme që arti dhe letërsia e realizmit socialist të ndjekin vazhdën përparimtare, si trashëgimtare legjitime të saj dhe ta ngrenë atë më lart, duke e pasuruar me përvojën e revolucionit e të ndërtimit të socializmit dhe me botëkuptimin dhe konceptet e shijet ideoestetike të klasës punëtore, të masave punonjëse dhe të partisë së tyre markiste-leniniste.

Së treti, cdo klasë e mëparshme shoqërore, si në ideo logji, edhe në letërsi e në art ka njohur, si rregull, dy faza të zhvillimit të vet: fazën e ngritjes revolucionare dhe fazën e rënies e të dekadencës. Në fazën e parë është

krijuar një letërsi e një art përgjithësisht përparimtar, disa herë me prirje revolucionare (kujtojmë, për shembull, iluminizmin francez), kurse në fazën e dytë, letërsia dhe arti, që nuk shkëputen prej këtyre klasave ose, në një mënyrë a në një tjetër, nuk u kundërvihen atyre, çoroditen ideologjikisht e artistikisht, marrin shprehje haptas reaksionare, bien në pozitat e dekadentizmit e të formalizmit dhe me çdo fytyrë që të marrin përhapin në atmosferë kulturbimën e kufomave dhe grahmat e atyre klasave, që ndodhen në buzën e varrit. Në këtë rast, është gjithashtu e natyrshme, që shkrimitarët dhe artistët e realizmit socialist, me gjithë rezervat ideoartistike dhe qëndrimet kritike ndaj tyre, të krijojnë afinitet me letërsinë dhe me artin e periudhave të ngritjes revolucionare dhe me atë krijimtari të fazave të rënies së klasave shfrytëzuese, që shkëputet prej tyre dhe u kundërvihet ideologjikisht dhe artistikisht.

Së katërti, përvetësimi kritik i traditës dhe i eksperiencës së letërsisë e të artit përparimtar botëror bëhet një kriter i domosdoshëm edhe për faktin se në të vihen re pleksje të atilla ideologjike e artistike — reflekse të kushteve shoqërore e të botëkuptimit të shkrimitarëve e të artistëve — saqë është shumë e vështirë, në mos e pamundur të gjendet një krijimtari, në të cilën, krahas anëve pozitive të mos kenë lënë gjurmë edhe rrymat filozofike e artistike borgjeze e mikroborgjeze të kohës. Duke bërë fjalë për shkrimitarët përparimtarë të kohës sonë, shoku Enver porosit që «*të mos harrojmë se në ta nuk do të gjejmë plotësisht atë që kërkojmë dhe ashtu si e duam ne, pasi edhe në këta autorë përparimtarë ose revolucionarë do të gjejmë të pleksur, në mos plotësisht, po në një mënyrë ose në një tjetër, pasqyrimin e ideve borgjeze të jetës dhe të mendimeve të epokës që kanë jetuar»<sup>76)</sup>*

Së pesti, çdo popull krijon kulturën dhe artin e vet, në të cilin reflektohet jo vetëm stadi i caktuar i zhvillimi-

76) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 374-375.

mit të tij, po edhe veçoritë e tij kombëtare, «konstitucioni shpirtëror» i tij, traditat kombëtare e popullore, deri dhe ambienti gjeografik në të cilin jeton. Duke pasur kurdoherë parasysh parësinë e statit të zhvillimit shqëror të shprehur në karakterin klasor të kulturës e të artit, nuk mund të mos përfillej edhe ndryshimet e tjera, të cilat krijojnë largësi ose afinitet ndërmjet kulturave të ndryshme kombëtare, sipas karakteristikave të përbashkëta ose dallimeve, që vihen në bazë të ndikimeve reciproke ndërmjet tyre. Edhe në këtë drejtim, çdo popull, duke synuar të krijojë e të zhvillojë kulturën dhe artin e vet, zgjedh prej përvojës së të tjerëve atë që i shkon më tepër për shtat, e asimilon dhe e vë në shërbim të vet.

Së fundi, megjithëse flasim për raportet artistike ndërmjet letërsive e arteve të popujve, të kohëve e të klasave të ndryshme, në qëndrimin ndaj traditës dhe përvojës së huaj në këtë fushë mbahet parasysh si një prej kritereve shumë të rëndësishme edhe vlera ideoedukative e krijimtarisë letrare e artistike, ndikimi ideologjik dhe etik që do të ushtrojë ajo në masat punonjëse. Ndryshtë «...në rast se nga një anë ne bëjmë një luftë të përditshme e këmbëngulëse për të zhdukur mbeturinat mikroborgjeze nga ndërgjegjja e njerëzve, ose luftojmë çdo ditë ndikimin e fesë e të bestyrtive dhe, nga ana tjetër, popullit i japim në dorë libra të autorëve me famë botërore në shekuj, në të cilët ata i trajtojnë të lyera «me sheqer» këto ide, atëherë me duart tona shkallmojmë natën atë që ndërtojmë ditën»<sup>77)</sup>

Përvetësimi kritik dhe venia në shërbim të letërsisë e të artit kombëtar të realizmit socialist i traditës dhe i përvojës së huaj artistike është një kriter leninist, që ka të bëjë me artin përparimtar e revolucionar, mbasi përrymat reaksionare, dekadente e formaliste ky kriter merr formën e kundërshtimit të hapur, të luftës së ashpër e të pandërpërë, të demaskimit të bazave të tyre ideolo-

77) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 375.

gjike e socialestetike, të hedhjes posht si shfaqje të degjenerimit e të regresit ideoartistik. Duke u nisur nga brendia shoqërore dhe nga idealet socialestetike, që frymëzojnë shkollat e shumta e të shumëzueshme si mizat të artit e të letërsisë së sotme dekadente e formaliste, ato pavarësisht nga koha kur lindin, në tërën e tyre e në çdo shfaqje konkrete, përfaqësojnë të vjetër reaksionare, botëkuptimin dhe shijet e borgjezisë së vogël të shtypur materialisht e shpirtërisht prej imperializmit dhe të tmerruar prej përbysjeve revolucionare. Përfaqësojnë snobizmin e intelektualëve të paformuar dhe të rretheve provinciale, që e ndiejnë veten të lumtur vetëm kur mendojnë se u përgjasojnë metropolitanëve dhe gjerbin me zell hirrën e baxhove të artit e të letërsisë së vendeve kapitaliste e revizioniste, duke nëpërkëmbur çdo ndjenjë e traditë kombëtare dhe çdo ideal shoqëror dhe ideoartistik përparimtar.

Në ballafaqimin e pozitave krejt të kundërtat të realizmit socialist, nga një anë dhe të rrymave reaksionare, dekadente e formaliste, nga ana tjetër, Partia e Punës e Shqipërisë, është nisur, para së gjithash, nga kundërvënia e qëllimeve të këtyre dy drejtimeve letrare e artistike, që përashtojnë njeri-tjetrin.

*«Ne e dimë fare mirë ku rrabin borgjezia, dhe ideoalogët e saj, ku synojnë politika dhe ideologjia e saj në letërsi dhe në arte. Ashtu si në të gjitha drejtimet, ajo zhvillon edhe në drejtimin e letërsisë e të arteve luftët e saj përmbrojtjen e sundimit të vet klasor dhe përruajtjen e shfrytëzimit mbi masat e gjera popullore. Kurse ne marksistët-leninistët zhvillojmë në të gjitha drejtimet luftët tonë klasore proletare për të çliruar, zhvilluar, për të bërë që të përparojë me hapa vigane mendimi krijuar dhe jo për ta frenuar dhe për ta shtypur atë»<sup>78)</sup>*

Nga këto pozita diametalisht të kundërtat, njëra reaksionare që synon të ruaj rendin kapitalist të shtypjes e të skllavërimit dhe tjetra, që synon ta përbysë këtë

rend dhe të krijojë shoqërinë socialiste, pa asnje formë shtypjeje e shfrytëzimi, vetveti kuptohet si në politikë e në ideologji edhe në kulturë e në art do të lindin drejtime diametalisht të kundërtat, të cilat, sikurse rendet shoqërore që përfaqësojnë janë në luftë me njëra-tjetrën, mohojnë plotësisht njëra-tjetrën. Kjo është baza shoqërore e armiqësisë së egër të propagandës borgjeze e revizioniste kundër realizmit socialist; kjo është baza shoqërore e mospajtimit dhe e luftës së papajtueshme të marksist-leninistëve kundër artit reaksionar, dekadent e formalist të çdo kohe, po sidomos të kohës sonë, kur ai ka marrë forma dhe përmasa të llahtarshme. Borgjezia përkrah letërsinë dhe artin dekadent e formalist, e përhap dhe e propagandon atë se nëpërmjet tij synon të degradojë moralisht e fizikisht njerëzit, t'i largojë ata nga çdo ide e revolucionit dhe e socializmit, të thyej vullnetin e tyre përluftë, të mbjellë korruptionin dhe krimin, të prishë shijet dhe të çoroditë mendimin dhe, nëpërmjet gjithë këtyre, të ruaj sundimin e vet ekonomik e shpirtëror mbi masat punonjëse.

Ky është realiteti i artit dhe i letërsisë reaksionare e dekadente dhe ky realitet ekziston objektivisht, në shumë vende dhe propagandohet me mjete të fuqishme e të gjithfarëshme, pavarësisht nga qëndrimi dhe dëshirat tona. Nëpërmjet propagandimit dhe përhapjes së këtij arti borgjezia dhe revizionistët e sotëm nuk synojnë vetëm të mbajnë në skllavëri shpirtërore masat punonjëse të vendeve të tyre dhe të çoroditit rininë, po edhe të godasin kulturën dhe artin përparimtar e revolucionar të popujve të tjerë për ta shtrirë sundimin e tyre shpirtëror në shkallë botërore, për të nënshtruar kulturalisht, pastaj edhe politikisht dhe ekonomikisht këta popuj. Propagandimi dhe përhapja e artit dekadent borgjez e revizionist dhe e teorive që e mbështesin atë, është pjesë e pandarë e, ndoshta më e rafinuara, e ekspansionit dhe e agresionit imperialisto-revizionist të kohës sonë. Ky agresion ideologjik e kulturor drejtohet sidomos, kundër vendit tonë, prandaj, si në të gjitha fushat e tjera, edhe në fushën e artit e të letërsisë «thjeshtëzimi i rrezikut të ndikimeve

78) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968), f. 489.

*borgjezo-revisioniste*», siç e provuan edhe disa shkarje të rënda të viteve të fundit në jetën letrare e artistike, mund të sjellë pasoja shumë të rënda, jo vetëm për de-vijimin e letërsisë e të arteve nga rruga e realizmit socialist, po edhe për vetë fatet e revolucionit e të socialist, po edhe për vetë fatet e revolucionit e të socializmit. Partia i ka porositur vazhdimisht njërežit e letërsisë e të arteve, që në qëndrimin ndaj rrymave të sotme dekadente e formaliste «...të jenë vigjilentë nga kurthet mbuluara me një cipë sheqeri, të mos gënjenhen dhe të entuziazmohen nga «stilet e ndritshme», nga gjoja «idetë e guximshme» dhe «figurat origjinale». Të mos harrojmë fjalën popullore «çdo gjë që ndrit nuk është ar». Nën këtë ndriçim fals fshihien plagët e qelbura të borgjezisë në dekompozim»<sup>79)</sup>

Në këto kushte lufta kundër rrymave reaksionare, dekadente e formaliste në art dhe teorive estetike borgjezo-revisioniste që i mbështetin ato, ka një karakter të theksuar aktiv në të dyja drejtimet: si kundër këtyre rrymave e teorive, duke zbuluar kalbësinë dhe thelbën antipopullor dhe antirealist të tyre, ashtu edhe kundër ndikimeve të tyre të mundshme në artin dhe në mendimin tonë teorik e kritik, në mënyrë që të ruhet e pastër fizionomia e tyre revolucionare. Kjo nuk është një luftë e lehtë, e thjeshtë dhe e shpejtë. Ajo përkundrazi, është tepër e vështirë, me komplikime të shumta, me gjëresi jashtëzakonisht të madhe, mbasi përfshin probleme nga më themeloret të filozofisë e të estetikës, të politikës e të moralit, të brendisë e të formës, të kuptimit të traditës e të novatorizmit, të funksionit shoqëror të artit dëshmorëve të tjera nga më të ndryshmet të shumë probleme të tjera nga më të ndryshmet të artit e të qëndrimit ndaj artit, prandaj lufta do të jetë tepër e gjatë dhe do të përfshijë të gjithë periudhën historike që na ndan prej fitores së socialistit në shkallë botërore. Në këtë luftë mbështetjet më të sigurta për letërsore. Në këtë luftë mbështetjet më të sigurta për letërsinë dhe artet e realizmit socialist janë, siç ka por-

79) Po aty, f. 489.

situr vazhdimisht Partia: studimi i marksizëm-leninizmit, jo vetëm në libra po edhe në jetë, në përpjekjet për zbatimin e vijës së Partisë; njohja e thellë e parimeve të estetikës marksiste-leniniste dhe vendosmëria për mbrojtjen dhe zbatimin e tyre; lidhjet e gjalla, të forta e të përhershme me popullin, me burimin e vetëm të frymëzimit e të forcës; përvetësimi krijues i traditave më të mira realiste e revolucionare populllore, kombëtare dhe botërore të së kaluarës e të ditëve tona; pjesëmarrja aktive në lufthanë e sotme ideologjike, politike dhe kulturore e artistike në anën e forcave më revolucionare dhe lulëzimi i mëtejshëm dhe ngritja e vazhdueshme e nivelit ideoartistik të letërsisë e të arteve të realizmit socialist, si art e letërsi që u kundërvihen realisht rrymave dekadente e formaliste të artit të sotëm borgjez e revisionist. Shmangjet e ndryshme, që u vunë re vitet e fundit dhe ndikimet borgjeze e revisioniste që zunë vend në një pjesë të kri-jimtarisë e të mendimit kritik, e kishin bazën, veç të tjerave, edhe në boshllëqet që ekzistojnë në drejtimet e mësipërme, në mosbatimin me konsekuencë dhe largimin nga orientimi i drejtë i Partisë për zhvillimin e një lufte ideologjike frontale në të dy krahët, si kundër konser-vatorizmit, ashtu edhe kundër liberalizmit. Prandaj përtë ardhmen shoku Enver porosit të bëhet një punë e kuj-desshme, e pjekur dhe e shkallëzuar, të mënjanohen qëndrimet ekstreme që kanë për bazë ksenomaninë ose ksenofobinë, liberalizmin ose sektarizmin, mungesën e qëndrimit kritik ose të qenit brënda.

«Ne, — thotë shoku Enver, — kemi vlerësuar e vlerësojmë vetëm artin revolucionar, përparimtar e demokratik të huaj, qoftë ky i së kaluarës ose i shekullit tonë. Ne do ta shfrytëzojmë atë edhe në të ardhmen në mënyrë kritike, sepse kjo është e nevojshme për zhvillimin kulturnal të masave, për edukimin ideo-estetik të tyre, si dhe për formimin e atyre shijeve që i rezistojnë ndikimit degjenerues e vulgar borgjezo-revisionist»<sup>80)</sup>

80) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfa-qjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 30.

Ky ka qënë dhe mbetet qëndrimi i pandryshueshmër i PPSH ndaj traditës dhe eksperiencës letrare e artistike të huaj, të së kaluarës e të kohës sonë dhe ky qëndrim është shkencor, revolucionar, patriotik e internacionalist konsekuent.

## KREU I PESTË

### 1.

Në drejtimin që marrin letërsia dhe arti e në zhvillimin e përparimin e tyre një rol me rëndësi luan kritika letrare e artistike, studimet historiko-artistike e teoriko-artistike dhe përpunimi i mendimit të përgjithshëm estetik. Prandaj krahas kujdesit për letërsinë e pér artet, Partia është interesuar vazhdimisht edhe pér zhvillimin e një kritike letrare e artistike marksiste-leniniste, të aftë pér të studjuar shkencërisht problemet e artit e të letërsisë, që të thotë me kompetencë e me guxim fjalën e vet, që të zbulojë me kohë dhe pa u lajthitur tendencat e zhvillimit dhe, mbi bazën e një shqyrtimi shkencor të gjendjes, të çelë edhe perspektiva pér ecjen e mëtejshme në rrugën e lartësimit të vazhdueshmër ideoartistik realist socialist. Një kritikë e tillë, sado me tradita jo aq të shumta, mund të themi se tanimë është krijuar dhe zëri i saj ndihet gjithnjë e më serioz në jetën letrare e artistike. Është pikërisht ky zhvillim, sado që jo aq i plotë e më i vonuar se ai i letërsisë dhe i arteve, që e ka rritur dhe më tepër peshën dhe përgjegjësinë e kritikës letrare e artistike dhe ka nxjerrë në pah probleme serioze të zhvillimit të saj të mëtejshëm. Kjo përgjegjësi e madhe e kritikës dhe e mendimit teorik u duk edhe një herë në konkretësinë dhe në seriozitetin më të plotë vitet e fundit, kur edhe pér shkak të mështësisë së mendimit kritik e të lajthitjeve ideologjike e artistike, që u vunë re

në punën e disa kritikëve dhe të organeve të shtypit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, në letërsi e në art gjetën përhapje disa ndikime borgjeze e revizioniste dhe u bënë orvatje për t'i përligjor ato.

Kritikët dhe gjithë punonjësit e letërsisë e të arteve, sidomos pas Plenomit IV të KQ të PPSH, ndodhen para detyrës që të nxjerrin mësimet e duhura nga posositë e Partisë se:

«Një rol shumë të madh më zhvillimin e drejtë të letërsisë e të arteve luan kritika letraro-artistike, zhvillimi i një debati serioz e shkencor për problemet themelore ideo-estetike. Por kritika jonë letraro-artistike nuk ka mbajtur kurdoherë qëndrime të qarta për këto probleme, ajo nuk ka zbuluar dhe goditur me kohë fenomenet negative, sidomos ndikimet formaliste e moderniste dhe në ndonjë rast është përpjekur t'u vejë edhe bazë teorike këtyre shfaqjeve të huaja. Në të njejtën kohë do theksuar se nuk ka ekzistuar gjithmonë edhe atmosfera e përshtatshme që kritika letraro-artistike të thotë lirshëm fjalën e saj»<sup>81</sup>).

Në këtë parashtrim të çështjes të térheqin vëmendjen katër momente kryesore:

Së pari, Partia i jep rëndësi shumë të madhe zhvillimit të kritikës, të studimeve historike e teorike për problemet e letërsisë e të artit dhe të mendimit estetik marksist-leninist, rrahjes shkencore të mendimeve për çështjet e krijimtarisë letrare e artistike. Dhe një pozitë e tillë është plotësisht e natyrshme, mbasi dhe në letërsi e në art, si në çdo fushë tjetër veprimtarie, nuk mund të çahet përpara, të stimulohet e të përkrahet e reja revolucionare dhe të zhduket ajo që është regresive ose që është vjetëruar, të vlerësohet drejt e kaluara dhe të çelen perspektivat për të ardhmen, të vlerësohen anët pozitive e të qortohen të metat e dobësítë pa luftë mendimesh dhe pa kritikë, aq më tepër, se në letërsi e në art,

81) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 32.

sic dihet mendimi, pëlgimet dhe prirjet individuale luajnë një rol të dukshëm. Për «zhvillimin e drejtë të letërsisë e të arteve» shkrimtarët dhe artistët kanë në dorë veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, orientimet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver, krahas mendimit më të përparuar botëror për artin e për letërsinë, po si një konkretizm të tyre, zbatim në vijim të orientimeve, zbërthim konkret të problemeve dhe përgjithsim të përvojës që grumbullohet, kritika letrare e artistike ka qenë dhe mbetet një pjesë e domosdoshme, me rëndësi, delikate dhe jo pa telashe gjithfarëshe e punës së përgjithshme në frontin e letërsisë e të arteve.

Së dyti, duke njobur këtë rëndësi si dhe arritjet e deritanishme në fushën e kritikës, të studimeve e të mendimit estetik, Partia ve theksin në dobësitet që vihen re akoma në këtë fushë, në punën e paktë që është bërë për trajtimin me kohë, me guxim e me seriozitet shkencor të problemeve që ka nxjerrë zhvillimi i letërsisë e i arteve, për përgjithësimin e përvojës krijuar të dhjetëra shkrimtarëve e artistëve të talentuar të realizmit socialist, për të kritikuar me kohë shfaqjet negative në krijimtari dhe për të zhvilluar me konsekuençë e pandërrerje luftën ideoestetike si kundër rutinës e konservatorizmit, ashtu edhe kundër modernizmit e liberalizmit, ndikime të të cilëve ka patur dhe nuk përjashtohet rasti që të ketë dhe në të ardhmen. Në këtë mënyrë rëndësia e kritikës lidhet ngusht me përgjegjësinë shoqërore të saj për zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë e të arteve.

Së terti, krahas dobësive dhe mefshtësisë, që është vënë re në kritikë, disa herë ajo ka bërë edhe punën e kundërt, duke u përpjekur t'u vërë bazë teorike shfaqjeve të huaja, me teorizime, që binin në kundërshtim të hapur me parimet e artit të realizmit socialist, me orientimet e Partisë në këtë fushë dhe me vetë pjesën kryesore të shëndoshë të krijimtarisë së shkrimtarëve e të artistëve tanë. Kështu kritika jo vetëm nuk ka luftuar sa e si duhet kundër shfaqjeve të huaja për realizmin

socialist, po në rastet më të këqija, është bërë edhe mbësh-tetje për to.

Së katërti, duke njojur këto dobësi e të meta, kra-has bosllëqeve në formimin ideologjik dhe estetik të një pjese prej atyre që filluan të merren me kritikë, si shkak tjetër objektiv Partia njeh edhe atmosferën jo të përshtatshme që u krijua për një kohë për zhvillimin e kritikës, mungesën e kushteve që ajo ta thoshte kurdo-herë me guxim e në kohë fjalën e saj. Një dëm shumë serioz solli në këtë drejtim me teorizimet dhe me qëndrimet e veta armiqësore Fadil Paçrami, i cili luftoi që ta orientonte edhe kritikën në hullitë e pikëpamjeve të tij të çoroditura antisocialiste. Prandaj, për një kohë, në gazeten «Drita» e në revistën «Nëntori», ndërsa u jepet vend gjerësisht teorizimeve moderniste, disa herë shumë konfuze e të pakuptueshme edhe prej vetë atyre që i shkruanin, gjithnjë e më vështirë bëhej të shfaqeshin mendime që nuk i pëlqenin Fadil Paçramit e «disa pak të tjerëve», që notonin në ujërat e ndikimeve borgjeze e revizioniste.

Duke njojur realisht rëndësinë, gjendjen dhe detyrat e kritikës letrare e artistike, Partia më se një herë ka folur për cilësitë që duhet të karakterizojnë atë, për shfa-qjet negative që janë venë re dhe për shkaqet e tyre, për kriteret shkencore marksiste-leniniste të vlerësimit, përbazat ideologjike, estetike dhe etike të kritikës dhe për shumë probleme të tjera që lidhen me të. Rëndësi të posaçme në këto drejtime ka sidomos fjalimi i mbajtur prej shokut Enver në Konferencën XVII të organizatës së Partisë të Tiranës (1968) dhe raporti i mbajtur prej tij në Plenumin IV të KQ të PPSH.

«Ne, — thekson shoku Enver, — kemi nevojë për një kritikë shkencore e të kualifikuar, e cila ka brenda edhe patosin e domosdoshëm revolucionar, aq të nevoj-shëm për zbulimin e vlerave të shquara të letërsisë e të artit, edhe frysmin e papajtueshmërisë me asnje shtrembërim, me asnje shfaqje të huaj në zhvillimin e tyre. Ne kemi nevojë për një kritikë të atillë, e cila ta thotë me

guxim e me kompetencë fjalën e vet për çdo fenomen letrar e artistik»<sup>82)</sup>

Cilat janë, sipas orientimeve të Partisë, disa prej kërkuesave kryesore për të patur një kritikë të tillë?

## 2.

Kërkesa e parë për të pasur një kritikë revolucionare marksiste-leniniste, është që ajo të jetë e orientuar drejtë ideologjikisht e politikisht, të jetë e mbështetur plotësisht në botëkuptimin materialist dialektik dhe të luftojë me vendosmëri, që përmes krijimtarisë letrare e artistike, në vetë zhvillimin e letërsisë e të arteve dhe në qëndrimet ndaj problemeve dhe veprave të veçanta, të zbatohet pa asnjë të çarë vija e përgjithshme e Partisë dhe orientimet e saj për artin e letërsinë.

Është bërë më se e qartë me kohë për këdo se letërsia dhe artet kanë qenë e mbeten një terren me rëndësi i shfaqjes së kontradiktave klasore dhe i luftës së klasave, një fushë lufte në të cilën ndeshen dhe jo vetëm ndeshen po edhe pleksen botëkuptime, ideologji, pikëpamje etike dhe estetike dhe rryma artistike nga më të ndryshmet e nga më të kundërtat. Vetë letërsia dhe artet janë zhvilluar e zhvillohen përmes një lufte të vazhduese-shme klasore, që merr disa herë forma specifike e «origjinale», që rrjedhin nga vetë natyra e artit, po në thelb është po ajo luftë klasash që zhvillohet kudo e veçanërisht në frontin ideologjik, që u nënshtrohet po atyre ligjeve objektive të luftës të së resë kundër së vjetrës, të shkatërrimit të së vjetrës dhe krijimit të së resë, të zhvillimit e të lartësimit të saj të pandërprerë. Prandaj letërsia dhe artet kanë qenë gjithnjë pjesë e revolucioneve dhe e kundërrevolucioneve ideologjike dhe janë përdorur e përdoren si mjete të efektshme të mobilizimit

82) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 32.

politik revolucionar ose të çoroditjes kundërrevolucionare të njerëzve. Historia e përpjekjeve për restaurimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera të Evropës Lindore ka dhënë një material shumë të pasur që e provon plotësisht këtë të vërtetë. Një material të pasur me vlerë jep edhe përvaja e përdorimit të letërsisë e të artit për mobilizimin revolucionar të masave gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe në periudhën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Kritika letrare e artistike nuk mund të mos i mbajë parasysh këto të vërteta e nuk mund të mos niset gjithnjë e për çdo rast nga porosia revolucionare që të kapet në radhë të parë pas orientimit dhe përbajtjes ideopolitike të krijimtarisë,<sup>83)</sup> mbasi «mbajtja qëndrim në letërsi dhe në art eshtë pjesë e luftës politike që bën Partia jonë marksiste-leniniste në unitet të plotë mendimi dhe veprimi me popullin e vet»<sup>84)</sup>

Këto lidhje të krijimtarisë me ideologjinë, me politikën dhe me luftën e klasave duke u nisur prej orientimeve të Partisë, kritika letrare e artistike e realizmit socialist i shikon të paktën në katër aspekte kryesore.

Së pari, në brendinë e veprave letrare e artistike, në faktin se c'pasqyrohet në to, c'anë me rëndësi të realitetit kanë tërhequr vëmendjen e shkrimtarit e të artistit, nga c'pozita klasore i ka trajtuar ai kontradiktat e konfliktet që ka vënë në themel të veprës, c'ideale u transmeton artdashësve dhe c'perspektiva gel para tyre, në shijet e në pikëpamjet e në c'kategori shoqërore eshtë mbështetur; me një fjalë kujt i shërben. Kjo eshtë analyesore e çështjes që ka të bëjë me funksionin shoqëror të letërsisë e të arteve. As që mund të përfytyrohet një kritikë revolucionare po të dobësohej interesimi për «përbajtjen ideopolitike të krijimtarisë», për hir të vlerave stilistike e gjuhësore, të figurave të bujshme «originale» apo të «profilit individual» të autorëve, siç filloj të merrte rrugë një prirje në kritikën tonë, si rezultat i ndikimeve

83) Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së, f. 137.

84) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1965-1966), f. 149.

borgjeze e revisioniste. Të gjitha këto kanë rëndësi vetëm në qoftë se shihen në funksion të brendisë që transmetojnë, ndryshe kritika do të shkasë në pozita formaliste dhe do të bëhet mbështetje për shfaqjen e ndikimeve të huaja moderniste në letërsi e në art.

«Një vepër, — thekson shoku Enver, — duhet të ketë thelbin e vet në rrugë të drejtë politike, ideologjike, morale dhe të paraqesë realist gjendjen, anët e përgjithshme e tipike të saj. Veprat, në radhë të parë, duhet t'i frymëzojë lexuesit. Forca dhe intensiteti me të cilët do ta bëjë ajo këtë varet nga thellësia e brendisë ideologjike dhe e formave, stilit, figurave, ngjyrave, etj., që përdor autorit». <sup>85)</sup>

Së dyti, një kritikë konsekiente revolucionare edhe vetë procesin e zhvillimit të letërsisë e të arteve në të gjitha aspektet e tij me rëndësi, e studion në raport me jetën shoqërore, me ideologjinë e me politikën dhe e vendos në terrenin e luftës së klasave në etapat e ndryshme historike, e udhëhequr prej parimit të njojur se të gjitha luftat letrare, në fund të fundit, kanë qenë dhe janë lufta ideologjike e politike. Një kërkesë e tillë mbështetet në faktin se të gjitha konceptet, shijet dhe praktikat estetike e artistike kanë bazë dhe prejardhje shoqërore klasore, përbajtje filozofike. Si në të kaluarën edhe në kohën tonë çdo rrymë a shkollë artistike ka qenë dhe eshtë e lidhur me një rrymë a shkollë filozofike dhe, me që në fazën e fundit të shoqërisë kapitaliste për të luttuar kundër marksizëm-leninizmit, vihet re tendencia e lindjes së shkollave e të shkollëzave të panumërtë filozofike reaksionare, siç ka vërejtur Lenini, edhe në art e në letërsi, për të kryer të njëjtën punë, lindin vazhdimi shkolla e shkollëza» estetike e artistike reaksionare, dekadente e formaliste, që përfaqësojnë degjenerimin borgjez. Rrezikshmëria e këtyre tendencave moderniste, që disa herë marrin edhe poza të së majtës eks-

85) Enver Hoxha: Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë f. 21.

treme, është shumë e madhe, e para, se kanë një natyrë artistike antirealistë në format dhe në teknikat që përdorin për pasqyrimin e transfiguruar të realitetit dhe, e dyta, se nëpërmjet paraqitjes disa herë të «ndritur» artistike transmetojnë pa u kuptuar një brendi shoqërisht të dëmshme, përhapin një mënyrë të shikuari të jetës, që shpie në largim prej të vërtetës historike. Kjo është rruga më e rafinuar nëpër të cilën kanë depërtuar e mund të depërtojnë ndikimet borgjeze e revisioniste edhe në letërsinë e në artin tonë, gjersa u arrit në ndonjë rast të kërkohet edhe përdorimi i «teknikave moderniste» në dobi të realizmit socialist. Po kuptohet se nga një krushqi e tillë vetëm vepra të realizmit socialist nuk mund të lindin. Do të lindin vetëm vepra si tabloja «*Epika e yjeve të mëngjesit*», në të cilën ndikimet e theksuara të kubizmit kanë shpënë në shtrëmbërim flagrant të figurës së partizanëve, të lidhjeve të tyre me popullin, bile, edhe të vetë natyrës. Kjo vepër është ndër shembullat më të qarta se si prej formave artistike mund të kalohet në një brendi ideoemocionale krejt të huaj për fryshten revolucionare të realizmit socialist. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për disa tregime, vjersha e drama, në të cilat kanë qënë të dukshme ndikimet e simbolizmit, që kanë sjellë me vete edhe këshime në dobi të ekzistencializmit e të froidizmit, me të cilat është lidhur aktualisht kjo shkollë artistike. Të gjitha këto forcojnë bindjen se konsolidimi i pozitave artistike të realizmit socialist, nuk është një çështje thjesht «profesionale» shkrimitarësh e artistësh, po është një çështje e madhe shoqërore me karakter të mprehtë ideologjik e politik.

Së treti, këto kriterë të përgjithshme do të mbeteshin pa jetë në qoftë se në kritikën letrare e artistike nuk do të zbatoheshin në çdo rast konkret, në studimin e krijimtarisë së shkrimitarëve e artistëve të veçantë dhe në analizën e veprave të letërsisë e të arteve të së kaluarës e të kohës sonë kombëtare ose të huaja. Ndryshtë kritika dhe qëndrimet tonë ndaj letërsisë dhe arteve do të karakterizoheshin nga inkosekuanca ideologjike dhe artis-

rike, që do të sillnin dëme serioze, mbasi do të mbanin të çelura shtigjet e çoroditjeve ideoartistike, nën pretekste metafizike të qëndrimit ndaj «klasikëve» dhe ndaj «talenteve të shquara». Nga ana tjetër, do mbajtur parasysh se parimet e përgjithshme ideoartistike ekzistojnë, përpunohen e pasurohen nëpërmjet krijimtarisë konkrete të shkrimitarëve e të artistëve të ndryshëm, të cilët kanë individualitetin dhe pëlqimet e tyre dhe ky individualitet, veçanërisht në art, duhet të respektohet plotësisht e të çmohet si vlerë pozitive, sa herë që nuk bie në kundërshtim me shijet, idetë dhe idealet ideoestetike të shqërisë socialiste në zhvillim. Në studimin e krijimtarisë së autorëve të ndryshëm dhe në analizën e veprave të veçanta do të shfaqet në dinamikën e vet lufta e njëkohshme e kritikës si kundër modernizmit, ashtu edhe kundër konservatorizmit, për të realizuar porosinë e Partisë që ta pastrojmë letërsinë dhe artin nga çdo trashëgim i vjetër negativ dhe nga çdo ndikim i ri borgjez e revisionist.

«*Kritika jone letraro-artistike*, — porosit shoku Enver, — duhet të fryshtohet dhe të ndjekë rrugën parimore të klasikëve të mëdhenj dhe të Partisë sonë. Kritikët tanë të janë realistë ashtu siç janë veprat që analizojnë, të janë të thjeshtë, të kuptueshëm, konçizë dhe të kapshëm nga publiku. Kritika duhet të jetë edukuese, prandaj ai që bën atë nuk duhet ta quaj veten sikur flet nga «*maja e Olimpit*», por ta konsiderojë autorin e një vepre si shok që i flet shokut për ta këshilluar kurdoherë për të mirë». <sup>86)</sup>

Së katërti, vetë zhvillimi i debateve për problemet e letërsisë e të arteve dhë të kritikës e të mendimit estetik është një fushë e hapur në të cilën kanë fryshtë dhe fryshtë erërat e luftës së klasave, janë përplasur e përplasen ideologjite dhe rrymat e ndryshme politike, janë ndeshur e ndeshen konceptet dhe shijet e ndryshme ideoestetike klasore. Prandaj është e domosdoshme që kritika, duke u mbështetur fort në botëkuptimin materialist dia-

86) Enver Hoxha: Shkrimitarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë f. 22-23.

lektik dhe në parimet e estetikës marksiste-leniniste, të luftojë edhe në terrenin e vet çdo shfaqje të ndikimeve konservatore ose moderniste, të forcojë përmbajtjen e saj të partishme dhe të ngrerë vazhdimisht nivelin shkençor. Vetëm në këtë mënyrë ajo do të bëhet mbështetje e zhvillimit të letërsisë e të arteve në rrugën e realizmit socialist, do të luftojë aktivisht kundër çdo shtrëmbërimi të parimeve dhe çdo shfaqje të huaj borgjeze e revizioniste dhe do ta thotë fjalën e vet më me kompetencë e më me guxim për të gjitha problemet që shtron e do të shtrojë ecja përpëra e letërsisë dhe e arteve.

Në të katër aspektet që përmendëm kritika do të ketë karakter të partishëm komunist në qoftë se do të jetë e lidhur me problemet e mëdha të kohës dhe do të pëershkohet jo nga preokupime «estetizantësh», po nga shqetësimi i vazhdueshëm përfatet e Atdheut e të socialistëve. Vetëm një kritikë e tillë me frymë të gjërë, të thellë e të shëndoshë shoqërore, që nëpërmjet analizës së krijimtarisë artistike përhap në masa idetë mobilizuese të revolucionit dhe ndikon në kultivimin e atyre cilësive pozitive për të cilat luftojnë shkrimitarët e artistët e realizmit socialist, do të jetë në gjendje të çmojë drejt edhe vlerat e formës artistike të veprave, individualitetet krijuarës së artistëve dhe kontributin e veçantë që sjell se cili prej tyre në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të artit të realizmit socialist. Një kritikë që niset vetëm prej librave dhe prej traktateve të vjetra e të reja estetike, që ka si preokupim kryesor ç'ka thënë ky ose ai estet dhe lakmon t'i reklamojë thëniet e tyre, disa herë edhe në mënyrë eklektike, ka rezik të shkëputet nga jeta, të heqë dorë prej idealeve të mëdha shoqërore dhe të kthehet në koment stilistik veprash. Kritika janë, duke u mbështetur në gjithë traditën pozitive të së kaluarës nuk e humbet currë fillin marksist-leninist dhe sheh si domosdoshmëri të përsosjes së vet njohjen dhe përvetësimin e shijeve e të idealeve ideoestetike të popullit, që janë mbështetja më e gjërë përfundim kryimtar. Ndryshe në kritikë dhe në studimet letrare e artistike do të pasqyrohen «pikëpamjet filozofike të shkollave borgjeze,

simpatitë individuale të njërit ose të tjeterit, sipas prirjes dhe sipas shkollës dhe kulturës me të cilën ai është mbrujtur dhe që nuk ka arritur dot akoma të spastrojë rrënjenjësisht «haurët e Avgjisë». Të gjitha këto ide dhe pikëpamje të papastruara mirë, këto simpatira ose pasione për një autor të vendit ose të huaj në erudicionin e tij, të ngarkuar dhe të pakthjellë, i trasmeton në shkollë ose në jetë nëpërmjet dhënies së mësimeve, leksioneve, konferencave, artikujve dhe librave që ai bën».<sup>87)</sup> Një kritikë e tillë çorienton jo vetëm krijimtarinë letrare e artistike, po ndikon shumë keq edhe në edukimin ideoestetik të masave.

Krahas lidhjeve me problemet e mëdha të kohës dhe njohjes konkrete të realitetit në zhvillim revolucionar, kritika e realizmit socialist as që mund të ekzistojë, pa njohjen mirë, në teori e në praktikë të filozofisë marksiste-leniniste, të botëkuptimit materialist dialektik, që përmban ligjet më të përgjithshme të zhvillimit objektiv të natyrës e të shoqërisë, pra, edhe të letërsisë e të arteve si fenomene shoqërore që janë. Kjo, aq më tepër, është një domosdoshmëri e kohës sonë kur «pa argumenta filozofike të shëndosha as shkencat natyrore, as materializmi nuk janë në gjendje t'u bëjnë ballë presionit të ideve borgjeze dhe rimëkëmbjes së botëkuptimit borgjez». Duke u nisur nga kjo ide e Leninit, shoku Enver ka porositur që «Shkençtarët tanë të socialistët duhet të mësojnë me durim dhe të jenë përkrahësit më të zjarrtë të filozofisë marksiste, me një fjalë, duhet të jenë materialistë dialektikë»<sup>88)</sup>

Çështja këtu nuk është vetëm në njohjen e ligjeve të realizmit dialektik e historik, as të parimeve themelore të estetikës marksiste-leniniste, po në përdorimin e metodës dialektike e të parimeve si busull në studimin e problemeve të letërsisë e të arteve, si armë përfundim kundër presionit të ideve borgjeze e revizioniste.

Këtë del detyra e partishme që «Kritika, si dhe letërsia e gjithë arti ynë, duhet të udhëhiqen kurdoherë nga

87) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968), f. 367-368.

88) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968), f. 360.

parimet e metodës së realizmit socialist, të cilat kanë lindur nga përvoja botërore e artit revolucionar të proletariatit, janë përpunuar nga estetika marksiste-leniniste dhe janë konfirmuar edhe nga praktika letrare e artistike e vendit tonë. Këto parime janë të patundshme dhe besnikëria ndaj tyre është e domosdoshme, sepse ndryshe biem në ndikime të huaja dhe largohemi nga traditat revolucionare. Novatorizmi nuk ka të bëjë me shkeljen e parimeve, por me zbatimin e tyre të drejtë»<sup>89)</sup>

Parimet e realizmit socialist janë mishërim në letërsi e në art i vetë marksizëm-leninizmit dhe i orientimeve të PPSH, prandaj besnikëria ndaj tyre dhe lufta për t'i mbrojtur prej presionit të teorizimeve borgjeze e revizioniste, është konkretizim në letërsi e në art i besnikërisë ndaj marksizëm-leninizmit, luftë për ta mbrojtur atë prej sulmeve të shfrenuara të të gjitha varieteteve të filozofisë e të estetikës së sotme borgjeze e revizioniste. Në këtë mënyrë ndeshjet në fushën e letërsisë e të arteve inkluadohen në luftën e përgjithshme ideologjike e politike dhe u nënshtrohen ligjeve të saj, si një pjesë aktive me rëndësi në përpjekjet që bëhen nga klasat dhe forcat e ndryshme politike për të fituar mendjet dhe zemrat e njerëzve.

### 3.

Partishmëria komuniste presupozon dhe kërkon një nivel të lartë shkencor të kritikës, të studimeve historike e teorike për artin dhe të mendimit estetik. Pasioni politik revolucionar dhe tendencioziteti i hapur klasor i tyre, aq të domosdoshme për t'i dhënë kritikës një frymë të përherëshme aktive luftarakë, nuk janë rezultat i dëshirave subjektive, po i njojjes së thellë shkencore të realitetit dhe të problemeve letrare e artistike, i njojjes së thellë të natyrës objektive dhe të kushtëzimit shoqëror, të originës së specifikës së krijimtarisë artistike, të ligjeve të zhvillimit historik, të objektivitetit të kategorive estetike të illojeve të artit e të formave të ndryshme artistike, të raporteve dialektike të përbajtjes e të formës dhe të shumë problemeve me rëndësi historike, teorike e praktike, që dalin prej zhvillimit të sotëm letrar e artistik. Prandaj Partia ka synuar kurdoherë që të kemi një kritikë «shkencore e të kualifikuar» dhe i jep rëndësi të dorës së parë zgjerimit të «punës kërkimore-shkencore në lëmin e teorisë e të historisë së letërsisë e të arteve, të estetikës, duke forcuar bërthamat ekzistuese si dhe duke krijuar bërthama të reja» dhe për «pregatitjen sistematike të kuadrove të rinj shkencor për estetikë, teori - histori të letërsisë e të arteve, kritikë letrare e artistike»<sup>90)</sup>

Por, për rritjen e mëtejshme të nivelit shkencor të kritikës krahas krijimit të kushteve të domosdoshme për një gjë të tillë, rëndësi të madhe ka pasur e vazhdon të ketë edhe clirim i saj prej disa dobësive e të metave të karakterit subjektiv, që e kanë penguar deri tanë të thotë «me kompetencë e me guxim fjalën e vet për çdo fenomen letrar e artistik».

Subjektivizmi ka qënë një prej sëmundjeve më të rënda e më të përhapura në kritikë dhe me të kanë qënë të lidhura shumë nga shtrembërimet e historisë së letërsisë e të arteve e të parimeve të realizmit socialist, teorizimet moderniste për traditën e novatorizmin dhe vlerësimet jashtë kritereve objektive shkencore marksiste-leniniste të krijimeve e të fenomeneve të ndryshme letrare e artistike.

Dihet që subjektivizmi është një mënyrë idealiste e të menduarit e të vlerësuarit të botës e të fenomeneve që lidhet hapur ose pa u ndier me një metodë idealiste të shqyrtimit të problemeve, ka për bazë shoqërore individualizmin borgjez, mbështetet në rolin e «individëve të shquar» dhe shpie në ngjalljen e në përkrahjen e anarqisë si kudo, edhe në letërsi e në art. Në kritikën tonë, si dhe në krijimtarinë letrare e artistike, shfaqjet e subjektivizmit nuk mund të merren të shkëputura prej trashëgime-

89) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 33.

90) Po aty, f. 32-33.

ve negative të së kaluarës dhe origjinës klasore të njerëzve, prej boshllëqeve në formimin e tyre ideologjik e ideoestetik, prej kufizimeve në njohjen e parimeve e të materialit konkret letrar e artistik, prej ndikimeve të sotme borgjeze e revizioniste si dhe prej disa ceneve etike, që kanë shpënë në mbivlerësimë tendencioze të njerit apo të tjetrit, duke ngjallur pasionet e sëmura për të ngritur e për të rrëzuar «idhuj». Kjo sëmundje, po të zhvishet prej mbulesave që i hidhen përsipër, mohon kriteret objektive të vlerësimit artistik dhe ligjshmërisë objektive të zhvillimit dhe i zëvendëson ato me pikëpamjet subjektive të njerit ose të tjetrit, me dëshirat e me pëlgjimet personale, që shpesh bien në kundërshtim me vlerën ose me dobësitë e vërteta të veprave.

Kritika e realizmit socialist, si shkencë, nuk mund të mbëshqetet në shijet, në formimin dhe në pëlgjimet personale të kritikëve. Ajo i gjykon veprat dhe krijimtarinë letrare e artistike në bazë të disa kritereve të përgjithshme objektive, sipas dobisë ose démit që i sjellin ato edukimit ideoestetik të njerëzve, sipas raporteve që kanë me kohën dhe me prirjet revolucionare të zhvillimit, sipas vlerave artistike, që janë konkretizime të fuqisë përgjithësuese e realizuese të talenteve, të mjeshtërisë së tyre etj. Vlerësimi i krijimtarisë, i personaliteteve, i periudhave të zhvillimit e i veprave të veçanta bëhet, gjithashtu, në raport me kushtet historike, në raport me ato q'kanë sjellë të re ato të krahasuara me letërsinë dhe me artin e mëparshëm.

Cilat kanë qënë disa prej shfaqjeve kryesore të subjektivizmit, në kritikën dhe në studimet tona për letërsinë dhe artin?

Një prej shfaqjeve më flagrante të subjektivizmit ka qënë trajtimi i problemit të novatorizmit të realizmit socialist, jo si një karakteristikë që përbahet në vetë natyrën e metodës krijuese, po si rezultat i eksperimentimeve të shkrimitarëve e të artistëve të veçantë, sidomos të shkrimitarëve e të artistëve të rindës. Në një tezë të tillë subjektiviste ngulte këmbë për shumë kohë në mënyrë metafizike Fadil Paçrami, i cili, teorikisht i shkëpuste kér-

kimet në letërsi e në art nga çdo kriter i shëndoshë ideoartistik, duke lakuar me snobizëm tu përngjante sa më tepër kushérinje të tij modernistë, kurse në praktikë, i nisur nga të njëjtat pozita fabrikonte drama pa vlerë, që atij i ndonjë tjetri që i vinte në skenë, u ngjanin kryevepratë fjalës së fundit. Kjo pozitë, që u reflektua dhe në frymën tendencioze subjektiviste të një pjese të kritikës, ishte pasojë pikërisht e mohimit të ligjshmërisë objektive dhe të rolit të masave në letërsi e në art, e injorimit të primariitetit të përbajtjes në novatorizmin e realizmit socialist dhe mbivlerësimit të kërkimeve dhe arritjeve individuale, edhe kur këto nuk ishin veçse shfaqje të hapura të ndikimeve moderniste ose përpjekje të lajthitura për të shartuar realizmin socialist me rrymat dekadente e formaliste. Duke njojur rrezikshmërinë e këtyre pozitave subjektiviste, Partia ndërhyri në kohë për sqarimin e çështjes dhe e vuri theksin në karakterin objektiv dhe masiv të novatorizmit të realizmit socialist, pa mohuar në këtë rast kontributin e shkrimitarëve e të artistëve të veçantë, as të drejtën e tyre për të kërkuar forma të reja realiste për pasqyrimin me besnikëri të realitetit në zhvillim revolucionar.

Subjektivizmi në trajtimin e çështjes së novatorizmit, siç u provua vitet e fundit, përbante rrezikun e krijimit të grupimeve e të «klaneve» në letërsi e në art, duke sajuar ndarje artificiale brezash e duke u ngjitur krijuesve etiketën e «novatorit» e të «tradicionalistit», të «eksperimentuesit të guximshëm» e të «konservatorit», jo sipas vlerave e dobesive të vërteta të tij, po sipas predispozitive subjektive të një kritiku a të një tjetri. Një praktikë e tillë krijoi konfuzion edhe në koncepte, mbasi shpesh u kalua deri në teorizime absurde për të gjetur novatorizëm dhe atje ku nuk kishte dhe për të bërë përgjithësimë, që i çelin rrugën rrymave moderniste në art, duke arritur deri në absurditetin se gjoja letërsia dhe arti ynë i vërtetë novator filloj vetëm pas viteve 60, me daljen e një apo të disa shkrimitarëve e artistëve të rindës. Kjo pozitë antihistorike e metafizike e marrë nga një qëndrim subjektivist flagrant, ishte një përpjekje tjetër e rrezikshme për mohimin e realizmit socialist, të vlerave të krijuara në çdo kohë

prej shkrimtarëve e artistëve tanë, ishte një kundërvënie jashtë çdo logjike e dy periudhave të afërta të zhvillimit të të njejtë art. Në këtë mënyrë, nga një anë janë mohuar sukseset e arritura prej letërsisë dhe prej arteve që nga Lufta Nacionalçlirimtare e këtej dhe, nga ana tjetër, «janë përligjur edhe ato krijime formaliste e moderniste në poezi, në muzikën e lehtë, në pikture, në regjizurë, në skenografi etj», të cilave, jashtë çdo kriteri të shëndoshë, u ngjitej etiketa e veprave «novatore».

Duke bërë fjalë për këtë shfaqje të subjektivizmit modernist dhe për vlerat reale të letërsisë e të arteve të realizmit socialist shoku Enver thotë se përballë tyre «nuk mund të mos pranojmë se kritika dhe shkenca janë letraros-artistike janë borxhli ndaj përgjithësimit të kësaj përvoste të re të kulturës artistike socialiste, të këtyre sukseseve e traditave të reja të fuqishme të letërsisë e të artit të realizmit socialist», duke theksuar që «mëngjanimi i boshllëqeve dhe i nënveftësimeve në këtë fushë është edhe një mjet për t'i myllur shtigjet përhapjes së ndikimeve dhe imitimeve të huaja»<sup>91)</sup>.

Krahas mohimit modernist të traditës së re, në kritikën tonë ka pasur vend edhe tendenca e kundërt e një subjektivizmi nga pozita konservatore, që u duk sidomos në fillim të viteve '60 dhe karakterizohej nga mbivlerësimi i rezultateve të arritura, nga absolutizimi i disa formave të njohura krijimi dhe nga shikimi me skepticizëm i çdo gjëje të re që sillej në letërsi. Kjo tendencë subjektiviste e shkëputse letërsinë dhe artin nga koha, u mohonte zhvillimin e perspektivën dhe, po të mos luftohej, do të shpinte në anakronizëm, në idealizëm të së kaluarës në dëm të së ardhmes së artit e të letërsisë realiste socialiste.

E lidhur me ato që u thanë dhe me mbivlerësimin e prirjeve e të pëlgjimeve personale ka qënë dhe ajo shfaqje subjektivizmi, sipas të cilës, krijimtaria letrare e artistike shihej nën prizmin e kërkësave të praktikave të veçanta dhe në përgjasim me veprat e një apo të disa pak autorëve

91) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, f. 25-26.

të preferuar, krijimet e të cilëve akoma pa u njohur mirëngriheshin kurdoherë në nivelin e modeleve të paqortueshme, pavarësisht prej dobësive e ndonjëherë, edhe prej rrëshqitjeve serioze ideoartistike. Me këtë metodë, arti çmohej dhe përcmohej sipas disa kritereve të përcaktuara subjektiviste, duke e shtyrë të gjithë krijimtarinë në hullitë e një uniformiteti modernist, që presupozonte domosdo mohimin e një pjesë të mirë të thesarit letrar e artistik të realizmit socialist e të individualiteteve krijuar, të cilët shpalleshin si pa të keq «tradicional» «konservatorë» etj. Është afër mendsh se edhe një praktikë e tillë një-anësore është e huaj për kritikën e realizmit socialist dhe bie në kundërshtim të hapur me parimin e njohur leninist, sipas të cilit në art duhet t'u lihet fushë e lirë të gjitha individualiteteve dhe prirjeve artistike realiste e të partishme.

«Nga shkrimtarët, nga poetët dhe nga artistët tanë ne duhet të kërkojmë që brendia, thelbi i veprës, të jetë në rrugë të drejtë partie dhe të nxitet nga një frymëzim i shëndoshë revolucionar, në shërbim të socializmit. Kjo është kryesorja që duhet të kenë parasysh autorët tanë në krijimtarinë e tyre. Pastaj se si do ta ndërtojë njeri ose tjetri temën që ka zgjedhur, personazhet, është puna e shkrimit, e poetit, e muzikant»<sup>92)</sup>

Së fundi, ka gjetur vend në veprimtarinë kritike dhe jashtë saj edhe një shfaqje tjetër subjektivizmi me prejardhje kryesishët etike, kur krijimtaria dhe vepra të vëcanta qmoheshin, jo sipas vlerave reale, po sipas simpative dhe antipative personale të shkrimtarëve, artistëve e kritikëve, që jashtë kritereve ideoestetike ngrinin në qill ose groposin vepra e autorë. Por, dihet mirë se «të fillosh kritikën vetëm duke u nisur nga dëshira jote individuale, nga konceptet e kompozimit të mundshëm, vetëm nga shijet dhe prirjet e tua, të cilat marrin forma të rrezikshme në rast se të ka mbuluar një ndjenjë mikrobor gjëze e mendjemadhësie për çdo punë që del nga dora

92) Enver Hoxha: Shkrimtarët dhe artistët tanë janë ndihmësit e Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë f. 23.

jote, atëherë kritika s'do të jetë objektive, mund të jetë fyese dhe dëmpruese».<sup>93)</sup>

Ngritja e nivelit shkencor të kritikës dhe sidomos formimi i ndjenjës së partishmërisë komuniste të saj janë ndër kushtet e para me rëndësi për të shkulur nga rrënjet shfaqjet e ndryshme të subjektivizmit dhe për të arritur që cdo vlerësim kritik dhe cdo debat për problemet e letërsisë e të arteve të pëershkohet nga interesimi i të gjithëve për lulëzimin e tyre të mëtejshëm, për forcimin e pozitave të realizmit socialist. Po nuk është ky i vetmi kusht për të luftuar me sukses e deri në fund kundër subjektivizmit, mbasi krahas tij, rëndësi të dorës së parë ka gjithashtu mbajtja parasysh dhe tërheqja e vazhdueshme e mendimit të masave për letërsinë dhe për artet, mbajtja gjallë përherë e bashkëbisedimit ndërmjet artisteve, kritikëve dhe popullit për problemet letrare e artistike, të cilat, duke qënë pjesë e atyre problemeve të mëdha të revolucionit ideologjik e kulturor që po zhvillohet në vendin tonë, s'ka si të mos ngjallin interes te masat punonjëse dhe të mos kërkojnë mendimin e tyre revolucionar.

«...Kritika letrare profesionale» shënon shoku Enver «nuk është i vetmi gjykues i veprimtarisë letraro-artistike. Mendimi i lexuesve, i publikut, i gjithë opinionit shoqëror, në fund të fundit, është gjykatësi më i drejtë i kësaj krijimtarie. Këtë të vërtetë duhet ta mbajnë kurdoherë parasysh si krijuesit, ashtu edhe kritikët»<sup>94)</sup>

Kjo do të thotë, së pari, që në veprimtarinë kritike e studimore si dhe në mendimet e shkrimtarëve e të artisteve për krijimtarinë e tyre të mbahen mirë parasysh shijet dhe kërkesat ideoestetike të masave punonjëse, aspiratat dhe interesat e tyre, mbasi «arti i takon popullit» dhe është e kuptueshme që, si në veprat artistike edhe në gjykimet për to, pozita e artisteve dhe e kritikëve do të jetë plotësisht e drejtë, vetëm në qoftë se do të nisemi prej popullit, do të njohim shijet e idealet e tij dhe do ta

93) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 481.

94) Enver Hoxha: Të thellojmë luftën kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre. f. 32.

shqyrtojmë cdo problem, cdo krijimtari e cdo vepër konkrete në raport me dobinë ose dëmin që i sjell ajo popullit, në lidhje të përhershme me luftën që bën Partia në unitet mendimi e veprimi me popullin e vet. Kështu do të ndodhë, siç ka ndodhur edhe deri tanë në të shumtën e herës që kritikët, sikurse shkrimtarët e artistët, të mos e «vetgjykojnë të përsosur krijimtarinë e tyre, në rast se në veprat e tyre nuk pasqyrohen, të ngritura në art, ndjenjat, shijet, mendimet, krijimtaria e masave»<sup>95).</sup>

Po nuk do të ishte e mjaftë, po të kërkohej vetëm që kritika profesionale të mbështetej në shijet e në idealet estetike popullore. Duke qënë një kërkesë e domosdoshme, kjo mbështetje duhet të plotësohet me vetë pjesëmarrjen aktive të masave punonjëse në gjykimin e problemeve të letërsisë e të arteve, që janë pronë e tyre, në përpjekjet e vazhdueshme, të ndërgjegjshme e të organizuara të artisteve e të kritikëve për të tërhequr mendimin e masave, për të dëgjuar me vëmendje zërin e tyre, për të mësuar gjithnjë, siç porosit shoku Enver, «nga mësuesi i madh dhe i pagabueshm popull». Në këtë drejtim bëhet një punë e mirë prej organizatave të masave dhe institucioneve kulturore e artistike, po nuk mund të thuhet se është arritur ajo që dëshirohet, mbasi akoma ka spontaneitet në këtë drejtim, bile edhe shfaqje të nënveftësimit nga pozita intelektualiste të mendimit të masave për letërsinë dhe artet. Vërejtjet e shumta që janë bërë nga masat për një pjesë të krijimtarisë e të kritikës si dhe demaskimi i spekulimeve që të paraqitej si mendim i masave opinioni i disa rretheve të parëndësishme shoqërore, kanë treguar se jo kurdoherë është mbajtur parasysh mendimi i vërtetë i masave. Partia, duke nxjerrë përfundimet e duhura prej zhvillimit të ngjarjeve, është mbështetur pikërisht në mendimin revolucionar të masave e të shumicës së shkrimtarëve e të artisteve dhe ka zbuluar falsitetin e atyre pretendimeve intelektualiste, që me mënyra sofistikë e bënin të zezën të bardhë dhe donin t'i shisnin popullit sa punin për djathë. Gjykimi i festivalit të njëmbëdhjetë të

95) Enver Hoxha: Raporte e fjalime (1967-1968), f. 487.

këngës në Radio-Televizion ishte një shembull shumë kuptimplot në këtë drejtim, që tregoi se kolektivat punëtore, të edukuara e të udhëhequra nga Partia, janë në gjendje të gjykojnë më me mprehtësi e nga pozita më revolucionare edhe për problemet e letërsisë e të artit.

Mbajtja parasysh e gjykimit kritik të masave, ka rënëdësi edhe për faktin se duke e njojur atë si gjykimin më të drejtë, me kohë bëhet seleksionimi i vëtë opinioneve të kritikës letrare e artistike, prej së cilës do të mbetet vetëm ajo që u qëndron provave dhe ka shprehur më besnikërisht shijet dhe idealet popullore.

## B I B L I O G R A F I

Për studimin e orientimeve kryesore të PPSH-së për letërsinë dhe artet, lexuesit kanë në dorë shumë botime me dokumente të rendësishme dhe me raporte e fjalime të shokut Enver dhe të udhëheqësve të tjerë të Partisë. Në këtë bibliografi të përbledhur, përtu ardhur në ndihmë atyre që interesohen posaçërisht për problemet e letërsisë dhe të arteve, po renditim materialet më me rendësi që kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij libri.

1. *Rezolucioni i Kongresit I të PKSH-së (PPSH — Dokumente kryesore, vëllimi I.)* Tiranë, 1960, f. 436-456.
2. *Vendim i KQ të PPSH-së «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve»* («Zëri i popullit» 1961, 4 qershor).
3. *Enver Hoxha: Raport në Kongresin I të PKSH-së* (Vepra, vëllimi i 5-të.) Tiranë, 1970 f. 417-438.
4. *Enver Hoxha: «Letërsia jonë të ecë në rrugën e realizmit socialist»* (Diskutim më mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së më 7 qershor 1949. Vepra, vëllimi i 6-të.) Tiranë, 1971 f. 188-194.
5. *Enver Hoxha: Këshilla për shkrimtarët e rinj — 23 qershor 1949* (Vepra, vëllimi i 6-të.) Tiranë, 1971 f. 207-211.
6. *Enver Hoxha: Fjala e mbajtur në Konferencën Kombëtare për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës në fshat*. Tiranë, 1959.
7. *Enver Hoxha: Raport në Kongresin IV të PPSH-së*, Tiranë, 1961 f. 68-69.
8. *Enver Hoxha: Fjala e mbajtur më mbledhjen e gjerë me shkrimtarët dhe artistët më 11 korrik 1961* (Gazeta «Drita» 1961, 6 gusht).
9. *Enver Hoxha: Fjala e mbajtur më takimin me përfaqësuesit e inteligjencës së kryeqytetit (25 tetor 1962)* Tiranë, 1962 f. 35-50.

10. Enver Hoxha: Mbi gjendjen ekonomike, sociale e kulturale të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj. Tiranë, 1963 f. 88-100.

11. Enver Hoxha: Përshtendetje me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Teatrit Popullor («Zëri i popullit» 1964, 31 maj).

12. Enver Hoxha: Fjala e mbylljes në Plenumin e KQ të PPSH-së «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve». Tiranë, 1964 f. 28-29.

13. Enver Hoxha: Fjala e mbajtur në Plenumin e 15-të të KQ të PPSH-së për letërsinë dhe artet (Raporte e fjalime 1965-1966) Tiranë, 1971 f. 132-166.

14. Enver Hoxha: Raport në Kongresin V të PPSH-së. Tiranë, 1966, f. 135-148.

15. Enver Hoxha: Idukimi ideologjik i kuadrove dhe i masave (Raporte e fjalime 1967-1968) Tiranë, 1969 f. 306-338.

16. Enver Hoxha: «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë» (Raporte e fjalime 1967-1968) Tiranë, 1969 f. 339-389.

17. Enver Hoxha: «Të zbatojmë me këmbëngulje e në mënyrë krijuese detyrat për revolucionarizimin e Partisë e të jetës së vendit» (Raporte e fjalime 1967-1968) Tiranë, 1969 f. 478-490.

18. Enver Hoxha: Raport në Kongresin VI të PPSH-së. Tiranë, 1971 f. 158-161.

19. Enver Hoxha: «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhë qëndrimeve liberale ndaj tyre». Tiranë, 1973 f. 5-41.

20. Enver Hoxha: Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë. Tiranë, 1975.

21. Mehmet Shehu: Mbi thellimin e luftës ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhë qëndrimeve liberale ndaj tyre në letërsi dhe arte. («Nëntori», 1974 Nr. 2).

22. Ramiz Alia: «Mbi disa çështje të letërsisë e të arteve» («Ruga e Partisë», 1961 Nr. 3).

23. Ramiz Alia: Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH-së «Mbi rritjen e rolit të letërsisë e të arteve për edukimin komunist të masave» mbajtur në Plenumin e 15-të të KQ të PPSH-së. Tiranë, 1965.

24. Ramiz Alia: «Mbi detyrat themelore që rrjedhin nga Kongresi VI i PPSH-së («Nëntori», 1972 Nr. 3).

25. Ramiz Alia: «Mbi zhvillimin e debatit për letërsinë dhe artet» («Nëntori», 1972 Nr. 8).

2651,890

1789,860

41441450

850000

5291450 ✓

13450

3500

5308406

444xx5

529xx5222549

26855310815800

3x0333300

313x82

620251